

BISMIL'LAHI'R-RAHMANI'R-RAHIM

FSHEHTËSITË E NAMAZIT

Imam Gazali

Prishtinë 2018

Ihja *Ulumid-din*
Ringjallja e diturive fetare
Imam Gazali

Titulli i origjinalit:
KITABU ESRARI'S-SALAT VE MUHIMMATIHI
LIBRI 4

Përgatiti dhe përktheu
Is'hak Shala dhe Abdullah B. Ferizi

Lektor:
Shenaj Zeneli

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

PARATHËNIE

Falënderim (*hamd*) i takon vetëm Allahut Teala, i Cili i mëshiroi të gjithë robët e Tij dhe i ndriçoi zemrat e tyre duke i mbushë ato me nurin e fesë dhe të obligimeve të saj.

Ai, i Vetmi, që posedon lartësinë dhe madhështinë e vërtetë, vepron ndryshe nga sunduesit në këtë botë, duke lëshuar përmes gradave të mëshirës nga froni i Tij i lartësuar deri te qielli më i ulët një nga manifestimet e mirësisë së Tij, dhe i nxitë njerëzit të kërkojnë dhe të bëjnë dua, duke thënë:

“A ka dikush që më bën dua Mua e Unë t’i përgjigjem? A ka dikush që më kërkon falje Mua, e Unë t’a fali?”

Ai vepron ndryshe nga sulltanët e kësaj bote; Ai i hapë dyert dhe e ngritë perden, prandaj ju mundësoi njerëzve që përmes namazit të flasin intimisht me të, varësisht gjendjes së tyre, me xhemat apo të vetëm. Bile, Allahu Teala inkurajon e fton me mirësi, e sundimtarët tjerë pranojnë takim vetëm nëse më herët i jepet dhuratë apo rryshfet.

Lavdi Allahut, Ai është i Plotfuqishëm, i Madhërishëm, Mëshirues e Mëshirëbërës për të gjithë robët të Tij; dhe salavat të singertë peygamberit të Tij të zgjedhur - Muhammedit a.s., çelës i udhëzimit dhe dritë në errësirë, si edhe familjës dhe as'habëve të tij.

Pas kësaj them:

Namazi vërtetë është shtylla e fesë, themel i bindjes së fortë, kulm i afrimit dhe ibadeteve.

Për rregullat kryesore dhe të tjerat që ndërlidhen me namazin, nga aspekti juridik (*fikh*), kemi folë në detaje në veprat për medh'hebet: *el-Besit*, *el-Vesit* dhe *el-Vexhid*, duke fokusuar vëmendjen në ndasitë e rralla dhe rastet e jashtëzakonshme të namazi, që të jetë i përshtatshëm për myftinë e t'i jetë burim me të cilin do të ndihmohet dhe të i cili gjithmonë do të kthehet.

Në këtë pjesë do të mjaftohemi me veprimet e jashtme dhe fshehtësitë e brendshme të namazit, që janë të domosdoshme për udhëtarin e ahiretit, duke zbuluar hollësitë dhe kuptimet e fshehta të përlules ndaj Allahut (*hushu*), singëritetit (*ihlas*) dhe qëllimit (*nijet*) që zakonisht nuk përmendet në veprat e fikhut.

Kapitulli i parë

RRETH VLERAVE TË LARTA (FAZILET) TË EZANIT,
NAMAZIT, SEXHDES, XHEMATIT DHE PJSËVE TJERA

VLERAT E LARTA (FAZILET) TË EZANIT

Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Tre persona në ditën e Gjykimit do të ulen mbi një kodër aromatike, nuk do të frikësohen nga llogaridhënia, as nuk do të ndjejnë kurrfarë frike deri sa të kryhet me të tjerët: ai që ka lexuar Kur’an duke kërkuar rizanë e Allahut Teala dhe që udhëzon njerëzit që me të janë të kënaqur, ai që ka thirrë ezan në xhami dhe ka thirrë njerëzit në ibadet duke dëshiruar rizanë e Allahut dhe ai që i është dhënë pasuri në dynja e nuk u mashtrua të mos punojë për ahiret.”¹

Gjithashtu, Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Secili xhin, njeri dhe krijesë tjetër që e dëgjon myezinin kur thërret ezanin, do t’i bëhen atij dëshmitarë në ditën e Gjykimit!”²,

¹ Tirmidhiu nga Ibn Omeri.

² Buhariu nga Ebu Seid.

dhe:

“Dora e Rahmanit është në kokën e myezinit deri sa ky të përfundojë ezanin!”³

Në tefsirin e ajetit:

“E kush flet më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira...” (41-Fusilet: 33),
është thënë se ky është myezini.

Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Kur e dëgjoni ezanin, thuani të njëjtën që e thotë myezini”⁴,

dhe kjo lavdërohet, pos që kur thuhet:
hajje ales-salah dhe ***hajje alel-felah,***

duhet të thuhet:

‘La havle ve la kuvvete ila billah,’

e te fjalët:

kad kametis-salah,

³ Taberani nga Hasen b. Seid.

⁴ Hadith *muttefekun-alejhi* nga Ebu Seid.

do të thotë:

***'Ekamehallahu ve edameha ma dametis-semavatu
vel-erdu,***

e në ezanin e sabahut, te:

es-salatu hajrun minen-nevm

do të thotë:

sadakte ve berekte ve nesahte

e kur të përfundojë ezani do të thotë:

***Allahumme rabbe hazihid-da'vetit-tamme ves-
salatil-kaime ati Muhammedenil-vesilete vel - fedilete
ved-dereheter-refiate veb'asthu-mekamel-
mahmudelezi ve-adteh. Inneke la tuhliful-maild.***

(O Allah, Rabb i kësaj thirrje të përkryer dhe i namazit që do të falet, dhuroi Muhammedit a.s., ndërmjetësimin, vlerën e lartë, gradën me të lartë, dhe dërgoje atë në vendin më të lavdishëm që Ti ia ke premtuar. Ti, vërtetë, nuk i thyen premtimet).

Ndërsa Said ibn Musejjeb ka thënë:

"Kush falet në hapësirë të hapur, nga e djathta dhe nga e majta e tij nga një melek do të falet me të, e nëse thërret ezanin dhe ikametin, pas tij do të ketë melekë në safe sa malet!"

VLERAT E LARTA (FAZILET) TË FARZIT TË NAMAZIT

Allahu Teala thotë:

“...namazi është detyrë e obligueshme për besimtarë, në kohë të caktuar.” 4-Nisa: 103

HADITHET NË KËTË ÇËSHTJE

“Pesë kohë namaze ia ka urdhëruar Allahu Teala robit të Tij. Nëse i falë të gjitha, e nuk braktisë ndonjë duke e konsideruar të parëndësishëm, Allahu e merr mbi Vete obligimin që ta fusë në xhennet. E kush nuk i falë, Allahu nuk ka marrë kurrfarë obligimi: nëse Ai do, e dënon, e nëse Ai do, e vendos në xhennet...”⁵

“Shembulli i pesë kohëve të namazit është sikurse një lumë i rrjedhshëm dhe i pastër para derës së njërit prej jush, në të cilin ai lahet pesë herë në ditë. A mendoni se do të mbetj papastërti te ky person?

- Jo, nuk do të mbetj asgjë.

- Edhe pesë namazet ditore vërtetë që i largojnë gjynahet, bash sikur uji që largon papastërtinë.”⁶

⁵ Ebu Davudi, Nesai, Ibn Maxhe dhe Ibn Hibban nga Ubade ibn es - Samit.

⁶ Muslimi nga Xhabiri, dhe Buhariu, të ngjashëm, nga Ebu Hurejre.

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

“Pesë namazet, prej njërit deri te tjetri, janë pastrues të gjynaheve në mes tyre, nëse ruheni prej gjynaheve të mëdha”⁷,

“Dallimi mes nesh dhe dyfytërëshave është falja e jaxisë dhe sabahut me xhemat në xhami. Ata nuk kanë fuqi për këtë”⁸,

“Kur personi takohet me Allahun e nuk e ka kryer namazin, Allahu Teala as nuk do ti shikojë veprat e tija të mira”⁹,

dhe:

“Namazi është shtyllë e fesë, dhe kush e braktisë e rrënon fenë!”¹⁰

E pyetën Resulallahun s.a.v.s., se cili është veprimi më me vlerë, e ai tha:

- *Namazi i falur në kohë!*¹¹

⁷ Muslimi, nga Ebu Hurejre.

⁸ Malikiu nga Said ibn Musejjebiut.

⁹ Është në kuptim të hadithit:

E para për çka njeriu do të japë lloogari është namazi...

ku gjithashtu thuhet:

...e nëse nuk i pranohet, nuk do t'i pranohen as veprat tjera.

E shënon Taberani në *‘Evsat,’* nga Enesi.

¹⁰ Bejhekiu nga Omeri.

Resulallahu s.a.v.s., e ka thënë edhe këtë:

“Kush kujdeset për pesë namazet ditore, pastrohet mirë dhe i falë në kohë, kjo do t’i bëhet dritë dhe dëshmi në ditën e Gjykimit. E kush i braktisë, do të jetë në shoqëri të Faraonit dhe Hamanit.”¹²

Gjithashtu, Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Namazi është çelësi i xhennetit!”¹³

Fjalë të Resulallahut s.a.v.s., janë edhe këto:

“Allahu Teala nuk ju ka urdhëruar robëve të Tij pas besimit në Njëshmërinë e Tij asgjë më të dashur se namazin. Po të kishte diçka më të dashur për Allahun se namazi, ai do të ishte ibadet i melekëve, sepse ata - disa janë në ruku, disa në sexhde, disa në këmbë, disa ulur.”¹⁴

Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Kush me qëllim nuk falë namaz, është bërë pabesimtar!”¹⁵

¹¹ *Muttefekun alejhi*, e shënojnë Buhariu dhe Muslimi, nga Ibn Mesud.

¹² Ahmedi dhe Ibn Hibban, nga Abdullah ibn Amr.

¹³ Ebu Davudi dhe Tajalisi, nga Xhabiri.

¹⁴ Nuk e kam gjetur këtë tekst, por ky përfundim gjendet te Taberani, nga Xhabiri, e te Hakimi nga Ibn Omeri.

¹⁵ Bezzari, nga Ebu Derda, me sened të diskutueshëm.

Kjo nënkupton që gati sa e ka humbur imanin, sepse e ka dobësuar lidhjen e tij dhe ia ka rrënuar shtyllën, sikur që thuhet për atë që është në hyrje të një qyteti se tashmë ka arritur dhe është brenda në qytet.

Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Kush me qëllim nuk falë namaz, largohet nga mbrojtja e Muhammedit s.a.v.s.”¹⁶

Ebu Hurejre r.a., ka thënë:

“Kush merr mirë abdes e niset me nijet të falë namaz, llogaritet që është në namaz deri sa të vazhdojë ky nijet; në një hap i shkruhet një sevap, e në tjetrin hap i fshihet një gjynah. Prandaj kur të dëgjosh ikametin - mos u vono, e shpërblimin më të madh e kanë ata që i kanë shtëpitë më larg.” Kur e pyetën për arsyen, Ebu Hurejre tha:

- Për shkak të hapave të tyre të shumtë.

Tregohet se namazi është *vepra e parë që do t'i shqyrtohet njeriut në ditën e Gjykimit, e nëse është plotësuar, do t'i pranohet, si edhe veprat tjera të tij. Por*

¹⁶ Ahmed ibn Hanbel dhe Bejhekiu në **Sunen**, nga Ummu Ejmen, të ngjashëm, e me transmetues të besueshëm.

*nëse nuk e ka të plotë, do t'i kthehet bashkë me veprat tjera.*¹⁷ Resulallahu s.a.v.s., i tha Ebu Hurejres:

“O Eba Hurejre, urdhëroje familjen të falin namazin, sepse Allahu do të të japë furnizim prej kah as nuk shpreson.”¹⁸

Një dijetar i islamit ka thënë:

“Namazliu është sikur tregtari, që nuk do të fitojë nëse kapitalin nuk e ka të pastër. Kështu as namazlisë nuk i pranohet nafileja deri sa nuk e falë farzin.”

Kur hynte koha e namazit, Ebu Bekr r.a., thoshte:

“Ngrituni të fikni zjarrin që e keni ndezur!”

VLERAT E LARTA (FAZILET) TË NAMAZIT

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Namazi farz është sikur peshorja, kush e jep masën e plotë, të plotë edhe e merr.”¹⁹

Jezid er-Rekashi ka thënë:

“Namazet e Resulallahut s.a.v.s., ishin në ekuilibër mes vete, sikur të ishin peshuar.”²⁰

¹⁷ Gjendet në *et-Tujurijjat*, nga Ebu Seid, me sened të dobët.

¹⁸ Burimi i transmetimit nuk është gjetur.

¹⁹ Ibn Mubarek në *Zuhd*.

²⁰ Ibn Mubarek, në *Zuhd*.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Dy persona nga umeti im, në të njejtën mënyrë falin namaz, rukunë dhe sexhden i kanë të njëjta, por dallimet në grada të sevapit do t’i kenë si dallimi mes qiejve dhe Tokës.”²¹

“Në ditën e Gjykimit, Allahu nuk do ta shikojë personin i cili në mes të rukusë dhe sexhdes nuk e drejton shpinën.”²²

“A nuk frikësohet ai që në namaz e kthen fytyrën, (në të djathtë e të majtë) se Allahu do t’ia shndërrojë fytyrën në të gomarit?!”²³

“Kush merr abdes si duhet, falë namaz në kohë, rukunë dhe sexhden i bën me përlulje të plotë, namazi do t’i ngritet i bardhë dhe ndriçues, duke i thënë:

- *Allahu të ruajtë, siç u kujdese ti për mua!*

Kush merr abdes sa për adet, falë namaz pas kalimit të kohës, nuk e bën rukunë dhe sexhden me përlulje, namazi do t’i ngritet lartë i zi dhe i errët, duke thënë:

- *Allahu të shkatërroftë, sikur ti mua!*

²¹ Ibnul-Muhabbir në *el-Akl*.

²² Ahmedi nga Ebu Hurejre.

²³ Nga Ebu Hurejre.

Dhe ngritet aq sa do Allahu, mbështillet si një paçavure, e do ta godasë atë namazli në fytyrë.”²⁴

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Hajduti më i keq është ai që vjedhë namazin e vet!”²⁵

Ibn Mesudi dhe Selmani, r.a., thoshin:

“Namazi është një peshore, kush jep masë të plotë, të plotë edhe do ta marrë, e kush lë mangu - epo, dihet çka thotë Allahu Teala për ta!”

VLERAT E LARTA (FAZILET) TË XHEMATIT

Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Namazi në xhemat është më i vlefshëm se ai i vetëm për njëzet e shtatë gradë.”²⁶

Ebu Hurejre tregon se Resulallahu s.a.v.s., nuk i pa do njerëz në disa namaze, e tha:

“Kam menduar t’i urdhëroj dikujt të udhëheqë njerëzit në namaz, e pastaj të shkoj te ata që mungojnë e t’iu djegë shtëpitë!”²⁷

²⁴ Taberani nga Enesi.

²⁵ Ahmedi dhe Haki mi nga Ebu Katade.

²⁶ *Muttefekun alejhi*, nga Ibn Omeri.

²⁷ *Muttefekun alejhi*.

Në një transmetim tjetër thuhet:

“...e pastaj të shkoj te ata që mungojnë në namaz që me turra drushë të djegen brenda shtëpive. Sikur ata të mendonin se do të gjejnë një asht më të madh, ose dy shigjeta, do të vinin në namaz.”

Osmani ka treguar, duke thënë se këto janë fjalë të Resulallahut s.a.v.s.:

“Kush e falë jacinë me xhemat, sikur të ketë kaluar gjysmën e natës në ibadet, e kush e falë namazin e sabahut në xhemat, sikur ta ketë kaluar gjithë natën ashtu!”²⁸

Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Ai që falë një namaz me xhemat e ka mbushur ditën me ibadet!”²⁹

Seid ibn Mussejeb thoshte:

“Njëzet vite nuk ka ndodhë që myezini të thirrë ezan e unë të mos jem në xhami.”

Muhammed ibn Vasi ka thënë:

“Nga kjo botë, vetëm tri më janë të dashura: vëllau që më drejton nëse devijoj, idarja e ditës që e fitoj pa obligime dhe falja në përulje e namazit me xhemat, e që më shkruhet sevap.”

²⁸ Muslimi nga Osmani, si fjalë të Resulallahut s.a.v.s.. Tirmidhiu thekson që përcjellen edhe si fjalë të Osmanit (*mevkuf*).

²⁹ Nuk i kam gjetur si fjalë të Resulallahut s.a.v.s., por Muhammed ibn Nasr i shënon si fjalë të Seid ibn Musejjebit në ***Kitabus-salah***.

Tregohet se Ebu Ubejde ibn Xherrah një herë fali namaz si imam, e kur u kthye kah xhemati, tha:

“Pandërprerë shejtani më shtynte para, kështu që mendova se jam më i vlefshëm se të tjerët. Kurrë më nuk do të jem imam në namaz.”

Hasan Basriu thoshte:

“Mos u falni pas atij që nuk i viziton dijetarët.”

Nehai ka thënë:

“Imami xhahil, që pa njohuri të duhur udhëheqë të tjerët në namaz, është si ai që e matë ujin në det, e nuk di të dallojë teprimin nga mangësia.”

Hatim Esammi thoshte:

“Më iku namazi në xhemat, e vetëm Ebu Is’hak Buhari më shprehu ngushëllime, e po të më vdiste fëmija, sigurisht përmbi dhjetë mijë njerëz do të më shprehnin ngushëllime, e kjo sepse njerëzit më pak kujdesen për fatkeqësinë në fe e më shumë në fatkeqësitë e dynjasë.”

Ibn Abbas r.a., me një rast, tha:

“Kush e dëgjon myezinin e nuk i përgjigjet, as nuk e dëshiron të mirën e as nuk i dëshirohet e mira.”

Ebu Hurejre r.a., ka thënë:

“Po t’i mbushej dikujt veshi me plumb të shkrirë, më mirë e ka, se sa të dëgjojë ezanin e të mos përgjigjet.”

Tregohet se Mejmun ibn Mehran erdhi në xhami, e dikush i tha:

- Njerëzit tashmë janë shpërndarë!,

e ai tha:

- Të arrija vlerën e këtij namazi do të më ishte më e dashur se udhëheqja me Irakun!

Resulallahu s.a.v.s., thoshte:

“Kush falë namaz me xhemat për katërdhjetë ditë, pa i ikur as tekbiri fillestar, Allahu i garanton dy gjëra: që nuk është dyfytirësh, dhe që nuk do të hyjë në xhehenem.”³⁰

Kanë treguar se kur të vijë dita e Gjykimit, disa njerëz do të ringjallen me fytyra sikur yje të ndritshëm. Melekët do t’i pyesin:

- Çfarë keni bërë ju?,

e ata do të përgjigjen:

- Kur e dëgjonim ezanin, i braktisnim punët tona, merrnim abdes e shkonim në xhami.

³⁰ Tirmidhiu nga Enesi.

Më pas do të ngjallet një grup me fytyra si hëna, të cilës pas pyetjes së njëjtë, do të thonë:

- *Merrnim abdes pa hyrë koha e namazit.*

Atëherë do të ngjallen ata që fytyrat do t'i kenë sikur Dielli, e që do të thonë:

- *Ne e dëgjonim ezanin në xhami.*

Tregohet se gjeneratat e para e ngushëllonin njëri-tjetrin për tri ditë nëse ju ikte tekbiri fillestar, e shtatë ditë nëse ju ikte namazi me xhemat!

KUPTIMI I SEXHDES

Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Robi nuk i afrohet Allahut Teala me asgjë më me vlerë se sa me sexhden e fshehtë. (pra, namazet nafile që i falë në shtëpi).”³¹

Gjithashtu, Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Secilit mysliman që i bën sexhde Allahut Teala, Allahu për këtë ia ngritë një gradë dhe ia fshinë një gjynah.”³²

³¹ Ibnul-Mubarek në veprën **‘Zuhd** ‘nga Damr ibn Habib.

³² Ibn Maxhe nga Ubade b. Samit.

Një person e luti Resulallahun s.a.v.s.:

- *Bëj dua te Allahu që të më bëjë nga ata që do t'i përfshijë ndërmjetësimi (shefati) yt, dhe të më shpërblejë me shoqërinë tënde në xhennet;*

e Resulallahu s.a.v.s., i tha:

- ***Më ndihmo, duke bërë shumë sexhde!***³³

Është thënë gjithashtu:

“Robi është më së afërti Allahut Teala kur është në sexhde!”³⁴

Ky është edhe kuptimi i fjalëve të Allahut Teala:

“...bëj sexhde dhe afrohu.” 96-Alak: 19

Allahu Teala thotë:

“Në fytyrat e tyre shihen shenjat e sexhdes.”

48-Feth: 29

Disa thonë se flitet për atë që ju mbetet nga dheu, pas sexhdes. Të tjerët thonë se ky është nuri i përulësisë, sepse ai nga brenda e shndritë të jashtmen, që është më afër të vërtetës. Disa thonë se janë shenjat që do t'i kenë në fytyrë ditën e Gjykimit, si gjurmë nga abdesi.

³³ Rebia ibn Ka'b el-Eslemi, që është edhe personi që i ka bërë këtë lutje Resulallahut s.a.v.s..

³⁴ Muslimi, nga Ebu Hurejre.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kur biri i Ademit lexon një ajet me sexhde e pas kësaj e bën sexhden, shejtani tërhiqet duke qarë, e duke thënë:

- I mjeri unë, këtij i është urdhëruar sexhdeja, e ky e bëri, dhe atij i takon xheneti. Edhe mua mu urdhërua sexhdeja, por unë nuk u nënshtrova, e mua më takon xhehenemi.”³⁵

Tregohet se Ali ibn Abdullah ibn Abbas për çdo ditë bënte njëmijë sexhde, prandaj e quajtën *Sexhxhad (ai që bën shumë sexhde)*. Tregohet gjithashtu se Omer ibn Abdulaziz sexhden e bënte vetëm mbi dhé, e Jusuf ibn Esbat thoshte:

“O djelmoha, përdoreni shëndetin para sëmundjes; unë i kam lakmi vetëm atij që e bën mirë rukunë dhe sexhden, pasi që unë, për shkak pleqërisë, më nuk po mundem.”

Said ibn Xhubejr ka thënë:

“E vetmja nga kjo botë për të cilën kam mall është sexhdeja!”,

³⁵ Muslimi, nga Ebu Hurejre.

e Ukbe ibn Muslim ka thënë:

“Më i dashuri te Allahu është ai që e dëshiron takimin me Të, e momenti kur njeriu është më së afërti Allahut Teala është kur i bie Atij në sexhde.”

Ebu Hurejre ka thënë:

“Momenti kur robi është më së afërti Allahut Teala është momenti kur është në sexhde, prandaj në sexhde bëni shumë dua.”

VLERAT E LARTA (FAZILET) TË PËRULËSISË

Allahu Teala thotë:

“...dhe fal namazin për të më kujtuar Mua.”

20-Ta Ha: 14,

dhe thotë:

“...dhe mos u bëj nga ata që nuk i kushtojnë vëmendje!” 7-Araf: 205.

Allahu Teala gjithashtu thotë:

“Mos iu afroni namazit duke qenë të dehur, derisa të dini se ç'flitni.” 4-Nisa: 43

Disa thonë se këtu flitet për të dehurit nga brenga e dynjasë e të tjerë thonë se janë të dehurit me dashurinë për dynjanë. Vehb ka thënë:

“Këtu mendohet në kuptimin e jashtëm (zahir). Me këtë paralajmërohet në dehjen e brengës së dynjasë, sepse në ajet shpjegohet edhe vet arsyeja”, dhe lexoi:

derisa të dini se ç'flitni...

Sa ka namazli që nuk kanë pirë alkool, e nuk e dinë se çka thonë në namazin e tyre.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kush i falë dy reqate duke mos menduar në to për asgjë të kësaj bote, i falen gjynahet e mëparshme!”³⁶

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

“Namazi është vërtetë një gjendje e varshmërisë, e përuljes, përgjërimit, vajit e pendimit; i zgjatë duart e thua: ‘O Allah, o Allah’, e kush nuk vepron kështu, namazin e ka të mangët.”³⁷

Në librat e mëparshëm është shkruar se Allahu Teala ka thënë:

“Unë nuk e pranoj namazin e secilit që falë, por e pranoj namazin e atij që është i përlur para madhësisë Time dhe nuk mburret te robët e Mi dhe i cili për rizanë Time e ushqen fukaranë dhe të uriturin!”

³⁶ Ibn Ebu Shejbe në *‘Musannef,’* nga Sile ibn Eshjem, si *mursel*. Në Sahiheshënohet nga Osmani r.a., me një shtesë në fillim, e pa fjalët: **“...për asgjë të kësaj bote”**, ndërsa te Tajalisi është edhe: **...përpos të mirës”**.

³⁷ Nesai nga Fadl ibn Abbas.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Përcaktimi i namazit farz, urdhërimi i haxhit dhe tavafit, njoftimi me rregullat e ibadetit, janë vetëm që të përkujtohet dhe përmendet Allahu Teala.”³⁸

Allahu Teala është qëllimi dhe dëshira e përmendjes, e nëse në zemër nuk ndjenë madhështinë e Atij që përmendet e as frikë-respekt ndaj Tij, atëherë çfarë dobie ka përmendja?

Duke këshilluar, Resulallahu s.a.v.s., tha:

“Kur falesh, falu sikur po ndahesh nga kjo botë”³⁹,

pra, po përshëndetet me veten, me kërkesat e veta, me jetën e vet, e cila po udhëton drejt Rabb-it të vet, siç thotë Allahu Teala:

“O ti njeri, që përpiqesh shumë, mundin tënd do ta gjesh te Rabbi yt.” 84-Inshikak: 6

Allahu Teala gjithashtu thotë:

“Kini frikë Allahun se Allahu ju mëson dituri (të jashtëzakonshme).” 2-Bekare: 282,

³⁸ Ebu Davudi dhe Tirmidhiu nga Ajsha r.anha.

³⁹ Ibn Maxhe nga Ebu Ejub dhe Hakimi nga Sa’d ibn Ebu Vekas. Thotë se është me zinxhir të besueshëm të transmetuesve, e Bejhekiu në ez-Zuhd nga Ibn Omeri, por të njëjtë.

dhe thotë:

“Kijeni frikë Allahun dhe dijeni se do të takoheni me Te.” 2-Bekare: 223

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Atë që namazi nuk e ndalon nga veprimet e këqija, veç sa e largon prej Allahut!”⁴⁰.

Namazi është lutje e fshehtë; e si të bëhet lutje pa vëmendje?

Bekr ibn Abdullah ka thënë:

- O bir i Ademit, nëse do të hysh në prani të Rabbit tënd pa leje e të flasësh me Të pa ndërmjetësues, hyr!

- Si të hyjmë?;

e pyetën, e ibn Abdullah tha:

- Kur merr abdes mirë dhe shkon te vendi ku do të falësh namazin, ke hyrë në prani të Rabbit tënd pa leje dhe flet me Të pa ndërmjetësues.

Tregohet se Ajshe r.anha. ka thënë:

“Ne bisedonim me Resulallahun s.a.v.s., e kur fillonte namazi, sillej sikur nuk na njuh dhe sikur ne nuk e njohim atë.”

⁴⁰ Teberani.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Allahu Teala nuk e shikon në namaz atë që nuk e ka përgatitur zemrën dhe trupin.”⁴¹

Për Ibrahim Halilin a.s., thuhet se, kur ngritej për namaz, rrahjet e zemrës i dëgjoheshin në dy milje larg! E kur Seid Tenuhi falej, lotët i rridhnin vazhdimisht mbi mjekër.

Resulallahu s.a.v.s., e pa një person se si luante me mjekër në namaz, e i tha:

“Po të ishte e përlur zemra e tij, do t’i ishin të përlura edhe gjymtyrët e tij.”⁴²

Thuhet se Hasan Basriu e pa një person si luante me gurë derisa falte namaz, e pastaj u lut:

- *O Allah, më marto me hyritë në xhenet!;*

e Hasani i tha:

- *Sa dhëndër i keq! Kërkon hyritë e jep gurë!*

Dikush e pyeti Halef ibn Ejjubin:

- *A nuk të pengojnë mizat në namaz e nuk i largon?;*

e ai ju tha:

- *Nuk bëj asnjë lëvizje që më prishë namazin.*

⁴¹ Hadithi nuk është gjetur në këtë formë.

⁴² Tirmidhiu nga Ebu Hurejre.

Prapë e pyetën:

- *E si mund të durohesh?!,*

e ibn Ejjub ju tha:

- *Kam dëgjuar se keqbërësit para sundimtarëve durojnë goditje me kamxhik dhe keqtrajtme të mëdha e nuk lëvizin, vetëm që të thuhet se janë të durueshëm e me këtë të lavdërohen. Ndërsa unë qëndroj para Rabbit tim; si të lëvizë për një mizë?!*

Tregohet se Muslim ibn Jesar, kur donte të falej, i thoshte familjes:

- *Flisni sa të doni, unë nuk ju dëgjoj.*

Gjithashtu, për të tregohet se një ditë po falej në xhaminë e Basrës, e një pjesë e xhamisë u rrënuar, e njerëzit nxituan të mblidhen, por ai as që e hetoi, deri sa përfundoi namazin.

Ali ibn Ebu Talib (Kerrema'llahu Vexh'hehu), kur hynte koha e namazit, fillonte të dridhej e i ndërronte ngjyra e fytyrës.

Dikush e pyeti se çfarë po i ndodhë, e ai u përgjigj:

- *Erdhi koha e amanetit. Allahu ia ofroi qiejve, Tokës e kodrave, e ato u përmbajtën dhe nuk e pranuan, por unë e kam pranuar. E si të mos frikësohem?!*

Tregohet se kur Ali ibnul-Husejn mernte abdes, zbehej. E kur e pyetën:

- *Çfarë po të ndodhë kështu para abdesit?!;*

ai tha:

- *A e dini ju para kujt do të dal?!;*

Ibn Abbas r.a., tregon se Davudi a.s., duke iu lutur Allahut, tha:

- *O Rabb, nga kush Ti e pranon namazin, e ai të hyjë në xhenet?;*

e Allahu Teala i shpalli:

- ***O Davud, Unë e pranoj namazin nga ai që është i përlulur karshi madhësisë Time, që ditën dhe natën e përmend (bën zikër) Emrin Tim, që për rizanë Time largohet nga kërkesat e veta, që ushqen të uriturin, i ofron strehim të huajit, shoqërohet me të varfrin. Drita e tij ndriçon në qiejt si diell. Kur më bën dua, Unë ia pranoj, e kur më kërkon, Unë i jap. I dhuroj mendjemprehtësi në padituri, kujtim në harresë, dritë në errësi. I tilli është si Firdevs - grada më e lartësuar e xhenetit, që lumenjtë nuk i thahen, e frutat nuk i prishen.***

Njëri e pyeti Hatim-i Esamin:

-*Si e falni ju namazin?;*

e ky u përgjigj:

“Kur të vjen koha e namazit, marr abdes mirë. Pastroj pjesët e trupit me ujë, ndërsa brendësinë time me teube (pendim), afrohem te vendi ku dua të falem, dhe aty ulem e qëndroj deri sa gjymtyrët të më qetësohen, pastaj ngritem të falem; e sjelli Qaben para syve, urën e Siratit nën këmbë, xhennetin në të djathtë, xhehenemin në të majtë, e melekun e vdekjes (Azrail) mbrapa meje. Llogaris se më është namazi i fundit. Atëherë qëndroj mes shpresës e frikës dhe marr tekbir me bindje, Kur’anin e lexoj drejtë dhe duke ia menduar kuptimin, rukunë e bëj i përulur e sexhden i penduar, dhe ulem në tehejjat. Të gjitha këto i bëj me sinqeritet, e prapë nuk e di a më pranohet namazi a jo.”

Ibn Abbas r.a., thoshte:

“Dy reqate që falen duke ua menduar kuptimin janë më të dobishme se sa falja tërë natën me zemër gafil (të shkujdesur).”

VLERAT E LARTA (FAZILET) TË XHAMISË DHE VENDIT KU
FALET NAMAZI

Allahu Teala thotë:

**“Faltoret e Allahut i vizitojnë dhe i mirëmbajnë
vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit”**

9-Teube: 18

E Resulallahu s.a.v.s., thotë:

**“Ai që për rizanë e Allahut e ndërton një xhami,
qoftë ajo edhe sa një fole zogjësh, Allahu Teala do t’ia
ndërtojë atij një pallat në xhennet!”⁴³**

**“Kujt i pëlqen të jetë në xhami, Allahut i pëlqen të
jetë me të!”⁴⁴**

**“Kur dikush nga ju të hyjë në xhami, le t’i falë dy
reqate para se të ulet.”⁴⁵,**

**“Nuk ka namaz për komshinë e xhamisë, përpos në
xhami!”⁴⁶**

⁴³ Ibn Maxhe nga Xhabiri.

⁴⁴ Taberani në *‘Evsat’* nga Ebu Seid.

⁴⁵ *Muttefekun alejhi*, nga Ebu Katade.

⁴⁶ Darekutni nga Xhabiri.

“Melekët ju bekojnë deri sa jeni në vendin ku faleni, duke thënë: ‘O Allah, bekoje! O Allah, mëshiroje! O Allah, fale’, deri sa nuk e prishë abdesin ose të del nga xhamia.”⁴⁷

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Në ahir zaman do të ketë nga ummeti im që do të vinë në xhami, dhe aty do të ulen në hallka, e do të përmendin vetëm këtë dynja dhe dashurinë për të. Mos u shoqëroni me ta, sepse Allahu Teala për ta nuk ka kurrfarë nevoje.”⁴⁸

Resulallahu s.a.v.s., ka treguar se Allahu Teala, në një prej librave të mëhershëm ka shpallur:

“Shtëpitë e Mia në Tokë janë xhamitë, e ata që në to më vizitojnë Mua, ju japin jetë. Lum ai që pastrohet në shtëpi të vet e pastaj më viziton Mua në shtëpinë Time. E i zoti i shpisë e ka obligim ta nderojë mysafirin e vet.”⁴⁹

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu thotë:

“Kur e shihni dikë që rregullisht shkon në xhami, dëshmoni që është besimtar!”⁵⁰

⁴⁷ *Muttefekun alejhi*, nga Ebu Hurejre.

⁴⁸ Ibn Hibban nga Ibn Mesudi.

⁴⁹ Ebu Nuajm nga Ebu Seid.

⁵⁰ Tirmidhiu nga Ebu Seid.

Seid ibn Musejeb ka thënë: *“Kush rri në xhami, është në shoqëri me Rabbin e vet, prandaj e ka obligim të flasë vetëm mirë.”*

Në një transmetim, thuhet: *“Bisedimi në xhami i shkatërron sevapet, sikur bagëtia kur e ha barin e thatë.”*⁵¹

Nehai ka thënë: *“Shkuarjen në xhami në natën e errët, e kanë llogaritur sebeb për hyjre në xhenet.”*

Enes ibn Malik ka thënë: *“Kush e ndezë një dritë në xhami, melekët pandërprerë kërkojnë falje për të, deri sa në xhami të vazhdojë ajo dritë.”*

Hazreti Alia (Kerrema’llahu Vexh’hehu), ka thënë:
“Kur vdes njeriu, për të qanë vendi në Tokë ku ai është falur dhe vendi në qiell ku ngriteshin veprat e tij”,
e pas kësaj lexoi ajetin:

“Për ta nuk qajtën as qielli e as toka dhe atyre nuk iu dha afat.” (44-Duhan: 29).

Ibn Abbas ka thënë: *“Vendi i namazit të myslimanit, pas vdekjes së tij qanë për katërdhjetë sabahe.”*

⁵¹ Nuk është gjetur burimi.

Atta el-Horasani ka thënë: *“Për secilin rob të Allahut që bën sexhde në cilën do pjesë të rruzullit tokësor, ai vend do të qajë kur ky të vdes dhe do të dëshmojë për të në ditën e Gjykimit.”*

Enes ibn Malik ka thënë: *“Secili vend ku përmendet Allahu në namaz e dhikr, mburret para vendeve tjera dhe gëzohen deri në katet e shtata të Tokës.”*

Kush fal namaz në një vend, ai vend zbukurohet për të. Dhe është thënë se nuk ka asnjë vend ku ndalen njerëzit, e ai vend të mos fillojë t'i bekojë apo t'i mallkojë.

Kapitulli i dytë

VEPRIMET E JASHTME NË NAMAZ, FILLIMI ME TEK BIR DHE ÇKA I PARAPRINË

Namazlia, kur përfundon abdesin dhe e pastron trupin, vendin dhe rrobën nga papastërtia dhe kur mbulohen pjesët e turpshme nga beli deri nën gjunj⁵², duhet të drejtohet, në këmbë, i kthyer kah kibla, t'i drejtojë shputat, por mos t'i bashkojë ato, sepse edhe kjo flet për kuptimin e tij të fesë. Resulallahu s.a.v.s., e ka ndaluar që në namaz të qëndrohet në një këmbë (*safn*) si edhe bashkimin e këmbëve mes vete (*safd*).⁵³

Safd pra është bashkimi i shputave njëra me tjetrën, e në këtë kuptim janë edhe fjalët e Allahut Teala:

“...të lidhur në pranga...”14-Ibrahim: 49,

⁵² Kjo, natyrisht, vlen për mashkullin. Femra duhet të mbulojë të gjithë trupin, përpos fytyrës, shuplakave të dorës dhe këmbët deri në nyjet e këmbës (përkthyesi).

⁵³ Rezin beson se është nga Tirmidhiu, por nuk e kemi gjetur atje, e as te tjerët, por e përmendin autorët e veprave për fjalët e panjohura në hadithe, siç është Ibnul-Esir në *en-Nihaje*, përderisa Sied ibn Mensur transmeton se Ibn Mesud e ka parë një person si qëndron në namaz vetëm në një këmbë e tha: “Ky nuk vepron sipas *sunnetit*”.

e *safn* është qëndrimi në një këmbë, shprehje që Allahu Teala e përmend në ajet:

“...qëndronin gatitu në tri këmbë, e ishin edhe shumë të shpejtë.” 38-Sa’d: 31

Gjatë *kijamit* (qëndrimit në këmbë) duhet pasur kujdes për shputat. Duhet gjithashtu patur kujdes që të drejtë gjunjë dhe belin. Kokën mund ta lë mbajë drejt, e mund edhe ta lëshojë poshtë, që është më afër përulësisë, dhe më lehtë e ka të ruaj shikimin. Shikimi duhet t’i kufizohet në sexhaden ku falet.

Nëse nuk ka sexhade, le t’i afrohet ndonjë muri, ose së paku të bëj një vijë para vetes, sepse kjo do t’ia zvogëlojë këndin e shikimit dhe do të pengojë shpërndarjen e mendimeve. Le ta lëshojë shikimin poshtë që të mos dalë përtej qosheve të sexhades apo skajeve të vijës. Kështu, pa u kthyer, le të vazhdojë të qëndrojë deri sa të kalojë në ruku. Kjo është mënyra e drejtë se si bëhet *kijami*.

Kur qëndron drejtë, kthehet kah kibla dhe e ulë kokën, lexon *suren ‘Nas’* dhe thotë:

‘Kul eudhi bi Rabbin-nas,

që të mbrohet nga shejtani. Nëse pret se dikush do t'i bashkangjitet, le të thërrasë një herë ezanin, e pas kësaj le të thërret ikametin, e më pas le ta bëj nijetin, për shembull e bën nijet të falë namazin e drekës, dhe me zemër thotë:

“Bismillah - në emër të Allahut, po e fali në kohë namazin farz të drekës.

Kështu, me fjalët *po e fali në kohë* do të bëjë dallimin nga falja e mëvonshme, me fjalën *farz*, nga namazi nafile, me fjalën *i drekës* nga ai i ikindisë etj.

Nëse këto kuptime gjinden në zemër, do të thotë se është bërë nijeti. Fjalët janë sebeb për rehatinë e zemrës. Duhet munduar që ky nijet të qëndrojë në zemër deri te përfundimi i tekbirit.

Kur e gjithë kjo i gjendet në zemër, dhe e bën nijetin, le t'i drejtojë shuplakat dhe t'i ngritë përballë krahëve⁵⁴, që shuplakat t'i drejtohen me krahët, gishti i madh me pulpat e veshit, e majat e gishtave me majat e veshëve, dhe kështu t'i bashkojë transmetimet që flasin për këtë.

⁵⁴ Në transmetime tjera përmendet ngritja deri te bula e veshit, e në disa deri te maja e veshëve. Në formulimin e parë, që vjen nga Ibn Omeri, është muttefekun alejhi. Ngritjen deri te bula e veshit e shënon Ebu Davudi nga Vail ibn Huxhr, me zinxhir të dobët të transmetuesve, deri sa te Muslimi, nga Malik ibn Huvejr is përmenden majat e gishtave

Gishtat të mos i hapë as ti palojë, por t'i mbajë në pozitë natyrore, sepse në transmetime tregohet edhe hapja edhe bashkimi⁵⁵, ndërsa kjo është e mesme, që është më e udhës. Pasi t'i ketë ngritur kështu duart, duke i lëshuar poshtë dhe me nijetin në zemër, bën tekbir.

Pas kësaj do t'i lidhë duart në brez (mbi kërthizë, e nën gjoks)⁵⁶, duke e vendosur dorën e djathtë mbi të majtën si respekt ndaj anës së djathtë, ashtu që ajo të jetë e dukshme, duke e drejtuar gishtin tregues dhe atë të mesëm të dorës së djathtë mbi të majtën, derisa nyjen e dorës së majtë do ta mbajë me të djathtën - gishtin e madh në një anë, e të voglin dhe gishtin e unazës në anën tjetër.

Ka transmetime se tekbiri bëhet gjatë ngritjes së duarve⁵⁷, kur duart janë të ngritura⁵⁸, por edhe kur

⁵⁵ Për zgjërimit dhe bashkimin e gishtave te tekbiri fillestar ka folur Atta, siç edhe i kanë shënuar Ibn Huzejm nga Ebu Hurejre dhe Bejhekiu, e kjo është se Resulallahu s.a.v.s., as nuk i zgjeronte gishtat, as nuk i bashkonte ata, e nuk është gjetur transmetim që flet direkt për bashkim të gishtave.

⁵⁶ Sipas medh'hebit Hanefi, duart lidhen nën kërthizë.

⁵⁷ Hadithin për bërjen tekbir kur të ngriten duart e shënon Buhariu nga Ibn Omeri:

"I ngriste duart kur bënte tekbir...", dhe Ebu Davud nga Vali:

"I ngriste duart me tekbir".

⁵⁸ Hadithin për bërjen tekbir kur duart janë të ngritura, e shënon Muslimi nga Ibn Omeri:

lëshohen⁵⁹ dhe nuk ka pengesë të bëhet gjatë cilës do prej këtyre pozitave, ani pse mendoj se më e drejta është të bëhet gjatë lëshuarjes së duarve poshtë, sepse tekberi është fjalë e lidhjes, dhe vendosja e një dore mbi tjetrën është formë e lidhjes, që fillim e ka lëshimin e duarve e fund bashkimin e tyre.

Fillimi i tekbrit është *elif*, e fundi i tij është *ra*, prandaj është bukur nëse përshtaten veprimet me lidhjen që krijohet. Ngritja e duarve është hyrje në këtë fillim. Në tekbir, gjatë ngritjes së duarve, nuk është mirë të lëvizet majtas a djathtas ose përpara a mbrapa. Do t'i lëshojë duart ngadalë e butësisht, dhe pas lëshimit do të vendosë të djathtën mbi të majtën. Në disa transmetime përmendet që Resulallahu s.a.v.s., i lëshonte duart, e kur fillonte të lexojë, e vendoste dorën e djathtë mbi të majtën.⁶⁰ Nëse ky transmetim është i besueshëm, atëherë një veprim i këtillë është më i mirë se ato që i përmendëm.

“Kur hynte në namaz, i ngritte duart deri sa nuk ishin para krahëve, e atëherë bënte tekbir”, dhe ka shtuar “...e edhe ata të dy vepronin njëjtë”.

⁵⁹ Hadithin për bërje tekbir kur i lëshon duart e shënon Ebu Davud nga Hamidi:

“Kur hynte në namaz, i ngritte duart deri sa i rrafshonte me krahët, dhe atëherë bënte tekbir, kur secili asht stabilizojë në vend të vet”.

⁶⁰ Shënojnë Taberani nga Muadh, me zinxhir të dobët të transmetuesve.

Në tekbir duhet thënë butësisht shkronjën *u* pas shkronjës *h* në fjalën *Allah*, pa e theksuar, dhe nuk duhet thënë mes shkronjës *h* dhe *e* nga *ekber* ndonjë tjetër, për shembull *v*, që ndodhë nëse theksohet shumë shkronja *h*, e as nuk duhet t'a zgjasë në mes të shkronjës *b* dhe asaj *r* të fjala *ekber*, si e zgjatë kur thotë *ekbār*. Në fund shkronjën *r* do ta thotë me *sukun*, e jo me *u*. Kjo është mënyra se si thuhet tekbiri dhe tjerat që shkojnë me të.

LEXIMI NË NAMAZ

Pas asaj, fillon me leximin e duasë së parë. Është e lavdëruar që menjëherë pas *Allahu ekber* të thotë:

Allahu ekber kebira, vel-hamdu lilahi kesira, ve subhanallahi bukreten ve esila. Vexhxhehtu vexhhije liledhi fetares-semavati vel-erda hanifen, ve ma ene minel-mushrikin. Inne salati, ve nusuki, ve mahjaje, ve memati lilahi Rabbil-alemin. La sherike lehu, ve bi dhalike umirtu, ve ene minel-muslimin⁶¹

⁶¹ Musliimi nga Ibn Omeri r.a.:

“po faleshim me Resulallahun s.a.v.s., e dikush tha ‘Allahu ekber kebira...’”,

pastaj Ebu Davudi, si edhe Ibn Maxhe nga Xhubejr ibn Mut'im se e ka parë Resulallahun s.a.v.s., si falet, dhe lexon:

*(Allahu është larg më i madhi, falënderim madhështor i qoftë Atij dhe i lartësuar qoftë Ai në mëngjes e në mbrëmje. Fytyrën time e kthej, si besimtar i vërtetë, drejt Atij që i krijoi qiejt e Tokën, unë nuk jam nga ata që Atij i përshkruajnë ortak. Namazi im, edhe ritet e mia, edhe jeta ime, edhe vdekja ime vërtetë i kushtohen Allahut, Rabbit të botëve. Ai nuk ka ortak; kjo më është urdhëruar dhe unë jam myliman)*⁶²

Pas kësaj lexon:

Subhanek Allhumme ve bi hamdike ve tebarekesmuke ve teala xhedduke ve la ilahe gajruke

*(Lavdëruar qofsh, o Allah. Të gjitha falënderimet vetëm Ty, i bekuar është emri Yt, e madhështia Jote është e paarritshme. Falënderimi Ty është lartësim, nuk ka zot pos Teje!)*⁶³,

'Allahu ekber kebira...'

⁶² Leximi i duasë pas tekbitit është sipas medh'hebit Shafi. Sipas medh'hebit Hanefi pas tekbitit lexohet Subhanek, Eudhubil-lahi dhe Bismi-lahi.

⁶³ Ebu Davudi, Tirmidhiu, që e konsideron të dobët, dhe Hakimi, që verzionin e Ajshes r.anha. e konsideron të besueshëm, deri sa të dobët e konsideron vetëm Tirmidhiu. Muslimi e përmend si transmetim të Omerit r.a., ndërsa Bejhekiu nga Xhabiri i shënon të plotë edhe *vexhxhehtu* edhe *subhaneke*

Kjo është më e përshtatshme për të përfshirë tekstet e ndryshme nga transmetimet. Nëse falë me imam dhe imami nuk bën ndalesë më të gjatë, e ky të ketë kohë, atëherë hesht.

Pas kësaj do të lexojë:

Eudhu bilahi minesh-shejtani-raxhim

(Tek Allahu strehohem nga shejtani i mallkuar),

e pas së cilës do të lexojë *Fatihane*, duke filluar me

Bismilahir-Rahmanir-Rahim

(në emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit),

I shqipton korrekt germat dhe teshtidet, dhe në fund të *Fatijasë* thotë *amin*, duke e shqiptuar të zgjatur. Nuk do ta bashkojë fjalën *amin* me *ve leddalin*.

Nëse është imam, me zë lexon në sabah, aksham dhe jaci⁶⁴, e xhemati lexon në vete dhe më zë thotë *amin*.

Pas kësaj do të lexojë një sure, ose së paku tri ajete nga Kur'ani. Përfundimin e sures nuk do ta bashkojë me tekbinin e kalimit, por do t'i ndajë me pauzë sa mund të thuhet *subhanallah*.

⁶⁴ Sipas medh'hebit Hanefi ai që falet me imam nuk lexon dhe as imami e as xhemati nuk thotë me zë *amin* por në vete, e ai që falet vetëm e ka mundësinë që në sabah, aksham dhe jaci të lexojë me zë ose në vete (përkthyesi).

Në sabah do të lexojë suret më të gjata, në aksham më të shkurta, e në drekë, jaci e ikindi do të lexojë sure mesatare.

Gjatë udhëtimit, në sabah mund të lexojë '**Kul ja ejuhel-kafirun**' dhe '**Kul huvallahu ehad**' e sure të ngjashme.

Njëjtë mund të lexojë në sunnetin e sabahut, në namazin pas *tavafit* dhe në *tehijjetul-mesxhid* (përshëndetje për xhaminë). Gjatë gjithë kësaj kohe ai qëndron drejtë dhe i mbanë duart siç e përshkruam te fillimi i namazit.

RUKUJA DHE VEPRIMET PËRCJELLËSE

Pas kësaj do të kalojë në *ruku* në të cilën gjithashtu do të ketë kujdes në gjëra të caktuara:

Do ta thotë tekbirin (*Allahu Ekber*) për rukunë, do t'i ngritë duart⁶⁵ bashkë me bërjen e tekbirit për rukunë dhe do t'a zgjasë shqiptimin e tekbirit deri sa të kalojë në *ruku*, do t' vendosë duart në gjunj në *ruku*, e gishtat le t'i ketë të hapur, gjunjtë do t'i drejtojë, shpinën do ta drejtojë, e qafën me kokën do t'i bëjë drejt me shpinë, kokën mos ta ketë as më poshtë e as më lartë, si edhe bërrylat t'i ndajë nga ijet, (femra i vë duart pak më lartë

⁶⁵ Sipas medh'hebit Hanefi, duart ngriten vetëm në tekbirin (*iftitahi*) fillestar.

gjurit, nuk përkulet shumë, qëndron pak më lartë, gjishtat e duarve i mbanë të mbyllura dhe i mbështesë bërrylat në ije), dhe tri herë thotë:

Subhane Rabbijel-adhim

(Lavdia i takon Rabbit tim Madhështor).

Është mirë që, nëse nuk është imam, këtë ta thotë deri në shtatë, respektivisht dhjetë herë. Më pas, nga rukuja do të ngitet përsëri në qëndrim të drejtë, do t'i ngritë duart⁶⁶ e do të thotë:

Semiallahu limen hamideh

(Allahu e dëgjon atë që e falënderon)

Do të qetësohet ashtu në këmbë, e do të thotë:

Rabbena lekel-hamdu, mil'es-semavati ve mil'el-erdi, ve mil'e ma shi'te min shej'in ba'dehu. ⁶⁷

(Rabbi jonë, falënderim Ty sa qiejt e Toka dhe sa Ti do ende para kësaj)

Nuk e zgjatë shumë në këtë qëndrim, përpos të *salatut-tesbihu* (namazi ku Allahu lavdërohet shumë), *salatul-kusuf dhe husuf* (namazi me rastin e zënies së Diellit dhe Hënës) dhe në namazin e sabahut. Në

⁶⁶ Shih shënimin paraprak.

⁶⁷ Sipas medh'hebit Hanefi thotë:

Rabbena lekel-hamdu, ose Rabbena ve lekel-hamdu, ose Allahumme rabbena lekel-hamdu, më shumë nuk thotë.

namazin e sabahut, në reqatin e dytë do të lexojë edhe duanë e *Kunutit*⁶⁸, me fjalët e njohura, para se të bjerë në sexhde.⁶⁹

SEXHDEJA

Pastaj do të niset për sexhde duke thënë përsëri *Allahu Ekber*.

Së pari në tokë duhet të lëshojë gjunjtë, e pas kësaj duart, e pas tyre fytyrën, pra ballin dhe hundën. Do t'i ndajë bërrylat nga ijet, e femra jo, dhe do t'i mbajë këmbët ndaras, e prapë, femra jo.⁷⁰ Gjatë sexhdes, do t'i ndajë gjunjtë, e femra jo. Gishtat nuk i lë të hapur por i bashkon, e nuk pengon nëse gishti i madh lihet ndaras. Bërrylat nuk do t'i shtrijë në tokë siç bën qeni, sepse e ka të ndaluar.⁷¹

⁶⁸ Sipas medh'hebit Hanefi, duaja e Kunutit nuk lexohet në sabah por në namazin e vitrit.

⁶⁹ Hadithin për leximin e duasë së Kunutit e shënon Bejhekiu nga Ibn Abbasi, në këtë formë: "*Resulallahu s.a.v.s., lexonte duanë e Kunutit në sabah dhe në namazin e vitrit me fjalët:*

'Allahummehdini fimen hedejte...'

(*Allahu im, më udhëzo me ata që tashmë i ke udhëzuar...*).

Shënojnë edhe Ebu Davudi, Tirmidhiu, që e konsideron të mirë, Nesai nga Hasan Basriu se Resulallahu s.a.v.s., ia ka mësuar këto fjalë që do t'i thoshte në namaz të vitrit. Zinxhirin e transmetuesve e ka të besueshëm.

⁷⁰ Sipas medh'hebit Hanefi mashkulli në sexhde i bashkon thembrat.

⁷¹ Hadith *muttefekun alejhi*, nga Enesi.

Duhet të thotë tri herë:

Subhane Rabbijel-ala

(Lavdi Rabbit tim të Lartësuar),

e nëse thotë më shumë herë, e gjithmonë tek, veç më mirë, por jo kur është imam.

Më pas do të ngritet nga sexhdeja, kokën do ta ngrisë duke thënë *Allahu Ekber*, e do të ulet në këmbën e tij të majtë, të djathtën e mbanë me gishta të drejtuar nga kibla, dhe qetësohet në atë pozitë. Duart do t'i vendosë në kofsha, e gishtat do t'i drejtojë, pa provuar as t'i bashkojë as t'i hapë.

Do të thotë:

Rabbifir li, verhammi, verzukni, vehdini, vexhburni, ve afini, veafu anni ⁷²

(O Rabbi im më fal, më mëshiro, më furnizo, më udhëzo, më kënaq, më dhuro shëndet dhe më fal për të keqen e veprimeve të mia).

Nuk do të qëndrojë gjatë i ulur në këtë pozitë, përpos te sexhdeja e namazit tesbih. Edhe sexhden e dytë do ta bëjë njëjtë. Do të drejtohet pas saj, shkurt të ulet sa për të marrë frymë në secilin reقات pas së cilit

⁷² Sipas medh'hebit Hanefi mes dy sexhdeve nuk lexohet asgjë.

nuk lexohet teshehud. Pas kësaj do të gritet duke vendos dorën në tokë, duke mos lëvizur asnjërën këmbë përpara gjatë ngritjes. Do ta zgjasë tekbirin, që të vazhdojë deri te gjysma e ngritjes në këmbë, ashtu që shkronja *h* nga fjala *Allah* të thuhet kur të drejtohet në pozitë ulur, ndërsa shkronja *k* nga fjala *ekber* kur të mbështetet në dorë gjatë ngritjes, e *r* nga *ekber* në mes të ngritjes në këmbë. Do të fillojë me tekbir kur të jetë në mes të ngritjes nga ulja, ashtu që tekbiri thuhet në mes të kalimit dhe që pa tekbir të jenë vetëm fillimi dhe fundi i asaj ngritje, që është mënyra më e mirë për të përfshirë të gjitha.⁷³

Reqatin e dytë do ta falë si të parin, ndërsa *eudhunen* do ta përsërisë⁷⁴ si në fillim.

TESHEHHUD

Pas reqatit të dytë do të lexojë *ettehijjat* për herë të parë, do t'i dërgojë salavat Resulallahut s.a.v.s., dhe ehli-bejtit, duke vendosur dorën e djathtë mbi kofshë të djathtë, duke i mbledhur gishtat e dorës së djathtë, përpos gishtit tregues, e nuk ka pengesë që të bashkohet edhe gishti i madh. Do të japë shenjë me

⁷³ Të gjitha këto janë sipas hedh'hebi Shafi.

⁷⁴ Sipas medh'hebit Hanefi, në reqatin e dytë nuk lexon as subhaneke, as eudhubillah, sepse këto janë përkshuar të lexohen vetëm për fillimin e namazit.

gishtin tregues të dorës së djathtë kur të thotë *ilallah*, e jo kur të thotë *la ilahe*. Do të qëndrojë ulur në këmbën e majtë, sikur në mes të dy sexhdeve.

Ulja e fundit, pas salavateve Resulallahut s.a.v.s., do të përfundojë me duanë e zakonshme⁷⁵, e sunnetet te kjo ulje janë si te e para. Megjithatë, në uljen e fundit do të ulet në kofshën e majtë, sepse nuk bëhet gati për ngritje, por qëndron aty. Këmbën e majtë do ta shtrijë përfundi vetes⁷⁶, majën e gishtit të madh të këmbës do ta vendos, nëse nuk i vije rëndë, kah kibla, e të djathtën do ta drejtojë, e atëherë do të thotë:

Es-selamu alejkum ve rahmetullah
(Paqja dhe rahmeti i Allahut mbi ju),

duke e kthyer fytyrën kah ana e djathtë, ashtu që faqja e djathtë mund të shihet nga ai që është pas tij nga e djathta, e njëjtë do të kthehet edhe në anën e majtë.

⁷⁵ Muslimi nga Alia r.a., bashkë me duanë fillestare:

“Më pas, e fundit që do të lexojë në mes të teshehudit dhe dhënies selam është: *Allahummagfir li ma kaddemtu...*”

Në të dy Sahihet transmetohet nga Ajsha r.anha:

“Kur dikush nga ju të lexojë teshehudin, le të kërkojë strehim nga katër gjëra: dënimin të xhehenemit...”

Në temën e njëjtë ka edhe transmetime tjera, që gjenden në burimet kryesore.

⁷⁶ Sipas medh’hebit Hanefi, namazlia nuk e vendos përfundi këmbën e majtë, por e shtrinë dhe ulet mbi të.

Atëherë do ta thotë selamin për herë të dytë. Me selam jep shenjë për daljen e tij nga namazi, por selamin mbi të gjitha ia drejton melekëve dhe myslimanëve që janë nga ana e tij e djathtë, dhe herën e dytë të njëjtëve në të majtë. Kur e shqipton fjalen *selam*, nuk do ta zgjasë. Ky është sunnet.

Kështu duket namazi i personit që falet i vetëm. Tekbiret dhe leximin do t'i theksojë me zë, por vetëm aq sa mundet ta dëgjojë veten.

Imami do ta bëj nijet të udhëheqë të tjerët, që me këtë të fitojë shpërblim, e nëse nuk e bën nijet kështu, namazi me xhemat është i drejtë nëse ata e kanë bërë nijet se do të përshtaten, me çka e arrijnë shpërblimin për namazin e falur së bashku.⁷⁷

Do ta lexojë në vete duanë fillestare dhe *eudhubilahun*, njëjtë si ai që falet vetëm. Me të do ta lexojë *Fatihane* dhe suren në të dy reقاتet e farzit të sabashut dhe në dy reقاتet e para të akshamit dhe jacisë, siç bën edhe kur falet vetëm⁷⁸.

⁷⁷ Sipas medh'hebit Hanefi nëse ka femra në xhemat kusht është bëj të nijet që të jetë imam edhe i femrave.

⁷⁸ Në namazet e natës, ai që falet vetëm mund të lexojë në vete, ose me zë (përkthyesi)

Me zë do ta thotë shprehjen *amin*, në namazet ku lexon me zë. Njëjtë do të veprojë edhe *muktediu* (ai që falet me imam). Ai do të thotë *amin* bashkë me imamin, e jo pas tij.

Pas *Fatihasë* imami do të heshtë, që muktediu të lexojë *Fatihane* gjatë kësaj pauze, te namazet ku *Fatihaja* lexohet me zë⁷⁹. Muktediu nuk do të lexojë suren te namazet ku lexohet me zë, përpos kur nuk e dëgjon zërin e imamit. Imami, si edhe muktediu⁸⁰, gjatë ngritjes nga rukuja do të thotë:

Semiallahu limen hamideh.

Në ruku dhe sexhde, imami nuk do ta thotë më shumë se tri herë lavdërimin Allahut Teala (*tesbih*), e as në uljen e parë nuk do të lexojë diçka më shumë se:

Allahumme sali ala Muhammedin ve ala ali Muhammed.

⁷⁹ Sipas medh'hebit Hanefi, muktediu pas imamit nuk lexon asgjë, përpos *subhaneke* dhe *eudhubilahun*, sepsellogaritete leximi i imamit është lexim edhe i muktedisë, pra që leximi i imamit është plotësisht i mjaftueshëm

⁸⁰ Sipas medh'hebit Hanefi, gjatë ngritjes nga rukuja imami thotë: ***Semiallahu limen hamided***, ndërsa muktediu thotë vetëm ***Rabbena lekel-hamd*** (përkthyesi)

Në dy reقاتet e fundit do të mjaftohet vetëm me *Fatiha*, nuk do ta zgjasë shumë namazin, dhe në uljen e fundit nuk do të lexojë dua që është më e gjatë se *ettehijjatu* dhe salavatet.

Duke dhënë selam, imami do të mendojë xhematin dhe melaqet, dhe xhemati ia kthejnë atij selamin e njëjtë. Imami do të presë për një çast, sa të përfundojnë edhe xhemati dhënien e selamit. Do të kthehet me fytyrë kah xhemati. Është mirë të presë nëse mbrapa ka edhe femra, që ato të dalin më herët, ndërsa asnjëri nga xhemati (meshkuj) nuk do të ngritet deri sa nuk ngritet imami.

Imami mund të kthehet djathtas apo majtas, si të dojë, por mua personalisht, ana e djathtë më është më e dashur.

Imami nuk do ta lexojë duanë e Kunutit në namazin e sabahut⁸¹ vetëm për vete, por do ta lexojë me zë, e xhemati do të bëjnë amin duke ngritur duart në lartësi të gjoksit. Do të lëmojë fytyrën në përfundim të duasë, sipas hadithit që flet për këtë. Në të kundërtën, sipas krahasimit, nuk do të duhej të ngritë duart, siç nuk i ngritë as në fund të teshehudit.

⁸¹ Siaps medh'hebit Hanefi, nuk praktikohet leximi i duasës së Kunutit në namaz të sabahut (përkthyesi).

VEPRIMET E NDALUARA NË NAMAZ

Resulallahu s.a.v.s., e ka ndaluar, siç e përmendëm, qëndrim në një këmbë (*safn*) dhe bashkimin e shputave me njëra-tjetrën (*safd*) në namaz. Gjithashtu i ka ndaluar: uljen në majë të gishtave (*ik'a*)⁸², mbështjelljen me rroba (*sedl*)⁸³, ngritjen e rrobave (*keft*)⁸⁴, mbështetjen e duarve në bel (*ih-tisar*)⁸⁵, ngjitjen e nënsqetullave (*salb*)⁸⁶ dhe bashkimin (*muvasala*)⁸⁷.

⁸² Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe nga Alia, me zingjir të dobët:

“...mos u ul në mes të sexhdeve në majë të gishtave...”, e më pas Muslimi nga Ajsha r.anha, që Resulallahu s.a.v.s., e ka ndaluar uljen e shejtanit. Hakimi nga Semuri, që Resulallahu s.a.v.s., ka ndaluar uljen në majë të gishtave, dhe e konsideron të besueshëm.

⁸³ Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Hakimi, që e konsideron të besueshëm, nga Ebu Hurejre.

⁸⁴ Hadith *muttefekun alejhi* nga Ibn Abbas, ku thuhet:

“Na ka urdhëruar Resulallahu s.a.v.s., që sexhden ta bëjmë në shtatë eshtra, e të mos ngritim as flokët as rrobat.”

⁸⁵ Ebu Davudi dhe Hakimi, që e konsideron të besueshëm, nga Ebu Hurejre, e *muttefekun alejhi* është me këtë tekst:

“E ka ndaluar Resulallahu s.a.v.s. që besimtari të falë me duar në bel”

⁸⁶ Hadith me zinxhir të besueshëm që e shënojnë Ebu Davudi dhe Nesai nga Ibn Omeri.

⁸⁷ Rezin e ndërlidhë me Tirmidhiun, por nuk është gjetur te ai. Imam Gazali shpjegon se bëhet fjalë për bashkimin e leximit të Kur’anit me shqiptimin e tekbitit dhe bashkimin e leximit të Kur’anit me rukunë e të ngjashme. Shënojnë edhe Ebu Davudi, Ibn Maxhe dhe Tirmidhiu, që e konsideron të mirë, nga Semure:

“ka dy ndalje që i kam mbajtur në mend që i bënte Resulallahu s.a.v.s., kur hynte në namaz dhe kur përfundonte leximin e

E ka ndaluar që namazlia të durojë nevojën e vogël (*hakin*)⁸⁸, nevojën e madhe (*hakib*)⁸⁹, çorapa ose meste të ngushta (*hazik*)⁹⁰, dhe urinë (*xhai*), si edhe të jetë i zemëruar (*gadban*) dhe me fytyrë të mbuluar (*mutelessim*)⁹¹.

Me *ik'a*, sipas gjuhëtarëve, mendohet në uljen në kofshë e me gjunjë e ngritur, e duart në tokë, ashtu siç bën qeni, derisa sipas dijetarëve të hadithit, mendohet në ulje me këmbët përfundi, në gjunj, ashtu që në tokë i prekin vetëm majat e gishtave dhe gjunjët. Mendim i dijetarëve të hadithit është që *sedl* përbëhet nga mbështjellja në rrobën e vet duke i futur duart brenda, dhe që i mbështjellur ashtu të bëjë ruku dhe sexhde.

Kur'anit, e në dy *Sahihët* përmendet transmetimi nga Ebu Hurejre ku thuhet se Resulallahu s.a.v.s., bënte një ndalje në mes të tekbritit fillëstar dhe leximit të Kur'anit.

⁸⁸ Ibn Maxhe dhe Darekutni nga Ebu Umame. Ebu Davudi nga Ebu Hurejre. E shënojnë edhe Ebu Davud dhe Tirmidhiu, që e konsideron të mirë, në transmetim prej Sevbanit, ndërsa Muslimi nga Ajsher.anha: **“Nuk ka namaz në prani të ushqimit, ose sa e duron nevojën e vogël ose të madhe!”**

⁸⁹ Nuk është gjetur me këto fjalë, por Gazali, duke përcjellë Ezheriun, e shpjegon me ndalesën e cekur më herët, të transmetuar nga Ajsha r.anha.

⁹⁰ Edhe këtë hadith Rezin e ndërli dhë me Tirmidhiun, por nuk e kam gjetur te ai, e megjithatë, autorët e veprave për shprehje të panjohura në hadithe e përmendin transmetimin ku thuhet:

“Personi në mbathje të ngushta nuk mund të mendojë!”

⁹¹ Ebu Davudi dhe Ibn Maxhe: **“E ka ndaluar Resulallahu s.a.v.s., që dikush të mbulojë gojën në namaz”**. Shënon edhe Hakimi dhe e konsideron të besueshëm.

Kështu bënin çifutët në lutjet e tyre, prandaj ndalohej përngjasimi me ta. Njëjtë edhe me këmishën (*kamis*). Nuk do të duhet ta bëjë rukunë as sexhden me duar brenda këmishës.

Disa thonë se kjo nënkupton vendosjen e pjesës së epërme të mantelit në kokë, e qoshet t'i lëshohen në të djathtë e në të majtë, e jo krahëve. Mendimi i parë, megjithatë është më i pranueshëm.

Keft është ngritja e rrobave përpara ose mbrapa, kur niset për sexhde, e mund të ndërlidhet edhe me flokët, prandaj mashkulli nuk do të duhej assesi të falë namaz me flokë të gërshetuara. Në hadith thuhet:

“Më është urdhëruar të bëj sexhden në shtatë pjesë të trupit dhe të mos mbledhi rrobat as flokët.”⁹²

Ahmed ibn Hanbelit r.a., nuk i pëlqente të lidhë rrip përmbi këmishë në namaz, duke e konsideruar këtë veprim të ndaluar.

Ihtisar është vendosja e duarve anash në bel, derisa *salb* është vendosja e duarve nën sqetulla kur qëndron në këmbë, e të largojë bërnylët nga njëri-tjetri.

⁹² *Muttefekun alejhi*, nga Ibn Abbas.

Muvasele (mënyrë, komunikim) janë pesë, prej të cilave dy kërkohen nga imami:

1. *Kur merr tekbin të mos fillojë menjëherë me lexim, por të presë pak; dhe*

2. *Kur e përfundon leximin të mos shkojë në ruku menjëherë, por të pushojë për një moment.*

Dy tjera kërkohen nga xhemati:

3. *Xhemati nuk duhet ta bëjë tekbin fillestar bashkë me imamin, por të presë pak e pastaj ta bëj; dhe*

4. *Selamin ta japë pas selamit të imamit.*

E një kërkohet edhe nga imami edhe nga xhemati:

5. *Kur jep selamin e parë që është farz, të presë pak e pastaj të japë edhe selmin e dytë.*

Me *hakin* nënkuptohet personi që duron nevojën e vogël (falja e namazit në këtë gjendje është mekruh) e me *hakib* ai që duron nevojën e madhe, ndërsa *hazik* është personi me çorapë ose meste të ngushta. Të gjitha këto pengojnë përlësinë (*hushu*) në namaz. Njëjtë edhe uria dhe shqetësimi.

Se namazi në gjendje të uritur është i papëlqyeshëm (mekruh), kuptohet nga ky hadith:

“Kur ushqimi është gati dhe ka hyrë koha e namazit, së pari hani.”⁹³,

pos nëse ka mbetur shumë pak kohë ose personi nuk është shumë i uritur.

E në një transmetim thuhet:

“Asnjëri prej jush mos ta nisë namazin i mërrolur, dhe asnjëri prej jush mos të falë kur është nervoz!”⁹⁴

Hasan Basriu thotë:

“Secili namaz në të cilin zemra nuk është prezent, është më afër dënimit!”

Në hadith thuhet:

“Shtatë gjëra në namaz janë nga shejtani: rrjedhja e gjakut nga hunda, dremitja, vesvesja, gogësima (hapja e gojës), kruarja, shikimi djathtas apo majtas dhe loja me ndonjë send”,

e disa e shtojnë edhe gabimin.⁹⁵

⁹³ *Muttefekun alejhi* nga Ibn Omeri r.a., dhe Ajshe r.anha.

⁹⁴ Nuk është gjetur në burime.

⁹⁵ Tirmidhiu nga Adijj ibn Sabit, ai nga i ati, e ai nga gjyshi duke përmend gjakun nga hunda, dremitjen dhe gogësimën,. I përmend

Disa nga selefitë kanë thënë:

“Katër gjëra janë gabim në namaz: shikimi anash, lëmimi i fytyrës, rrafshimi i sexhades dhe falja aty ku dikush mund të kalojë përpara.”

Ndalohet gjithashtu të ndërthurë gishtat⁹⁶, të kërcasë me gishta⁹⁷, të mbulojë fytyrën⁹⁸, të vendosë një shuplakë në tjetrën dhe që në ruku t’i fusë mes kofshëve⁹⁹.

edhe tri tjerat, por thotë se është transmetim *garib*. Te Muslimi shënohet nga Ebul-As:

“Ja Resulallah, shejtani vërtetë që hyn mes meje dhe namazit tim...”

Te Buhariu përmendet transmetimi nga Ajshe r.anha., për kthimin në namaz, për çka thuhet se është **vjedhje e namazit nga shejtani**. Buhariu dhe Muslimi përmendin hadhithin nga Ebu Hurejre ku thuhet se gogësima është nga shejtani, e gjithashtu, që të dy, njëjtë nga Ebu Hurejre:

“Vërtetë, kur dikush nga ju ngritet për namaz, shejtani i vjen dhe ia bën rrëmujë namazin, ashtu që ky nuk e di sa i ka falur”

⁹⁶ Ahmedi, Ibn Hibban, Hakimi, që në transmetim nga Ebu Hurejre e konsideron të besueshëm, pasta j Ebu Davudi, Tirmidhiu, Ibn Maxhe dhe Ibn Hibban të ngjashëm, nga Ka’b ibn Uxhra.

⁹⁷ Ibn Maxhe nga Alia me zinxhir të dobët të transmetuesve.

⁹⁸ Ebu Davud, Ibn Maxhe dhe Hakimi, që e konsideron të besueshëm, nga Ebu Hurejre, dhe më herët u përmend hadithi për mbulimin e gojës.

⁹⁹ *Muttefekun alejhi* nga Sa’d ibn Ebu Vekkas:

“Vepronim ashtu, dhe na u ndalua, e na u urdhërua të vendosim shuplakat në gjunj.”

Njëri prej as'habëve ka thënë:

“Ne në fillim vepronim ashtu në ruku e pastaj na u ndalua!”

Gjithashtu, është e papëlqyer (*mekruh*), që gjatë sexhdes të fryjë në dysheme që ta pastrojë ose ta rrafshojë me dorë, sepse për të gjitha këto në namaz nuk ka nevojë.

Personi që e falë namazin nuk duhet të qëndrojë në një këmbë (që tjetrën ta pushojë), e kur qëndron në këmbë (*kijam*) nuk duhet të mbështetet në mur ose në shtyllë, as nëse fillon të rrëzohet, sepse atëherë gjithsesi që namazi i tij nuk do të ishte i drejtë.

SHPJEGIMI VEÇ E VEÇ I FARZEVE DHE SUNNETEVE

Këto që i përmendëm deri tani janë farzet (obligimet)¹⁰⁰, sunnetet, edebi dhe format për të cilat udhëtari i ahiretit duhet të jetë i kujdesshëm.

Dymbëdhjetë prej tyre janë farz:

1. Nijeti;
2. Tekbiri fillestar (*iftitah terbir*);
3. Qëndrimi në këmbë (*kijam*);
4. Leximi i Fatihasë;
5. Përkulja (*ruku*) në qetësi, ashtu që meshkujt kapin gjunjët me duar;
6. Ngritja nga rukuja, ashtu që drejtohet dhe qëndron pa lëvizje;
7. Bërja e sexhdes në qetësi të plotë (nuk obligohet vendosja e duarve në tokë);¹⁰¹
8. Ulja në qetësi mes dy sexhdeve;
9. Ulja e fundit. (pas dy sexhdeve);¹⁰²
10. Leximi i *ettehijjatu*;

¹⁰⁰ Për veprimet e obliguara sipas medh'hebit Hanefi, shih fundin e këtij libri.

¹⁰¹ Siaps medh'hebit Hanefi, shtatë pjesët e trupit duhet të jetë në tokë.

¹⁰² Siaps medh'hebit Hanefi në teshehudin e fundit ulja për një kohë sa që lexohet tehijjat është farz, por leximi i tehijjatit është vaxhib.

11. Dërgimi i salavateve Resulallahut s.a.v.s.; dhe

12. Dhënia e selamit të parë,

e nijeti për përfundimin e namazit nuk është farz.

Pra, këto janë farzet, veprimet tjera nuk janë farz, por janë sunnet¹⁰³, ani pse kanë formë të njëjtë. E sunnetet e namazit janë *veprime* dhe *lexime*.

Veprimet sunnet janë:

1. Ngritja e duarve në tekbinin fillestar;
2. Ngritja e duarve kur shkon në ruku;
3. Ngritja e duarve gjatë ngritjes prej rukusë;
4. Ulja në teshehudin e parë.

Si zgjërohen gishtat dhe deri ku ngriten, për çka tashmë folëm, shkojnë bashkë me këtë sunnet. Ulja mbi këmbë dhe zgjatja e këmbës, shikimin i drejtuar në një pikë dhe moskthimi djathtas apo majtas janë forma që i takojnë uljes. Ulja për frymë (*xhelsetul-istihara*) nuk u përmend si sunnet i veçantë sepse është zbukurim i ngritjes nga sexhdeja në këmbë, e jo qëllim në vete.

Leximet sunnet janë:

1. Duaja hyrëse (*subhaneke*);
2. Eudhu-besmele;

¹⁰³ Për shkak që në medh'hebin Shafi nuk ka vaxhib, prej farzeve kalon në sunnete.

3. Shqiptimi i *aminit* – ky është sunnet *muekkede*;
4. Leximi i sures;
5. Tekbiret gjatë kalimit (pos tekbirin fillestar);
6. Tesbihët në ruku dhe sexhde si dhe shqiptimi i *Semiallahu limen hamideh e Rabbena ve lekel hamd* në ngritje nga rukuja;
7. Leximi i ettehijjatu në uljen e parë;
8. Salavate Resulallahut s.a.v.s., në uljen e parë;
9. Leximi i duasë në përfundim të uljes së fundit;
10. Selami i dytë.

Ani pse të gjitha këto i përmendëm si sunnete, ato kanë grada të ndryshme, sepse katër prej tyre kompenzohen me bërjen e *sehvi-sexhdes*¹⁰⁴. Një veprim sunnet kompenzohet me *sehvi-sexhde*, që është ulja e parë për lexim të *teshehhud*-it të parë. Kjo i ndihmon vëzhguesit ta kuptojë strukturën e namazit dhe t'a dije se a është namaz katër reقاتësh, për dallim nga ngritja e duarve, që nuk dallon, pa marrë parasysh strukturës. Ato quhen *pjesë*, e thuhet se pjesët kompenzohen me

¹⁰⁴ Sipas medh'hebit Hanefi, *sehvi-sexhde* bëhet që të plotësohet mangësia e namazit që ndodh me lëshimin e një a më shumë vaxhibeve pa qëllim. Nuk bëhet për lëshim të sunnetit, sepse namazi nuk konsiderohet i mangët, e nuk bëhet as për lëshimin e njërit prej farzeve, sepse atëherë namazi është prishur dhe nuk mund të përmirësohet me *sehvi-sexhde*.

sehvi-sexhde. Tri lexime të humbura kërkojnë bërjen e *sehvi-sexhdes*:

1. Bërja e duasë së Kunutit;
2. Leximi i parë i ettehijjatu; dhe
3. Dërgimi salavat Resulallahut s.a.v.s., në uljen e parë.

Kjo dallon nga tekbiri në kalim dhe leximi në ruku e sexhde si edhe drejtimit pas tyre, sepse ruku dhe sexhde me formën e tyre janë të pazakonshme dhe me to arrihet kuptimi i ibadetit, edhe pa lexim të dhikrit dhe tekbirit në kalim, sepse mungesa e këtyre leximeve nuk e ndryshon formën e ibadeteve.

Ulja për të lexuar *ettehijjatun* e parë është veprim i zakonshëm dhe është shtuar vetëm leximi i *teshehudit*, prandaj nëse kjo lëshohet, ndikimi është i qartë. Lëshimi i leximit të duasë hyrëse dhe sures nuk ndikon në rregullsinë e namazit, sepse kijami me *Fatihanë* është veprim i bekuar, prandaj dallon nga një veprim i thjeshtë. Njëjtë është edhe me duanë në uljen e fundit, deri sa duaja e Kunutit është e fundit që kompenzohet me sehvi-sexhde. Megjithatë, për shkak të saj është përcaktuar që të qëndrohet më gjatë në kthim nga rukuja në namaz të sabahut, prandaj është sikur zgjatja e uljes për të kthyer frymën, sepse me zgjatjen gjatë leximit të *ettehijjatu* bëhet ulje për teshehudin e parë, prandaj edhe kjo mbetet qëndrim i zakonshëm i zgjatur

ku nuk ka lexim të obligueshëm. Me zgjatje bëhet dallimi prej namazeve tjera, e me moslexim të dhikrit të obligueshëm bëhet dallimi nga kijami i parë në namaz.

Nëse ti pyet:

“Dallimi i farzit prej sunnetit është i kuptueshëm sepse vlefshmëria e namazit varet nga kryerja e farzeve, për dallim nga sunnetet, dhe për moskryerje të farzit dënohet, për dallim nga moskryerja e sunnetit; por pse sunnetet dallojnë mes vete, kur është e lavdëruar të bëhen të gjitha, dhe nuk ka dënim për mosbërje të asnjërit prej tyre, ndërsa shpërblimi është për të gjitha së bashku, ku është pra kuptimi i kësaj?!”,

dije se fakti se e kanë të përbashkët shpërblimin, dënimin dhe lavdërimin, nuk i kundërshton dallimet mes tyre. Le ta shpjegojmë këtë me një shembull:

Njeriu nuk konsiderohet njeri, krijesë e plotë, pa përmbajtje të brendshme dhe organe të jashtme. Përmbajtje të brendshme janë jeta dhe shpirti, e të jashtme janë gjymtyrët. Nëse mungon ndonjë nga ato gjymtyrë, si zemra, mëlçia apo truri, as njeriu nuk mund të mbijetojë, nëse një prej tyre mungon - nuk ka jetë. Me mungesën e ndonjë organi tjetër, megjithatë nuk ndalon jeta, por mungojnë synimet e jetës, siç janë syri, dora, këmba, gjuha. E me mungesë të ndonjë organi

tjetër, as nuk ndalon jeta, as nuk i mungojnë synimet, por humbet bukuria, siç janë vetullat, mjekra, qerpikët, çehreja e bukur. Me mungesë të disa tjerave, nuk humbet as bukuria por vetëm cenohet, siç janë vetullat e lakuara, ngjyra e qimeve në mjekër dhe qerpikë, përmasat mes gjymtyrëve dhe lëkura e mirë. Këto janë grada të ndryshme. Njëjtë ibadeti është një tërësi që e formëson sheriati, e ne i nënshtrohemi Allahut duke e zbatuar atë. Shpirti dhe jeta e brendshme e atij ibadeti është përlësia, nijeti, prania e zemrës, sinqeriteti, për çka do të flasim, por tash jemi te pjesët e tij të jashtme. Rukuja, sexhdeja, kijami dhe pjesët tjera përbërëse të namazit (*ruknet*) janë si zemra, koka e mëlçia, e pa to nuk ka namaz. Sunnetet që i përmendëm, ngritja e duarve, dua ja hyrëse (*subhaneke*) dhe teshehudi i parë janë si duart, sytë, këmbët. Namazi mbetet i drejtë edhe kur mungojnë, siç nuk humbet jeta nëse nuk ka duar a sy a këmbë, por personi që këto i mungojnë ka formë të ndryshuar dhe nuk është atraktiv. Kështu edhe ai që kufizohet me pjesën më të vogël të mundshme të namazit është sikur personi që ia fal sundimtarit një skillav, por pa gjymtyrë.

Format, që nuk llogariten as si sunnete janë sikur shkaktarët e bukurisë: vetullat, mjekra, qerpikët dhe çehre e mirë, derisa leximet e përshkuara në ato sunnete janë sikur gjërat që e plotësojnë bukurinë, siç

janë vetullat e lakuara, kufizimi i mjekrës e të ngjashme. Namazin e ke mjet për afrim dhe dhuratë me të cilën i afrosh të Gjithëfuqishmit, Sundimtarit të sundimtarëve, mu sikur një robëreshë që ia dhuron sundimtarit ai që kërkon afërsinë e tij. Kjo dhuratë del para Allahut Teala, e ty do të kthehet në ditën e llogarisë më të madhe, dhe ti mund të zgjedhësh a do ta zbukurosh apo ta shëmtosh. Nëse e bën në mënyrë të bukur, epo – dobia është e jotja, e nëse e bën keq, kjo është në dëmin tënd. Angazhimi yt në fikh nuk duhet të jetë vetëm dallimi i sunnetit nga farzet, dhe që nga vetitë e sunnetit të mbashë mend vetëm atë se lejohet të braktiset dhe kështu të mos e bësh. Ajo është sikur mjeku të thotë:

- *Nxjerrja e syrit nuk do ta mbysë njeriun,*

por kjo gjithsesi se e shkurton ymytin se ai person do të pranohej si dhuratë, kur të dalë para sundimtarit.

Kështu duhet të kuptosh gradat e sunnetit, format dhe edebet në namaz, sepse secili namaz në të cilin personi nuk e bën drejtë rukunë dhe sexhden, kjo do t'i bëhet kundërshtari i parë i tij. Atij, namazi do t'i thotë:

- *Siç më rrënove ti mua, le të rrënojë ty Allahu!*

Kthehu pak te hadithet që i përmendëm lidhur me plotësimin e namazit, për të vërejtur ndikimin.

Kapitulli i tretë

KUSHTET E BRENDSHME TË VEPRIMEVE TË ZEMRËS

Do të përmendim në këtë kapitull ndërlidhjen e namazit me përlësinë dhe praninë e zemrës, më pas do të përmendim kuptimet e brendshme, vendosmërinë e tyre, shkaktarët dhe mënyrat e shërimit.

SHPJEGIM I KUSHTËZIMIT TË PËRULËSISË DHE PRANISË SË ZEMRËS

Argumentet janë të shumta, e mes tyre edhe fjalët e Allahut Teala:

“pra Mua më adhuro dhe fal namazin për të më kujtuar Mua.” 20-Ta Ha: 14

Është e qartë që urdhri është obligues, e pakujdesia është e kundërta e kujtimit, prandaj ai që është i pakujdesshëm gjatë gjithë namazit të tij, si mund të falë namaz për të kujtuar Allahun Teala?! E fjalët e Allahut:

“...mos u bën i pakujdesshëm.” (7-Araf: 205), janë një ndalesë, e në kuptimin *zahir* këtu, *pakujdesi* është haram.

Fjalët e Allaut Teala:

“...mos iu afroni namazit duke qenë të dehur, derisa të dini se ç'flitni.” (4-Nisa: 43),

shprehin arsyen e ndalesës për pijanecin, që është njejtë si ai që falë namaz i thelluar në mendimet e dynajllëkut e në vesvese; as ai me këtë pakujdesi nuk e di se çka këndon, bile nuk e di as sa reqate i ka falë.

HADITHET NË KËTË ÇËSHTJE

Fjalët e Resulallahut s.a.v.s.:

“Namazi është vetëm gjendje e varësisë dhe përrulësisë”,

janë përmbledhur në veprime, e shprehja *innema* (vetëm) shprehë vërtetimin dhe përforcimin e kësaj.

E nga fjalët e Resulallahut s.a.v.s.:

“E drejta e blerjes më të rëndësishme ka të bëjë vetëm me atë që nuk është e ndarë”,

fakihët kanë kuptuar zbatimin, vërtetimin dhe negacionin.

Resulallahu s.a.v.s., thosë:

“Atë që namazi i vet nuk e largon nga veprat e këqija e të turpshme, ai vetëm largohet nga rahmeti i Allahut”,

e namazi i të pakujdesshmit nuk ndalon veprat e këqija e të turpshme!

Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Sa ka namazli që nga namazi i tyre kanë vetëm lodhje e zahmet!”¹⁰⁵,

dhe me këtë sigurisht që ka menduar në namazin e të pakujdesshmin.

E Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

“Personi nga namazi i tij ka vetëm aq sa ka qenë i vetëdijshëm në të!”¹⁰⁶

Rezultat i kësaj është se namazliu bisedon intimisht¹⁰⁷ me Rabbin e vet, siç e dëshmojnë transmetimet, mirëpo të folurit e pakujdesshëm nuk mund të jetë bisedë intime.

¹⁰⁵ Nesai dhe Ibn Maxhe nga Ebu Hurejre, si edhe Ahmedi, e zinxhirin e transmetuesve e ka të mirë.

¹⁰⁶ Nuk i kam gjetur si fjalë të Resulallahuts.a.v.s., por Muhammed ibn Nasr el-Merzevi e shënon si *mursel* në ***Kitabus-Salah***, nga Osman ibn Ebu Dehresh si edhe Ebu Mensur Dejlemiu në ***Musnedul-firdeus*** nga Ubejj ibn Ka’b, e Ibnul-Mubarek në ***ez-Zuhd*** nga Ammari si hadith *mevkuf*

¹⁰⁷ Hadith *Muttefekun-alejhi* nga Enesi

Këtë e shpjegojmë ashtu që, për shembull, edhe nëse dikush jep zeqatin pa vëmendje, kjo i pranohet, sepse është një ibadet që nefsit i vjen shumë i rëndë dhe është kundër dëshirës së tij. Edhe agjërimi është i tillë - ibadet që e then forcën dhe dëshirat e nefsit, e që janë vegla e shejtanit; edhe nëse bëhet pa vëmendje, ai e siguron këtë dobi. Edhe haxhi është një ibadet i vështirë dhe i lodhshëm, dhe pa marrë parasysh se a është prezent edhe me zemër gjatë kryerjes së haxhit apo jo, kjo i shkakton dhimbje nefsit.

E në namaz ka vetëm dhikr, lexim të Kur'anit, ruku, sexhde, qëndrim në këmbë dhe qëndrim ulur. Dhikri është lutje dhe bisedë intime me Allahun Teala, sepse qëllim i namazit edhe është njëra nga këto dyja: ose lutja ose biseda intime.

Ashtu siç sprovohen barku dhe epshi me abstenim gjatë agjërimit, ose siç sprovohet trupi me vështirësitë e haxhit, ose zemra me vështirësinë e dhënies së zeqatit apo dorëzimin e pronës së dashur, edhe guha sprovohet me zë dhe shkronja.

Padyshim që kjo është kështu, sepse sprova me fjalët boshe që thuhet pa vëndje, nuk është sprovë e veprimit, por qëllim janë vet shkronjat, të folurit, Shkronjat që nuk e shprehin atë që është në zemër nuk do të jetë e folur; atë që është në zemër do të shprehë vetëm me prezencën e zemrës.

Çfarë lutje drejtuar Allahut Teala është ajo me fjalët:
“Udhëzona në Rrugën e drejtë...” (1-Fatiha: 5),

kur zemra është e pavëmendshme dhe nuk e ka për qëllim që kjo të jetë një lutje e përvuilur dhe një dua?! Çfarë vështirësie paska në rrotullim të pakujdesshëm të gjuhës për t'i thënë këto fjalë, sidomos kur gjuha mësohet?!

Kështu është puna me dhikrin.

Aq më shumë, e theksoj se - nëse dikush do të betohej duke thënë:

- Do t'i falënderohem filanit, do ta lavdëroj dhe do t'i lutem për një shërbim,

e më pas fjalët me këto kuptime do të dilnin nga gjuha e tij në ëndërr, ai nuk e ka përmbushur betimin e vet.

Edhe po t'i thuheshin këto fjalë në terr tjetrit që është aty prezent, por që ky nuk e njeh atë person dhe as nuk e sheh, as atëherë ky nuk do ta përmbushte betimin sepse fjalët e tij nuk konsiderohen adresim as bisedë me të, përderisa tjetri nuk është plotësisht i pranishëm në zemrën e tij.

Bile, edhe nëse i thotë këto fjalë në pikë të ditës e në prezecë të personit tjetër, por i thelluar në mendimet e veta, duke mos qenë i vetëdijshëm që personi është prezent, përsëri nuk e përmbushë betimin, sepse nuk po e pranon tjetrin si bashkëbisedues.

Nuk ka aspak dyshim se qëllim i leximit të Kur'anit dhe i dhikrit është falënderimi (*hamd*) dhe lavdërimi, lutja e përvuilur dhe duaja, e Ai të cilit i drejtohem i është Allahu Teala, dhe përderisa zemra e njeriut është nën perden e pakujdesit, nuk mund ta sodisë shpirtërisht Allahun.

Aq më shumë, i tilli është i pakujdesshëm ndaj Atij të Cilit i drejtohet, e gjuha i lëvizë vetëm pse i është bërë shprehi. Sa larg është kjo prej asaj që dëshirohet me namaz, i cili na është urdhëruar për të pastruar zemrën, të ripërtërijë kujtimin në Allahun Teala, dhe të rrënjosë besimin në Allahun. Kështu duhet lexuar Kur'ani; me një fjalë - kjo është e folur që nuk mund të injorohet dhe me të cilën dallohet nga veprimi.

Ndërsa qëllim i rukusë dhe sexhdes padyshim që është shprehja e respektit ndaj Allahut. Rukuja dhe sexhdeja e bërë pa vëmendje nuk pranohet si respekt. E pasi nuk pranohet si respekt, ajo mbetet vetëm lëvizje e trupit.

Kur humbet nderi i atij veprimi dhe mbetet vetëm lëvizja e trupit, aty nuk ka sprovë, e namazi është bërë shtyllë e fesë, namazi e ndanë imanin prej kufrit, dhe i jepet përparësi ndaj haxhit dhe ibadeteve tjera, prandaj është e domosdoshme të kryhet dënimi me vdekje mbi atë që e braktisë.

Nuk mendoj që namazi e ka një vend kaq të rëndësishëm vetëm për shkak të veprimeve të tij të jashtme, përpos nëse atyre veprimeve ju shtohet edhe kuptimi i bisedës intime, sepse kjo i jep përparësi namazit ndaj agjërit, zekatit, haxhit dhe ibadeteve tjera.

Namazit i është dhënë përparësi edhe ndaj kurbanit që bëhet si luftë kundër nefsit, duke harxhuar pasurinë. Allahu Teala thotë:

“Tek Allahu nuk arrin as mishi, as gjaku i tyre, por arrin bindja juaj” (22-Haxh: 37),

pra, është cilësia që mbizotëron në zemër, e cila e nxitë në kryerjen e urdhrave që i janë caktuar. Prandaj, si mund të jenë urdhëruar lëvizje të parëndësishme në namaz?

Këto shpjegime e bëjnë të qartë pse prezenca e zemrës në namaz është kusht.

E nëse ti pohon:

“Kur thua se namazi e ka kusht për rregullsinë e tij praninë e zemrës, ti po i kundërvihesh konsesuzit të fakihëve, sepse ata e kanë kushtëzuar praninë e zemrës vetëm në nijet!”,

atëherë dije se më herët, në *Librin për diturinë*, është thënë që fakihët nuk janë marrë me të brendshmen e as nuk e shikojnë zemrën dhe nuk përzihen në udhëtimin e ahiretit, por janë mbështetur në vendime të jashtme të fesë lidhur me veprimet e dukshme të gjymtyrëve.

Zbatimi i veprimeve të dukshme të mjaftojnë të shpëtosh nga dënimi me vdekje ose ndonjë dënim tjetër nga Sundimtari, por se a do të ketë përfitim në ahiret, kjo është jashtë fokusit të fikhut.

Bile as nuk mund të flitet për konsensus në këtë temë, e Sufjan Sevriu tregon nga Ebu Talib Mekki që Bishr ibn Haris ka thënë:

“Namazi pa u përulur, është namaz i prishur.”

Tregohet që edhe Hasan Basriu ka thënë:

“Secili namaz ku zemra nuk është e pranishme, është më afër dënimit!”,

e Muadh ibn Xhebel thotë:

“Ai që në namaz shikon se kë e ka në të djathtë e në të majtë, nuk ka namaz!” .

E përmes zinxhirit të transmetuesve, gjithashtu na vijnë fjalët nga Resulallahu s.a.v.s.:

“Njeriu vërtetë fal namaz, por nuk i shkruhet as e gjashta pjesë, as e dhjeta, por i shkruhet vetëm aq sa ka qenë i vetëdijshëm!”¹⁰⁸

Sikur kjo të na përcjellej nga dikush tjetër, do ta konsideronim mendim juridik; e si pra të mos e pranojmë hadithin?

Edhe Abdulvahid ibn Zejd ka thënë:

“Dijetarët islamë janë pajtuar unanimisht se njeriu ka nga namazi i vet përfitim vetëm aq sa ka qenë i vetëdijshëm në të.”

Ai këtë e konsideronte pajtim të mendimeve. Dhe aq shumë thënie të këtilla janë përcjellë nga fakihët e devotshëm dhe nga ulematë e ahiretit, sa nuk mund të numërohen. Fakt është se në këtë çështje duhet t'i kthehemi argumenteve të shariatit.

¹⁰⁸ Ebu Davudi, Nesai dhe Ibn Hibban, nga Ammar ibn Jasir.

Edhe pse transmetimet qartë e përkrahin prezencën e zemrës si kusht, fetvaja për obligim të përgjithshëm përcaktohet sipas mangësive të popullit, dhe është e pamundur t'i kushtëzohet popullit prezenca e zemrës gjatë gjithë namazit, sepse këtë vetëm pakica do të mund ta zbatonte.

Dhe pasi nuk është e mundur të kushtëzohet prezenca e zemrës gjatë gjithë namazit, kjo kushtëzohet qoftë edhe për një moment, e momenti më i rëndësishëm për këtë është tekberi fillestar, dhe për këtë arsye si obligim jemi kufizuar me kaq.

Krahas kësaj që e përmendëm, shpresoj që gjendja e personit të pavëmendshëm gjatë namazit nuk është si gjendja e atij që nuk fal namaz, sepse ky megjithatë do të kryej veprimet e jashtme, dhe së paku për një çast do të jetë i pranishëm me zemër.

Dhe si të mos jetë ky më mirë, kur edhe ai që nga harresa falë namaz pa abdes, namazin e ka gabim, e prapë do të ketë ndonjë shpërblim për veprimin, varësisht mangësisë dhe pendimit.

Bashkë me shpresën është edhe frika që gjendjen mos ta ketë më të keqe se ai që plotësisht braktisë namazin. E si të mos ketë frikë, kur ai që i shërben zotëriut dhe e injoron atë, flet pa kujdes e me nënvlerësim, vërtetë që është në gjendje më të keqe se sa ai që fare nuk shërben.

Kur të ballafaqohen arsyet e shpresimit dhe të frikës, dhe kur situata bëhet vetvetiu më e komplikuar, ti pas kësaj mund të zgjedhësh se a do të kesh kujdes, e kështu të mbrohesh, apo do të sillesh me mospërfillje.

E gjitha kjo nuk e bartë dëshirën për kundërshtim të fakihëve në fetvanë e tyre se namazi është i pranuar, edhe me pakujdes, sepse fetvaja ashtu duhet të jetë, për çka treguam më herët.

Por, ai që e ka kuptuar esencën e namazit, e di që ajo esencë të kundërt e ka pakujdesin, mirëpo e kemi përmendur në pjesën për dallimet në mes të diturisë së brendshme dhe asaj të jashtme, në *Librin për themelet e besimit*, që mangësia e njerëzve është një prej arsyeve që pengon shfaqjen e fshehtësive të shariatit.

Prandaj në këtë studim do të kufizohemi me kaq. Kjo do t'i mjaftojë muridit që është në kërkim të rrugës së ahiretit, derisa atij që dëshiron zëshëm të polemizojë, nuk duam as t'i drejtohemi.

Kuptimi i asaj që u tha është se prania e zemrës është shpirti i namazit, e më së paku me çka mbahet gjallë shpirti është prania e zemrës në tekbirin fillestar, e nëse as atëherë nuk e ka, namazi ka dështuar.

Me rritjen e pranisë së zemrës, shpirti i namazit shtrihet në pjesët e tij, e sa ka të gjallë e që nuk lëvizin, që janë më afër të vdekurve. Namazi i atij që gjithë kohën është i pakujdesshëm, përpos në tekbirin fillestar, është sikur jeta pa lëvizje, e nga Allahu lusim ndihmë për të mirë.

SHPJEGIM I KUPTIMEVE TË BRENDSHME ME TË CILAT PLOTËSOHET GJALLËRIA E NAMAZIT

Dije se këto kuptime manifestohen në mënyra të ndryshme, por të gjitha i përmbledhin këto gjashtë pika:

- prania e zemrës (*hudhuru-kalb*),
- të kuptuarit e asaj që lexon (*tefehhum*),
- shprehja e respektit (*ta'zim*),
- frikë-respekti (*hejbet*),
- shpresa (*rexha*), dhe
- turpi (*haja*).

Do t'i përshkruajmë detajisht, e pastaj do të japim edhe shpjegimin si të përvetësohen ato.

Hudhuru-kalb do të thotë të mendojë vetëm atë në çka angazhohet dhe që e lexon, largimi i zemrës nga masiva¹⁰⁹, lidhja e plotë e zemrës me veprimin në të cilin është i angazhuar dhe me fjalën (e Kur'anit) që e lexon.

¹⁰⁹ *Mâsivâ*: çdo gjë përveç Allahut. Është një term që përdoret për çdo gjë, përveç Allahut

Në këtë mënyrë bashkohen dituria, fjala e veprimi, dhe mendimi nuk largohet nga kjo. E kur në zemër e ka vetëdijen për atë që po e vepron, assesi nuk është i pavëmedshëm ndaj veprimit të vet dhe vetëm atë e mendon, atëherë realizohet *hudhuri-kalb*.

Tefehhum është të kuptuarit e asaj që lexon, dhe kjo vjen pas *hudhuri-kalb*. Kjo sepse zemra shumë herë bëhet gati me fjalë por nuk ua mendon kuptimin. Me *tefehhum* nënkuptojmë të menduarit dhe të kuptuarit e fjalës që e thotë.

Kjo është grada ku dallojnë njerëzit, sepse nuk e kuptojnë të gjithë njësoj Kur'anin dhe tesbihët. Sa ka kuptime të thella që i arrijnë namazliut gjatë namazit, e asnjëherë më parë të mos i ketë menduar.

Pikërisht falë kësaj namazi ndalon prej veprimeve të turpshme dhe të shëmtuara, sepse ai namaz jep kuptime të tilla që patjetër e largojnë njeriun nga e keqja.

Ta'zim (respekti) vjen pas *hudhuri-kalb* dhe *tefehhum*. Kur personi i drejtohet shërbëtorit të vet, zemrën e ka prezent dhe i kupton fjalët që i thotë, por nuk shprehë respekt. Prandaj *ta'zim* (respekti) vjen pas pranisë së zemrës dhe të kuptuarit.

Hejbet (frikë-respekti) vjen pas respektit. *Hejbet* është frikë që buron nga respekti (*ta'zim*), e ai që nuk ndjenë frikë nuk ka frikë-respekt. Frika nga akrepi, nga vesi i keq i dikujt dhe të njëjta kështu të ulëta, nuk quhen *frikë-respekt* por quhen vetëm *frikë*, e frika nga sundimtari i nderuar, kjo po - quhet *frikë-respekt*. Domethënë, frikë-respekti burim e ka respektin.

Rexha (shpresa). Kjo padyshim që është e veçantë. Sa ka të tillë që e lartësojnë ndonjë sundimtar, i frikësohen, por nuk presin prej tij shpërblim për këtë. E besimtari duhet të shpresojë në shpërblim nga Allahu Teala për namazin e vet, njëjtë siç frikësohet nga dënimi i Allahut për lëshimet e veta.

Haja (turpi); edhe kjo është diçka e veçantë. Baza e kësaj është të tregojë mangësitë dhe gabimet e veta.

Sa i përket sebepeve të këtyre gjashtë kuptimeve: dije se sebeci i pranisë së zemrës (*hudhuri-kalb*) është dëshira për ngritje (*himme*). Zemra jote ndjekë atë që ti dëshiron dhe është e pranishme vetëm në atë çfarë është qëllimi yt dhe për çka zemra jote është përgatitur.

Kur ti synon diçka, zemra jote e mendon atë, me apo pa dëshirën tënde. Zemra i përshtatet dhe i shërben qëllimit.

Nëse zemra jote nuk e mendon namazin që je duke e falë, ajo nuk rri bosh; me siguri është duke e menduar ndonjë qëllim nga dynjallëku.

Për të siguruar praninë e zemrës (*hudhuru-kalb*) në namaz, zgjidhje e vetme është të lidhet dëshira me namazin. E, nuk do të ketë dëshirë për namazin përderisa nuk i bëhet e qartë se kusht i domosdoshëm është besimi dhe vërtetimi me zemër se ahireti është më i mirë dhe i përhershëm dhe që namazi është rrugë për në ahiret.

Kur ky besim dhe vërtetim bashkohet me diturinë e cila qartë e vërteton se kjo botë dhe pasuria e saj është e pavlerë, prania e zemrës në namaz realizohet.

E nëse zemra nuk është e pranishme në bisedën intime me Sunidmtarin e sundimtarëve, e në dorën e Tij janë edhe kjo botë edhe bota tjetër, edhe dobia edhe dëmi, assesi mos mendo që aty ka arsye tjetër, përpos dobësisë së imanit, *prandaj* menjëherë angazhohu në forcim të imanit, e mënyra si bëhet kjo është e shpjeguar në detaje në libra tjerë.

Shkaktar për të kuptuarit (*tefehhum*), pas pranisë së zemrës (*hudhuri-kalb*), është të menduarit e thellë dhe

drejtimi i mendimeve kah njohja e kuptimeve, e trajtimin e ka njëjtë si te prania e zemrës, duke u drejtuar kah mendimi dhe gatishmëria për të larguar mendimet e panevojshme.

Mënyra për të larguar mendimet e panevojshme që na preokupojnë është t'ju këputen rrënjët, pra të çlirohet nga shkaktarët që i tërheqin ato mendime, dhe përderisa nuk këputen këto rrënjë, as këto mendime nuk do të mund të largohen. Kush don diçka, e përmend shpesh, e përmendja e të dashurit sigurisht që e mbushë zemrën, dhe ti e sheh se ai që do dikë tjetër, por jo Allahun, nuk mund ta ndajë namazin nga mendimet për të.

Shprehja e respektit (*ta'zim*) është gjendje e zemrës si pasojë e dy njohjeve:

1. Njohja për lartësinë dhe madhësinë e Allahut Teala, që është një nga themelet e besimit, sepse ai që nuk e beson madhësinë e Allahut Teala, nuk pranon që Atij t'i shprehë respektin; dhe

2. Njohja që ti vet je i parëndësishëm, i përçmuar dhe se je një rob i pafuqishëm i nënshtruar urdhreve të Allahut Teala.

Nga këto dy njohje lind përlësia, qetësia shpirtërore dhe modestia karshi Allahut Teala, dhe kjo gjendje quhet nderim.

Deri sa nuk bashkohen njohja për pavlerën tënde dhe përsosurinë e plotë të Allahut Teala, nuk do të arrihet gjendja e respektit dhe përlësisë, sepse, me të vërtetë - ai që nuk ka nevojë për të tjerët dhe që është i sigurt në vete mund të njohë te tjetri cilësi të perkryer, por nuk do të jetë i përlur e të shprehë respekt ndaj tij, sepse i mungon cilësia tjetër – njohja e pavlerës dhe varësisë së vet ndaj tij.

Frikë-respekti dhe frika është gjendje që rezultojnë nga njohja e fuqisë së Allahut Teala, dominimit dhe zbatimit të vullnetit të Tij pa vështirësi, si edhe vetëdijes se edhe po t'i shkatërronte të gjitha gjeneratat e njerëzve që kanë jetuar dhe ata që jetojnë, Atij nuk i pakësohet pushteti.

Me një fjalë, gjithmonë kur rritet njohja për Allahun, shtohet edhe frika e frikë-respekti. Shkaktarët e kësaj do të përmenden në *Librin për frikën*, në pjesën për veprimet që shpëtojnë.

Shkaktar i shpresës është njohja e mirësisë dhe fisnikërisë së Allahut Teala, njohja e të gjitha bereqeteve e Tij, mjeshtresë së krijimit të Tij, si edhe njohja e vërtetësisë në premtimin e xhennetit për atë që e kryen namazin.

Kur të arrihet bindja e fortë në premtimin e Tij dhe njohja e mirësisë së Tij, nga kjo pashmangshëm lind shpresa.

Turpërimi lind nga njohja e mangësisë së vet në ibadet dhe njohja se është i pafuqishëm në kryerjen e shumicës së obligimeve ndaj Allahut Teala. Tutje, ky turpërim forcohet me njohjen e të metave që i ka, të josinqeritetit, shëmtisë përreth tij, që në të gjitha punët anon kah dynjallëku, si edhe kuptimit se Allahu Teala i di të fshehtat e zemrës së tij dhe mendimet e tij, sado të vogla e të fshehura të jenë ato. Njohja e kësaj rezulton me bindje të fortë dhe nga kjo dituri lind gjendja që quhet *turpërim*.

Këta janë shkaktarët e cilësive të përmendura, prandaj sa herë që dëshirohet të arrihet ndonjëra nga këto cilësi, duhet të sigurohet shkaktari i saj. Me njohjen e shkaktarit kuptohet edhe ilaçi, e të gjitha këto cilësi i ndërlihdë besimi (*iman*) dhe bindja e plotë (*jekin*).

Me *jekin* (bindje e plotë) nënkuptohet nxjerrja e dyshimit nga zemra dhe mbushja e zemrës me bindje, siç është thënë në shpjegimin e kësaj në *Librin për diturinë*. Zemra është e përlur aq sa është bindja e fortë. Prandaj Ajsha r.anha. ka thënë:

“Resulallahu s.a.v.s., fliste me neve, por kur hynte namazi, sikur të mos njiheshim mes vete!”

Tregohet se Allahu Teala i shpalli Musasë a.s.:

“O Musa, kur të më përmendësh Mua, trupi le të dridhet! Kur të më përmendësh Mua, të jesh i përlur dhe i qetësuar. Kur më përmend Mua, gjuha le të jetë pas zemrës, e kur të qëndrosh para Meje, qëndro si një rob i përlur dhe M’u drejto me zemër të frikësuar e me gjuhë të singertë!”

Gjithashtu tregohet se Allahu Teala ka shpallur:

“Thuaju gjynahqarëve në mesin e ummetit tënd të mos më përmendin Mua, sepse e kam obliguar Vetën që edhe Unë do ta përmendi secilin që më përmend Mua, prandaj nëse ata më përmendin Mua në gjynahet e tyre, edhe Unë do t’i përmend ata në mallkimin Tim!”

Nëse kjo e pret gjynahqarin që me vëmendje përmend, si bëhet puna nëse bashkohen pavëmendja me gjynahun?!

Varësisht nga prania e kuptimeve të përmendura, njerëzit ndahen në ata që falën namazin, e zemrën nuk e kishin të pranishme as për një çast, dhe në ata që falën namazin, e zemra nuk ju mungoi as për një çast. Aq më shumë, ky i dyti gjithë vëmendjen e ka drejtuar kah Allahu, ashtu që nuk e vëren se çfarë po ndodhë as përpara tij.

Prandaj Muslim ibn Jesar nuk ka ndjerë asgjë kur ka rënë shtylla e xhamisë rreth të cilës ishin mbledhur njerëzit, e disa prej tyre për një kohë të gjatë vinin në xhami, e nuk dinin se kë e kanë djathtas as majtas tyre, ndërsa rrahja e zemrës së Ibrahimit a.s., mund të ndëgjohej në dy milje. Të tjerëve u zbehej fytyra dhe nisinin e dridheshin.

Të gjitha këto janë gjëra të mundshme, që mendja e logjika mund t'i pranojë. Si të mos jenë të mundshme kur raste të njëjta shihen edhe te ata që janë dhënë pas dynjasë para sundimtarit të tyre, e i cili në esencë është i pafuqishëm dhe dënimi e mirësia e tij nuk kanë vlerë.

Bile, kur një person shkon para sundimtarit apo ministrit (vezir) dhe i flet për qëllimin ose problemin që e ka, e më pas del, e sikur të pyetej për të tjerët që kanë qenë rreth sundimtarit apo vezirit, ose për rrobat e tyre,

ai për këtë nuk do të mund të thoshte gjë, për shkak që është interesuar vetëm për qëllimin e vet e vëmendja e tij aspak nuk ka qenë e drejtuar kah rrobat e sundimtarit apo kah të pranishmit aty.

Secili e ka gradën sipas veprimit dhe kështu secili person fiton nga namazi aq sa në të e ka shprehur frikën, përvullësinë dhe respektin që ka, sepse Allahu Teala shikon zemrën, e jo në lëvizjet e jashtme.

Për këtë arsye, njëri nga as'habët r.a., ka thënë:

“Në ditën e Gjykimit njerëzit do të ringjallen ashtu të heshtur e të qetë, siç kanë qenë në namaz, dhe me aq kënaqësi e lezet sa kanë ndjerë në të.”

Të vërtetën e ka thënë, sepse secili do të ngjallet ashtu si ka vdekur, e secili vdes ashtu si ka jetuar. Kur falë namazin, duhet të kujdeset për gjendjen e zemrës, e jo për trupin dhe veshjen. Qenia në ahiret do të marrë formën sipas veprimit të zemrës. Aty do të shpëtojë vetëm ai që vjen me zemër të pastër (*kalbi-selim*). E lusim Allahun, me mirësinë dhe fisnikërinë e Tij, që të na ndihmojë të veprojmë për dëshirën dhe kënaqësinë e Tij.

SHPJEGIM I ILAÇIT TË DOBISHËM PËR PRANI TË ZEMRËS

Dije se, është e domosdoshme që besimtari të shprehë respektin dhe frikë-respektin e tij ndaj Allahut Teala, të shpresojë te Ai dhe të turpërohet para Tij për mangësitë e veta, dhe nuk do të duhej t'i braktisë këto gjendje pasi të jetë bërë besimtar, ani pse fuqia e këtyre gjendjeve do të varet nga fuqia e bindjes së plotë (*jekin*).

Braktisja e këtyre gjendjeve në namaz mund të jetë pasojë e mendimeve dhe kujtimeve të shkapërderdhura, mungesës së zemrës gjatë bisedës intime si edhe pakujdesit ndaj vet namazit. Kujtimet e pengojnë njeriun që të mendojë më gjatë namazin dhe ia okupojnë zemrën. Refuzimi i atyre kujtimeve është ilaç për të siguruar praninë e zemrës në namaz. Kujtimet mund të largohen vetëm nëse u largohet shkaktari, prandaj të shohim se çfarë shkakton i ato.

Shkaktar i lajmërimit të këtyre kujtimeve mund të jetë nxitja e jashtme ose e brendshme. E jashtme është ajo që dëgjon dhe shikon. Këto nganjëherë mund të tërheqin vëmendjen ashtu që njeriu mendon për to, më pas nga kjo lind një mendim tjetër dhe kështu radhiten njëri pas tjetrit. Kështu, ajo që shihet, bëhet shkak të për mendime, e më pas, ky mendim bëhet shkak për ringjalljen e kujtimeve të tjera.

Ai që ka vullnet dhe nijetin e fortë, nuk do të merret me ato gjëra që i shohin sytë e tij. Por, personit të dobët, gjërat që ia shohin sytë ia tërheqin vëmendjen dhe ia shpërndajnë mendimet.

Mënyra e shërimit të kësaj është largimi i shikimit nga çdo gjë që mund të ringjallë kujtimet, të falet në hapësirë të errët, ose të largojë para vetes gjithçka që do të mund të interesojë shqisat e tij, ose që në namaz t'i afrohet murit ashtu që t'i ngushtohet hapësira që e sheh. Duhet ngurruar nga falja e namazit në rrugë, në hapësira të gdhendura e të përpunuara, në sexhade me ngjyra, e për këtë arsye të devotshmit ibadet bënin në hapësira të ngushta e të errëta, që ishin aq sa vetëm sexhdeja mund të bëhej, që të mundën kështu të fokusohen më mirë. Më të fortit mes tyre shkonin në xhami dhe e ulnin shikimin, duke mos shikuar tjetër pos pikës ku e bënin sexhden, dhe konsideronin se namazin e kanë të plotë vetëm atëherë kur nuk e dinin se kë e kanë në të djathtë e kë në të majtën e tyre. Ibn Omeri r.a., nuk lente aty ku falej as Mus'haf, as shpatë, e as tekst të shkruar. Ky është ilaçi i shpëtimit nga shkaktarët e jashtëm (*zahir*).

Shkaktarët e brendshëm (batin) janë më të vështirë, sepse atij që vëmendja i përhapet nëpër luginat e dynjasë, mendimi nuk mund t'i ndalet në asnjë pikë, por vazhdimisht do të fluturojë nga një vend në tjetrin, prandaj as lëshimi i shikimit nuk do t'i ndihmojë, sepse ajo që më herët i është në zemër do t'i mjaftojë që t'ia preokupojë mendjen.

Zgjedhjen e ka në detyrim të vetes për të menduar atë që lexon në namaz, dhe të merret me këtë, duke injoruar gjithçka tjetër.

Në këtë do t'i ndihmojë përgatitja para hyrjes në namaz, kur do të ripërtërijë kujtimin në ahiret, gjendjen e bisedës intime dhe rëndësinë e qëndrimit para Allahut Teala, i Cili i sheh të gjitha, dhe ashtu do ta çlirojë zemrën para se të hyjë në namaz nga gjithçka që e preokupon, dhe nuk do të lë në zemër asgjë në çka mendja mund t'i lidhet. Resulallahu s.a.v.s., i tha Osman ibn Ebu Shejbit:

“Kam harruar të të them të mbulosh ibrikun, sepse në shtëpi nuk duhet të ketë asgjë që njerëzve mund t’ju largojë mendjen nga namazi.”¹¹⁰

¹¹⁰ Ebu Davudi nga Osman ibn Talha.

Pra, këto janë mënyrat e parandalimit të kujtimeve. Nëse kjo nuk përmirësohet me ilaçet qetësuese, atëherë shërimi është në përdorimin e ilaçit të fortë për pastrim (*mushil*) që e zhdukë sëmundjen me rrënjë, e për këtë duhet të zbulojë se cilat janë ato gjëra që e pengojnë praninë e zemrës në namaz.

Padyshim, ato janë gjëra të cilat personit i nevojiten dhe këto nevoja vijnë nga epshi. Për të larguar këto dëshira të epshit duhet ta qortojë nefsin (veten) dhe ta dijë se gjithçka që ia largon mendimet nga namazi është kundër fesë dhe është ushtri e armikut të tij, shejtanit.

Mbajtja e tyre brenda është shumë më e dëmshme se sa të nxjerren e të hudhen. Njeriu duhet ta shpëtojë veten duke i nxjerrë nga brenda gjendjet e tilla. Transmetohet se Resulallahu s.a.v.s., pasi që e veshi xhyben e zezë të qëndisur që ia dha Ebu Xhehm dhe me të cilën falej, e hoqi pas namazit, e tha:

“Dërgojani Ebu Xhehmit, sepse më pengoi në namaz, e më sillni nga ai xhyben e leshtë të paqëndisur.”¹¹¹

¹¹¹ Është përmendur më herët në *Librin për diturinë*

Resulallahu s.a.v.s., kërkoi t'i vendosin rrip të ri në sandale, e më vonë gjatë namazit e shikoi si duket rripi, e pas kësaj kërkoi që ta heqin e t'i vendosin prapë rripin e vjetër.¹¹²

Resulallahu s.a.v.s., i mbathi sandalet dhe i pëlqeu bukuria e tyre, bëri sexhde e tha:

“Jam i përvulur para Rabbit tim, që të mos më hidhërohet”,

e pastaj doli e ia fali lypësarit të parë që e takoi, dhe Alisë r.a., i urdhëroi që t'i blejë sandale të përdorura e të punuara nga copëzat e lëkurës.

Sa ishte në minber, Resulallahu s.a.v.s., në gisht e mbante një unazë ari, e kjo para se të ndalohej bartja e tij, por e hodhi duke thënë:

“Duke e shikuar herë atë e herë juve, ma tërhoqi vëmendjen!”¹¹³

Tregohet se Ebu Talha Ensari falej në bahçen e vet, dhe u mahnit nga një turtulleshë që po fluturonte nëpër degë, duke kërkuar dalje. E përcolli një kohë me shikim, dhe harroi sa reqate i ka falur, e më pas ia tregoi këtë ngjarje Resulallahut s.a.v.s., dhe tha:

- O Resulallah këtë bahçe e jap sadaka, e ti ndaja kujt të duash.”¹¹⁴

¹¹² Ibnul Mubarek në *ez-Zuhd* nga Ebu-Nadr si *mursel*, me zinxhir të besueshëm.

¹¹³ Nesai nga Ibn Abbasi.

¹¹⁴ Malikiu nga Abdullah ibn Ebu Bekr.

Tregohet edhe për një tjetër që falej në bahçen e vet, e hurmët ishin zbukuruar me fruta. Ky i shikoi dhe e mahnitën, e kështu harroi sa reqate i kishte falur. I tregoi për këtë Osmanit r.a., duke i thënë:

- *Kjo bahçe është sadaka, përdore në rrugë të Allahut Teala”,*

dhe Osmani r.a., e shiti për 50.000.

Ata vepronin kështu për të siguruar praninë e zemrës në namaz dhe si shpagesë për mangësitë që ju ndodhën në namaz. Ky është ilaç, e që nuk ka nevojë për tjetër, sepse ky e largon rrënjën e sëmundjes.

Ilaçi qetësues që e treguam më herët mund të jetë efektiv në dëshira (epshe) të dobëta dhe për mendime që nuk janë vendosur në zemër por qarkullojnë rreth saj, për të drejtuar vëmendjen në atë që lexon.

Por ai nuk është efektiv ndaj dëshirave (epsheve) të rrënjosura. Ato të joshin ty e ti i josh ato. Qëndrojnë vazhdimisht me ty deri sa nuk të mposhtin dhe gjithë namazi të kalon duke u marrë me to.

Kjo është ngjashëm me gjendjen e personit i cili qëndron nën hijen e pemës e në degë të saj zogjtë cicërojnë, e ky dëshiron të mendojë në qetësi, të jetë posedues i *hudhuri-kalb*. Zogjtë cicërojnë vazhdimisht dhe për ta siguruar qetësinë, ky i largon zogjtë, por sapo

e arrinë qetësinë, zogjtë prapë kthehen, dhe kështu në vazhdimësi. Atëherë dikush i thotë se ky është veprim i kotë që nuk ka fund, dhe që, nëse dëshiron t'i largojë zogjtë, duhet ta presë pemën.

Njëjtë është me pemën e epsheve, që zgjerohet dhe degëzohet e i tërheqë mendimet e dynjallëkut, bash ashtu siç i tërheqë pema zogjtë dhe papastërtinë e mizave. Për t'i larguar këto mendime puna zgjatet, si largimi i mizave që kthehen prapë dhe sado që i largon, ato prapë kthehen. Pra, njëjtë është edhe me kujtimet. Zgjidhja e vetme është të prehet pema e epshit.

Këto epshe janë lloj-lloj, dhe të pakët janë njerëzit që mund të mbrohen nga to, e të gjitha e kanë një burim të njëjtë – dashurinë ndaj kësaj bote. Kjo është gjithashtu koka e të gjitha gjynaheve, themel i të gjitha mangësive dhe burim i të gjitha parregullsive.

Ai që e mbushë zemrën me dashuri të kësaj bote, dhe synon çkado qoftë nga kjo botë, dhe atë jo që me këtë të furnizohet ose ndihmohet për ahiret - as të mos shpresojë se mund të ndjejë përjetimin e vërtetë në bisedën intime gjatë namazit. Ai që i gëzohet kësaj bote, nuk mund t'i gëzohet Allahut Teala dhe bisedës intime me Allahun.

Vëmendja e njeriut është e drejtuar kah ajo që e i jep kënaqësi; nëse i jep kënaqësi kjo dynja, vëmendja e tij sigurisht do t'i kushtohet dynjasë.

Përkundër kësaj, nuk duhet ndalë luftën, duhet kthyer zemrën në namaz dhe duhet zvogëluar shkaktarët që e preokupojnë, sepse ky është një ilaç i idhët, dhe për shkak të shijes së tij të idhët, natyra e njeriut e refuzon, e kështu sëmundja zgjatë për një kohë, dhe bëhet kronike.

Kështu, shumë nga të mëdhenjtë u munduan të falin dy reqate e në to të mos mendojnë për asgjë të kësaj bote, por nuk patën sukses.

Prandaj, për të këtillët sikur ne, kjo mbetet vetëm dëshirë. Sukses për ne do të ishte nëse gjysma, ose së paku një e treta e namazit, të jetë pa vesvese të shejtanit, e kështu të jemi nga ata që ju përzihen veprimet e mira me të këqijat.

Me një fjalë, vëmendja për dynjanë dhe ajo për ahiretin në zemër janë sikur uji që derdhet në gotën plot me vaj, dhe sa të futet ujë në gotë, aq do të dalë vaj nga aty, sepse ato nuk përzihen.

SHPJEGIM I DETAJUAR I ASAJ QË DUHET TË GJENDET NË ZEMËR KUR ZBATOHEN KUSHTET E NAMAZIT

Nëse e dëshiron ahiretin, nuk duhet të harrosh paralajmërimet që ndërlidhen me kushtet dhe parimet themelore të namazit. Kushtet që i paraprijnë namazit janë: ezani, pastërtia, mbulimi i vendeve të turpshme, drejtimi kah kibla, kijami dhe nijeti.¹¹⁵

Ezani

Kur e dëgjon ezanin, mendo thirrjen në ditën e gjykimit e ngutu, dhe përgatitu me të brendshmen e me të jashtmen, sepse ata që nguten kur dëgjojnë ezanin, në ditën e llogarisë do të ftohen me mirësi dhe butësi. Ekspozoja zemrën tënde kësaj thirrje, dhe nëse ajo mbushet me gëzim e lumturi, dije se ezani po të sjellë lajmin e gëzuar dhe sukses në ditën e Gjykimit.

Prandaj Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Na qetëso me të, o Bilal”¹¹⁶,

pra, *na qetëso* me ezan e me thirrjen në namaz, sepse kënaqësia e Resulallahut s.a.v.s., ishte në namaz.

¹¹⁵ Për veprimet e obliguara sipas medh’hebit Hanefi, shih fundin e këtij libri.

¹¹⁶ Darekutni në ***el-llel*** nga Bilalli, ndërsa Ebu Davudi me zinxhir të besueshëm të transmetuesve të njëjtë nga një as’hab që nuk i tregohet emri.

Pastërtia (taharet)

Kur pastrohesh nga papastërtia - nevojtorja është mbulesa e jashtme, rrobat janë mbulesa e brendshme, e tutje mbulesë e ke lëkurën tënde, që është më së afërti teje dhe që mbulon trupin tënd. Mos harro që të gjitha këto e mbulojnë esencën, pra, zemrën tënde. E Allahu Teala shikon në zemër, prandaj mundohu ta pastros atë me pendim e keqardhje për atë që ke lëshuar, dhe me vendosmëri që në të ardhmen nuk do të bësh punë të këqija.

Mbulimi i trupit

Dije se me këtë mendohet në mbulimin e vendeve tua të turpshme nga shikimet e njerëzve, sepse njerëzit e shohin të jashtmen e trupit tënd, e çfarë mendon për veprat e turpshme të brendisë tënde dhe paturpësinë e mendimeve tua të fshehura, të cilat mund t'i shohë vetëm Rabbi yt i Lartësuar?!

Fillo të mendosh për ato paturpësi dhe mundohu t'i fshehësh ato, por dije pa dyshim se nuk do të mund t'i fshehësh nga shikimi i Allahut! Dhe dije, ato i zhdukë vetëm pendimi, turpi dhe frika jote. Duke i menduar ato paturpësi, nxite në lëvizje frikën dhe turpin në zemër, me çka nefsi yt bëhet i përlulur ndërsa zemra jote, përmes turpërimit, bëhet e nënshtruar. Qëndro para

Allahut Teala si një rob gjynahqar, i cili, pasi ka ikur, është penduar dhe me kokë të lëshuar nga turpi dhe frika, i kthehet pronarit të vet.

Kthimi kah kibla

Kjo është kthimi i fytyrës tënde në drejtim të Qabes, larg prej të gjitha drejtimeve tjera.

Por, nëse mendon që vetëm kaq të mjafton, mashtrohesh. Prej teje kërkohet ta largosh zemrën tënde nga gjithçka, e ta lidhësh me urdhrat e Allahut.

Ky orientim i jashtëm nxitë në lëvizje ndjenjat e brendshme, të cilat e zaptojnë zemrën që të mos kryengritet duke e orientuar në drejtimin e përcaktuar. Sepse gjymtyrët janë në lëvizjet e tyre natyrore dhe kur drejtohen kah ana që ato duan e të kalojnë masën në lëvizje duke bërë zullum, e marrin edhe zemrën nën urdhrat e tyre, dhe mund ta largojnë atë nga rruga e Allahut Teala. Pasi është kështu, siç e drejton fytyrën kah kibla, edhe zemrën drejtoje kah Allahu.

Dije, ashtu siç nuk mundet fytyra të kthehet kah Bejtullahu pa u larguar nga drejtimet tjetra, njëjtë edhe zemra nuk mund të drejtohet kah Allahu Teala, pa u

larguar nga gjithçka tjetër përvec Allahut. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Nëse personi kur ngritet të falë namazin i drejton dëshirat, fytyrën dhe zemrën kah Allahu Teala, do ta përfundojë namazin të pastër nga gjynahet ashtu siç ka qenë në ditën kur e ka lindur nëna.”¹¹⁷

Qëndrimi në këmbë (kijami)

Kjo nënkupton qëndrimin para Allahut Teala edhe me trup edhe me zemër. Kokën, pjesën tënde më e lartë e më e ndershme, përkule me modesti. Kjo bëhet dëshmi që edhe zemra e ka pranuar modestinë e është larguar nga kryengritja. Atëherë kujtoje peshën e madhe të qëndrimit para Allahut Teala dhe tmerrin e vendit të pritjes për llogari. Mendo si qëndron para fuqisë hyjnore, para Allahut, e nuk mund të njohësh Lartësinë e Tij. Prandaj qëndro para Tij së paku si do të qëndroje para ndonjë sundimtari të dynjasë, ose mendo se po të mbikqyrë syri i mprehtë i ndonjë personi të mirë nga familja jote, ose nga ata që ti do të të njohin për të mirë. Gjymtyrët qetësohen e organet e trupit përulen, nga frika se ai person të thotë se nuk ishe i përulur. Atëherë thuaj vetes:

¹¹⁷ Hadithi nuk është gjetur.

“Pohon se e ke njohur Allahun dhe e do, e nuk turpërohesh të bëhesh mendjemadh para Tij e i jep rëndësi njërit prej robëve të Tij?! A frikësohesh prej njerëzve e jo prej Allahut, e më e mirë për ty është të ndjesh frikë nga Ai?!”

Prandaj Resulallahu s.a.v.s., në pyetjen e Ebu Hurejres r.a., se si të turpërohet prej Allahut Teala, tha:

“Ashtu siç turpërohesh nga personi i mirë mes popullit tënd”, e në transmetim tjetër:

“...nga familja jote”.¹¹⁸

Nijeti

Nijeti përbën vendosmërinë për të falë një namaz të përkryer duke u përmbajtur prej asaj që e prishë dhe që ndikon në rregullsinë e tij, në zbatimin e urdhrin të Allahut Teala, shpresën në shpërblimin e Tij, frikësimin nga dënimi i Tij, kërkimin e afërsisë së Tij dhe njohjen se të gjitha mundësitë t'i ka dhuruar Allahu Teala. Mendo që je në prani të lartë, para Allahut Teala. Mendo me Kë po flet, si po flet e pse po flet! Mendo, që nga turpërimi balli yt të nisë të djersitet, nga frikë-respekti gjoksi të dridhet, e nga frika – fytyra të zbehet!

¹¹⁸ Haraiti në ***Mekarimul-ahlak***, Bejhekiu si mursel në ***esh-Shuab*** dhe Darekutni në ***el-Ilel*** nga Ibn Omeri, e tha se ky është versioni më korrekt sepse vjen nga Seid ibn Zejd, njërit prej dhjetë personave që janë gëzuar me xhennet.

Tekbiri

Kur gjuha jote t'a shqiptojë tekbinin: **Allahu ekber** (Allahu është më i madhi, nga çdo gjë), zemra nuk do të duhej ta mohojë. Por, nëse në zemrën tënde ka diçka tjetër më të madhe se Allahu, atëherë Allahu Teala e dëshmon që je gënjeshtar, pa marrë parasyshtë që fjalët janë të vërteta, siç ka dëshmuar Ai edhe për dyfytërsinë, kur thanë se e pranojnë që Muhammedi s.a.v.s., ishte i Dërguar i Allahut. Nëse kërkesat tua janë më të fuqishme për ty se urdhri i Allahut Teala, ti atëherë je më i nënshtruar atyre se Allahut. Ti i ke zgjedhur ato kërkesa për zot tëndin dhe ato i madhëron, e fjalët tua *Allahu ekber* do të jenë vetëm frazë e thënë me gjuhë, e zemra do të ndahet nga gjuha. Nëse nuk bëhet teube për këtë gjendje dhe në përfundim nuk arrihet falja e Allahut, kjo është tepër e rrezikshme.

Duaja hyrëse

Fjalët e para të duasë (sipas medh'hebit Shafi) janë:

"E kthej fytyrën (vexhhije) time drejt Atij i Cili i ka krijuar qiejt dhe Tokën..."

(vexhxhehtu vexhhije lillezi fetessemavati),

e me *vexhh* (fytyrë), nuk mendohet në fytyrën tënde fizike, sepse atë e ke kthyer në një anë, kah kibla, e Allahu Teala është larg prej mundësisë që të përcaktohet me anë, e që ti me fytyrën tënde fizike të

mund të kthehesh kah Ai, por që me fytyrën e zemrës tënde kthehesh drejt Krijuesit të qiejve dhe Tokës.

Shiko zemrën tënde dhe përcjelli kërkesat e saj: a është kthyer ajo kah dëshirat e veta, vëmendjen a e ka në shtëpi apo çarshi; apo me të vërtetë është kthyer kah Allahu, Krijuesi i qiejve dhe Tokës! Ruaju që fillimi i duasë të mos jetë gënjeshtër! Fytyra jote kthehet drejt Allahut Teala vetëm kur largohet nga gjithçka tjetër. Mundohu menjëherë që zemrën ta kthesh kah Ai, e nëse nuk mund ta bësh vazhdimisht, së paku fjalët tua në këtë çast le të jenë të singerta.

Kur të thuash:

“...si besimtar i vërtetë” (hanifen myslimen),

duhet të kujtohesh se mysliman është ai që prej gjuhës dhe dorës së tij myslimanët tjerë janë të sigurt. Nëse nuk është ashtu, ti je gënjeshtar! Mundohu që në këtë të jesh i vendosur në të ardhmen, dhe të pendohesh për situatat e mëhershme.

Kur të thuash:

“Unë nuk jam mushrik dhe nga ata që Atij i përshkruajnë ortak” (ve ma ene mine’l-mushrikin),
kujto edhe shirkun e fshehur, sepse fjalët e Allahut:

“Kush shpreson takimin me Rabbin e vet, le të bëjë vepra të mira, dhe, le të mos i bëjë ortak askë në të adhuruarit e Rabbit të vet!” (18-Kehf: 110),

janë shpallur për atë i cili me ibadetin e tij synon kënaqësinë e Allahut, por edhe lavdërimin e njerëzve. Të jesh i kujdesshëm e i matur karshi këtij shirku. Ndjeje turpin në zemrën tënde nëse thua për vete që nuk je prej myshrikëve (atyre që i përshkruajnë ortak Allahut), ndërsa nuk je i pastër nga ky lloj shirku, sepse termi *shirk* ka të bëjë me formën e tij më intenzive, por edhe me formën e tij më të dobët.

E kur të thuash:

*“...jeta ime dhe vdekja ime i takojnë Allahut”
(ve mahjaje ve memati lillahi),*

dije se kjo është gjendja e robit i cili e ka humbur veten për të ekzistuar vetëm për Rabbin e vet, prandaj nëse këto fjalë dalin nga ai që, gëzimin dhe zemërimin, veprimin e pushimin, dëshirën për jetë dhe frikën nga vdekja, i ka të lidhura me dynjanë, ai nuk i përshtatet gjendjes së përshkruar në dua.

Kur thua:

*“te Allahu strehohem nga shejtani i mallkuar”
(eudhu billahi mine’sh-shejtani’r-raxhim),*

dije që shejtanin e ke armik dhe që ai vazhdimisht mundohet të largojë zemrën tënde nga Allahu Teala, nga xhelozia për shkak të bisedës tënde me Allahun Teala dhe sexhden tënde bërë Allahut, ndërsa ai është i mallkuar vetëm për një sexhde që nuk e bëri.

Kërkimi yt për strehim te Allahu Teala nga shejtani duhet të jetë me largim nga ajo që shejtani e do dhe me zbatimin e urdhrave të Allahut Teala, e jo vetëm me fjalë, sepse ai të cilin e sulmon bisha apo armiku, që ta shqyejë apo vrasë, e ky thotë:

“Mbrohëm nga ti me kështjellë të fortë”,
por edhe më tutje qëndron aty ku ishte, kjo aspak nuk i sjell dobi. Do të mbrohet vetëm nëse e ndërron vendin.

I tillë është rasti me atë që ndjekë epshtet që shejtani i do, e Allahu i urren. Vetëm fjalët nuk do t’i sjellin dobi.

Prandaj, bashkë me fjalë le ta shtojë edhe vendimin se do të mbrohet nga e keqja e shejtanit me kështjellën e Allahut Teala, e kështjellë e Tij janë fjalët

La ilahe ilallah (nuk ka zot pos Allahut),
sepse Resulallahu s.a.v.s., na ka treguar që Allahu Teala ka thënë:

“La ilahe ilallah është kështjella Ime, e kush të hyjë në kështjellën Time është i sigurt nga dënimi Im!”¹¹⁹

¹¹⁹ Ebu Nuajm në *Hilje*.

Me këtë kështjellë është i mbrojtur ai që adhuron vetëm Allahun Teala, ndërsa ai që epshet e veta i merr për zot, ai është në shkretëtirë të shejtanit, e jo në kështjellën e Allahut Teala.

Dije, një nga kurthet e shejtanit është që të argëtojë në namaz me mendime rreth ahiretit dhe me planifikimin e veprave të mira, që kështu të të pengojë të kuptosh atë që po e lexon. Dhe dije, gjithçka që të largon nga kuptimi i porosisë të asaj që po lexon është vesvese e shejtanit, sepse nuk kërkohet vetëm lëvizja e gjuhës por qëllimi kryesor është të kuptosh porosinë e asaj që po lexon.

E te leximi i Kur'anit, njerëzit ndahen në tri lloje:

1. ata që gjuhën e lëvizin, por zemrën e kanë mospërfillëse;

2. ata që lëvizin gjuhën, e zemra ia ndjekë, e kupton dhe dëgjon prej gjuhës, thuaj se po dëgjon dikë tjetër. Këto janë grada të atyre që do të jenë në anën e djathtë (*as'habul-jemin*); dhe

3. ata që një herë zemra ju arrinë kuptimin, e më pas gjuha i shërben zemrës në përkthim.

Dallimi qëndron në atë se a është gjuha përkthyes i zemrës apo mësues i saj. Tek *mukarrebunët* (ata që janë afër Allahut), gjuha është përkthyes që e pason zemrën, e jo që zemra e tyre ndjekë gjuhën.

Shpjegim i detajuar i përkthimit të kuptimeve

Kur thua:

Bismillahi’r-Rahmani’r-Rahim

(*Me emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit!*), bëje nijet të fillosh me emrin e Allahut për të fituar bereqetin e Fjalës së Tij, mendo se si këto fjalë nënkuptojnë që gjithçka është prej Allahut Teala dhe dije se me *Emër* këtu nënkuptohet vet i Emërtuari. Kur e kupton se gjithçka është prej Allahut Teala, atëherë e kupton që gjithsesi edhe falënderimi i takon Allahut.

Prandaj edhe thua:

Elhamdulillah Rabbil-alemin

(*Hamdi i takon vetëm Allahut, Rabb të botëve*), sepse të gjitha bereqetet janë prej Tij, e kush mendon që bereqetet po i vijnë prej dikujt tjetër e jo prej Allahut Teala, ose falënderimin e tij ia drejton dikujt tjetër e jo Allahut Teala, këso mendimi dhe ky falënderim janë mangësi e tij, si pasojë e drejtimit të tij kah ato krijesa.

Kur thua:

Er-Rahmani'r-Rahim

(Mëshirues, Mëshirëbërës),

kujto të gjitha llojet e mirësisë së Tij, që të bëhet e qartë mëshira e Tij, e kështu të rritet shpresa jote.

Pastaj kur thua:

Maliki jevmi'd-din

(Sunduesit të Ditës së Gjykimit),

duke u shprehur që sundimi i takon vetëm Atij, mendo madhështinë e Tij dhe frikësohu prej Tij duke menduar tmerrin e ditës së dënimit dhe të llogarisë, që është ditë e Tij.

Më pas, duke thënë:

ijjake na'budu

(Vetëm Ty të adhurojmë),

rigjallëro sinqeritetin tënd.

E më pas kur thua:

ve ijjake neste'ijn

(vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë),

shprehe edhe pafuqinë tënde, varësinë dhe pamundësinë e posedimit të forcës së vërtetë e të fuqisë për ta ndryshuar veten. Bindu që nënshtrimi yt nuk do të ishte i mundur pa ndihmën e Tij, dhe Atij

falënderohu që të ka udhëzuar që t'i nënshtrohesh, e që ke mundësi t'i bësh ibadet Atij. Sikur Ai të të kishte privuar nga udhëzimi, do të ishe nga të refuzuarit, bashkë me shejtanin e mallkuar.

Pasi që i kuptove domethëniet e *eudhu*, *besmeles* dhe *hamdit*, dhe pasi që shprehe varësinë e plotë për ndihmën e Tij, kalo në synim, kërko atë që të duhet më së shumti, e thuaj:

Ihdines-Sirata'l-mustekim

(udhëzoni në rrugën e drejtë!),

rrugë kjo që do të na dërgojë në afërsinë Tënde dhe do të na sjellë te kënaqësia (*riza*) Jote.

Dhe thuaj:

Sirataledhine en'amte alejhim

(në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi),

pra në rrugën e peygamberëve, sidikkëve, shehidëve dhe njerëzëve të mirë të cilët i ndriçove me dhuratën e udhëzimit Tënd.

E duke thënë:

Gajri'l-magdubi 'alejhim ve la ed-daline

(jo në të atyre që kundër vetes tërhoqën hidhërimin, e as në të atyre që e humbën veten!),

shpjegoje këtë më gjerë duke thënë: jo në rrugë të pabesimtarëve, çifutëve të humbur, të krishterëve dhe sabeanëve (ata që adhurojnë yjet dhe idhujt).

Pas kësaj kërko pranimin e duasë, the thuaj ***Amin!***

Kur të lexosh kështu *Fatihane*, të ka hije të jesh nga ata për të cilët - siç na tregon Resulallahu s.a.v.s., në një hadithi kudsi - Allahu Teala thotë:

“Namazin mes Meje dhe robit Tim e ndava në dy pjesë. Gjysma është e Imja, e gjysma e robit Tim, e robit Tim i takon ajo që kërkon; robi thotë:

- *Falënderimet Allahut, Rabbit të botëve,*
e Allahu Teala thotë:

- *Po më lavdëron robi Im, dhe po më falënderon.*

Ky është edhe kuptimi i shprehjes ***Semiallahu limen hamideh*** (e dëgjoji Allahu atë që e falënderoi)¹²⁰

Edhe sikur nga namazi të mos kishe gjë tjetër përpos që e përmend Allahun në madhësinë e Tij dhe me lartësimin e Tij, kaq përfitim për ty është i mjaftueshëm, bile të tepron, ndërsa aty është edhe shpresa për më shumë, shpërblimi për këtë namaz dhe të mirat që i ke kërkuar!

¹²⁰ Musliimi, nga Ebu Hurejre.

Njëjtë duhet të kuptosh edhe suret tjera që i lexon, për çka do të flasim më shumë në *Librin për leximin e Kur'anit*.

Mos i shpërfill urdhrat dhe ndalesat e Tij, premtimet e kërcënimet, këshillat dhe tregimet e pejgamberëve, përmendjen e dhuratave dhe mirësive të Tij; këto i kanë të drejtat (*hak*) e veta, veç e veç: haku i premtimit është lutja dhe frika, haku i urdhërimit dhe ndalesës është veprimi ose përmirësimi, haku i vazit është mësimi, haku i mirëbërësit është mirënjohja, haku i lajmeve të pejgamberëve është marrja mësim.

Tregohet se Ibrahim Nehai, kur i dëgjoi fjalët e Allahut Teala:

“Kur qielli të çahet.” (84-Inshikak: 1),
aq shumë u shqetësua, sa gjunjët filluan t’i kërcasin, ndërsa Zurare ibn Evfa ra i vdekur në tokë kur arriti te fjalët e Allahut:

“E, kur të fryhet në Sur.” (74–Mudethir: 8).

Abdullah ibn Vakid thoshte:

“Kur Abdullah Ibn Omeri falte namazin, digjej si tigani mbi zjarr.”

Ai ka të drejtë që zemrën e vet ta djegë me premtimin dhe me kërcënimin nga Rabbi i vet, sepse ai është rob i përrulur e gjynahqar, para të Gjithëfuqishmit (*Xhebbar*) dhe Atij që mposhtë (*Kahhar*). Ai hynte në atë gjendje, sepse i mendonte këto kuptime.

Këto kuptime ndryshojnë sipas aftësisë së njerëzve për të kuptuar, e aftësia e njerëzve për të kuptuar shtohet krahas pastërtisë së zemrës dhe shkallës së diturisë. Këto grada janë aq të shumta sa që nuk mund të numërohen. Namazi është çelës i zemrës, aty zbulohet fshehtësia e fjalëve. Kjo është e drejtë (*haku*) e leximit të Kur'anit, si edhe e dhikrit dhe tesbihëve të tjerë. Më pas do të ketë vëmendjen në frikë-respekt gjatë leximit të Kur'anit, dhe do të lexojë qartë, jo shpejt, sepse ashtu është më lehtë të kuptohet.

Do të bëjë dallim në theksim të ajeteve për mëshirën dhe atyre për dënimin, për premtimin e kërcënimin, për falënderimin, për shprehjen e respektit dhe nderit.

Kur Ibrahim Nehai lexonte:

“Allahu nuk ka zgjedhur për Vete ndonjë bir dhe përveç Atij s’ka asnjë zot tjetër” (23-Mumin: 91),

dhe fjalë të ngjashme të Allahut Teala, e ulte zërin, sikur turpërohej që t’a përmend Allahun me diçka që nuk i takon Atij.

Transmetohet se lexuesit të Kur'anit në ditën e kijmetit do t'i thuhet:

- Lexo Kur'an qartë, siç e lexoje në dynjallëk. ¹²¹

Qëndrimi në kijam me qetësi, është dëshmi që zemra është në gjendje tërësisht të lidhur me Allahun Teala. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Allahu Teala vërtetë është i kthyer kah namazlia deri sa ai të mos kthejë kokën.”¹²²

Ashtu siç duhet pasur kujdes që koka dhe sytë të mos kthehen tjetër kah, gjithashtu duhet ruajtur zemra që të drejtohet vetëm në namaz. Në atë moment kur mendon diçka tjetër, duhet të mundohesh ta arrish përlësinë e zemrës në namaz, për shkak se ti e di që Allahu Teala ka dijeni për këtë dhe që lutja nuk mund të bëhet në gaflet.

Zemra jote le të jetë e përlur, sepse moslëvizja, as brenda as jashtë, është fryt i përlësisë. Kur brendia është e përlur, e tillë është edhe e jashtmj.

Resulallahu s.a.v.s., kur e pa një person si gjatë namazit luante me mjekër, tha:

- Po të ishte e përlur zemra e këtij, sigurisht edhe gjymtyrët do t'i kishte të përlura!,

¹²¹ Ebu Davudi, Tirmidhiu dhe Nesai nga Abdullah ibn Omer.

¹²² Ebu Davudi, Nesai dhe Hakimi, nga Ebu Dherr.

sepse *kopeja është e tillë çfarë e ka çobanin*, pra, gjymtyrët janë në urdhrin e zemrës. Prandaj në dua thuhet:

*“O Allah, bëje të mirë edhe çobanin edhe kopenë.”*¹²³

Ebu Bekr es-Siddiku r.a., në namaz ishte i palëvizshëm si një shtyllë, Abdullah Ibn Zubejr r.a., qëndronte si kallam, e bile disa ashtu qetësoheshin në ruku, sa që trumcakët ndaleshin mbi ta, thuajse janë të palëvizshëm. Këto janë sjellje të zakonshme edhe para njerëzve që i respekton, e si të mos kërkohet kjo prej atij që e njih Sundimtarin mbi të gjithë sundimtarët, dhe gjendet para Tij?!

Secili që rri i qetë para tjetër përpos Allahut, ndërsa është nevrík e lëviz para Allahut Teala, e bën këtë vetëm pse i mungon njohja e madhërisë së Allahut Teala, e nuk është i vetëdijshëm se Ai po ia vrojton edhe zemrën. E lkrime ka thënë se në ajetin:

“I cili të sheh kur ti rri në këmbë (në namaz),

Dhe (e sheh) përkuljen tënde në mesin e atyre që bëjnë sexhde” (26–Shuara: 218, 219),

me shprehjen **‘takallub’** (përkulje) nënkuptohet kijami, rukuja, sexhdeja dhe teshehudi (ulja).

¹²³ Nuk është gjetur në burime

Rukuja dhe sexhdeja

Kur shkon në ruku dhe sexde, duke rifreskuar nijetin për t'ju përshtatur sunnetit të Resulallahut s.a.v.s., dhe duke kërkuar falje nga Allahu, i ngritë duart lartë duke thënë **Allahu Ekber**.

Edhe në ruku rifresko frikë-respektin ndaj Allahut Teala duke treguar përlësi dhe mundohu të zbutësh zemrën, e duke thënë:

Subhane Rabbije'l- dhim

(i Lartësuar qoftë Rabbi im),

ndihmohu me gjuhën tënde për ta vendosur në zemër madhështinë e Rabbit tënd.

Ngritu nga rukuja duke thënë:

Semiallahu limen hamideh

(e dëgjoji Allahu atë që e falënderoi),

duke shpresuar në rahmetin e Tij.

Më pas thuaj:

Rabbena ve lekel-hamd.

(Rabbi ynë, Ty të takon falënderimi),

dhe (sipas medh'hebit Shafi) kësaj ia shton:

Mil'e's –semavati ve mil'e'l –ardi.

(sa qiejt dhe Toka).

Më pas lëshohu në sexhde, shkalla më e lartë e përlësisë. Mbështet pjesën më të ndershme të trupit tënd - fytyrën tënde, në më të ulëtën – te këmbët.

Bile, nëse mund të largosh gjithçka të shtruar, e të bësh sexhde në tokë, ashtu vepro! Ashtu më lehtë e arrin përlësinë, dhe kjo shprehë më shumë nënshtrimin. Nëse gjendesh në pozitë të përljes, atëherë dije që ke marrë pozitën e duhur dhe që degën e ke kthyer në trungun e saj, sepse ti je krijuar nga dheu dhe te ai kthehesh.

E tash prapë në zemrën tënde përkujto madhësinë e Allahut, dhe thuaj:

Subhane rabbijel-ala

(I pastër nga çdo e metë është Rabbi im i Lartësuar).

Këtë vërtetoje me përsëritje, sepse shqiptimi një herë ka pak ndikim.

Kur të vendosësh madhësinë hyjnore në zemër dhe zemra të zbutet, le të forcohet shpresa jote për rahmetin e Allahut, sepse rahmeti i Tij është për të përlurin, jo për arrogantin e mendjemadhin.

Më pas ngrit kokën kur e thua tekbinin, duke lutur Allahun për atë që të duhet, e duke thënë:

Rabbifir verham ve texhavez amma ta'lem

(O Rabb, më fal e bëj rahmet dhe kaloi ato që Ti i di),
ose ndonjë dua tjetër.

Më pas, njëjtë i përlur kthehu për herë të dytë në sexhde.

Teshehud

Kur të ulesh për të lexuar *teshehud*, ulu me edeb. Thuaje qartë se të gjitha bereqetet dhe mirësitë, pra të gjitha cilësitë e mira që i përmend, i takojnë Allahut. Edhe pushteti, gjithashtu, i takon Allahut, dhe e gjitha kjo është kuptimi i shprehjes *ettehijjatu* (përsëndetjet). Vendose në zemër Resulallahun s.a.v.s., personalitetin e tij fisnik, dhe thuaj:

Selamun alejke ejuhen-nebijju ve rahmetullahi ve berekatuh

(Paqja, mëshira e Allahut dhe bereqeti i Tij qofshin me ty, o i Dërguar).

Të jesh i sigurt se ai selam do ta arrijë Resulallahun s.a.v.s., dhe beso që Resulallahu s.a.v.s., do ta kthejë ty selamin edhe më të përkryer. Pastaj dërgoi selam edhe vetes dhe të gjithë robëve të mirë të Allahut, dhe

mendo që edhe Allahu Teala po të dërgon ty selam, pra, po të mëshiron. Më pas dëshmo njëshmërinë e Allahut Teala, dhe pejgamberllëkun e Muhammed Mustafasë, s.a.v.s.. Pastaj, i përlur në modesti dhe plotësisht i dorëzuar, lexo duanë e zakonshme. Përmend në duanë tënde edhe prindërit dhe besimtarët tjerë. Te dhënia selam mendo si po i jep selam melekëve dhe të pranishmëve, e me këtë edhe bëj nijet përfundimin e namazit. Veçanërisht falëndero Allahun Teala që të ka mundësuar ta bësh këtë ibadet, dhe mendo se ky mund të jetë namazi yt i fundit e që ndoshta nuk do ta arrish namazin e radhës.

Duhet të kesh frikë që nuk do të pranohet ky namaz, për shkak të mangësive, të dukshme e të fshehta. Kur një person kërkoi këshillë nga Resulallahu s.a.v.s., Resulallahu s.a.v.s., i tha:

- Fale namazin sikur të jetë namazi yt lamtumirës...

Bashkë me të gjitha këto, shpresoj që Allahu Teala, me fisnikërinë dhe mirësinë e Tij, do ta pranohë namazin tënd. Jahja ibn Vessab, pas namazit qëndronte ulur një orë, sikur të ishte ende në namaz, dhe ndjente mall për namazin, ndërsa Ibrahim, pas namazit qëndronte ulur për një kohë, sikur të ishte i sëmurë.

Ky është shpjegim i detajuar i namazit të atyre që janë të përlurur në namazin e tyre, që kujdesen për namazin e tyre dhe e kryejnë rregullisht, atyre që bisedojnë intimisht me Allahun Teala, përshtatshëm mundësive të tyre. Le ta vendosë personi veten karshi këso namazi; le të gëzohet për arritjet e të mërzhitet për lëshimet, dhe le të jetë i vendosur në përmirësimin e tyre.

Namazi i pavëmendshëm është i rrezikshëm. Megjithëkëtë, ne nuk humbim shpresën nga mëshira e Allahut Teala, sepse mëshira e Tij është e pafund, dhe fisnikëria e Tij është e pakufizuar.

Prandaj ne, duke shprehur pafuqinë tonë dhe ibadetet e bëra me mangësi, lusim Allahun Teala të na i pranojë ato me mëshirën e Tij.

Dije, falja e namazit me sinqeritet në mënyrën që e shpjeguam - me përlulësi, respekt, turpërim e duke iu përshtatur kushteve të brenshme, vetëm për rizanë e Allahut Teala, siguron që nuri hyjnor të shkëlqejë në zemër, e ai nur do të jetë çelës për njohjet përmes shpalosjes.

Miqve të Allahut, të cilëve ju zbulohen botët e fshehta të qiejve e Tokës dhe fshehtësitë e *Rubbubijjet-it*, këto ju zbulohen në namaz, e posaqërisht në sexhde, sepse njeriu me sexhde i afrohet Rabbit të tij.

Prandaj, Allahu Teala thotë:

“... bëj sexhde dhe afrohu.” 96-Alak: 19

Shfaqjet për secilin namazli janë sipas pastrimit të tij nga ndytësit e kësaj bote. Ato shfaqje ndryshojnë, sipas fuqisë dhe dobësisë, lajmërimit të shpeshtë ose të rrallë, dhe sipas asaj se a janë të dukshme apo të fshehta. Kështu, disave ju shfaqet diçka ashtu siç është, e të tjerëve, e njëjta ju shpjegohet me ndonjë shembull. Disave kjo botë ju shfaqet në formë të cofëtinës, e shejtani në formë të qenit të shtrirë në të e që fton njerëzit në cofëtinë. Disave ju shfaqen cilësitë e Allahut Teala, disave veprimet e Tij, e disave u shfaqen finesat e diturisë praktike të fesë.

Me qëllim që të përcaktohen ato kuptime në secilën kohë, ekzistojnë shkaktarë të panumërt të fshehur, e njëri prej shkaktarëve më të fortë është drejtimi kah ajo që e intereson personin.

Prandaj, kur interesimi është i përqëndruar në diçka konkrete, ajo çështje i shfaqet atij më lehtë. E meqenëse këto shfaqje mund të shihen vetëm në pasqyrat e pastra, pra në zemrën e pastër, e pasqyrat janë përlyer e ndryshkur, pra zemrat janë përlyer e ndryshkur për shkak të mohimit, as udhëzimi nuk

paraqitet aty, jo pse Ai që e dhuron udhëzimin është dorështrënguar, por për shkak të ndryshkut aty ku udhëzimi duhet të lajmërohet, e gjuhët nguten për të mohuar sepse natyra njerëzore anon kah mohimi i asaj që nuk është prezente.

Po të kishte fetusi mendje, do të mohonte mundësinë e ekzistimit të njeriut në ajër të hapur, e po të kishte foshnja mundësi për arsyetim, ndoshta do të mohonte botët e padukshme të qiejve dhe Tokës, për të cilat të rriturit pohojnë se i kanë njohur.

Njeriu është kështu në çdo shkallë. Me siguri për shkak të moskuptimit, ai do ta mohojë shkallën më të lartë, që vjen më pas. Ai që mohon evliallëkun (velajet) dhe shkallët e saj, domosdo duhet të mohojë edhe pejgamberllëkun (*nubuvvet*), dhe shkallët e kësaj. Ndërkaq Allahu Teala i krijoi njerëzit veç e veç dhe në forma të ndryshme.

Prandaj, askush nuk duhet të mohojë atë që është më lartë se grada e vet. E ata kërkuan përmes bisedave dhe polemikave, e nuk kërkuan përmes pastrimit të zemrës nga gjithçka tjetër përpos Allahut Teala, prandaj natyrisht edhe humbën dhe mohuan.

Atij që nuk i është shfaqur diçka, më së paku që mundet është të besojë në të padukshmen dhe ta konsiderojë të vërtetë, deri sa kjo t'i dëshmohet me përvojë.

Në një lajm thuhet:

“Kur personi të hyjë në namaz, Allahu Teala e ngritë perden mes Tij dhe robit të Tij, dhe kthehet me fytyrën e Tij kah ai, e melekët i qëndrojnë pas krahëve, drejt kupës qiellore, falen si falet ai, dhe bëjnë amin në duanë e tij. Namazlisë, në kokë i lëshohet mirësi nga retë, e një telall bërtet:

- Po ta dinte ky me Kë po bisedon, nuk do ta kthente kokën.

Dyert e xhennetit i hapen, e Allahu Teala krenohet para melekëve me robin e Tij namazli.”

Hapja e dyerve të qiellit dhe kthimi i Allahut Teala me fytyrën e Tij kah namazlia është kuptimi alergorik i shfaqjes (*keshf*) dhe kerametit. Në Tevrat është shkruar:

“O i biri i Ademit, qaj kur je duke falë namazin para Meje, e nga qarja mos u rëndo. Unë jam Allahu, i Cili iu afrua zemrës tënde dhe, ani pse në mungesë, ti e ke parë nurin Tim.”

Ja kështu, butësia, vaji dhe hapja që përjeton namazlia në zemrën e tij janë nga afrimi i Allahut Teala në atë zemër. Kjo nuk është afërsi në hapësirë, por afërsi e rahmetit e hidajetit, përmes ngritjes së perdes.

Thuhet se kur njeriu i falë dy reqate, e lavdërojnë dhjetë safe me melekë. Në secilin saf janë nga dhjetë mijë melekë. Me namazlinë, Allahu Teala lavdërohet para njëqind mijë melekëve. Kjo sepse njeriu i bashkon në namaz kijamin, uljen, rukunë dhe sexhden, e Allahu Teala e ka shpërndarë këtë në katërdhjetë mijë melekë. Melekët që janë në kijam nuk do të shkojnë në ruku deri në ditën e Gjykimit. Ata melekë që janë në sexhde nuk do të ngriten deri në ditën e Gjykimit. Njëjtë edhe me melekët në ruku dhe ulur. Afërsia dhe pozita me të cilat Allahu Teala i shpërbleu melekët, janë në gjendje të njëjtë e nuk ndryshojnë.

Prandaj Allahu Teala na tregon që melekët kanë thënë:

“Nuk ka prej nesh (melekëve) që nuk e ka vendin (detyrën, pozitën) e vet të njohur.” 37-Safat: 164

E për dallim nga melekët, njeriu ngritet nga grada në gradë. Ai vazhdimisht i afrohet Allahut Teala, dhe përfiton afërsi gjithnjë e më të madhe, deri sa dyert e

afrimit janë të mbyllura për melekët. Secili prej melekëve e ka pozitën ku qëndron dhe ibadetin me të cilin është i angazhuar. As nuk kalon në pozitë tjetër, as nuk lodhet nga kjo:

“E ata që janë pranë Tij (melekët), nuk shprehin mendjemadhësi në adhurimin ndaj Tij, e as nuk ndjejnë lodhje.

Ata lartësojnë (Allahun) natë e ditë dhe nuk mërzhiten.” 21-Enbija: 19, 20

Çelës i ngritjes është namazi. Allahu Teala thotë:

**“Me të vërtetë, shpëtuan besimtarët,
të cilët, në namazin e tyre janë të përlshëm.”**

23-Muminun: 1, 2

Pas besimit (imanit) të tyre, Allahu Teala i lëndroi ata me namazin e tyre të përlshëm, e më pas Allahu Teala i përshkruan cilësitë e të shpëtuarve:

“...që e ruajnë namazin e tyre” 21-Muminun: 9,

e për rezultatet e këtyre cilësive, Allahu Teala thotë:

**“Pikërisht ata do të jenë trashëgimtarët,
të cilët do ta trashëgojnë Firdeusin, ku do të qëndrojnë përjetësisht.”** 21-Muminun: 10, 11

Fillimisht për ta Allahu Teala tha që janë të suksesshëm, e në fund se do ta trashëgojnë Firdeusin.

Nuk mendoj se me falje të pavëmendshme të namazit dhe me leximin e pavëmendshëm të Kur'anit mund të arrihet deri në këtë gradë. Pikërisht për këtë, Allahu Teala për të tjerët që janë ndryshe prej këtyre, thotë:

“Çka u solli juve në Sekar?

Ata thonë: ‘Nuk ishim prej atyre që falin namaz’.”

74-Mudethir: 42, 43

Ata që falin namzin trashëgojnë Firdeusin, ata do të shikojnë nurin e Allahut dhe do të kënaqen në afërsinë e Tij. Nga Allahu Teala dëshirojmë të na bëjë prej tyre, e jo nga ata që fjalët i kanë të bukura e veprimet e këqija. Dhuratat dhe mirësitë e Tij janë të pafund. Bereqeti i Tij qoftë mbi secilin rob të zgjedhur!

TREGIME PËR ATA QË FALNIN NAMAZIN ME PËRULJE (HUSHU)

Dije se përlësia është fryt i besimit dhe rezultat i bindjes së fuqishme në madhësinë e Allahut Teala. Ai që e kupton këtë, do të jetë i përlur në namaz, jashtë namazit, kur është vetëm, bile edhe në arkën e shtetit.

Shkaktar i përlësisë është njohja që Allahu Teala po e vështron robin e Vet, njohja e madhësisë së tij dhe kufizimit të njeriut. Nga këto njohje lindë përlësia, e cila nuk mbetet e ndërlidhur vetëm me namaz. Kështu

tregohet për disa që për katërdhjetë vjet nuk e ngritën kokën kah qielli, duke u turpëruar para Allahut Teala, dhe për shkak të përulësisë së tyre ndaj Tij. Disa njerëz mendonin se Rebi ibn Hasejm ishte i verbër, për shkak të shikimit të tij shumë të ulur dhe kokës së lëshuar poshtë. Plot njëzet vjet vinte te Ibn Mesud, dhe sa herë e shihte shërbëtorja e tij i thoshte:

- *Të erdhi ky shoku yt i verbër;*

e Ibn Mesud vetëm buzëqeshej. Kur trokiste për të hyrë, shërbëtorja ia hapte derën dhe e gjente me kokë të lëshuar e shikim të ulur poshtë, e Ibn Mesud, lexonte:

“Jepu lajme të mira atyre që janë të përulur.”

22-Haxh: 34,

e atëherë do të thoshte:

- *Pasha Allahun, po të shihte Muhammedi a.s., do të gëzohej;;*

e në transmetim tjetër: “...do të të donte”,

dhe në një tjetër: “...do të buzëqeshej”.

Ibn Hasejm kaloi një ditë me Ibn Mesud kah kovaçët, dhe kur e pa gjyrykun si lëshon flakë, kujtoi zjarrin e xhehenemit e i ra të fikët. Ibn Mesud i qëndroi te koka deri në hyrje të kohës për namaz, por Ibn Hasejm nuk u ngrit. E barti në shpinë deri te shtëpia e vet. Ibn Hasejm qëndroi pa vetëdije për njëzet e katër orë, deri të nesërmen, në kohën e njëjtë kur i kishte rënë të fikët,

dhe i ikën të pesë vaktet, e Ibn Mesud, afër kokës së tij, thoshte:

- Pasha Allahun, kjo është frika e vërtetë!

E vet Rebiu ka thënë: *“Asnjëherë nuk kam hyrë në namaz, e të mendoj për diçka tjetër përpos asaj që e thoja.”*

Amir Ibn Abdullah ishte gjithashtu namazli i përlur. Kur falej, vajza nganjëherë luante në def, gratë flisnin për çka të donin, e ai këto nuk i dëgjonte as nuk i kuptonte. Një ditë, dikush e pyeti:

- Çfarë të bie ndër mend në namaz?; e ai u përgjigj:

- Frika nga qëndrimi para Allahut në ditën e llogarisë dhe a do të shkoj në xhennet apo në xhehenem.

Dikush tjetër e pyeti:

- A të preokupon ndonjëherë në namaz diçka prej kësaj bote, që neve na preokupon; e ai u përgjigj:

- Më shumë do të doja të më therrin disa herë, se sa të mendoj në namaz atë që ju preokupon juve!

Amiri gjithashtu thoshte: *“Edhe po të më ngritej perdja, nuk do të më shtohet bindja!”*

Edhe Muslim ibn Jesar ishte njëri prej tyre. E përmendëm si nuk e ka vërejtur kur shtylla u rrëzua në xhaminë ku falej. Për Urve Ibn Zubejr thuhet se ju

dëmtuan gjymtyrët prej namazit, sa duhej t'i amputohen, por nuk ishte e mundur, prandaj dikush tha: *“Ky në namaz nuk ndjen çfarë ndodh rreth tij”*; dhe ia amputuan gjymtyrën derisa ai po falej, e ai fare nuk kishte njohuri! Disa thonin:

- *Namazi është punë e ahiretit, prandaj kur të hysh në namaz, ti e këputë lidhjen me dynja.*

E kur e pyetën njërin prej tyre se a mendon për gjëra të dynjasë në namaz, ai tha: *“As në namaz e as jashtë tij nuk mendoj tjetër pos Allahut.”*

Njërin e pyetën a kujton diçka tjetër në namaz, e tha: *“Asgjë nuk më është më e dashur se namazi, që ta kujtoj kur jam në namaz.”*

Ebu Derda r.a., ka thënë: *“Është nga dituria e personit që të hyjë në namaz me zemër të gatshme (huzur), pasi i kryen nevojat e veta.”*

Disa e falin namazin shpejt, nga frika e vesveses. Tregohet se Ammar ibn Jasir një herë e fali namazin shpejt dhe dikush e pyeti pse u ngut, në çka ai tha:

- *A mos braktisa ndonjë farz të tij?*

- *Jo, nuk i braktise,*

i thanë, e ai tha:

- Unë u fala shpejt që ta pres vesvesen e shejtanit, e Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Ka shumë që falin e nga namazi i shkruhet gjysma, një e treta, një e katërta, një e pesta, një e gjashta, një e dhjeta...”¹²⁴

Ammar ibn Jasir gjithashtu ka thënë: “Njeriut nga namazi do t’i shkruhet vetëm aq sa ka qenë i pranishëm në të.”

Thuhet se Talha, Zubejr e një grup i as’habëve tjerë, falnin namaz shumë shpejt, dhe thoshin: “Namazin nuk e zgjasim shumë për t’i prerë vesveset e shejtanit.”

Me një rast, Omer ibn Hattab r.a., në minber tha: “Vërtetë personi plaket në islam, e asnjë namaz të mos e ketë falë të përkryer.”

- E si ashtu?; e pyetën, e ai tha:

- Nuk ka qenë plotësisht i përlur, as modest, e as që ka qenë në batin plotësisht i kthyer kah Allahu Teala.

Ebu’l-Aliu u pyet për fjalët e Allahut Teala:

“Të cilët ndaj namazit të tyre janë të pakujdesshëm (të harrueshëm).” 107-Maun: 5,

¹²⁴ Transmeton Ahmed b. Hanbel.

e ai tha se i tillë është personi që harron se sa reqate ka falë. Për të njëjtin, Hasani Basriu thotë: *“Ky është personi që e harron kohën e namazit, dhe i kalon pa e falur”*, e dikush tjetër ka thënë: *“I tillë është ai që, nëse e falë në fillim të kohës, kjo nuk e gëzon, e nëse e falë pas kalimit të kohës, kjo nuk e mërzitë.”*

Dije se është e mundur që nga namazi të llogaritet ose shënohet një pjesë, e të mos i llogariten ose shënohen të tjerat, siç tregojnë transmetimet, ani pse fakihu do të thotë se namazi nuk mund të ndahet. Megjithatë, e thamë që kjo ka edhe kuptim tjetër, për të cilin gjithashtu tregojnë hadithet, ku është shënuar:

“Mangësitë e farzit plotësohen me nafile”¹²⁵

Në transmetime është shënuar që Isa a.s., ka treguar se Allahu Teala ka thënë:

“Me farzet, robi shpëton nga Unë, e me nafilet, Më afrohet!”

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Allahu Teala ka thënë:

- robi Im mund të shpëtojë nga Unë vetëm duke kryer atë që ia kam bërë të obliguar.”¹²⁶

¹²⁵ Autorët e *Sunen-it* dhe Hakimi, që e konsideron të besueshëm, nga Ebu Hurejre, ku thuhet: ***Vepra e parë për të cilën njeriu do të japë llogari në ditën e Gjykimit, do të jetë namazi...***

¹²⁶ Hadithi nuk është gjetur.

Tregohet se Resulallahu s.a.v.s., po falte namaz, e gжатë leximit e kaloi një ajet, e kur përfundoi namazin, u kthye, dhe tha:

- Çfarë bëra ashtu?

Të pranishmit heshtën, e Resulallahu s.a.v.s., e pyeti Ubejj ibn Ka'b r.a., e ai tha:

- Po lexoje filan suren, dhe nuk e lexove një ajet, për të cilin nuk e dimë a është i përjashtuar apo i hequr.

- Ti ishe i vetëdijshëm, ti e dije, o Ubejd!

tha Resulallahu s.a.v.s., e pastaj u kthye kah të tjerët:

- Çfarë është me ata që marrin pjesë në namaz, i mbushin safet, të dërguarin e vet e kanë me ta, e nuk dinë se çfarë u lexohet nga Libri i Rabbit të tyre. Kështu vepronin edhe të bijtë e Israilit, prandaj Allahu Teala i shpalli të dërguarit të Tij t'i thotë popullit: “Me trup përgatiteni dhe me gjuhë lexoni, por zemrat tuaja janë në anë tjetër dhe kjo që bëni është e kotë!”¹²⁷

Kjo tregon se dëgjimi dhe kuptimi i asaj që imami lexon është i mjaftueshëm. Dikush ka thënë: “Njeriu bën sexhde, e mendon se kështu i afrohet Allahut Teala, e sikur gjynahet e tij nga ajo sexhde të shpërndahen në banorët e një qyteti, të gjithë do të shkatërroheshin”;

¹²⁷ Muhammed ibn Nasr në **Kitabus-salah** si mursel, e Ebu Mensur Dejlemi nga Ubejj ibn Ka'b, si edhe në verzion të shkurtuar nga Abdurrahman ibn Ebza, me zinxhir të besueshëm të transmetuesve.

dhe dikush e pyeti:

- *Si bën kjo?*;

e ai ju tha:

- *Ai bën sexhde, por zemra i dëgjon kërkesat e veta, dhe e shikon të keqen si e ka pushtuar.”*

Këto janë cilësitë e të përulurve. Lajmet dhe tregimet e përmendura, bashkë me ato që u thanë më herët, tregojnë se esencë e namazit është përulësia dhe prania e zemrës, si edhe që vetëm lëvizjet, bashkë me pakujdesin, pak do të sjelli ndobi në ahiret, e Allahu e di më së miri. Nga Ai kërkojmë ndihmë dhe udhëzim.

Kapitulli i katërt

DETYRAT E IMAMIT NË NAMAZ DHE ÇËSHTJET PAS SELAMIT

Imami ka detyra para namazit, gjatë leximit të Kur'anit, gjatë pjesëve të tjera të namazit, si edhe pas selamit.

Gjashtë detyrat para namazit

1. Të mos pranojë detyrën e imamit nëse të tjerët nuk e dëshirojnë. Nëse janë ndarë, do të shikohet shumica, e nëse besimtarët dhe mirëbërësit janë në pakicë, më mirë e ka t'ju kushtoj kujdesin atyre. Në hadith thuhet:

“Tre personave, namazi nuk ju pranohet: skllavit të arratisur, gruas me të cilën bashkëshorti nuk është i kënaqur (*razi*) dhe imami që i'u fal namazin xhematit e ata nuk e dojnë.”¹²⁸

Ashtu siç është e ndaluar të pranohet detyra e imamit nëse ai nuk është i dashur nga xhemati, njëjtë ndalohet të pranohet detyra e imamit nëse pas tij është dikush më i dijshtëm se ai, përpos nëse ky i dijshtëmi nuk

¹²⁸ Tirmidhiu, nga Ebu Umame.

ka mundësi. Nëse nuk janë këto raste, atëherë le ta pranojë detyrën sapo të vjen, dhe le të jetë i sigurt që mund t'i plotësojë të gjitha kushtet e detyrës së imamit. Refuzimi i kësaj nuk është i pëlqyer.

Thuhet se disa refuzuan të jenë imamë, pasi që xhemati ishte mbledhur, prandaj u shkatërruan. As'habët evitonin imametin sepse i jepnin përparësi atij për të cilin mendonin se ka epërsi, ose i frikësoheshin harresës, si edhe peshës së garantimit të namazit të të tjerëve, sepse imami është dorëzanë. Ai që nuk është mësuar në këtë, zemra mund t'i shqetësohet në namaz, për shkak të turpit nga ata që e përcjellin, posaçërisht kur të lexojë Kur'anin me zë. Pra, këto mund të jenë sebebepet pse nuk e kanë pranuar detyrën e imamit.

2. Nëse dikujt i jepet mundësia të zgjedhë në mes të thirrjes së ezanit dhe imametit, duhet zgjedhë imameti. Të dyja i kanë përparësitë e veta, e të bashkohen nuk pëlqehet, prandaj është e nevojshme që imam të jetë dikush tjetër, e jo myezini. E meqenëse nuk bashkohen, imameti ka përparësi. Disa thonë se thirrja e ezanit ka përparësi, në bazë të transmetimeve që flasin për vlerën e ezanit, si edhe bazuar në hadithin ku thuhet:

“Imami është dorëzanë, e myezini është njeri i besueshëm.”¹²⁹

¹²⁹ Shënojnë Ebu Davudi dhe Tirmidhiu nga Ebu Hurejre.

Duke u mbështetur në këtë hadith, të parët kanë preferuar myezinllëkun, sepse në dorëzani ka rrezik. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Imami është i besueshëm, prandaj kur ai e bën rukunë, bëjeni edhe ju, e kur ai të lëshohet në sexhde, lëshohuni edhe ju!”¹³⁰

Në tjetër hadith thuhet:

“Nëse e falë namazin e plotë, kjo i llogaritet edhe atij edhe xhematit, e nëse ka mangësi, mangësia i llogaritet vetëm atij, por jo edhe xhematit”¹³¹, si edhe:

“O Allah, udhëzoi imamët dhe fali myezinët!”¹³²

Kërkimi i faljes është më i mirë, sepse falja përfshinë edhe udhëzimin.

Në një transmetim thuhet:

“Kush është imam për shtatë vjet në një xhami, meriton të hyjë në xhenet pa dhënje të llogarisë, edhe kush thërret ezan për katërdhjetë vjet, do të hyj në xhennet pa dhënë llogari.”¹³³

¹³⁰ Buhariu nga Ebu Hurejre.

¹³¹ Ebu Davud, Ibn Maxhe, Hakimi, që e konsideron të besueshëm nga Ukbe ibn Amir dhe Buhariu nga Ebu Hurejre, me fjalët: ***Ata ju udhëheqin në namaz, nëse ata e falin mirë, ju e keni shpërblimin, e nëse gabojnë, ju e keni shpërblimin, e ata gjynahun.***

¹³² Vazhdim i hadithit të përmendur më lartë: ***Imami është dorëzanë...***

¹³³ Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe nga Ibn Abbas, vetëm me pjesën e parë. Tirmidhiu e konsideron garib.

Për këtë arsye transmetohet se as'habët ngurronin nga imameti, edhe pse imameti ka vlerë më të lartë se sa myezinllëku, sepse edhe Resulallahu s.a.v.s., ishte vazhdimisht imam, si edhe Ebu Bekr r.a., Omeri r.a., dhe imamët pas tyre. Në imamllëk është rreziku i dorëzarisë, por edhe vlera e lartë (fazilet) e saj është më e lartë, siç është më me vlerë pozita e sundimtarit (sulltanit) se sa e valisë, sipas fjalëve të Resulallahut s.a.v.s.:

“Sundimi një ditë me drejtësi është më me vlerë se sa ibadetet e shtatëdhjetë vjetëve.”¹³⁴

Prandaj është e domosdoshme t'i jepet përparësi më të moralshmit dhe më të dijshtit. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Imamët tuaj janë shefatxhitë tuaj”; ose ka thënë:

“...janë nga ata që ju dërgojnë juve Allahut, nëse dëshironi të plotësoni namazet tuaja, zgjedhni më të mirin.”¹³⁵

¹³⁴ Taberani nga Ibn Abbasi.

¹³⁵ Darekutni.

Dikush nga të parët, thotë:

“Pas peygamberëve, vlerën më të lartë e kanë dijetarët, e pas dijetarëve, vlerën më të lartë e kanë imamët që u prijnë të tjerëve në namaz, sepse ata qëndrojnë edhe para Allahut Teala, edhe para njerëzve: të parët me peygamberllëk, të dytët me dituri, e të tretët me namaz, shtyllën e fesë.”

Këtë dëshmi e përdorën as’habët për t’i dhënë përparësi Ebu Bekr Siddik r.a., në halifet, kur thanë:

*“E kuptuam që namazi është shtyllë e fesë tonë; Resulallahu s.a.v.s., e zgjodhi imam Ebu Bekrin r.a., duke e preferuar atë për fenë tonë, dhe ne e zgjodhëm udhëheqës edhe për punët tona të dynjallëkut.”*¹³⁶

Por, Bilal-i Habeshin r.a., nuk e zgjodhën, ani pse Resulallahu s.a.s.v., e kishte zgjedhur atë si myezin.¹³⁷

¹³⁶ Ibn Shahin në **Sherh mezaheb ehli-sunne** nga Alia r.a.:

*“Resulallahu s.a.v.s., e urdhëroi Ebu Bekr të bëhet imam, e edhe unë isha prezent, nuk mungoja, as nuk isha i sëmurë, dhe u pajtuam në punët tona të dynjasë me atë me të cilin Resulallahu s.a.v.s., ishte i kënaqur për punët tona të ahiretit”. Fjalët e Resulallahuts.a.v.s., janë muttefekun alejhi nga Ajshe r.ana., dhe Ebu Musa, ku thuhet: **“Urdhëroni Ebu Bekrin t’ju falë namaz njerëzve...”***

¹³⁷ Shënojnë Ebu Davudi dhe Tirmidhiu, që e konsideron të besueshëm, Ibn Maxhe, Ibn Huzejme, Ibn Hibban nga Abdullah ibn Zejd në **Bed’ul-ezan**, e në to thuhet: **“Ngritu me Bilallin dhe tregoi çfarë ke parë në ëndërr, dhe ashtu le ta thërras ezanin.”**

Sa për transmetimin ku thuhet që dikush i tha Resulallahut s.a.v.s.:

- *O Resulallah, më udhëzo për atë që do të më fusë në xhennet!*;

e Resulallahu s.a.v.s., i tha:

- ***Bëhu myezin!***

- *Nuk mundem, tha personi.*

- ***Bëhu pra imam!***

- *Nuk mundem as këtë;* e Resulallahu s.a.v.s., tha:

- ***Atëherë falu menjëherë pas imamit***¹³⁸;

është e mundur që Pejgamberi t'a ketë propozuar fillimisht për myezin duke menduar që xhemati nuk do ta dojë atë person për imam. Pastaj i propozoi imamllëkun duke menduar se mund ta bëj.

Për dhënie përparësi Bilallit pas vdekjes së Resulallahut s.a.v.s., Taberani transmeton se si Bilalli erdhi te Ebu Bekr, e i tha:

- *O përfaqësues i Resulallahut, dua që deri në vdekje t'i kushtohem xhihadit;* e Ebu Bekr i tha:

- *Pasha Allahun o Bilall, pasha nderin e drejtësinë, jam plakur e dobësuar, dhe vdekja më është afruar;* dhe Bialli qëndroi me të, e kur Ebu Bekr r.a., vdiq dhe erdhi Omeri r.a., që i tha njëjtë si Ebu Bekr, Bilalli e refuzoi, dhe Omeri r.a., e pyeti:

- *E kush pra, Bilall?*

- *Sa'di, sepse ka thirrë ezan në Kuba gjatë kohës së Resulallahut s.a.v.s., prandaj Omeri ia besoi leximin e Kur'anit Sa'dit dhe Ukbës. Në sened të këtij hadithi gjendet edhe një person i panjohur.*

¹³⁸ Buhariu dhe et-Tarihu, Ukajli në Duafa dhe Taberani në '***Evsat***', nga Ibn Abbas me zinxhir të dobët të transmetuesve.

3. Që imami të ketë kujdes për kohët e namazit dhe t'i falë në vaktin e parë, që të arrijë rizanë e Allahut Teala, sepse me një hadith, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Vlera e lartë (*fazilet*) e pjesës së parë të kohës në krahasim me kohën e fundit është sikur vlera e ahiretit në krahasim me dynjallëkun.”¹³⁹

Prapë me një hadith thuhet:

“Njeriu falë namazin në fund të vaktit e nuk e lë pa e falë, por fazileti i humbur nga koha e parë do t'i ishte më i hairit se e gjithë dynjaja me gjithë çka ka.”¹⁴⁰

Nuk duhet të shtyhet namazi që të pritët më shumë xhemat, përkundrazi - e kanë obligim të mundohen të fitojnë vlerën e vaktit të parë. Kjo ka më shumë vlerë se sa xhemati masiv dhe zgjatja e leximit të sureve. Bile edhe është thënë:

“Nëse dy persona janë në xhemat, nuk e presin të tretin, e nëse katër persona janë te xhenazja, nuk e presin të pestin.”

Kur ishin në betejën e Tebuk-ut, Resulallahu s.a.v.s., u vonua me pastrim për namaz të sabahut, por të tjerët nuk e pritën dhe ia lanë imametin Abdurrahman ibn Avfit, e ai i udhëhoqi në namaz. Resulallahut s.a.v.s., i kaloi

¹³⁹ Ebu Mensur ed-Dejlemi nga Ibn Omeri.

¹⁴⁰ Darekutni nga Ebu Hurejre.

një reqat, prandaj në fund të namazit u ngrit dhe e fali edhe atë. Njerëzve ju erdhi keq, por Resulallahu s.a.v.s., tha: **“Mirë keni bërë, ashtu të veproni!”**¹⁴¹

Në një rast tjetër, Resulallahu s.a.v.s., u vonua për namazin e drekës, dhe e vendosën përpara Ebu Bekrin r.a.. Kur erdhi Resulallahu s.a.v.s., Ebu Bekr tashmë kishte filluar namazin, e Resulallahu s.a.v.s., vetëm iu afrua pranë.¹⁴² Imani nuk e ka obligim të presë myezinin, por myezini e ka obligim ta presë imamin për ikamet, dhe sapo janë gati imami dhe myezini, askush tjetër nuk pritet;

4. ta bëjë nijetin sinqerisht për rizanë e Allahut Teala, që do të zbatojë pastërtinë (personle) dhe shartet tjera të namazit. Sinqeriteti nënkupton që për këtë të mos marrë kompenzim material. Resulallahu s.a.v.s., e urdhëroi Osman ibn Ebi’s Sekafijj:

“Angazho myezinin i cili për ezan nuk merr pagesë.”¹⁴³

Ndërsa ezani është vetëm thirrje në namaz, prandaj edhe më e rëndësishme është që për namaz të mos merret pagesë. Nëse merr mjete nga xhamia, të cilën

¹⁴¹ *Muttefekun alejhi*, nga Mugire.

¹⁴² Autorët e *Sunen-it* nga Osman b. el-As.

¹⁴³ E përmendin autorët e *Sunen-it* dhe Hakimi, që e konsideron të besueshëm.

vakëfi e mbledhë për atë që do të jetë imam i asaj xhamie, kjo nuk mund të konsiderohet e ndaluar (*haram*), por është e papëlqyer (*mekruh*). Mospëlqimi është më i madh për namazet farz, se sa për namazin e taravisë. Nëse merr para, do ta marrë për kohë, për praninë e tij të vazhdueshme aty dhe për kujdesin për xhaminë gjatë mbledhjes së xhematit, por jo për imamllëk.

Sa për besushmërinë e imanit, e kjo është pastërtia e tij, mendohet në pastërtinë e vazhdueshme nga gjynahet e mëdha si edhe ato të voglat - të brendshme. Kandidati për imam duhet maksimalisht të ruhet nga kjo, sepse i përfaqëson ata njerëz, prandaj edhe duhet të jetë më i miri mes tyre. Njëjtë duhet ta pastrojë të jashtmen, nga papastërtitë e dukshme e të padukshme, sepse ato nuk i sheh kush pos tij. Kështu, nëse gjatë namazit i kujtohet se është pa abdes, ose lëshon gazëra, pa ngurrim do ta marrë për dore atë që e ka më afër dhe do ta vendosë si zëvendësim.

Këto gjendje nuk janë diçka që duhet të turpërohet. Sufjan-i Servi ka thënë:

“Falu mbrapa cilit do mirëbërësi apo gjynahqari, përpos mbrapa pijanecit, atij që bën gjynahe haptaz, atij që nuk i dëgjon prindërit, bidatxhisë dhe skllavit të arratisur”;

5. Të mos bëjë tekbir pa u drejtuar safet. Le të kthehet djathtas e majtas, dhe nëse sheh vende të zbrazëta, të urdhërojë të plotësohen. Thuhet se as'habët drejtoheshin me krahë, dhe i afronin thembrat me njëri-tjetrin. Nuk duhet të bëj tekbir deri sa myezini nuk përfundon ikametin. Intervalin mes ikametit dhe ezanit myezini duhet t'ia përshtatë gjendjes së xhematit. Në transmetim thuhet:

“Myezini le të bëjë një pushim në mes të ezanit dhe ikametit, sa t'i mjaftojë atij që është duke ngrënë që të përfundojë, dhe atij që është duke kryer nevojën, deri sa të marrë abdes.”¹⁴⁴

Arsye është ndalesa e Resulallahut s.a.v.s., për të duruar nevojën¹⁴⁵ si edhe urdhri i tij që një herë të hahet darka e më pas të falet jacia¹⁴⁶, duke kërkuar kështu qetësi shpirtërore.

6. Që me zë të lartë t'a bëjë tekbirin fillestar, e edhe tekbirët tjerë, e xhemati vetëm aq sa ta dëgjojë veten. E

¹⁴⁴ Tirmidhiu dhe Hakimi, nga Xhabiri: **“O Bilall, bëj pushim në mes ezanit dhe ikametit aq sa u mjafton atyre që po hanë ose po pinë që të përfundojnë, dhe atij me nevojë, ta kryejë”**.

¹⁴⁵ Muslimi, nga Ajshe r.anha., me fjalët: **“Nuk ka namaz...”**, e te Bejhekiu: **“Asnjëri nga ju të mos falë...”**

¹⁴⁶ *Muttefekun alejhi*, i përmendur më herët, nga Ibn Omer dhe Ajshe r.anha., me fjalët:

“Kur të shtrohet darka edhe nisë namazi, filloni me darkën.”

për të fituar faziletin e imamatit duhet ta bëj nijet për imamat; nëse nuk e bën nijet - namazin e ka të drejtë por nuk fiton faziletin e imamatit e xhemati që e bën nijet ta pasojë fiton faziletin e pasimit. Xhemati duhet ta thotë tekbirin pasi që imami e përfundon tekbirin.

Tri detyrat në lexim

1. Duanë hyrëse dhe eudhubilahun e lexon në vete, e me zë lexon *Fatih*anë dhe suren pas saj, në sabah dhe në dy reqatet e para të akshamit dhe jacisë. Njëjtë edhe ai që falë vetëm. Aminin e thotë me zë te namazet ku suret lexohen me zë, e njëjtë edhe xhemati, që synon ta thotë aminin në të njëjtën kohë me imamin, jo pas tij. Me zë do ta thotë *bismilahun*.¹⁴⁷ Transmetimet për këtë janë kundërshtuese, e Imam Shafiu ka zgjedhur leximin me zë;

¹⁴⁷ Sipas medh'hebit Hanefi, sunnet është që edhe imami edhe xhemati *bismilahun* ta lexojë në vete. Hadithin për lexim me zë e shënojnë Darekutni dhe Hakimi, që e konsideron të besueshëm nga Ibn Abbas r.a., e hadithin për të mos lexuar *bismilah* me zë e shënon Muslimi nga Enesi r.a., ku thuhet:

“Po falja namaz me Resulallahun s.a.v.s., Ebu Bekrin dhe Omerin dhe nuk e dëgjova asnjërin duke thënë *bismilahir-rahmanir-rahim*”.

Te Nesai thuhet: **“...lexonte me zë *bismilahir-rahmanir-rahim*”.**

2. Të bëjë tri ndalesa gjatë leximin në *kijam*.¹⁴⁸ Këtë e tregon Semure ibn Xhundub dhe Imran Ibnu'l- Husejn nga Resulallahu s.a.v.s..¹⁴⁹

Ndalesa e parë, më e gjata prej tyre, është mes tekbitit fillestar dhe *Fatihës*. Zgjatë aq sa i duhet xhematit ta lexojë *Fatihën*, e gjatë kësaj kohe imami lexon duanë hyrëse, ose pret. Nëse (sipas Shafive) nuk ndalet, xhemati mbetet i privuar nga fazileti i dëgjimit dhe imami bëhet përgjegjës. E nëse xhemati nuk e lexojnë *Fatihën* gjatë ndalesës, por merren me diçka tjetër, kjo është përgjegjësi e xhematit¹⁵⁰.

¹⁴⁸ Sipas medh'hebit Hanefi xhemati heshtë dhe dëgjon leximin e imamit dhe kjo i mjafton, e nëse lexon, do të ishte *mekruh tahrimi*, prandaj imami nuk e ka obligim të bëjë pushimet e cekura.

¹⁴⁹ Ahmed, nga Semure, ku thuhet: "**Resulallahu s.a.v.s., bënte ndalesa në lexim gjatë namazit.**" Imrani thotë: "**Unë i mbaj në mend dy ndalesa të Resulallahut s.a.v.s.**" I shkruan Ubejj ibn Ka'b-it për këtë, e ai u përgjigj se Semure ka të drejtë. Kështu thuhet në një botim të pashqyrtuar të *Musnedit*. Është e njohur se Imrani ia mohonte këtë Semurit, gjë që përmendet disa herë në *Musned*. E shënojnë gjithashtu edhe Ebu Davudi, Ibn Maxhe, Ibn Hibban dhe Tirmidhiu, te i cili thuhet: "**Imrani këtë e mohoi, dhe tha: Mbajmë mend vetëm një ndalesë.**" Tirmidhiu e konsideron të mirë. Në transmetimin nga Semure përmenden dy ndalesa, por ka dallim në transmetime lidhur me pozitën e të dytës. Në një transmetim thuhet që ndalesa e dytë është pas *Fatihës*, e në tjetrin – pas sures. Te Darekutni, nga Ebu Hurejre, i cili e konsideron të dobët, thuhet: "**Kush falë namazin farz me imamin, le ta lexojë *Fatihën* kur imami të ndalojë.**"

¹⁵⁰ Hanefitë që i përshtaten Imamit, heshtin dhe dëgjojnë, edhe kur imami lexon me zë edhe pa zë.

Ndalesa e dytë është kur të përfundojë me *Fatihane*, në mënyrë që ai që ka filluar *Fatihane* në ndalesën e parë, tash e përfundon. Kjo zgjatë sa gjysma e ndalesës së parë.

Ndalesa e tretë është pas leximit të sures, para rukusë. Kjo është më e shkurta, zgjatë vetëm aq sa për të ndarë leximin nga tekberi, sepse bashkimi i tyre është i ndaluar. Pas imamit (sipas Shafive), xhemati lexon vetëm *Fatihane*. Nëse imami nuk ndalon, xhemati do ta lexojë *Fatihane* bashkë me të, e mangësia është e imamit.

Nëse xhematlia nuk e dëgjon imamin për shkak të distancës, në namazet ku lexohet me zë, nuk ka dëm nëse me zë e lexon edhe suren;

3. Në namazin e sabahut të lexojë dy sure *mesani*¹⁵¹, më pak se njëqind ajete; leximi i gjatë në namaz të sabahut dhe falja e tij pas agimit është sunnet. Nuk ndalohet as dalja nga ajo kohë dhe pritja deri para lindjes së diellit. Lejohet edhe leximi i sureve nga tridhjetë e njëzet ajete, e deri në fund të ajeteve, sepse veshët nuk i dëgjojnë shpesh këto, prandaj do të kenë më shumë ndikim si dhe nxisin mendimet. Disa dijetarë e konsiderojnë të papëlqyer të lexohet një pjesë e sures e pastaj të ndërpritet, mirëpo është transmetuar që

¹⁵¹ Ndarja e Kur'anit sipas gjatësisë së sureve u shpjegua më herët.

Resulallahu s.a.v.s., po lexonte një pjesë të sures *Junus*, dhe kur arriti te përmendja e Musasë a.s., dhe Faraonit, e ndërpreu leximin dhe bëri *ruku*.

Gjithashtu tregohet se Resulallahu s.a.v.s., lexoi në namaz të sabahut një ajet nga surja *Bekare*:

“thuani: *ne i besuam Allahut, atë që na u shpall neve...*” (2-Bekare: 136),

e në reqatin e dytë:

“Zoti ynë, ne e besuam atë që e zbritte (shpalljen).”

3-Ali Imran: 53

Resulallahu s.a.v.s., e dëgjoi një herë Bilallin si lexon nga sure të ndryshme, dhe e pyeti për këtë, e Bilalli tha:

- *Po e përziej të mirën me të mirën* (pra, ajetet e rahmetit), e Resulallahu s.a.v.s., iu përgjigj:

- **Mirë ke vepruar!**¹⁵²

Në namaz të drekës lexonte sure më të gjata, (*mufessail*), deri në tridhjetë ajete, në ikindi gjysmën e kësaj, në aksham, suret e fundit, që janë më të shkurta. Namazi i fundit që ka falur Resulallahu s.a.v.s., ishte në aksham, ku lexoi suren *Mursetat*. Pas kësaj nuk fali asnjë

¹⁵² Ebu Davudi nga Ebu Hurejre me zinxhir të besueshëm të transmetuesve.

namaz, deri në vdekje.¹⁵³ Pra, leximi më i shkurtë është më i dëshirueshëm, sidomos kur ka shumë xhemat. Për këtë lehtësim, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kur dikush nga ju bëhet imam i xhematit, mos ta zgjasë, sepse mes tyre ka të dobët, të vjetër dhe njerëz me nevoja. E kur falet i vetëm, le ta zgjasë sa të dojë.”¹⁵⁴

Muadh ibn Xhebel po falte jacinë dhe lexoi suren Bekare, dhe një person e lëshoi xhematin dhe u fal vet. E quajtën mynafik dhe iu ankuan Resulallahut s.a.v.s., por Resulallahu a.s., e qortoi Muadhin duke thënë:

“Mos bëj fitne, o Muadh, lexo suret *Sebbih, Ves-semai vet-tarik* dhe *Vesh-shemsi ve duhaha*.”¹⁵⁵

Tri detyrat në mënyrën e faljes

1. Të mos qëndrojë gjatë në ruku dhe sexhde. Të mos bëj më shumë se tre tesbihë. Është transmetuar se Enesi r.a., ka thënë: *“Nuk kam parë namaz më të lehtë e më të plotë se sa namazi i Resulallahut s.a.v.s.”*¹⁵⁶

¹⁵³ *Muttefekun alejhi*, nga Ummu-Fadl.

¹⁵⁴ *Muttefekun alejhi* nga Ebu Hurejre.

¹⁵⁵ *Muttefekun alejhi*, nga Xhabiri, e aty nuk përmendet *Ves-semai vet-tarik*, por përmendet te Bejhekiu.

¹⁵⁶ Hadithi është *Muttefekun alejhi*.

Transmetohet edhe nga Enes ibn Malik që, kur po falte namaz prapa Omer ibn Abdulaziz, që në atë kohë ishte Emir i Medines, tha:

“Nuk kam falur namaz pas askujt tjetër, e të ma kujtojë namazin e Resulallahut s.a.v.s., sikur namazi i këtij të riu.”

Tregohet gjithashtu se kanë thënë:

“Bënim tesbih prapa Resulallahut s.a.v.s., në ruku dhe sexhde, nga dhjetë herë.”

Kjo është e bukur, por nëse është xhemati më i madh, më mirë të mjaftohet me tri.

Nëse të pranishëm janë xhemati i njohur, atëherë nuk ka pengesë të bëhet tesbih edhe nga dhjetë herë. Kjo është mënyra e përshtatjes së këtyre transmetimeve.

Te ngritja nga rukuja, imami duhet të thotë:

Semiallahu limen hamideh

(Allahu e dëgjon atë që e falënderon).

2. Detyra e dytë i përket xhematit. Nuk do të duhej të shkojë në ruku dhe sexhde bashkë me imamin, por do të presë pak, ashtu që të lëshohet në sexhde vetëm pasi që balli i imamit të prekë dyshtemenë e mesxhidit, e

kështu edhe as'habët e përcjellnin Resulallahun s.a.v.s..
Nuk duhet as të niset në ruku, para se imami nuk vendoset në ruku. Dikush ka thënë:

“Njerëzit e përfundojnë namazin në tri grupe: një grup fiton njëzet e pesë gradë, e këta janë ata që bënin tekbir dhe ruku pas imamit. Grupi tjetër fiton një gradë, dhe janë ata që tekbir dhe ruku bëjnë bashkë me imamin. Një grup nuk fiton asnjë gradë, e këta janë ata që tekbir e ruku i bënin para imamit.”

Ka ndarje të mendimeve se a duhet imami në ruku të presë bashkëngjitjen e atij që sapo ka hyrë, dhe imami i dëgjon hapat e tij, që edhe ai ta arrijë vlerën e xhematit duke u bashkuar në atë ruku. Ndoshta më e udhës është të thuhet se nuk ka kurrfarë pengese ta zgjasë pak dhe nëse kjo për xhematin nuk është ndalesë e gjatë, sepse duhet pasur kujdes në të drejtën e tyre që të mos ju zgjaten shumë pjesët e namazit.

3. Imami në *teshehud* nuk duhet të lexojë më shumë se duanë e teshehudit, duke u ruajtur nga zgjatja. Duanë e lexon në shumës, prandaj do të thotë *‘O Allah, na fal’* (*Allahummagfirlena*), e jo *‘më fal mua’* (*Allahummagfirli*).

Konsiderohet *mekruh* që imami të lexojë vetëm për vete. Në teshehud mund të kërkohet strehim me pesë fjali, të shënuara nga Resulallahu s.a.v.s., i cili ka thënë:

“Tek Ti strehohemi nga dënimi i xhehenemit dhe nga tmerri i varrit. Tek Ti strehohemi nga sprovat e jetës dhe vdekjes, dhe nga sprova e *Mesih-i dexhallit*. Kur Ti dëshiron të sprovosh njerëzit, na merr pranë Teje, para sprovës.”¹⁵⁷; e është treguar se u quajjt *mesih-i dexhall* për shkak të një syri të verbër.

Tri detyrat në fund të namazit

1. Kur jep selam t’i bëjë nijet për xhemat dhe për të gjithë myslimanët.

2. Të qëndrojë ulur në vend për një kohë pas selamit, e të mos të largohet menjëherë.¹⁵⁸ Ashtu vepronin Resulallahu s.a.v.s., Ebu Bekr dhe Omeri r.a., ndërsa për sunnet e ndërron vendin. Nëse pas tij ka gra, nuk do të ngritet deri sa ato të largohen.

Në një transmetim të njohur thuhet se Resulallahu s.a.v.s., qëndronte ulur vetëm aq sa të mund të thoshte:

¹⁵⁷ Tirmidhiu, nga Ibn Abbas r.a.. Hakimi të ngjashëm nga Sevban dhe Abdurrahman ibn Ajshe, dhe të dy transmetimet i konsideron të besueshme.

¹⁵⁸ Buhariu, nga Ummu Seleme r.a.

**Allahumme entes-salam ve minkes-salam,
tebarekte ja dhel-xhelali vel-ikram**

(O Allahu im, Ti je shpëtim dhe prej Teje është shpëtimi, i lartësuar qofsh Ti, që je i Madhëruar dhe i Nderuar)¹⁵⁹;

3. Kur të ngritet, duhet që me fytyrë t'i kthehet xhematit. Është e papëlqyeshme që xhemati të ngritet e të largohet para imamit. Talha dhe Zubejr r.a., falën namaz me një imam, e kur dhanë selam, i thanë imamit:

- *Namazin e fale shumë mirë, pos që pas selamit nuk u ktheve me fytyrë kah xhemati*“, e xhematit i thanë:

- *Shumë mirë u falët, pos që u larguat para imamit.*

Pas kësaj, imami mund të kthehet kah të dojë, kah e djathta ose e majta, e ana e djathtë është më e mirë.

Këto janë detyrat në pesë kohët e namazit. Te namazi i sabahut (sipas Shafive), shtohet edhe dua ja e Kunutit, dhe kur imami të thotë:

“O Allah, më udhëzo...”, xhemati do të thotë *amin*, ndërsa kur imami të arrijë te fjalët:

“...Ti gjykon, e Ty askush nuk mund të të gjykojë...”, nuk është me vend të thuhet *amin*, meqenëse ky është nderim e jo lutje, prandaj do të thotë të njëjtën si imami, ose do të thotë:

¹⁵⁹ Musliimi nga Ajsher.a.

Bela ve ene ala dhalike minesh-shahidin (Gjithsesi, e unë jam njëri nga ata që dëshmojnë), ose:

Sadakte ve bererte (të vërtetën dhe të drejtën e tua), e të ngjashme.

Transmetohet edhe hadithi për ngritjen e dorës te leximi i duasë së Kunutit, prandaj nëse hadithi është i besueshëm, kjo është mirë (*mustehab*) të bëhet, ani pse është e kundërt me sjelljen te leximi i duasë në fund të teshehudit, sepse aty nuk ngriten duart. Megjithatë, duhet mbështetur në atë që është vërtetuar me tekstet e fikhut, e për këto raste, edhe aty ka dallime. Duart kanë rol në teshehud, e që është vendosja e tyre në kofsha në mënyrë të caktuar, mirëpo te duaja e Kunutit duart këtu nuk kanë ndonjë rol të veçantë, prandaj nuk është larg mendjes të thuhet se ato duhet ngritur, sepse është përshtatshëm duasë, e Allahu e di më së miri.¹⁶⁰

Kjo është përmbledhje e rregullave të sjelljes te imameti dhe ndjekja e imamit, e prej Allahut është udhëzimi, për çdo punë.

¹⁶⁰ Të gjitha këto janë sipas medh'hebi Shafi, ndërsa sipas Hanefive kunuti është në vitër.

Kapitulli i pestë

VLERAT E LARTA (FAZILET), RREGULLAT E SJELLJES (ADABI), SUNNETET DHE KUSHTET E XHUMASË

VLERAT E LARTA (FAZILET) TË XHUMASË

Dije që dita e xhumasë është ditë e rëndësishme; Allahu Teala e zbukuroi Islami me këtë ditë, dhe ua caktoi vetëm myslimanëve. Allahu Teala thotë:

“O ju që besuat, kur bëhet thirrja për namaz, ditën e xhumasë, ecni shpejtë për aty ku përmendet Allahu (dëgjojeni hutben, faleni namazin), e lini shitblerjen, kjo është shumë më e dobishme për ju, nëse jeni që e dini.” (62-Xhuma: 9),

prandaj ndaloi angazhimin me punët e kësaj bote dhe gjithçka tjetër që pengon shkuarjen në xhuma.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Allahu Teala ua bëri xhumanë farz, në këtë ditë dhe në këtë vend.”¹⁶¹

¹⁶¹ Ibn Maxhe, nga Xhabiri.

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

“Atij që tri herë pa arsye nuk vjen në namaz të xhumasë, Allahu ia vulosë zemrën!”¹⁶²,

e në transmetim tjetër:

“...e ka hedhur islamin pas shpine.”¹⁶³

Një person vinte shpesh te Ibn Abbasi dhe e pyeste për shokun që i kishte vdekur, e nuk kishte shkuar në asnjë xhuma, as në një namaz me xhemat, e Ibn Abbas r.a., i tha:

- *Do të shkojë në xhehenem.*

Për një muaj ky kthehej te Ibn Abbasi dhe gjithmonë e pyeste të njëjtën, e ai gjithmonë përgjigjej:

- *Do të shkojë në xhehenem.*

Në transmetim thuhet:

“Pasuesve të dy Librave ju dha xhumaja, por u ndanë rreth saj, prandaj u larguan nga kjo, e Allahu Teala neve na udhëzoi në atë ditë. E la për këtë ummet, ua bëri ditë të bekuar, prandaj ata kanë më së shumti të drejtë në të, ndërsa pasuesit e dy Librave vijnë pas.”¹⁶⁴

¹⁶² Autorët e *Sunen*-it dhe Bejhekiu.

¹⁶³ Bejhekiu nga Ibn Abbas.

¹⁶⁴ *Muttefekun alejhi*, nga Ebu Hurejre.

Enesi r.a., tregon se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Më erdhi Xhebraili a.s., në dorë mbante një pasqyrë shkëlqyese, e më tha:

- *Kjo është e xhumaja. Rabbi yt e përcaktoi që të jetë ditë e bekuar, për ty dhe pasuesit e tu.*

- *Çfarë kemi në të?; e pyeta.*

- *Në të keni një orë që është më e mira, kush lutet në atë kohë për të mirën që i është caktuar, Allahu Teala do t’ia japë, e nëse nuk i është caktuar, i jepet diçka edhe më e mirë në ditën e kijametit, ose nëse strehohet nga e keqja që i është përcaktuar, Allahu Teala do ta mbrojë edhe nga e keqja më e madhe.*

Te ne kjo është dita më e mirë, dhe ne në ahiret e quajmë dita e shtimit (dita Mezid).

- *E pse?; pyeta përsëri, e Xhebraili a.s., më tha:*

- *Vërtetë Allahu Teala ka krijuar një fushë të bardhë, me aromën më të këndshme, e kur të vijë xhumaja fton në atë fushë robët të Tij. Allahu Teala lëshohet nga qielli më i lartë në Arshin e Tij, dhe ju shfaqet, që robët e Tij të shohin fytyrën e Tij fisnike.”¹⁶⁵*

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Dita më e mirë në të cilën lind dielli është e premtja (xhuma); në atë ditë është krijuar Ademi a.s., në atë ditë hyri në xhennet, në atë ditë u zbriti në

¹⁶⁵ Taberani në’ *Evsat’*.

Tokë, në atë ditë iu pranua pendimi (teube), në atë ditë vdiq, në atë ditë do të bëhet kijameti. Tek Allahu Teala, kjo është *'jevmu'l-Mezid'* (Dita e shtimit), e kështu e quajnë edhe melekët në qiell, dhe kjo është dita e shikimit të Allahut Teala në xhennet.”¹⁶⁶

Në një transmetim tjetër thuhet:

“Çdo xhuma Allahu Teala i çliron 600.000 robë nga xhehenemi.”¹⁶⁷

Enesi r.a., tregon se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Kur xhumaja është e mirë, e mirë është e gjithë java.”

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu thotë:

“Vërtetë që xhehenemi digjet flakë për çdo ditë para zevallit, kur Dielli është në gjysmë të qiellit, prandaj mos u falni në atë kohë, përpos të xhumanë, sepse në këtë ditë namazi mund të falet në secilën kohë, për shkak se xhehenemi të premtëve nuk digjet.”¹⁶⁸

¹⁶⁶ Muslimi, nga Ebu Hurejre.

¹⁶⁷ Ibn Adijj, Ibn Hibban në *'Dhu'afa'*.

¹⁶⁸ Ibn Hibban në *'Dhu'afa'*.

Ka' b thoshte që Allahu Teala ka zgjedhur Meken në mesin e qyteteve, Ramazanin në mesin e muajve, *Lejletul-kadr* në mesin e netëve e xhumanë në mesin e ditëve.

Thuhet se të xhumave takohen zogjtë dhe insektet dhe e përshëndesin njëri-tjetrin duke thënë:

“Kjo është ditë e bukur”.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kush vdes ditën e xhumasë ose natën e saj, Allahu Teala do t’i shkruajë shpërblimin e një shehidi, dhe do të kursehet nga vuajtjet e varrit.”¹⁶⁹

KUSHTET E NAMAZIT TË XHUMASË

Dije, xhumaja i ka të gjitha kushtet si namazet tjera, e përveç kësaj i ka edhe gjashtë kushte të veçanta:

1. *Koha*

Koha e xhumasë është koha e drekës; nëse imami fillon namazin e xhumasë në kohën e drekës, por jep selam kur hyn koha e ikindisë, xhumaja nuk i është e vlefshme, por është obligim të kryhet si dreka - me katër reqate; pra, nëse i shton edhe dy reqate pa dalë prej namazit, kalon në vend të drekës. Qëndrimet dallojnë

¹⁶⁹ Ebu Nuajm në veprën *‘Hilje’*.

se a e ka humbur xhumanë personi që arrin në reqatin e dytë, e më pas ngritet të falë edhe reqatin e ikur, dhe hyn koha e ikndisë.

2. *Vendi*

Xhumaja nuk falet në shkretëtirë, e as në tenda, por duhet të falet në një ndërtesë të palëvizshme, nga guri, qerpiçët ose druri, me pjesëmarrje të së paku katërdhjetë personave që e kanë obligim xhumanë. Në këtë rast, fshati trajtohet njëjtë si qyteti.¹⁷⁰ Nuk është kusht pjesmarrja e sundimtarit, e as leja e tij, ani pse është më mirë të kërkohet leja e tij;

3. *Numri*

Xhumaja nuk mund të mbahet me më pak se katërdhjetë meshkuj, të obliguar me shariat, të lirë, që janë në vendin e vet, të cilin nuk e braktisin as verës, as dimrit.¹⁷¹ Nëse shpërndahen dhe numri është më i vogël, në hutbe ose namaz, xhumaja nuk është e rregullt, por duhet të jetë numri i përmendur, për gjatë kohës.

¹⁷⁰ Fakihët e medh'hebit Hanefi kushtëzojnë që të jetë vendbanim që ka rrugë, dyqane, hapësirë të mirëmbajtur dhe udhëheqës in e vet që mund të mbrojë të drejtat e të gjithënjerezve me autoritetin e vet e të zyrtarëve të vet.

¹⁷¹ Sipas medh'hebit Hanefi, numri më i vogël i xhematlive që mjafton për namaz të xhumasë është tre, pos imami.

4. *Xhemati*

Nëse të gjithë ata (pra, katërdhjetë meshkuj) falen të ndarë, xhumaja nuk është e drejtë. Atij që bashkohet në reqatin e dytë i lejohet që ta falë reqatin e lëshuar. Nëse nuk arrin as në rukunë e reqatit të dytë, i përshtatet imamit, por e bën nijet namazin e drekës, e kur imami jep selam, e përfundon si namaz të drekës;

5. *Xhumaja brenda një vendbanimi*

Nëse nuk është e mundur që të gjithë të mbledhen në një xhami, lejohet që xhumaja të falet në dy, tri a më shumë xhami, varësisht nevojës. Nëse nuk ka nevojë, e drejtë është xhumaja e atyre që marrin më herët tekbinin fillestar, e nëse ka nevojë reale, xhumaja më me vlerë është ajo me imamin më me vlerë. Nëse kanë vlerë të njëjtë, atëherë xhamia më e vjetër, e nëse janë të njëjta, atëherë falet në më të afërmen, e gjithashtu duhet të preferohet xhamia me xhematin më të madh.

6. Dy hutbet;

Që të dyja janë farz, leximi në këmbë është farz, si edhe ulja mes tyre është farz. Në hutben e parë janë katër farze: i pari është falënderimi Allahut Teala, ku më së paku duhet të thuhet ***El-hamdu lilah*** (*Falënderim Allahut*), i dyti është t'i dërgohen salavate Resulallahut s.a.v.s., i treti që t'i këshillojë myslimanët për

devotshmëri dhe i katërti është të lexohet një ajet Kur'anor. Te hutbeja e dytë janë njëjtë katër farze por, në hutben e dytë, në vend të leximit të një ajeti Kur'anor, obligim është të lexohet dua.

SUNNETET E XHUMASË

Kur dielli e kalon zenitin dhe myezini të thërrasë ezanin e imami të ulet në minber, nuk mund të falet kurrfarë namazi, përpos *tehijjetul-mesxhid*.¹⁷²

Bisedat ndalen sapo të fillojë hutbeja.¹⁷³ Imami do t'ju jep selam të pranishmëve kur të kthehet me fytyrë nga ta, dhe ata ia kthejnë selamin.¹⁷⁴ Kur myezini përfundon ezanin, imami do të ngritet i kthyer me fytyrë kah xhemati, duke mos u lakuar djathtas apo majtas.

Në dorë mbanë shpatën, bajonetën ose mbështetet në minber, apo e vendos njërën dorë mbi tjetrën. Nuk përdorë fjalë të pakuptueshme, nuk e zgjatë shumë, nuk këndon (*teganni*); hutbeja bëhet e shkurtë, thelbësore dhe përmbledhëse.

¹⁷² Sipas medh'hebit Hanefi, nuk falet as *tehijjetul-mesxhid*.

¹⁷³ Fakihët Hanefi thonë se bisedimet duhet ndalur sapo të ngjitet imami në minber, dhe nuk flet deri në përfundim të namazit.

¹⁷⁴ Sipas medh'hebit Hanefi, të jepet selam në këtë moment nuk është sunnet, por *mekruh* (e papëlqyer).

Është e lavdërueshme (*mustehab*) që në hutben e dytë të lexojë një ajet. Ai që hyn derisa imami po flet, nuk jep selam, e nëse jep nuk meriton përgjigjen. Përshëndetja me isharet është e bukur. Në tështimë nuk reagohet. Hutben e dëgjon në heshtje.

OBLIGIMI (VAXHIB) I XHUMASË

Xhumaja është obligim për mashkullin, të pjekur, me mendje të shëndoshë, mysliman, i lirë e që banon në vendbanim ku jetojnë katërdhjetë¹⁷⁵ persona me cilësitë e përmendura ose në paralagjen e qytetit afër ku e dëgjon ezanin, kur është qetësi, e myezini me zë të fortë, e kjo sipas fjalëve të Allahut Teala:

“Kur bëhet thirrja për namaz, ditën e xhuma, ecni shpejtë për aty ku përmendet Allahu (dëgjoni hutben, falni namazin), e lini shitblerjen,” 62-Xhuma: 9

Ata që kanë një nga këto pesë arsye, mund të mos shkojnë në xhuma: shiu, balta, frika, sëmundja dhe kujdesi për të sëmurin, në rast se nuk ka kush tjetër të kujdeset për të.

Për ta është e lavdëruar ta vonojnë faljen e namazit të drekës, deri sa të tjerët të përfundojnë xhumanë. E

¹⁷⁵ Sipas medh’hebit Hanefi tre, pos i mamit.

nëse ata, pra njerëzit që kanë arsyetimet e lartpërmendura, si edhe gratë, marrin pjesë në xhuma dhe falin namazin e xhumasë, namazin e kanë në rregull.

EDEBET E XHUMASË, SIPAS RENDITJES

Edebe të xhumasë janë dhjetë:

1. Për xhumanë duhet të përgatitet që nga e enjta, i vendosur se do ta falë, dhe duke pritur të mirat e saj, prandaj t'i kushtohet duasë, kërkim-faljes dhe lavdërimit të Allahut Teala (*tesbih*), të enjten pas ikindisë. Disa myslimanë nga gjeneratat e para (*selef-i salihin*), kanë thënë:

“Vërtetë Allahu Teala ka të mira përtej furnizimit për njerëz, të cilat ia dhuron vetëm atyre që i luten të enjten mbrëma dhe të premtën.”

Që nga e enjte mbrëma, merr gusul (lahet), i pastron rrobat, parfumohet dhe i organizon punët që të shkoj më herët në xhuma. Do ta bëj njet për të agjëruar ditën e xhuma, sepse kjo është një vlerë e veçantë, mirëpo agjërimi i xhumasë duhet të jetë e lidhur me agjërimit të enjten ose të shtunën, sepse agjërimi vetëm ditën e xhumasë është i papëlqyer.

Do të përpiqet ta ngjallë këtë natë me lexim të Kur'anit e me namaz, sepse kjo ka peshë të veçantë me të cilën ndërliidhet vlera e xhumasë.

Këtë natë dhe në sabahun e xhumasë mund të ketë marrëdhënie intime me gruan, sepse disa këtë e konsideronin të lavdëruar; ata besonin se për këtë mendohet në hadithin nga Resulallahu s.a.v.s.:

“Allahu Teala e ka mëshiruar atë që ngutet për në xhami dhe arrinë në fillim të hutbes, që të tjerët i ka bërë të lahen (*gassele*) e edhe vet është larë (*igtesele*).”¹⁷⁶

Shprehja *gassele* këtu nënkupton që gruaja të bëhet xhunub, e disa do të thonë që kjo nënkupton: “...ai që ka larë rrobat e veta”, prandaj e transmetojnë pa ndarjen e bashkëtingëllores, derisa shprehja *igtesele* nënkupton trupin e tij. Pra, zgjohet herët, lahet, lanë rrobat dhe përgatitet për xhuma, kështu që ndahet nga të pavëmendshmit, të cilët kur zgjohen në mëngjes, pyesin: “Çfarë ditë është sot?” Disa nga gjeneratat e para, (selef-i salihin), kanë thënë: “Dobinë më të madhe nga xhumaja do ta ketë ai që përgatitet një ditë më

¹⁷⁶ Autorët e *Sunen*-it, Ibn Hibban, Hakimi, që e konsideron të besueshëm nga Evs ibn Evs. Të mirë e konsideron Tirmidhiu.

herët, e dobinë më të vogël e ka ai që kur zgjohet në mëngjes pyet:

- Çfarë dite është sot?"

Bile, për ta fituar vlerën e lartë (faziletin) e xhumasë, disa prej tyre e kalonin natën në xhami.

2. Kur të zditet, pas lajmërimit të agimit, do të fillojë të bëjë *gusul* (të lahet), e nëse nuk del herët jashtë, atëherë më mirë e ka që këtë ta bëjë para nisjes, në mënyrë që *gusuli*, i cili është jashtëzakonisht i lavdëruar, të jetë më i pastër. Bile, disa dijetarë thonë se kjo është e detyruar (*vaxhib*). Resulallahu s.a.v.s., thotë:

"Gusuli në ditën e xhuma është detyrim (*vaxhib*) për secilin të rritur."¹⁷⁷

Është i njohur transmetimi i Nafiut nga Ibn Omeri r.a., se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

"Kush shkon në xhuma, le të lahet."¹⁷⁸

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu thotë:

"Kush prej meshkujve e grave merr pjesë në xhuma, le të bëjë gusul!"¹⁷⁹

¹⁷⁷ *Muttefekun alejhi*, nga Ebu Seid

¹⁷⁸ *Muttefekun alejhi*, e këto janë fjalët e Ibn Hibban.

¹⁷⁹ Ibn Hibban dhe Bejhekiu, nga Ibn Omeri r.a.

Banorët e Medines, kur i thonin njëri-tjetrit fjalë të këqija, thonin:

“Je më i keq se ai që nuk lahet të premtën!”

Omeri r.a. ishte në hutbe. Hyri Osmani r.a. e ky i tha:

- *Vallë, deri tash?!;* duke e qortuar që nuk ka ardhë më herët, e Osmani r.a., iu përgjigj:

- *Sapo e dëgjova ezanin, mora abdes e dola;*

ndërsa Omeri r.a., ia vazhdoi:

- *Dhe vetëm abdes, e unë e di se Resulallahu s.a.v.s., na ka urdhëruar gusulin.”¹⁸⁰*

Se lejohet edhe të mos lahet, shihet nga fakti se Osmani r.a., ka marrë vetëm abdes, si edhe në bazë të fjalëve të Resulallahut s.a.v.s., ku thuhet:

“Ai që merr abdes për xhumanë, kjo i mjafton dhe ka vepruar bukur, por gusuli është më i mirë!”¹⁸¹

Kush bën gusul për shkak se është xhunub, le ta lajë trupin me ujë edhe një herë, me nijetin e gusulit për xhuma. Megjithatë, nëse e bën vetëm një pastrim, i mjafton. Nëse bën nijet për të dy pastrimet duke bashkuar dy gusulët, fiton edhe vlerën e lartë (faziletin)

¹⁸⁰ *Mutefekun alejhi*, nga Ebu Hurejre, por Buhariu nuk e cekë se bëhet fjalë për Osmanin r.a..

¹⁸¹ Ebu Davudi dhe Tirmidhiu, që e konsideron të mirë, dhe Nesai nga Semure.

e xhumasë. Një as'hab hyri te djali i vet, e ai ishte duke u larë, dhe ky e pyeti:

- *A po lahesh për xhumanë?*; e djali tha:

- *Jo, por jam xhunub;*

e ai i tha që të lahet edhe një herë.

Është përcjellë hadithi se gusuli është detyrim për secilin të rritur, ndërsa ky i urdhëroi larjen e dytë, sepse nuk e ka bërë nijet herën e parë. Mund të thuhet:

“Qëllim i larjes është pastrimi, dhe kjo arrihet edhe pa nijet”; por, meqenëse larja në ditën e xhumasë është pranuar në shariat si ibadet, atëherë duhet nijeti për ta fituar vlerën e lartë të atij pastrimi.

Edhe në abdes është kështu. Kush lahet në ditën e xhumasë dhe pas kësaj i priset abdesi, abdesin do ta përsërisë, por vlera e lartë e larjes ende i vlenë. Por, më e vlefshme është të falet xhumaja me adesin e gusulit.

3. Zbukurimi për xhuma është i lavdërueshëm (*mustehab*), dhe kjo i ka tri pjesë: pastërtinë, aromën e mirë dhe rrobat e pastra.

Pastërtia arrihet me pastrimin e dhëmbëve (*sivak*), largimin e qimeve, shkurtimin e thonjve e të mustaqeve dhe të tjerat që janë përmendur në *Librin për pastërtinë*. Ibn Mesud thoshte:

“Ai që i prenë thonjtë në ditën e xhumasë, Allahu Teala e largon nga ai sëmundjen, dhe i dhuron shërim.”

Nëse shkon në hamam të enjten apo të mërkuren, e arritë qëllimin, prandaj të premtën edhe le të parfumose me aromën më të këndshme, që të neutralizojë aromën e pakëndshme dhe që me këtë të ofrojë aromë të mirë e freskim për hundët e atyre që gjenden rreth tij.

Aroma e mirë. Parfumet më të mirë për meshkuj janë ata pa ngjyrë e me aromë të theksuar, e për femra parfumet dukshëm me ngjyrë, por pa aromë të fortë. Kështu thuhet në një transmetim.¹⁸²

Ndërsa Imam Shafiu thoshte:

“Kush vishet bukur dhe pastër, ia heq vetes një brengë të madhe, e ai që përdorë aromë të mirë, i shtohet mendja.”

¹⁸² Ebu Davudi dhe Tirmidhiu, që e konsideron të mirë, dhe Nesai nga Ebu Hurejre.

Sa për **veshjen**; më e mira është ngjyra e bardhë, sepse rrobat më të dashura për Allahun Teala janë ato me ngjyrë të bardhë. Nuk do të veshë asgjë që bie në sy, ndërsa veshja e të zezës nuk është sipas sunnetit, e as nuk ka ndonjë vlerë në të, bile, disa dijetarëve nuk ju pëlqen as të shikojnë në ngjyrë të zezë, sepse ajo është bidat, që është futur pas Resulallahut s.a.v.s..

Çallma në kokë në ditën e xhumasë është *mustehab*. Vasile ibn el-Eska tregon se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Vërtetë Allahu dhe melekët e tij ditën e xhumasë i dërgojnë selam atyre që bartin çallmë!”¹⁸³

Nëse gulçon nga vapa, nuk ka pengesë ta heqë çallmën nga koka, para ose pas namazit, por nuk është e përshtatshme që ta heqë rrugës për në xhami, gjatë hutbes dhe në namaz.

4. Të shkohet herët në xhami. Është e lavdërueshme që të niset herët për në xhami nga largësia prej dy a tri *fersahëve*¹⁸⁴, dhe të arrijë më herët. Shkuarja më herët fillon me lindjen e diellit dhe ka vlerë të lartë.

¹⁸³ Shënojnë Taberani dhe Ibn Adijj, i cili thotë se është *munker*, nga Ebu Derda.

¹⁸⁴ Një *fersah* është 5,5 km.

Gjatë ecjes për në xhami duhet të jetë i përlurur dhe modest, me nijetin që kohën deri në namaz ta kalojë në xhami, duke synuar që sa më herët të përgjigjet në ftesën e Allahut Teala dhe të synojë faljen (*magfired*) dhe kënaqësinë (*riza*) e Allahut.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kush shkon për xhuma në orën e parë, sikur të ketë bërë kurban një deve. Kush shkon në orën e dytë, sikur të ketë bërë kurban një lopë. Kush shkon në orën e tretë, sikur të ketë bërë kurban një dash me brirë. Kush shkon në orën e katërt, sikur të ketë dhuruar një pulë, e kush shkon në orën e pestë, sikur të ketë dhuruar një vezë. E kur imami ngritet në mimber që të paraqitet, fletët palohen, lapsat ngriten dhe melekët mbledhen rreth minberit që të dëgjojnë hutben. Kush vjen pas kësaj, ka ardhur vetëm për obligimin e namazit, dhe mbetet i privuar nga këto vlera të larta.”¹⁸⁵

Ora e parë është deri në lindjen e diellit, e dyta deri te ngritja e tij, e treta deri te shpërndarja e dritës së diellit në horizont, e treta kur filon dielli të ngrohë këmbët, para dreke, e katërta dhe e pesta nga dreka deri në zevall, dhe përfitimi për dy orët e fundit është

¹⁸⁵ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre.

shumë i vogël, përderisa zevalli tashmë është kohë namazi, dhe për të nuk ka tjetër përfitim.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Sikur ta dinin vlerën e tri gjërave, njerëzit do të garonin sikur devet për te ato: ezani, safi i parë dhe shkuarja e hershme në xhuma.”¹⁸⁶

E Ahmed ibn Hanbel ka thënë:

“Nga të trijat, më me vlerë është shkuarja herët për xhuma.”

Në një transmetim thuhet:

“Ditën e xhumasë, melekët ulen para dyerve të xhamisë e në dorë kanë fleta të argjendit dhe lapsa të artë, dhe i shënojnë një nga një ata që arrijnë të parët.”¹⁸⁷

Në transmetim tjetër thuhet:

“Melekët vërtetë interesohen për personin i cili në xhuma nuk vjen në kohën e zakonshme, dhe e pyesin njëri-tjetrin:

- Çfarë ka ndodhë me filanin, çfarë e ndaloi të vijë?, e pastaj thonë:

¹⁸⁶ Shënon Ebu’sh-Shejh, në *‘Sebvabu’l-eamal’*.

¹⁸⁷ Ibn Merdevejh në *‘Tefsir’*.

- O Rabb, nëse e ka ndaluar varfëria, bëje të pasur, nëse e ka ndaluar sëmundja – shëroje, nëse e ka ndaluar ndonjë obligim – liroje nga ajo që ai të bëj ibadet Ty, por nëse e ka ndaluar ndonjë lojë apo argëtim, mos ia shijo atij kënaqësinë e ibadetit!”¹⁸⁸

Në shekullin e parë, para agimit dhe menjëherë pas agimit mund të shiheshin rrugët plot me njerëz, që ecnin me kandilë, dhe i drejtoheshin xhamisë, sikur të ishte Bajram, deri sa kjo nuk u zhduk.

Thonë se bidati i parë që është futur në islam ka qenë ndalimi i shkuarjes herët në xhami. Si nuk turpërohen myslimanët nga hebrenjtë dhe të krishterët, që shkojnë herët në sinagogat dhe kishat e tyre, të shtunën dhe të dielën? Nuk i shikojnë ata që kërkojnë dynjanë, si shkojnë herët në tregje, shesin, blejnë e fitojnë; dhe pse nuk krahasohet me ta ai që kërkon ahiretin?

Thuhet se atëherë kur njerëzit do t'a shikojnë Allahun, ata do të jenë afër Allahut Teala aq sa kanë shkuar herët për në xhuma. Një herë Ibn Mesud erdhi herët në xhami, dhe aty i pa tre persona, që kishin ardhur para tij. Kjo e mërziti, dhe filloi, duke u

¹⁸⁸ Bejhekiu nga Amr ibn Shu'ajb.

turpëruar, të thotë me vete: *“I katërti! Oh, sa larg që është i katërti nga ardhja herët!*

5. Hyrja në xhami. Nuk do të duhej të ju dalë të tjerëve përpara, duke kaluar nëpër supe të xhematit, as të ju ndërpresë rrugën, ndërsa shkuarja herët ia siguron safin e parë. Për kalim para të tjerëve përmendet kërcënim i ashpër - thuhet se i tilli në ditën e Gjykimit do të shndërrohet në urë mbi xhehnem, e njerëz kalojnë duke e shkelur atë.

Ibn Xhurejh e përmend një transmetim *mursel*, ku thuhet se një të premtë, deri sa Resulallahu s.a.v.s., po mbante hutbe, e pa një person se si kalonte para të tjerëve, deri sa nuk arriti përpara dhe u ul. Kur Resulallahu s.a.v.s., e fali namazin, u nis pas atij personi, dhe kur e arriti, e pyeti:

- ***Çfarë të pengoi të falësh xhumanë me neve sot?***

- *O Resulallah, por unë me juve e fala xhumanë!;*

u përgjigj ai, e Resulallahu s.a.v.s., i tha:

- ***A nuk të pamë si kaloje mbi supe të xhematit?***¹⁸⁹;
duke aluduar kështu se me këtë veprim namazi i xhumasë i ka humbur vlerën. Në një hadith *musned* shkruan se personi ka thënë:

- *A nuk më keni parë aty, o Resulallah?!;*

¹⁸⁹ Ibnul-Mubarek në *el-Rekaik*.

në çka Resulallahu s.a.v.s., i thotë:

- Të pashë, u vonove, dhe i pengoje të tjerët¹⁹⁰;
pra, nuk ke ardhur herët, dhe u ke penguar të tjerëve.

Megjithatë, nëse safi i parë ka mbetur i paplotësuar, ka të drejtë të kalojë të tjerët që kanë ardhur më vonë, sepse ata nuk e kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre dhe e kanë lënë të zbrazët një vend të ndershem. Hasan Basriu thoshte:

“Kaloni përtej atyre që për xhuma rrinë ulur në dyert e xhamisë, sepse ata edhe meritojnë të pengohen.”

Nëse në xhami nuk ka të tjerë pos atyre që falen, nuk duhet dhënë selam, sepse ata e kanë të vështirë kthimin e selamit.

6. Të mos kalojë përpara atij që falë namazin në xhami, dhe që të tjerët të mos kalojnë para tij, prandaj kur të falet, le t'i afrohet shtyllës ose murit, aq sa është e mundur.

Kalimi para dikujt që falet nuk ia prishë atij namazin, por se është e ndaluar. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Më e hairit është të presë katërdhjetë vite, se sa të kalojë para atij që po falet.”¹⁹¹

¹⁹⁰ Ebu Davudi, Nesai, Ibn Hibban dhe Hakimi, nga Abdullah ibn Busr, në verzion më të shkurtë.

Në një tjetër hadith, për atë që kalon përpara namazlisë i cili nuk e largon kalimtarin, thuhet:

“Sikur kalimtari para namazlisë dhe ai që falet në vendkalim ta dinë se sa i madh është gjynahu i kësaj! Më mirë për të do të ishte të presë katërdhjetë vite, se sa të kalojë para atij që është në namaz.”¹⁹²

Shtylla, muri, shkopi i vendosur, sexhdeja e shtruar para atij që falet janë kufij të tij, prandaj ai që dëshiron të kalojë andej, duhet të ndalohej, aq sa është e mundur.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Le ta ndalojë, atë i cili është duke kaluar; nëse nuk dëgjon, përsëri le ta ndalojë, e nëse përsëri refuzon, le ta rrahë, sepse ai është shejtan!”

Ebu Seid el-Hudri r.a., e shtyente atë që donte të kalonte para tij, bile e godiste, dhe ndodhi që njëri u përlesh me të dhe e akuzoi te Mervani, e ky e njoftoi se kështu ka urdhëruar Resulallahu s.a.v.s..¹⁹³ Nëse nuk

¹⁹¹ El-Bezar, nga Zejd ibn Halid, e në të dy sahihët, nga Ebu Xhehm. Ebu Nadr thotë: *“nuk di a janë kstërdhjetë ditë, muaj apo vite.”* E shënojnë edhe Ibn Maxhe dhe Ibn Hibban, nga Ebu Hurejre, që thotë: *“...njëqind vite!”*

¹⁹² Shënon Ebul-Abbas Muhammed ibn Jahja es-Sirazh në **Musned-in** e tij, nga Zejd ibn Halid, me zinxhir të besueshëm të transmetuesve.

¹⁹³ Hadithi është muttefekun alejhi.

gjen shtyllë, le të vendosë para vetes çkado qoftë, në lartësi të një arshini¹⁹⁴, që kjo t'i jetë shenjë e kufirit të tij.

7. Duhet të synojë safin e parë, sepse vlera e tij, siç e përmendëm, është e madhe. Në hadith thuhet:

“Kush pastron rrobat në ditën e xhumasë, e edhe vet lahet, shkon herët në xhami, ulet pranë imamet dhe e dëgjon hutben - kjo do ta pastrojë nga gjynahet mes të dy xhumave, bile edhe tri ditë më shumë”¹⁹⁵,

e në një version tjetër:

“...Allahu do ta falë deri në xhumanë tjetër.”¹⁹⁶

Safi i parë nuk preferohet, vetëm për tri sebepe:

Sebepi i parë. Nëse në saf të parë ka diçka negative ku ky nuk mund ndikojë, siç është veshja nga mëndafshi e të ngjashme nga imami ose dikush tjetër, ose dikush falë namaz me armë që tërheq vëmendje, ose sheh ndonjë të keqe që e shqetëson. Atëherë falja në safet e fundit është më e sigurtë dhe më e lehtë për fokusim.

¹⁹⁴ Gjatësia e arshinit vlerësohet ndryshe, por zakonisht bëhet fjalë për 65 cm.

¹⁹⁵ Hakimi, nga Evi ibn Evi, dhe gjendet edhe në Sunene.

¹⁹⁶ Ebu Davudi, Ibn Hibban dhe Hakimi, nga Ebu Seid dhe Ebu Hurejre, dhe thotë që është i besueshëm sipas kritereve të Muslimit.

Kështu kanë vepruar disa dijetarë, duke kërkuar qetësinë për namaz. Dikush i tha Bishr ibn Harisit:

- *Të shohim si vjen herët, e falesh në safet e fundit?*; në çka Harisi u përgjigj:

- *Kërkohet afërsia e zemrës, jo e trupit.*

Me këtë ka treguar se zemra e gjen më lehtë qetësinë në safet e fundit. Sufjan Sevri shikonte Shuajbin se si afër minberit, dëgjonte hutbe nga Ebu Xhafer Mensuri, halife i dytë i Abasive. Pas namazit, i tha:

- *Zemra m'u mundua, sa shumë iu afrove këtij. A je i qetë, kur e dëgjoje si flet për ato që duhet të reagosh, e ti as nuk lëvizje?*

Pastaj i tregoi se ata filluan me veshje të rrobave të zeza në xhuma dhe bidate të ngjashme, e Shuajbi i tha:

- *O Ebu Abdullah, a nuk thuhet në hadith:*

“Afrohu e dëgjo”?!;

në çka Sufjani iu përgjigj:

- *Mjerë ti, ajo ka qenë për hulefai-rashidinët, e sa për këta, sa më larg prej tyre e sa më pak t'i shikosh, je më afër Allahut Teala.*

Seid ibn Amir ka thënë:

“Shkuam me Ebu Derda në xhami të falim namazin, e ai duke thënë: ‘prapa, prapa...’ arritëm në safin e fundit, dhe pasi u falëm, i thashë:

- A nuk është thënë se safi i parë është më i miri?!, e ai më tha:

- Po. E megjithatë, këtij ummeti i është dhënë rahmeti, dhe në të shikohet ndryshe nga të gjithë të tjerët. Vërtetë që Allahu Teala, kur e shikon një person në namaz, e falë edhe atë edhe personin pas tij. Unë preferova të qëndroj në fund, duke shpresuar se Allahu Teala do të më falë për hir të ndonjërit para meje që Allahu e ka shikuar.”

Disa transmetues thonë se këtë e ka dëgjuar nga Resulallahu s.a.v.s., prandaj kush qëndron në safet e fundit me këtë qëllim, duke u dhënë kështu përparësi të tjerëve dhe duke shprehur njetin e tij të mirë, atëherë në këtë nuk ka pengesë, sepse është thënë:

“Veprat vlerësohen sipas qëllimeve”;

Sebepi i dytë. Nëse te hatibi ka *maskurë*¹⁹⁷ që është e ndarë nga hapësira për falje dhe e rezervuar për

¹⁹⁷ *Maksura* është hapësirë e veçantë në xhami, e ndarë me parmak, të cilën së pari e ndërtoi Muavi ibn Ebu Sufjan, kur u sulmua fizikisht në xhami. Për namazin në *maksur*, mendimet e dijetarëve ndahen. Shumica mendon se namazi i falur në të është i

sundimtarët, safi i parë nuk preferohet, e nëse nuk ka maskurë, atëherë safi i parë është i dëshiruar.

Por, disa dijetarë e konsiderojnë hyrjen në maskurë *mekruh* (të papëlqyer). Hasan Basriu dhe Bekr el-Muzeni nuk faleshin në maksurë, duke konsideruar se ajo është hapësirë e rezervuar vetëm për sundimtarë. Ky është bidat, që është futur në xhami pas Resulallahut s.a.v.s.. Mesxhidi është i hapur për të gjithë njerëzit, e kjo hapësirë është e ndarë, që është në kundërshti me këtë princip. Enes ibn Malik dhe Imran ibn Husajn faleshin në maksurë dhe nuk e konsideronin këtë të qortuar, duke kërkuar afërsinë e imamit. Është e mundur që kjo është e qortuar vetëm në rastet kur është i rezervuar për falje vetëm për sulltanin, me çka të tjerët pengohen të falen aty. Ndërsa *maksura*, në vetvete, nëse nuk ua pamundëson çasjen të tjerëve, nuk është e qortuar;

Sebepi i tretë. Minberi që ndërpre në safin në dy. Safi i parë konsiderohet vetëm pjesa kompakte në hapësirën para minberit, ndërsa pjesa anash llogaritet e ndërprerë. Sufjan Sevriu thoshte:

“Safi i parë është safi që gjendet para minberit.”

drejtë nëse në të kanë çasjetë gjithë, sepse atëherë është pjesë e hapësirës tjetër për namaz, e në të kundërtën nuk është.

Kjo është e pranueshme, sepse ajo pjesë është e pandarë, dhe ai që qëndron aty është karshi hatibit, dhe e dëgjon. Së bashku me këtë, saf i parë është safi që është më së afërti kiblës, dhe nuk ka rëndësi që minberi e ndërpreen këtë saf. Është e papëlqyer (*mekruh*) të falet namazi në sheshe dhe hapësira të hapura jashtë xhamisë. Disa as'habë fizikisht i largonin njerëzit nga hapësirat e hapura.

8. Kur imami hipë në minber ndërprehen namazi dhe bisedat, vëmendja përqëndrohet në përgjigje myezinit, e më pas në dëgjim të hutbes. Është zakon te disa njerëz të bëjnë sexhde kur myezini thërret ezanin, ani pse kësaj nuk i është dëshmuar baza, as në transmetimet nga Resulallahu s.a.v.s., as në ato nga të parët e ndershëm. Por, nëse ndodhë në kohë të njëjtë me *sexhdetut-tilavet*, atëherë nuk ka pengesë. Kjo sexhde nuk mund të konsiderohet e ndaluar, sepse nuk ka asnjë arsye për këtë.

Tregohet se Alia dhe Osmani r.a., kanë thënë:

“Kush heshtë dhe dëgjon hutben, i ka dy shpërblime. Kush heshtë por nuk dëgjon hutben, ka një shpërblim. Kush dëgjon hutben dhe flet pa nevojë i ka dy gjynahe, e kush nuk e dëgjon hutben për shkak që është larg dhe flet pa nevojë, e ka një gjynah.”

Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Kush i thotë ‘hesht’ apo ‘qetësi’ personit afër vetes, deri sa imami mbanë hutben, ka folur pa nevojë, e ai që flet pa nevojë nuk ka xhuma!”¹⁹⁸

Kjo tregon se heshtja e tjetrit duhet të bëhet me ndonjë shenjë, e jo me të folur.

Në hadithin nga Ebu Dherr, thuhet:

“Deri sa Resulallahu s.a.v.s., po mbante hutbe, Ebu Dherri e pyeti Ubejjin:

- Kur është shpallur kjo sure?,

e ai i bëri me shenjë të heshtë. Pasi që Resulallahu s.a.v.s., zbriti nga minberi, Ubejj i tha Ebu Dherrit:

- Largohu, ti nuk ke xhuma!

Ebu Dherr iu ankua Resulallahut s.a.v.s., për Ubejjin, e Resulallahu s.a.v.s., i tha:

- Ubejji e ka thënë të vërtetën.”¹⁹⁹

Edhe nëse është larg imamit e nuk mund ta dëgjojë hutben, nuk do të duhej të flasë, as për diturinë as për diçka tjetër, por të heshtë, sepse këto ndërliohen dhe shkaktojnë psherëtima që i dëgjojnë të tjerët. As nuk do

¹⁹⁸ Tirmidhiu dhe Nesai nga Ebu Hurejre. Tirmidhiu e thekson se hadithi është i besueshëm. Gjendet në të dy Sahihët, në formë tjetër, ndërsa e transmeton edhe Ebu Davudi nga Alia r.a.

¹⁹⁹ Bejhaki, Ebu Davud dhe Ibn Maxhe.

të ulet te ata që flasin, e nëse nuk ka mundësi le të heshtë, dhe kjo është e lavdërueshme (*mustehab*).

Nëse falja e namazit kur imami mbanë hutbe është e papëlqyer, atëherë të folurit është *mekruh* edhe më i madh.

Alia r.a., thotë:

“Namazi është i papëlqyer (mekruh) në katër kohë: pas sabahut, para drekës - kur dielli është në zenit, pas ikindisë, dhe deri sa imami mbanë hutbe.”

9. Siç i përshtaten imamit në namazet tjera, edhe në xhuma duhet të respektojë të njejtat kushte. Për shembull (sipas Shafive), kur të dëgjojë leximin nga imami, nuk lexon asgjë përpos *Fatihasë*, e kur të përfundojë me namaz të xhumasë, para se të flasë do ta lexojë *Fatiha*, *Ihlas*, *Felek* dhe *Nas*, nga shtatë herë. Njëri nga gjeneratat e para, (selef-i salihin) ka treguar se kush vepron kështu, është i mbrojtur nga fatkeqësia mes dy xhumave. Është mirë që pas xhumasë të thotë:

Allahume ja Ganij, ja Hamid, ja Mubdi, ja Mu'id, ja Rahim, ja Vedud agnini bi halalike an haramike ve bi fadlike ammen sivake.

(O Allah, o i Pasuri, o i Falënderuari, o Nismëtari, o Rikrijuesi, Mëshirëploti, o i Dashuri, ma bëj të mjaftueshëm furnizimin Tënd hallall, që të mos anoj kah harami, dhe më jep të mirën Tënde).

Thuhet se ai që e lexon këtë dua rregullisht, Allahu Teala do ta bëj të pavarur nga të tjerët dhe do ta furnizojë prej nga ky nuk e pret.

Pas farzit të xhumasë do të falë edhe gjashtë reqate. Ibn Omeri r.a., tregon se Resulallahu s.a.v.s., i falte pas xhumasë dy reqate.

Ebu Hurejre transmeton se Resulallahu s.a.v.s., i falte katër reqate pas xhumasë, ndërsa Alia r.a. dhe Abdullah ibn Abbas, transmetojnë se i falte gjashtë. Të gjitha janë të drejta, në kushte të ndryshme, ndërsa më e plotë dhe më e mira është gjashtë reqate.

10. Është e lavdërueshme (*mustehab*) të qëndrojnë në xhami deri sa të falë ikindinë. Nëse qëndron deri në aksham, kjo është edhe më mirë. Thuhet se ai që e falë ikindinë në xhami ka shpërblim sikur të ketë bërë haxhin, e nëse falë edhe akshamin në xhami, ka shpërblim sikur të ketë bërë haxhin dhe umren. Nëse nuk është i sigurtë se nuk do të shtiret ose që nuk do ta gjejë diçka e keqe për shkak që të tjerët ia shikojnë ibadetin, ose nëse frikësohet se do të lëshohet në atë që nuk e intereson, më mirë e ka të kthehet në shtëpi duke e përmendur Allahun Teala, duke menduar për bereqetet e Tij, duke e falënderuar për Udhëzimin, duke

u frikësuar nga mos-përsosja e vet dhe duke vrojtuar zemrën dhe gjuhën e vet deri në perëndim të Diellit, që të mos i ikë ora e ndershme.

Nuk duhet të flasë për gjëra të kësaj bote as në xhaminë kryesore, as në xhamitë tjera, , sepse Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Do të vijë koha kur njerëzit në xhamitë e tyre do të flasin për dynjallëk. Ata nuk kanë vlerë tek Allahu, prandaj mos u ul me ta!”²⁰⁰

SUNNETET DHE EDEBI QË DEL NGA RENDITJA E PËRMENDUR, E QË VAZHDOJNË PËRGJATË GJITHË DITËS SË XHUMASË

Edhe këto janë shtatë:

1. Të marrë pjesë në takime të diturisë herët në mëngjes ose pas ikindisë, e mos të dëgjojë tregimtarët, sepse nga e folmja e tyre nuk ka dobi.

Udhëtari i ahiretit nuk do të duhej të ndërpresë veprat e mira dhe duatë gjatë gjithë ditës së xhuma, që orën e ndershme ta shpenzojë në të mirë. Nuk do të

²⁰⁰ Bejhekiu, në *esh-Shuab*, nga Hasan Basriu, si *mursel*, ndërsa si *musned* shënon Hakimi nga Enesi, që e konsideron të besueshëm zinxhirin e transmetuesve të tij. Ibn Hibban e shënon të ngjashëm nga Ibn Mesud, dhe është përmendur më herët.

duhej të marrë pjesë në takime para namazit. Abdullah ibn Omeri r.a., tregon se Resulallahu s.a.v.s. ka ndaluar tubimin në hallka të premtëve para namazit të xhumasë²⁰¹, përpos kur bëhet fjalë për atë që ka njohuri për Allahun Teala, që tregon për nimete të Allahut dhe i cili mëson fenë e Allahut, dhe flet në xhami që nga orët e hershme të mëngjesit, e ky ulet afër tij, me çka i ka bashkuar arritjen herët dhe dëgjimin. Sepse dëgjimi i diturisë së dobishme për ahiretin është më e vlefshme se sa namazi vullnetar. Ebu Dherr transmeton se pjesëmarrja në tubime të ditursë është më e mirë se falja e njëmijë reqateve.²⁰² Allahu Teala thotë:

“Dhe, kur të përfundojë namazi, atëherë shpërndahuni nëpër tokë, dhe kërkoni nga mirësitë e Allahut...” (62-Xhuma: 10),

e në tefsirin e këtij ajeti, Enes ibn Malik thotë:

“Kjo nuk ka të bëjë me kërkimin e dynjallëkut, por me vizitë të sëmurit, përcjellje të xhenazes, përfitim të diturisë, vizitë vëllaut për kënaqësi (riza) të Allahut Teala e të ngjashme.”

²⁰¹ Shënojnë Ebu Davudi, Nesai dhe Ibn Maxhe, nga Amr ibn Shuajb, ai nga i ati, e ky nga gjyshi i vet, por nuk është gjetur nga Ibn Omeri.

²⁰² Është përmendur më herët në *Librin për diturinë*.

Në disa vende, Allahu Teala e emërton diturinë me shprehjen ***fadl*** (mirësi, bereqet, mëshirë). Allahu thotë:

“...dhe të mësoi atë që nuk e ke ditur. *Mirësia e Allahut për ty është shumë e madhe.*” 4-Nisa: 113,
dhe:

“Ne i dhamë Davudit *mirësi prej Nesh,*” 34-Sebe: 10
prandaj përfitimi i diturisë në këtë ditë dhe mësimi i tjetrit është një nga mënyrat më të vlefshme të afrimit Allahut Teala.

Falja e namazit është më e vlefshme se sa dëgjimi i tregimtarëve, sepse as’habët i konsideronin tregimet bidat, dhe i nxjerrnin tregimtarët jashtë xhamisë. Ibn Omeri r.a. ngutej për te vendi i vet në xhaminë qendrore, e aty gjeti ulur një tregimtar që po tregonte ngjarje, e i tha:

- *Ngritu nga vendi im!*

- *Nuk ngritem, i tha ai – jam ulur këtu para teje.*

Ibn Omeri ftoi mbrojtësit e rendit, dhe e ngriti nga aty.

Po të ishin tregimet sunnet, nuk do t’i lejohej t’a largojë, sepse vet Ibn Omeri r.a. ka treguar që Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Askush nga ju, në asnjë rast, të mos e ngrisë vëllaun nga vendi, e vet të ulet aty, por zgjrohuni dhe krijoni hapësirë”²⁰³

²⁰³ Muttefekun alejhi, nga Ibn Omeri.

Ibn Omeri ishte shumë i kujdesshëm në këtë çështje; nëse një person nisej të ulej në vendin e tij, Ibn Omeri nuk do të ulej deri sa edhe ai person nuk ulej në vend të vet. Transmetohet se një tregimtar ishte ulur në kopshtin afër dhomës së Ajshes r.anha, dhe tregonte tregime e Ajsha r.a., dërgoi dikë ta thirrte Ibn Omerin, sepse tregimtari po e shqetësonte me tregimet e veta dhe po e pengonte në ibadet. Ibn Omeri r.a., ashtu e goditi këtë tregimtarin, sa shkopi u thye në shpinën e tij, dhe e largoi nga aty.

2. Të ketë kujdes mirë për çastin e vlefshëm, sepse në një transmetim të njohur thuhet:

"Ditën e xhumasë, është një çast që, nëse myslimani, pikërisht në atë çast kërkon diçka nga Allahu Teala, Ai do t'ia dhurojë"²⁰⁴,

e në transmetim tjetër thuhet:

"...nëse pikërisht në këtë çast falë namaz..."²⁰⁵

Ka mendime të ndryshme se kur është ky çast i vlefshëm; një grup thotë se kjo është koha e lindjes së Diellit, grupi i dytë thotë kur Dielli është në zenit, i treti kur këndohet ezani, i katërti kur imami ngjitet në

²⁰⁴ Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe, nga Amr ibn Avfa Muzenij.

²⁰⁵ Muttefekun ajehi, nga Ebu Hurejre.

minber dhe fillon me hutben, i pesti kur njerëzit fillojnë me namaz, i gjashti në kohën e mëvonshme kur falet ikindia, e grupi i shtatë thotë se kjo është koha para perëndimit të diellit.

Fatime r.a., kishte kujdes për këtë kohë, dhe e urdhëronte shërbëtoren që të shikojë Diellin dhe ta lajmërojë kur Dielli fillon të ulet, që të bëjë dua dhe të kërkojë falje deri në perëndim të Diellit, dhe thoshte se kjo është ora e vlefshme që duhet të pritet, e që këtë e ka dëgjuar nga babai i saj, s.a.v.s..²⁰⁶

Disa dijetarë thonë se kjo orë është e fshehur në të gjithë ditën, sikur *Lejletul-kadr*, që kështu të forcohet motivi për të kërkuar këtë orë. Të tjerë mendojnë se kjo orë lëvizë në kohë të ndryshme xhumasë, njëjtë si *Lejletul-kadr*. Ky është mendimi më i pranueshëm. Kjo ka një fshehtësi që nuk është e përshtatshme të përmendet në dituri praktike të fesë, megjithatë duhet vërtetuar atë që e ka thënë Resulallahu s.a.v.s., se:

“Vërtetë që Rabbi juaj në disa ditë ju ofron dhurata, prandaj pranoni ato!”²⁰⁷

²⁰⁶ Darekutni në *el-Ilel*, Bejheku në *esh-Shuab*, ndërsa të metë të fshehur e ka kundërshtinë në dukje të parë, mes dy verzioneve.

²⁰⁷ Taberani në *‘Evsat’* nga Muhammed ibn Eslem.

Edhe xhumaja është në mesin e këtyre ditëve, prandaj njeriu duhet të përgatisë zemrën gjatë gjithë ditës për këto dhurata, me dhikr të vazhdueshëm dhe me largim nga mashtrimet e dynjallëkut. Ja një bisedë mes Ka’b el-Ahbar dhe Ebu Hurejres në këtë çështje:

Ka’b el-Ahbar tha:

- *Ky çast është në fund të ditës së xhumasë, pra kur përfundon dielli;*

ndërsa Ebu Hurejre u habit:

- *Si mund të jetë koha e fundit, kur unë e kam dëgjuar Resulallahun s.a.v.s., të thotë:*

*“... nëse falë pikërisht në këtë orë”,
e në atë kohë nuk ka namaz?!*

Në këtë, Ka’b i tha:

- *A nuk ka thënë Resulallahu s.a.v.s.:*

“Kush ulet dhe pret namazin, ai është në namaz”?

Ebu Hurejre tha:

- *Natyrisht që ka thënë;*

dhe Ka’b tha:

- *Qe, ky është ai namaz! Ebu Hurejre heshti.*

Ka’b e pranonte që rahmeti i Allahut Teala i takon atyre që i kanë kryer të gjitha që kjo ditë i kërkon, ndërsa që shpërblimi dërgohet pasi që puna të jetë kryer. Shkurtimisht, kjo është koha posaqërisht e

vlefshme, që nga momenti i ngjitjes së imamit në minber, prandaj le të bëjë shumë dua në këtë kohë.

3. Është e lavdëruar (*mustehab*) që këtë ditë t'i dërgohet më shumë salavat Resulallahut s.a.v.s.. Me një hadith Resulallahu s.a.v.s. thotë:

“Kush më dërgon ditën e xhumasë 80 salavate, Allahu ia falë gjynahet e 80 viteve.”²⁰⁸

- O Resulallah, si të dërgojmë ty salavate?;

- Do të thuash:

Allahumme Sali ala Muhammedin, abdike ve nebijjike ve resuliken-nebijjil-umijji

(O Allah, bekoje Muhammedin, robin dhe pejgamberin, të dërguarin Tënd, që nuk ka përdorur shkrimin),

dhe këtë e thua një herë. E edhe më mirë të thuash:

Allahumme Sali ala Muhammedin ve ala ali Muhammed salaten tekunu leke ridaen, ve li hakkihi edaen ve eatihil-vesile-te veb'ashul-mekamel-mahmudeledhi veadteh, vexhdhihi amma ma huve ehlul, vexhdhihi efdale ma xhazejte nebijjen an ummetih, ve Sali alejhi, ve ala xhemii ihvanihi minen-nebijjine ves-salihine, ja erhamer-rahimin

(O Allah, bekoje Muhammedin, dhe familjen e Muhammedit, me bekim për kënaqësinë Tënde, dhe me të cilin do të përmbushet e drejta e tij, dhuroja vendin

²⁰⁸ Darekutni nga Ibnul-Musejb.

qëndror në xhennet, dhe ringjalle në gradë të denjë për lavdërim që Ti ia ke premtuar, dhe shpërbleje nga ne me atë që ai e meriton, shpërbleje me më të vlefshmen që ke shpërblyer ndonjë peygamber prej pasuesve të vet. Bekoje Muhammedin dhe të gjithë vëllezërit e tij, peygamberët dhe njerëzit e mirë, o Mëshiruesi më i mëshirshëm!)

Këtë do ta lexosh shtatë herë.

Thonë se ai që e lexon këtë dua shtatë të premtë, secilën të premtë nga shtatë herë, ai arrinë shëfatin (ndërmjetësimin) e Resulallahut s.a.v.s..

Kush dëshiron të lexojë më shumë, do të lexojë salavatit tradicional:

Allahummexh'al fedaile salevatike, ve nevamije berekatike, ve sheraife zekevatike, ve re'fetike, ve rahmetike, ve tehijetike ala Muhammedin, sejjidil-murselin, ve imamil-muttekin, ve hatemin-nebijjin, ve resuli Rabbil-alemin, kaidil-hajri, ve fatihil-birri, ve nebijjir-rahmeti, ve sejjidil-ummeti. Allahummeb'ashu mekamen mahmuden tezlifu bihi kurbehu, ve tukirru bihi ajnehu, jagbituhu bihil-evvelun vel-ahirun. Allahumme eatihil-fadle vel-fedile, veshsherife vel-vesile, ved-derexheter-refia, vel-menziletesh-shamihatel-munife. Allahumme eati Muhammeden

su'lehu, ve belighu me'mulehu, vexh'alhu evvele shafiin ve evvele musheffein. Allahumme adhim burhanehu, ve sekkil mizanehu, ve eblig huxhxhetehu, verfe'fi ealel-mukarrebin derexheteh. Allahummahshurna fi zumretih, vexh'alna min ehli shefaatih, ve ahjina ala sunnetih, ve teveffena ala miletih, ve evridna havdahu, veskina bi ke'sihi gajre hazaja ve la nadimin, ve la shakkine, ve la mubeddilin, ve la fatinine ve la meftunine, amin ja Rabbel-alemin

(O Allah, dhuroi bereqetet Tua më të vlefshme e më të frytshme, dhuratat më të ndershme, mëshirën Tënde, rahmet e selam Muhammedit, të parit të profetëve, udhëheqësit të atyre që kanë frikë Allahun, vules së pejgamberëve, pushtuesit të mirësisë, pejgamberit të rahmetit, të parit të ummetit. O Allah, ringjalle në gradë të denjë për lavdërim, me çka do ta afrosh tek Vetja, dhe syrin do t'ia ndriçosh, në çka pa të keq do t'i kenë lakmi, edhe i pari edhe i fundit. O Allah, dhuroi të mirën dhe fedile, nderin dhe vesile, derexhe të lartë dhe pozitë mbi gjithçka. O Allah, dhuroi Muhammedit atë që e kërkon, plotësoja shpresat dhe bëje ndërmjetësuesin e parë dhe të parin që do t'i ketë sukses ndërmjetësimi. O Allah, forcoja dëshminë, rëndoje tasin e mizanit të tij, zbuloja argumentet dhe ngritja derexhen në mesin e më të dashurve Tu. O Allah, na ringjall neve në shoqërinë e tij,

*na bëj prej atyre për të cilët ai do të angazhohet, na bëj të jetojmë sipas sunnetit të tij, na vdis në fenë e tij, na dërgo deri te burimi i tij dhe na bëj të pimë me gotën e tij, pa poshtërim e pendim, pa dyshim e hezitim, pa sprovuar ne të tjerët dhe pa u sprovuar nga të tjerët. Pranoje duanë, o Rabb i botëve!)*²⁰⁹

Shkurtimisht, me të gjitha salavatet që i lexon, edhe me atë të njohurin që lexohet në *teshehhud*, ai bekon Resulallahun s.a.v.s.. Salavateve duhet shtuar kërkimin e faljes, sepse edhe kjo është e lavdëruar në këtë ditë;

4. Këtë natë le të lexojë shumë Kur'an. Sidomos le të lexojë suren *Kehf*, sepse tregohet nga Ibn Abbas dhe Ebu Hurejre r.a., se atij që lexon suren *Kehf* natën ose ditën e xhumasë, do t'i dhurohet dritë nga vendi ku e ka lexuar, deri në Mekë, do t'i falen të gjitha gjynahet, deri të premtën tjerër, e përpos kësaj, edhe tri ditë tjera.

Për të bëjnë istigfar 70.000 melekë, deri në mëngjes, lirohet nga sëmundja, dhimbja në lukth, nderja e mushkërive, lepra, murtaja dhe telashet tjera të Dexhallit.

²⁰⁹ Ibn Ebu Asim në *Kitabus-salah alen-nebijj s.a.v.s.*, nga Ibn Mesud, si fjalët e tij, me zinxhir të dobët të transmetuesve.

Nëse është e mundur, do të ishte mirë që të lexohet një herë komplet Kur'ani-hatme para xhumasë ose ditën e xhumasë. Nëse ka lexuar natën, hatmen le ta përfundojë me namaz të sabahut, ose mes ezanit dhe ikametit për xhuma, sepse këto kohë kanë vlerë të posaçme.

Të devotshmit e konsideronin të lavdëruar që ditën e xhumasë të lexojnë suren *Ihlas* 1000 herë. Bile disa kanë thënë se leximi i sures *Ihlas* 1000 herë në dhjetë ose në njëzet reqate, ka sevap sa të lexohet komplet Kur'ani-hatme.

Thuhet se atij që e lexon këtë sure të plotë, për dhjetë ose njëzet reqate, kjo i është më me vlerë se sa të lexojë gjithë Kur'anin.

Të devotshmit i dërgonin salavat Resulallahut s.a.v.s., nga njëmijë herë, duke thënë:

“Subhanallah, vel-hamdu lilah, ve la ilahe ilallah, vallahu ekber”

(I Famshëm je vetëm Ti, O Allahu im, dhe lavdia të qoftë Ty! I lartë është emri Yt dhe Madhëria jote është shumë e madhe. Nuk ka Zot tjetër përveç Teje.)

Është mirë të lexohen shtatë sure të cilat fillojnë me lavdërim të Allahut (*musebbeat-i seb'a*)²¹⁰ para xhumasë ose ditën e xhumasë.

Nuk është transmetuar nga Resulallahu s.a.v.s., të ketë lexuar suren e njëjtë gjithmonë, përpos të premtën. Resulallahu s.a.v.s., lexonte të enjten në aksham suret *Kafirun* dhe *Ihlas*, e në jaci suren *Xhuma* dhe *Munafikun*.

Transmetohet se këto dy të fundit i lexonte në dy reqatet e xhumasë, ndërsa në sabahun e xhumasë lexonte suren *Sexhde* dhe *Dehr*²¹¹;

²¹⁰ Janë shtatë sure që fillojnë me lavdërim të Allahut Teala, e ato janë *Isra*, *Hadid*, *Hashr*, *Saff*, *Xhuma*, *Tegabun* dhe *Eala*.

²¹¹ Musliimi, nga Ibn Abbas dhe Ebu Hurejre.

5. është e lavdërueshme që, kur të hyjë në xhami, mos të ulet pa i falur katër reqate në të cilat do të lexojë suren *Ihlas* dyqind herë, në secilin reqat nga pesëdhjetë herë, sepse është transmetuar nga Resulallahu s.a.v.s., se ai që vepron kështu nuk do të vdesë deri sa të shohë vendin e vet në xhennet, ose deri sa ky vend t'i shfaqet.²¹²

Nuk do t'i anashkalojë as dy reqatet e tehiyyetul-mesxhid, edhe nëse imami fillon me hutben²¹³, por do t'a shkurttojë, sepse këtë e ka urdhëruar Resulallahu s.a.v.s..²¹⁴

Në një hadith garib thuhet se Resulallahu s.a.v.s., në hudbe heshti për ta përfunduar namazin *tehiyyetul-mesxhid* një person që ishte duke falë.²¹⁵

Fakihët e Kufes thonë:

“Nëse imami heshtë, atëherë do të falë namazin tehiyyetul-mesxhid.”

²¹² Hatibi, në veprën *er-Ruvatu an Malik*, nga Ibn Omeri, dhe thotë që është transmetim shumë i vetmuar (*garib*).

²¹³ Më herët e kemi përmendur që sipas medh'hebit Hanefi, gjatë hutbes nuk mund të falet kurrfarë namazi.

²¹⁴ Muslimi nga Xhabiri. Buhariu e përmend urdhërimin për faljen e dy reqateve, por nuk përmend shkurtimin.

²¹⁵ Darekutni nga Enesi, dhe thotë që me zinxhir të pandërprerë të transmetuesve e përmend Ubejd ibn Muhammed, por ka bërë një gabim, sepse në fakt transmetohet nga Mu'temir, e ky na i ati, si *mursel*.

Është e lavdëruar që të premtën, ose para saj, të falë katër reqate me suret: *Enam, Kehf, Ta-Ha* dhe *Ja-Sin*. Nëse nuk i di këto, do të lexojë *Ja-Sin, Sexhde, Duhan* dhe *Mulk*.

Nuk do të anashkalojë leximin e këtyre katër sureve para të premtës, sepse në to ka vlera të larta. Kush nuk di mirë të lexojë Kur'anin, lexon aq sa di dhe e lexon shumë suren *Ihlas*, e prapë merr sevap.

Mirë është gjithashtu të falë *salatul-tesbih*, e që do ta shpjegojmë në pjesën për ibadetet vullnetare, për shkak që Resulallahu s.a.v.s., i tha xhaxhait të tij Abbasit r.a.:

“Fale këtë namaz çdo xhuma!”²¹⁶, dhe Ibn Abbasi r.a., kurrë nuk e ka lëshuar faljen e këtij namazi të premtën, kur Dielli kalonte zenitin, e fliste për rëndësinë e tij.

Koha më e mirë për këtë namaz është 45 minuta pas lindjes së Diellit deri 45 minuta para namazit të drekës.

²¹⁶ Ebu Davudi, Ibn Maxhe, Ibn Huzejne dhe Hakimi nga Ibn Abbas r.a., ndërsa Ukajli e të tjerë konsiderojnë se për këtë nuk ka hadith të besueshëm.

Pas faljes së xhumasë deri në ikindi është kohë e mirë për dëgjim të diturisë, e nga ikindia deri në aksham për *tesbih* dhe *istigfar*.

6. dhënia e sadakasë është posaqërisht e lavdëruar në këtë ditë, sepse shpërblimi është dy fish. Nuk i jepet sadaka atij që lypë deri sa imami mbanë hutben, për shkak që është *mekruh* të folet në atë kohë.

Salih ibn Muhammed tregon:

“Një fukara lypte përpara babait tim gjatë xhumasë, deri sa imami mbante hutben,²¹⁷ Një person i dha babasë tim para për t’ia dhënë lypësit, por babai nuk i mori paratë.”

Ibn Mesud thotë:

“Kur dikush lyp në xhami, ka merituar të mos i jepet, e kur të lypë duke bërë be Kur’anin, mos i jepni.”

Disa dijetarë e konsideronin të papëlqyer dhënien e sadakasë atyre që lypin në xhami duke shëtitur, por nëse lypin duke qëndruar në një vend, kanë thënë se mund t’i jepet.

²¹⁷ Babai i Salih ibn Muhammedit është muhaddithi dhe fakihu i njohur, Ahmed ibn Hanbel.

Ka'b el-Ahbar thotë:

“Kush falë namazin e xhumasë dhe pastaj jep sadaka, e më pas i falë dy reقات përulur dhe thotë:

Allahumme inni es'eluke bismike Bismilahl-Rahmanir-Rahim, ve bismikelezi la ilahe ilallahu, huvel-Hajjul-Kajjumulezi la te'huzuhu sinetun ve la nevm

(O Allah, të lutem Ty me emrin Tënd, me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit, nuk ka zot pos Atij, Allahut, Ai është i Gjalli, i Gjithëpushtetshmi, Ai që nuk e zë as kotja, as gjumi),

Allahu Teala do t'i japë çfarëdo që të kërkojë.”

Njëri nga gjeneratat e para, (*selef-i salihin*) ka thënë:

“Ai që të premtën e ushqen një fukara, dhe herët shkon në xhami dhe arrinë fillimin e hutbes, duke mos shqetësuar askë, dhe pastaj kur imami jep selam, thotë:

Bismilahir-Rahmanir-Rahimil-Hajjil-Kajjun es'sluka en tagfire li ve terhammi ve tuafini munen-nar

(Me emrin e Allahut, Mëshirues, Mëshirëplotë, të Gjallit, të Përjetshmit, Ty të lutem të m'i falësh gjynahet, të kesh mëshirë me mua dhe të më shpëtosh nga Zjarri),

pas së cilës bën dua për atë që dëshiron, duaja do t'i pranohet.”;

7. Ditën e xhumasë le t'ia kushtojë vetëm ahiretit, duke ndërprerë angazhimin me çfarëdo pune të dynjallëkut, të angazhohet me dhikrin e rregullt dhe vazhdueshëm (vird), si edhe të mos udhëtojë.

Transmetohet se atë që niset në rrugë ditën e xhumasë e mallkojnë dy melekët mbrojtës.²¹⁸

Udhëtimi është haram pas lindjes së deillit²¹⁹, dhe mund të udhëtojë vetëm nëse në rast se nuk udhëton, do t'i humbasë shokët.

Disa nga gjeneratat e para, (*selef-i salihin*) e konsideronin të papëlqyer blerjen e ujit në xhami, qoftë për ta pirë ose ta shpërndajë për mirëbërje, sepse edhe shitja edhe blerja në xhami janë të papëlqyera. Thonë se nuk ka dëm nëse ujin e pi brenda xhamisë ose e dhuron në xhami, në rast se e paguan jashtë xhamisë.

Shkurtimisht, ditën e xhumasë duhet të shtojë virdin dhe veprat e mira sepse kur Allahu Teala e do robin e Vet, e angazhon në kohë të mira me veprat më të

²¹⁸ Darekutni në *el-Efrad* nga Ibn Omeri r.a., e në zinxhir të transmetuesve gjednet edhe Ibn Lehia, dhe thotë se është *garib*. E përmend edhe Hatibi në veprën *er-Ruvat an Malik* nga Ebu Hurejre, me zinxhir të dobët të transmetuesve.

²¹⁹ Sipas medh'hebit Hanefi nuk ka pengesë të niset në rrugë e të udhëtohet ditën e xhumasë.

vlefshme, e kur e urren, në këto kohë posaqërisht të vlefshme, e angazhon me veprime të këqija, që kështu ta dënojë më rëndë dhe ta urrejë më shumë, sepse është privuar nga bereqeti i atyre kohëve.

Në ditën e xhumasë ka shumë dua që janë *mustehab*. Inshallah edhe këto do t'i shpjegojmë në *Librin për duatë*.

Kapitulli i gjashtë

ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME NË LIDHJE ME NAMAZIN QË SECILI KA NEVOJË T’I DIJË

Situatat që rrallë ndodhin, trajtohen në detaje në veprat e fikhut. Këtu do t’i shpjegojmë çështjet e përgjithshme.

Çështje 1

VEPRIMET E VOGLA NË NAMAZ (AMELI KALIL)

Veprimet e vogla, ani pse nuk e prishin namazin, janë të papëlqyera nëse bëhen pa nevojë, siç është largimi i kalimtarit apo mbytja e akrepit nga i cili frikësohet me një ose dy goditje.²²⁰ Nëse bëhen tri goditje, numri i veprimeve është rritur (ameli kesir) dhe namazi priset. Njëjtë me morrin apo mizën. Nëse e shqetësojnë, ai ka të drejtë të mbrohet, njëjtë si me nevojën për t’u kruar, nëse kjo nevojë e largon nga përlësia.

²²⁰ Sipas medh’hebit Hanefi largimi i kalimtarit bëhet me shenjë, jo me dorë. Sa për mbytjen e akrepit, duhet mbështetur hadithit ku thuhet: **“Edhe nëse jeni në namaz mbyteni gjarpërin dhe akrepin.”** Të mbysë gjarpërin ose akrepin sa është në namaz, edhe nëse është rritur numri i veprimeve, sipas medh’hebit Hanefi, nuk e prishë namazin.

Muadhi nxinte morra dhe buba në namaz, e Ibn Omeri në namaz edhe i mbyste morrat, sa i shihej gjaku në gishta. Imam Nehai thotë:

“Le ta largojë, e nuk është gjynah as të mbytet”,

e Ibnul-Musejjeb thotë:

“Le ta kapë e ta hedhë jashtë.”

Muxhahidi thekson që më së miri është t’i lëshojnë, nëse nuk e shqetëson, por nëse e shqetëson dhe e pengon në namaz, e kapë, e shkelë dhe e hedhë jashtë. Kjo është një leje. Megjithatë, më së mirë është të ruhet edhe nga veprimet më të vogla.

Disa fare nuk i largonin mizat, e thonin:

“Nuk dua të lëshohem në këtë, e t’ia prishë vetes namazin. Kam dëgjuar se keqbërësit para sundimtarëve durojnë keqtrajtme të mëdha, e nuk lëvizin, e unë si mos të duroj pak vështirësi para Allahut?!”

Kur t’i hapet goja, nuk ka pengesë ta vendosë dorën para gojës, bile është e pëlqyeshme të veprojë kështu. Nëse tështinë, do t’i falënderohet Allahut Teala në vete, pa lëvizur gjuhën. Nëse gromësitë, nuk do të duhej kokën ta ngritë kah qielli. Nëse i rrudhet setra, nuk

duhet ta rregullojë²²¹, e as skajet e çallmës. Krejt kjo është e papëlqyer, përpos kur është e domosdoshme.

Çështje 2

FALJA ME MBATHJE

Falja e namazit me sandale lejohet unanimisht, por nëse nuk ka vështirësi t'i z bathë, më e pëlqyeshme është të z bathet. Unanimisht është lejuar edhe falja me meste, nëse nën meste nuk ka papastërti të dukshme. Si meste mund të përdoren edhe mbathje tjera.

Resulallahu s.a.v.s., po falte namaz me sandale, dhe i z bathi, e pas tij, edhe të tjerët vepruan njëjtë e Resulallahu s.a.v.s., i pyeti:

- Përse i hoqët këpucët?

- Të pamë ty, prandaj i z bathëm!;

i thanë ata, e Resulallahu s.a.v.s., ju tha:

- Më erdh Xhebraili a.s., dhe më njoftoi se sandalet i ma ishin të papastra. Prandaj kur dikush nga ju nisët për xhami, le ta kthejë mbathjen e ta shikojë përfundi. Nëse sheh papastërti, le ti fërkon për toke, dhe me to le të falet.²²²

²²¹ Sipas medh'hebit Hanefi është mekruh të falet me setrën mbi supe, pa e veshur.

²²² Davudi dhe Hakimi nga Ebu Seid.

Disa thonë që namazi me mbathje është më i mirë, sepse Resulallahu s.a.v.s., pyeti:

“Përse i hoqët...?”,

mirëpo ky është teprim, sepse Resulallahu s.a.v.s., i pyeti për t’ju shpjeguar pse ai i zbathi të tijat, pasi e kuptoi se ata vepruan si ai.

Ndërsa Abdullah ibn Saib tregon se Resulallahu s.a.v.s., i zbathi sandalet sa ishte në namaz.²²³ Po shihet se, siç është falë me sandale, Pejgamberi a.s., është falë edhe pa to.

Kur zbathet, këpucët nuk i lë ku ngushtojnë hapësirë dhe pengojnë xhematin, por i lë para vetes, nëse është e mundur, dhe jo mbrapa, që të mos e prishë qetësinë e vet e të kthehet të shikojë. Është e mundur se kjo është menduar kur është thënë se namazi me mbathje është më i mirë - të mos kthehet, Ebu Hurejre r.a., tregon që Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Kur dikush prej jush të falet, le t’i vendosë këpucët para vetes.”²²⁴,

e vet Ebu Hurejre i tha një personi:

“Vendosi sandalet në mes këmbëve dhe mos e shqetëso myslimanin me to.”

²²³ Hadithin nga Abdullah ibn Saib që Resulallahu s.a.v.s., i hoqi të dy sandalet e transmeton Muslimi.

²²⁴ Ebu Davudi.

Kur ishte imam, Resulallahu s.a.v.s., i vendoste në të majtë.²²⁵ Imami ka të drejtë për këtë, sepse askush nuk është në të majtën dhe në të djathtë të tij. E prapë mirë është t'i vendosë mes këmbëve, pra përpara, e është e mundur që pikërisht kjo të jetë dëshiruar me hadith. E megjithatë, Mut'im b. Xhubejr²²⁶ ka thënë:

“Vendosja e këpucëve në mes këmbëve është bidat.”

Çështje 3

PËSHTYRJA NË NAMAZ

Nëse pështyn në namaz, namazi nuk i prishtet, sepse konsiderohet veprim i vogël.²²⁷ Diçka që nuk prodhon zë, nuk konsiderohet e folur, e pështyma nuk është formë e të folurit, por megjithatë është *mekruh*, prandaj duhet përmbajtur nga ajo, përpos në rastet kur edhe Resulallahu s.a.v.s., e ka lejuar. Dikush prej as'habëve ka treguar që Resulallahu s.a.v.s., pa pështymë në murin kah kibla e u zemërua shumë, dhe e pastroi me degë të thatë palmeje që e mbante në dorë, pas së cilës, tha:

- ***Më sillni parfum***, dhe i fërkoj gjurmët e pështymës me shafran, e më pas u kthye kah as'habët, e ju tha:

- ***Cili prej jush do të donte ta pështyjnë në fytyrë?***

²²⁵ Muslimi nga Abdullah ibn Saib.

²²⁶ Është as'hab dhe Kurejsh. E pranoi Islamin në çlirimin e Mekes.

²²⁷ Ameli kesir e prish namazin, por për këtë ka mosmarrëveshje.

- Askush, u përgjigjën as'habët, e pas kësaj, Resulallahu s.a.v.s., ju tha:

- ***Kur ndonjëri prej jush falë namazin, Allahu Teala është mes tij dhe kiblës.***²²⁸

E në transmetim tjetër thuhet:

“...Allahu Teala është karshi tij, prandaj asnjëri prej jush të mos pështyjë kah kibla, as djathtas, as majtas, as nën shputën e majtë, e nëse i vjen pështyma, le të përshtyjë në mindil, dhe le t'a palojë mindilin.”

Çështje 4

QËNDRIMI I XHEMATIT NË SAF

Kjo i ka sunnetet dhe farzet e veta. Sunnet është që mashkulli të qëndrojë në të djathtë të imamit, pak i tërhequr prapa, ndërsa femra qëndron pas imamit. Po të jetë pranë imamit, nuk ka dëm, por është kundër sunnetit. Po të jetë edhe një mashkull, mashkulli qëndron nga e djathta e imamit, e gruaja pas mashkullit. Askush nuk qëndron pas safit vetëm, por hyn në saf, ose tërheqë një prej safit. Po të mbetet vet, namazin e ka të rregullt, por si veprim është i qortuar.

²²⁸ Muslimi nga Xhabiri, dhe është *muttefekun alejhi* në formë më të shkurtë nga Enesi r.a., Ajshe r.anha, Ebu Seid, Ebu Hurejre dhe Ibn Omeri.

Është farz që safet t'i afrohen njëri-tjetrit për të krijuar lidhje mes imamit dhe atyre që i përshtaten imamit, sepse ata janë xhemat. Nëse janë brenda në xhami, edhe po të mos jenë safet e rregulluar, lidhja është krijuar, sepse xhamia për atë qëllim edhe është ndërtuar. Mjafton të shikojë vetëm lëvizjen e imamit. Ebu Hurejre r.a., i ishte përshtatur imamit, nga kulmi i xhamisë. E nëse xhemati është në oborr të xhamisë, në rrugë ose ambient të hapur, ashtu që mes tyre nuk ka ndarje me objekte e të ngjashme, atëherë lidhje e mjaftueshme është afërsia aq sa e arrin shigjeta. Nga kjo distancë mund t'i përshtatet imamit, sepse mund t'i shohë lëvizjet e tij.

Kusht për të bërë lidhje është kur xhemati falë namazin në ndërtesat djathtas apo majtas xhamisë.

Nëse dyert e këtyre ndërtesave çelen kah xhamia, kusht është që safi i xhamisë të vazhdohet pandërprerë brenda në ndërtesë; namazi i xhematit në këtë saf dhe atyre pas këtij safit është i drejtë, por jo edhe i atij që falet para këtij safi. Kështu është vendimi edhe për ndërtesa tjera por një ndërtesë e vetme, ose një oborr, llogariten si fushë.

Çështje 5

VONESA NË NAMAZ

Ai që arrinë në reqatin e fundit të imamit, për të reqati i fundit është reqati i parë. Ai i përshtatet imamit, dhe pasi që imami jep selam, vazhdon vet. Për shembull, ai që arrin në reqatin e dytë të imamit në namazin e sabahut, dhe me imamin lexon duanë e kunutit, ngitet në këmbë, falë edhe një reqat, dhe prapë lexon duanë e kunutit. Nëse arrinë imamin në mesin e kijamit, nuk do të lexojë duanë por le të fillojë me *Fatiha* dhe le ta lexojë shpejt. Nëse imami shkon në ruku, ky mund t'i bashkohet edhe pa e përfunduar leximin e *Fatihësë*, e do ta përfundojë kur të drejtohet nga rukuja. Nëse nuk mundet ta përfundojë, do ta përcjellë imamin, sepse në këto gjendje, *Fatiha* do të trajtohet si e plotë. Nëse imami bën rukunë deri sa namazlia lexon sure, atëherë namazlia duhet ta ndërpresë leximin.

Nëse imamin e gjen në sexhde ose ulur, do të bëj tekbirin fillestar, e më pas do të ulet, pa bërë tekbir, për dallim nga rasti kur e gjen në ruku, kur bën edhe tekbirin e dytë me nisjen në ruku, sepse ky është kalim nga një gjendje në tjetrën, që merret parasys. Tekbiret bëhen për ato kalime të rëndësishme në namaz, e jo për situata të reja, që janë rezultat i pasimit të imamit. Nuk do ta arrijë reqatin nëse nuk ka arritë në ruku, deri sa

imami edhe vet është në ruku. Nëse nuk arrin para se imami të ngritet nga rukuja, ai reقات i ka ikur.

Çështje 6

NAMAZET KAZA

Kush nuk e falë namazin e drekës dhe hyn koha e ikindisë, së pari le ta falë drekën, pastaj ikindinë. Nëse fillimisht e falë ikindinë e pastaj drekën, prapë është e lejuar (*xhaiz*), por ka hyrë në çështje të diskutueshme. Nëse e gjen imamin në namaz, fillimisht le ta falë me të ikindinë, e pastaj edhe drekën, sepse falja e namazit me xhemat në kohë është më e vlefshme. Nëse pas hyrjes së kohës për namaz ky e falë një namaz farz, e pastaj mbledhet xhemati, e bën nijet atë namaz, i përshtatet imamit dhe falë me xhemat, e Allahu Teala do të vendos se cilin do ta pranojë Ai. Kur i bashkohet xhematit, është *xhaiz* (e lejuar) edhe nëse e bën nijet për një namaz kaza ose nafile.

Nëse falë namazin me xhemat, e pastaj takon edhe xhemat tjetër, le ta bëj nijet për namaz kaza ose nafile, sepse nuk ka kurrfarë arsye të përsërisë namazin e falur me xhemat edhe një herë. E xhematit të dytë i bashkohet për të përfituar vlerën e xhematit.²²⁹

²²⁹ Sipas medh'hebit Hanefi, me nijetin e nafiles imamiti përshtatet vetëm në namazin e drekës dhe të jacisë.

Çështje 7

FALJA E NAMAZIT ME RROBA TË PAPAŞTRA

Kush falet, e pastaj vëren se ka pasur papastërti në rroba, më mirë e ka ta përsërisë namazin, ani pse këtë nuk e ka të obliguar.

Nëse papastërtinë e sheh gjatë namazit, do t'a heqë atë rrobë, e të vazhdojë namazin, e bazë për këtë është rasti i heqjes së sandaleve, kur Xhebraili a.s., e lajmëroi Resulallahun s.a.v.s., që në to ka papastëri, e Resulallahu s.a.v.s., nuk e përsëriti namazin. Megjithatë, më mirë është ta patrojë papastërtinë dhe të falet nga fillimi.²³⁰

Çështje 8

SEHVI-SEXHDE

Kush nuk e mbërrinë uljen e parë, leximin e duasë së kunutit ose dërgimin salavate Resulallahut s.a.v.s., në uljen e parë, ose bën diçka nga harresa, nëse e ka bërë me vetëdije, do ta prishte namazin, ose nëse është në dilemë se a i ka falur tri apo katër reqate, do të veprojë

²³⁰ Sipas medh'hebit Hanefi, nëse sasia e papastërtisë është sa një dërhem, e përsëritë namazin. Te Shafitë nuk ka limit të sasisë së papastërtisë, dhe nëse kalon koha e namazit, nuk ka nevojë të përsëritet namazi.

sipas asaj në çka është i sigurtë, dhe do të bëjë dy sehvi-sexhde para selamit.²³¹ Nëse harron dhe jep selam, atëherë pas selamit i bën dy sehvi-sexhde pa humbur shumë kohë.

Nëse i prishet abdesi pas selamit të parë e dukë bërë sehvi-sexhden, namazin nuk e ka të rregullt, sepse sehvi-sexhe është para selamit të fundit, prandaj është sikur të ketë dhënë selam para kohe, dhe me sehvi-sexhde nuk e përfundon namazin, por prapë është kthyer në namaz, dhe për këtë duhet të japë selam përsëri. Prandaj me prishjen e abdetit në këtë mes, namazin nuk e ka të rregullt.

Nëse sehvi-sexhde i kujtohet pas daljes nga xhamia, ose më vonë, koha e saj tashmë i ka kaluar.

Çështje 9

VESVESET NË NIJET

Vesveseja në nijet buron nga mendja e trazuar ose nga mosnjohja e sheriatit; zbatimi, si i tillë, i urdhrave të Allahut Teala është i ngjashëm me zbatimin e urdhrit të

²³¹ Sipas medh'hebit Hanefi, sehvi-sexhde bëhet pas dhënies së selamit të parë. Lejohet edhe para selamit, por konsiderohet e papëlqyer (*mekruh tenzihi*).

kujtudo tjetër dhe shprehja e respektit ndaj Allahut, sa i përket nijetit, është ngjashëm me shprehjen e respektit kujtudo tjetër. Për shembull, nëse dikujt i vjen mysafir një dijetar, e ky ngritet e thotë:

- Nijetin e kam të qëndroj në këmbë nga respekti për ardhjen e Zejdit të nderuar e të kthehem me fytyrë kah ai, për shkak të reputacionit të tij, dhe veprimin tim e ndërlidhi me hyrjen e tij,;

do të konsiderohej budalla, mirëpo fakti që e ka parë dhe e ka njohur reputacionin e mysafirit, te ai ka ngjallur dëshirën për të shprehur respektin, prandaj edhe është ngritur e i ka shprehur respekt, pos nëse ngritet nga pakujdesi ose për ndonjë punë tjetër.

Vendosja si kusht e urdhrit që të theksohet se cilin namaz po e falë, që po falet në kohë dhe që është farz, është sikur kushti që ngritja të ndërlidhet me hyrjen, bashkë me fytyrën e kthyer kah personi që ka ardhur, pa pasur nxitje tjera, si edhe me qëllimin që kjo të konsiderohet shprehje e respektit. Sepse, nëse ngritet duke ia kthyer shpinën, ose përmbahet e ngritet vetëm pas një kohe, me këtë nuk shprehë respekt.

Është e domosdoshme që këto cilësi të njihen e të synohen; edhe nëse kjo qëndron vetëm për një çast në mendime, ajo do të vazhdojë me strukturën e fjalëve që tregojnë në këtë, qofshin të thëna me gjuhë, apo të menduara në zemër. Ai që nijetin (qëllimin) për namaz nuk e kupton kështu, nuk e kupton nijetin fare. Atëherë, te kuptimi i nijetit nuk mbetet tjetër pos kuptimit që je i ftuar të falesh në kohë të caktuar dhe ti je përgjegjur e po falesh. Mashtrimi nga shejtani është padituri e plotë. Këto njohuri dhe nijeti bashkohen në zemër në një gjendje të caktuar të personit, e nuk janë të ndara në elemente të veçanta në mendje, që zemra t'i shohë të ndara e të mendojë për to, ndërsa dallmi në mes të asaj që është prezente në zemër dhe asaj që me mendje analizohet, është i madh. Prania e këtyre njohurive dhe e nijetit në zemër, edhe mos qofshin specifike, janë kundërshtim i mungesës dhe pavëmendshmërisë. Ai që, për shembull, e njeh një krijesë, e njeh atë me një njohuri, në një gjendje, e kjo njohuri i bashkon njohuritë tjera për atë krijesë, edhe nëse ato njohuri nuk janë të theksuara. Ai që njeh diçka të krijuar, e njeh ekzistimin dhe mosekzistimin e atij krijimi, kohën para dhe pas atij krijimi dhe e di që koha para saj i takon mosekzistencës së saj e koha më pas, ekzistimit të saj. Të gjitha këto njohuri përmbledhen në njohurinë për atë krijim. Kjo ndodhë me argumentin se, sikur t'i thuhej atij që e njeh

një krijim, e po të mos njihete asgjë tjetër: *“A ke njohuri për kohën para këtij krijimi, ose kohën më pas, ose për mosekzistencën e këtij krijimi, ose çka kishte para ekzistimit të saj, ose pas, ose si ndahen kohët në të mëhershme e të mëvonshme?,*

e ai të thotë:

- Unë nuk di asgjë për këto!;

do të gënjente, dhe fjalët e tij do të ishin të kundërta me qëndrimin e tij se e njeh atë krijim. Mosnjohja e këtyre finesave mundëson mashtrimin prej shejtanit. Ai që është i mashtruar nga shejtani, mundohet që në zemër t’i ketë në të njëjtën kohë edhe mendimin se po e falë drekën, edhe që po falet në kohë, edhe që është namaz farz; krejt këto të ndara nga fjalët që po i shqipton - e kjo është e pamundur. E vesveseja e shejtanit eliminohet me njohjen se, në rastin e nijetit, zbatimi i urdhrit të Allahut Teala është i ngjashëm me zbatimin e urdhrit të kujtdo tjetër. Me qëllim të thjeshtëzimit e lehtësimit, do të shtoj: nëse personi nën mashtrimin e shejtanit nijetin e kupton si prani të të gjitha këtyre cilësive të ndara, dhe nuk mundet që për një moment në vete të mendojë zbatimin e urdhrit, por megjithatë kjo do të kishte ndodhë gjatë tekbitit dhe pa e kryer ende tekbinin, kjo do t’i lejohej. Nuk e obligojmë që gjithë këtë ta ndërlihdë me fillimin ose fundin e tekbitit, sepse do të ishte obligim përtej mundësive.

Sikur kjo t'i urdhërohej, të parët e mirë do të pyesnin për këtë, ose së paku një as'hab do të ishte nën mashtrimin e shejtanit gjatë nijetit. Meqenëse nuk ka ndodhë, kjo tregon se çështja është fleksibile. Pasi që është e mundur që personi i mashtruar nga shejtani ta bëjë nijetin, le të mjaftohet me kaq deri sa nuk mësohet në këtë e t'i largohet mashtrimi. Nuk do të kërkojë nga vetja realizimin e kësaj, sepse kjo vetëm sa e shton mashtrimin.

Në veprën tonë *Fetva*, i kemi përmendur disa mënyra të realizimit e të njohjes, si edhe qëllimet që ndërliken me nijetin, e që dijetarët duhet t'i dinë. Nëse njerëzit e rëndomtë dëgjojnë për to, kjo mund t'i dëmtojë e edhe më shumë t'i habitë mashtrimi, dhe për këtë arsye nuk i përmendëm këtu.

Çështje 10

PËRCJELLJA E IMAMIT

Pasi që e pasojnë imamin, xhemati nuk duhet të bëjë ruku dhe sexhde para tij. Bile, nuk duhet as t'i bëjnë në të njëjtën kohë, por ta pasojnë dhe përcjellin imamin, e ky është edhe kuptimi i përshtatjes imamit. Nëse qëllimisht i bën këto lëvizje në të njëjtën kohë me imamin, namazi nuk i prishet, e as nëse qëndron pranë imamit, duke mos u tërhequr mbrapa. Nëse lëvizjet i

bën para imamit (përveç në tekbinin fillestar) ka ndarje të mendimeve se a është namazi i tij i rregullt apo jo. Nuk është larg mendjes të thuhet se është i parregullt nëse e krahasojmë me situatën kur qëndron para imamit. Aq më shumë, namazi falet me xhemat për të pasuar lëvizjen, e jo vendin, prandaj pasimi në lëvizje është më i rëndësishëm. Është vënë si kusht të mos dilet para imamit, që të lehtësohet përcjellja e lëvizjeve të tij dhe që të arrihet forma e pasimit, sepse është e udhës që përpara të jetë ai që ndiqet. Të bëhet lëvizje para imamit është e paarsyeshme, pos nëse ndodh nga harresa. Prandaj Resulallahu s.a.v.s., e dënoi ashpër këtë, duke thënë:

“A nuk frikësohet ai që e ngritë kokën para imamit se Allahu nuk ia shndërron në kokë gomari?!”²³²

Kur të vonohet pas imamit për një ruku, as kjo nuk e prishë namazin, e as kur imami të drejtohet nga rukuja, e ky ende nuk e ka bërë rukunë, por megjithatë një vonesë e këtillë është e papëlqyer. E nëse imami tashmë e ka lëshuar ballin në tokë, e namazlia ende nuk ka bërë rukunë, namazi i tij nuk është i drejtë. Njëjtë me rastin kur imami e bën sexhden e dytë, e namazlia ende nuk e ka bërë as të parën.

²³² *Muttefekun alejhi*, nga Ebu Hurejre.

Çështje 11

REAGIMI NË PARREGULLSITË E TË TJERËVE

Është obligim i atij që merr pjesë në namaz që të reagojë dhe t'ia tërheqë vërejtjen personit të cilin sheh që nuk po e falë namazin si duhet. Nëse ai person është i padijshëm, ky do të jetë i butë dhe do ta mësojë. Këtu bën pjesë urdhri që të drejtohen safet, ndalimi i individit të dalë jashtë safit, qortimi i atij që e ngritë kokën para imamit dhe veprime të ngjashme, sepse Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Mjerë dietari që nuk e mëson të paditurin!”²³³

Ibn Mesud r.a., ka thënë: *“Kush e sheh dikë që po gabon në namaz e nuk e paralajmëron, është ortak në gjynah.”*

Tregohet se Bilall ibn Sa'd ka thënë: *“Gabimi i fshehur e dëmton vetëm atë që e bën, e gabimet e hapura i dëmtojnë të gjithë.”*

Në një hadith përmendet se Bilalli r.a., i rrafshonte safet duke i goditur namazlitë me kamxhik në gjunj²³⁴, ndërsa Omeri r.a., ka thënë: *“Kërkoni vëllezërit tuaj në*

²³³ Dejlami në **Musnedul-firdeus** nga Enesi.

²³⁴ Hadithi nuk është gjetur.

namaz; nëse nuk i gjeni – interesohuni për ta; nëse janë të sëmurë – vizitoni, e nëse janë shëndosh – qortoni!”,

pra, qortoni mungesën e tyre në xhemat. Në këtë nuk duhet pasur lëshime. Të parët e mirë ishin shumë të përkushtuar në këtë, aq sa disa ia dërgonin tabutin atyre që mungonin në xhemat, duke aluduar kështu se vetëm i vdekuri nuk i bashkohet xhematit. Kush hyn në xhami duhet të preferojë anën e djathtë. Në kohën e Resulallahut s.a.v.s., të gjithë vraponin në anën e djathtë, sa që ana e majtë mbetej zbrastë, dhe për këtë Resulallahu s.a.v.s., ju tha:

- *Kush e ngjallë anën e majtë të mesxhidit, do të ketë shpërblim të dyfishtë!*²³⁵

Kush takon ndonjë të ri në saf, e vet nuk ka vend, ka të drejtë ta tërheqë djaloshin në safin mbrapa, e ai të merr vendin e tij, natyrisht, nëse djaloshi është i mitur.

Këtu deshëm t’i shpjegojmë çështjet e përgjithshme, ndërsa rregullat e veçanta për namazet inshallah do të shpjegohen në *Librin për virdet*.

²³⁵ Ibn Maxhe, nga Ibn Omer.

Kapitulli i shtatë

NAMAZET NAFILE

Dije se namazet nafile ndahen në tri grupe: *sunnet*, *mustehab* dhe *tetavvu*.

Me *sunnet*, mendojmë në ato namaze të cilat Resulallahu s.a.v.s., siç na është transmetuar, i bënte rregullisht, siç janë namazet e rregullta bashkë me namazin farz, namazin e duhasë, namazin vitri²³⁶, *tehexhjud* e të tjerë, sepse *sunnet* është shprehje që nënkupton rrugën që pasohet.

Me *muhstehab* (të pëlqyera) mendohet në ato namaze, për vlerën e latë (fazilet) të të cilave flasin transmetimet, por nuk është transmetuar që Resulallahu s.a.v.s., t'i ketë bërë rregullisht, siç janë namazet e ndërlydhura me secilën prej ditëve dhe netëve të javës, për çka do të flasim, ose siç është namazi para daljes nga shtëpia, me hyrje në shtëpi e të ngjashme.

²³⁶ Sipas medh'hebit Hanefi, namazi i vitrit nuk është nafile, por është *vaxhib* (i obliguar).

Namazet vullnetare (*et-tetavvu*) janë namazet për të cilat transmetimet nuk flasin posaqërisht, por bëhen vullnetarisht, me dëshirën për bisedë intime me Allahun Teala përmes namazit.

Sheriati flet për vlerën e namazit në përgjithësi, dhe e sygjeron namazin, ani pse jo këtë namaz konkretisht, prandaj namazet vullnetare janë kur personi vet të vendos për to.

Shprehja *tetavvu*, do të thotë ajo që personi e bën vullnetarisht, prej vetes. Këto namaze, të ndara në tri grupe, quhen *nafile*, sepse *nefl* është tepricë, shtesë, dhe ato në përgjithësi janë shtesë në namazet farz. Me shprehjet *nafile*, *sunnet*, *mustehab*, dhe *tetavvu*, deshëm të përcaktojmë terminologjinë për të definojmë kuptimet e tyre, dhe nuk ka kurrfarë gjynahu ai që ndryshon ndonjë prej këtyre shprehjeve, sepse kur kuptimet janë të qarta, nuk ka diskutim për shprehjet.

Shkallët e namazit të secilës prej këtyre pjesëve dallojnë mes vete sipas vlerës, përshtatshëm teksteve të transmetimeve që i përmendin ato vlera, faljes së atyre namazeve nga Resulallahu s.a.v.s., vlerave dhe popullaritetit të transmetimeve që flasin për to, prandaj do të thuhet që sunnetet që falen me xhemat kanë më

shumë vlerë se ato që falen individualisht, e namazi sunnet në xhemat me vlerën më të madhe është namazi i Bajramit²³⁷, pastaj namazi për shkak të errësimit të Diellit dhe për kërkim të shiut.

Namazi me vlerën më të lartë (fazilet) që bëhet i vetëm është namazi i vitrit, e pas kësaj dy reqate të sunnetit të sabahut, e pas kësaj sunnetet e tjera të rregullta bashkë me farzet.

Dhe varësisht rrethanave nga të cilat varen, namazet nafilet ndahen në:

1. *Nafilet sipas shkakut*, siç janë namazi me rastin e zënies së *Diellit (Kusuf)* dhe *Hënës (Husuf)* dhe *namazi për shi (istiska)*; dhe
2. *Nafilet në kohë të caktuar*, e që ndahen në ditore, javore dhe vjetore.

Bazuar në këtë, përshkrimin e tyre e kemi ndarë në katër pjesë:

²³⁷ Sipas medh'hebit Hanefi, falja e namazit të Bajramit është vaxhib për secilin që namazin e xhumasë e ka farz, sepse Resulallahu s.a.v.s., e falte rregullisht dhe i urdhëronte njerëzit të dalin e ta falin këtë namaz

- Namazet nafile ditore,
- Namazet nafile javore,
- Namazet nafile vjetore, dhe
- Namazet nafile sipas shkakut.

Pjesa e parë
NAMAZET NAFILE DITORE

Namazet nafile ditore janë tetë: sunnetet e rregullta bashkë me pesë namazet e ditës, si edhe tri të tjera: namazi i duhasë, namazi *evvabin* dhe *tehexhjud*.

1. Sunneti i sabahut,
 përbëhet nga dy reqate. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Dy reqate sunnet të namazit të sabahut janë më të mira se gjithë dynjaja dhe krejt çfarë ka në të!”²³⁸

Koha e hyrjes së këtij namazi është me lajmërimin e agimit të parë, kur zgjerohet në horizont, e nuk është në gjatësi dhe pingul. Ta njohësh me shikim është vështirë në fillim, pos nëse mësohen fazat e Hënës, ose e di lidhjen e lajmërimit të agimit me yjet që mund të shihen me sy, prandaj në bazë të yjeve vendos për të. Mund të bazohet edhe në Hënën, dy netë në muaj. Hëna

²³⁸ Muslimi nga Ajsher.anha.

lajmërohet bashkë me agimin në natën e 26, e mëngjesi lajmërohet me perëndimin e Hënës në natën e 12 të muajit. Kryesisht është kështu, e në këtë ndikojnë edhe pozitat e ndryshme të yjeve, e shpjegimi i tyre do të zgjatej. Mësimi i fazave të Hënës është një nga obligimet e rëndësishme të muridit, që kështu të kuptojë kohën përmes natës dhe mëngjesit. Koha e sunnetit të sabahut kalon me përfundimin e kohës së farzit të sabahut, me lindjen e Diellit, por është sunnet që ato të falen para farzit.

Nëse kur hyn në xhami xhemati është duke e falë farzin, menjëherë i bashkohet xhematit dhe hyn në namaz. Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Kur fillon namazi farz, nuk ka tjerë, përpos atij”²³⁹,
e kur të përfundojë me farzin, ngritet dhe e falë sunnetin e sabahut.²⁴⁰

²³⁹ Muslimi nga Ebu Hurejre

²⁴⁰ Kur të jetë në situatë të këtillë, personi do të vlerësojë se a mund të falë sunnetin dhe prapë t'i bashkohet xhematit, e nëse është i sigurt që mund t'a arrijë këtë, ashtu do të veprojë. E nëse vlerëson se xhemati mund t'i kalojë deri sa ky të falë sunnetin, do t'i bashkohet imamit në xhemat, sepse vlera e xhematit është më e madhe se sa sevapi i sunnetit të sabahut. Pas faljes së farzit të sabahut, sipas medh'hebit Hanefi nuk mund të falet kurrfarë nafile, e as sunneti i sabahut. Falja në këtë kohë është *tahrimen mekruh*.

E drejtë është që të falet në kohë, para lindjes së Diellit, sepse sunnetet përcjellin farzin që falet në kohë, ndërsa renditja se çka falë më herët e çka më vonë është sunnet, nëse nuk do të kishte xhemat. Megjithatë, nëse në xhami e takon xhematin, renditja ndërron, por sunneti i sabahut edhe më tutje kryhet në kohën e vet. Është e lavdëruar të falë sunnetin shkurt në shtëpi, e pastaj vjen në xhami, i falë dy reqate të *tehijjetul-mesxhid*²⁴¹, më pas ulet dhe nuk falë asgjë deri sa të falë farzin. Pasi të falë farzin e sabahut, më mirë është të mos falë asnjë namaz tjetër e të kalojë kohën deri në lindjen e Diellit me dhikr dhe meditim.

2. Sunneti i rregullt i mesditës,

përbëhet nga gjashtë reqate, katër para farzit dhe dy pas farzit. Sado që dy reqatet e fundit janë më të fortë, që të dy namazet janë *sunneti muekkede*. Ebu Hurejre r.a., tregon që Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Ai që i falë katër reqate pasi që dielli të kalojë zenitin, duke lexuar drejtë Kur’anin në to, dhe duke e bërë si duhet rukunë dhe sexhden, me të falen shtatëdhjetë mijë melekë, dhe kërkojnë falje për të deri në mbrëmje.”²⁴²

²⁴¹ Sipas medh’hebit Hanefi, është *mekruh* (e papëlqyer) të falet namaz nafilë pas lajmërimi të agimit, përpos dy reqate sunnet të sabahut.

²⁴² Abdulmelik ibn Habib nga Ibn Mesud.

Resulallahu s.a.v.s., nuk i lëshonte pa falë katër reqate pas kalimit të Diellit, të cilat i falte më gjatë, e thoshte:

“Në këtë kohë hapen dyer e qiellit, dhe unë dëshiroj që në këtë çast të më ngriten veprat.”²⁴³

Këtë hadith e përcjellë vetëm Ebu Ejjub Ensari. E Ummu Habibe r.a., bashkëshortja e nderuar e Resulallahut s.a.v.s., thotë:

“Do t’i ndërtohet shtëpi në xhennet atij që për çdo ditë i falë dymbëdhjetë reqate përpos farzit - dy reqate para sabahut, katër para drekës, dy pas drekës, dy para ikindisë dhe dy reqate pas akshamit.”²⁴⁴

Ibn Omeri r.a., ka thënë: *“E kam mësuar nga Resulallahu s.a.v.s., faljen e dhjetë reqateve për çdo ditë,”* dhe ka përmendur të njëjtën si Ummu Habibe r.a., përpos dy reqateve sunnet të sabahut, për të cilat ka thënë: *“Kjo është koha kur unë nuk hyja te Resulallahu s.a.v.s., por më ka treguar motra ime Hafsa r.a., që Resulallahu s.a.v.s., i falte dy reqate në shtëpi, e pastaj dilte.”²⁴⁵*

²⁴³ Ahmedî me zinxhir të dobët, e te Ebu Davudi dhe Ibn Maxhe në verzion më të shkurtë, deri sa Tirmidhiu e shënon të ngjashëm nga Abdullah ibn es-Saib, duke theksuar se është transmetim i mirë.

²⁴⁴ Nesai dhe Hakimi, që thotë se zinxhirin e transmetuesve e ka të besueshëm sipas kritereve të Muslimit. Muslimi e shënon në verzion më të shkurtë, ku nuk përmendet koha për namaz.

²⁴⁵ Muttefekun alejhi, e formulimi është nga Buhariu, por nuk ka thënë *“çdo ditë”*.

E në transmetim, Ibn Omeri r.a., thotë edhe: “...Dy reqate para drekës dhe dy reqate pas jacisë”.


Me këtë, dy reqate para drekës është bërë sunnet më i fortë prej katër reqateve para farzit të drekës. Koha e tyre hyn me kalimin e diellit përtej gjysmës së qiellit. Ky kalim vërehet me zgjatjen e hijes së personit që qëndron në këmbë, të kthyer kah lindja. Meqenëse hija e njeriut kur të lind dielli është në anën perëndimore dhe është e zgjatur, dielli kështu vazhdimisht ngritet, e hija zvogëlohet, dhe e braktisë anën perëndimore, deri sa dielli të arrijë majën e ngritjes së vet, kufirin e gjysmës së ditës. Ky do të jetë fundi i zvogëlimit të hijes. Kur dielli largohet nga pika më e lartë e ngritjes, hija fillon prapë të zgjatet. Kur zgjatja e hijes mund të vërehet me sy, atëherë fillon koha e namazit të drekës.

Është absolutisht e njohur që *zevalli*²⁴⁶, me dijen e Allahut Teala, ndodhë para kësaj, e megjithatë obligimet ndërlidhen vetëm me atë që shqisat mund të regjistrojnë. Pjesa e mbetur nga zgjatja e hijes, dimrit është më e gjatë e verës më e shkurtë. Më e gjata është kur Dielli arrinë në fillimin e konstalacionit të bricjapit (29 janar) e më e shkurta kur Dielli vjen në fillim të konstalacionit të gaforres (31 qershor). Kjo kuptohet me ndihmën e mjeteve për vrojtim dhe me matje.

²⁴⁶ Momenti kur dielli kalon zenitin e nisët kah perëndimi.

Një prej mjeteve me të cilën lehtë mund ta vërtetojë ai që di të shikojë mirë yjet, është të vërejë Yllin polar natën, dhe të vendosë drejt në tokë një pllakë katërkëndëshe ashtu që njëra anë e saj të jetë i kthyer kah Ylli polar. E paramendon se një gur bie nga Ylli polar në Tokë, dhe më pas paramendon një vijë nga vendi i supozuar ku mund të ketë rënë ai gur drejt anës tjetër në pllakë, do të krijohet vijë në anën e përmendur në dy kënde të drejta, pra vija nuk do të anojë nga asnjëra prej dy anëve. Më pas vendos një shtyllë drejt në pllakë, në vendin që e shënon me 0 (zero), që është karshi Yllit polar. Hija e asaj shtylle do të bjerë në pllakë në fillim të ditës duke anuar kah perëndimi në anën e vijës 1, e atëherë vazhdimisht do të anojë deri sa nuk palohet me vijën 2, ashtu që sikur maja të mund t'i zgjatej, do të arrinte në vijën e drejtë deri te vendi ku ka rënë guri, dhe do të ishte paralel me anën perëndimore dhe lindore, duke mos anuar kah asnjëra.

Kur më nuk ka hije kah perëndimi, Dielli është ngritur në pikën më të lartë. E kur hija të kalojë vijën që gjendet në pllaka kah lindja, Dielli tashmë e ka kaluar gjysmën e qiellit (*zeval*). Kjo vërehet saktë me shqisën e të pamurit, shkurt pas fillimit të zevallit. Kur hija të kalojë, vendoset një shenjë në majën e saj, e kur hija e asaj shenje bëhet sikur shtylla, hyn koha e ikindisë. Kaq do të duhej të dish për zevallin, dhe ja si duket kjo:



3. Sunneti i ikindisë,

përbëhet nga katër reqate para farzit. Ebu Hurejre r.a., tregon se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Allahu i bëftë rahmet atij robi që ka i falë katër reqate para ikindisë.”

Praktikimi i kësaj duke shpresuar se do të përfshihet me duanë e Resulallahut s.a.v.s., është jashtëzakonisht e lavdëruar, sepse duaja e Resulallahut s.a.v.s., pashmangshëm pranohet. Por Resulallahut s.a.v.s., këtë sunnet para ikindisë nuk e ka vazhduar sikur dy sunnetet të drekës.

4. Sunneti i akshamit,

është dy reqate pas farzit, për çka nuk ka transmetime të ndryshme. Përmendet falja e dy reqateve para farzit, në mes të ezanit dhe ikametit, që tregohet nga një grup as’habësh, si Ubejj ibn Ka’b, Ubade ibn es-Samit, Ebu

Dherr, Zejd ibn Sabit e të tjerë. Ubade, ose dikush tjetër prej tyre, ka thënë:

“Kur mujezini lexonte ezan për aksham, as’habët e Resulallahut s.a.v.s., nguteshin për të zënë ndonjë shtyllë, që të falin pas tyre dy reqate.”²⁴⁷

Dikush prej tyre ka thënë:

“I falnim dy reqate para akshamit; po të hynte dikush, do të mendonte që po falim aksham, e do të na pyeste:

- A e falët akshamin?”²⁴⁸

Kjo hyn në suaza të përgjithshme të fjalëve të Resulallahut s.a.v.s.:

“Në mes të secilit ezan e ikamet mund të falet namaz.”²⁴⁹

Ahmed ibn Hanbeli i falte këto dy reqate, dhe pasi filluan ta pasojnë në këtë, e braktisi. Kur e pyetën, tha:

“Nuk kam parë dikë që po i falë, prandaj e lashë”,
dhe gjithashtu ka thënë: ***“Nëse dikush i falë në shtëpinë e vet, ose atje ku njerëzit nuk e shohin - është e mirë.”***

²⁴⁷ Muttefekun alejhi, nga Enesi, e jo nga Ubade. Abdullah b.

Ahmed shënon në shtesat e tij në ***Musned-in*** e të atit, që Ubejj ibn Ka’b dhe Abdurrahman ibn Avf, kur perëndonte Dielli, i falnin dy reqate, para akshamit.

²⁴⁸ Muslimi nga Enesi.

²⁴⁹ *Muttefekun alejhi* nga Abdullah ibn Muhaffel.

Koha e akshamit hyn me humbjen nga shikimi të Diellit në rrafshinat që nuk janë të rrethuar me kodra. Nëse janë të rrethuara kah perëndimi, do të presë deri sa të sheh paraqitjen e errësirës nga ana lindore. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kur të hyjë terri i natës nga lindja, e kur perëndon dielli nga perëndimi, agjëruesi le të bëjë iftar!”²⁵⁰

Posaqërisht është e lavdëruar të ngutet me faljen e namazit të akshamit. Nëse vonohet, dhe e falë para humbjes së të kuqërremtës në qiell, akshami do të falej në kohë, por është e papëlqyer. Omeri r.a., një herë u vonua të falë akshamin, ylli tashmë ishte lajmëruar, prandaj e liroi një skllav.

5. Sunneti i jacisë, katër reqate pas farzit,

për të cilat Ajsha r.anha., ka thënë se Resulallahu s.a.v.s., i falte katër reqate pas jacisë, e më pas flinte.²⁵¹ Disa dijetarë islam, në bazë të gjithë këtyre transmetimeve pranuan që numri i sunneteve të rregullta ditore janë 17 reqate, bashkë me farzet: dy reqate para farzit të sabahut, katër para drekës e dy pas drekës, katër para ikindisë, dy pas akshamit, dhe tri pas jacisë së vonë, që është në fakt namazi vitri.²⁵²

²⁵⁰ *Muttefekun alejhi* në transmetimin e Omerit r.a.

²⁵¹ Ebu Davud.

²⁵² Ahmed, ndërsa Nesai nga Ajshe r.anha.:

“Falte vitr-namaz prej tri reqateve, pa i ndarë”.

Nëse i njeh hadithet që flasin për sunnet, atëherë e di se nuk ka vend për caktim të saktë të numrit sepse Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Namazi është vepra më e mirë, e kush do falë më shumë, kush do falë më pak.”²⁵³

Prandaj, secili murid do të zgjedhë numrin e reqateve të këtyre namazeve sipas dëshirës së tij sepse nga kjo që e përmendëm shihet që disa prej tyre janë më të fortë se të tjerët, ndërsa braktisja e atyre që janë të forta është jashtëzakonisht e mospëlqyer, posaqërisht për faktin se farzi plotësohet me nafile, prandaj kush nuk falë më shumë nga këto namaze do të mund t'i ndodhë që farzin të mos e ketë të plotë.

6. Namazi vitri.²⁵⁴

Enes ibn Malik thotë:

“Resulallahu s.a.v.s., e falte pas jacisë namazin vitri prej tri reqateve, duke lexuar në reqatin e parë suren Ala, në të dytin suren Kafirun, e në të tretin suren Ihlas.”²⁵⁵

²⁵³ Ahmedi, Ibn Hibban dhe Hakimi, që e konsideron të besueshëm nga Ebu Dherr.

²⁵⁴ E thamë se sipas medh'hebit Hanefi namazi vitri është *vaxhib*, e jo sunnet (sipas medh'hebit Shafi nuk ka *vaxhib*).

²⁵⁵ Ibn Adijj në biografinë e Muhammed ibn Eban, si edhe Tirmidhiu, Nesai dhe Ibn Maxhe nga Ibn Abbas me zinxhir të besueshëm të transmetuesve.

Në transmetim thuhet gjithashtu se Resulallahu s.a.v.s., pas namazit vitri do të falte edhe dy reqate ulur²⁵⁶, e në të tjera thuhet se falej këmbëkryq.²⁵⁷

Në disa hadithe përmendet që Resulallahu s.a.v.s., para se të hyjë në shtrat, i afrohej shtratit dhe aty falte dy reqate para se të shtrihet. Në to lexonte suret *Zelzele* dhe *Tekathur*²⁵⁸, e një transmetim tjetër thotë se ishte sureja *Kafirun*. Namazi vitri lejohet që të falet ndaras prej jacisë, ose bashkë me të, me një ose dy selame.

Tregohet se Resulallahu s.a.v.s., falte vitr namaz prej një²⁵⁹, tri²⁶⁰, pesë²⁶¹, e kështu gjithmonë numër tek²⁶², deri në njëmbëdhjetë²⁶³ reqate.

²⁵⁶ Muslimi, nga Ajshe r.anha

²⁵⁷ Megjithatë, më së miri është të lihet vitri si namazi i fundit i natës. Kjo sipas hadithit që e përcjellë Ibn Omeri r.a., ku thuhet: *"Namazi i fundit i një nate le të jetë vitri!"*

²⁵⁸ Bejhekiu nga Ebu Umame.

²⁵⁹ *Muttefekun alejhi* nga Ibn Omeri, e te Muslimi prej Ajshe r.anha.

²⁶⁰ Është përmendur më herët.

²⁶¹ Pjesë e transmetimit nga Ajshe r.anha., ku thuhet se Resulallahu s.a.v.s., i falte pesë reqate, dhe ulej vetëm në përfundim.

²⁶² Hadithin për namazin vitri prej shtatë reqateve e shënojnë Muslimi, Ebu Davudi, Nesai, e fjalët janë të Ajshe r.anha., ku thuhet se Resulallahu s.a.v.s., kur u plak e u dobësua, e falte namazin vitri prej shtatë reqateve, e ulej vetëm pas të gjashtit, pas të cilit ngritej, pa dhënë selam, dhe e falte namazin e shtatë. E hadithin për namaz vitri prej nëntë reqateve e shënon Muslimi nga Ajshe r.anha. si pjesë e hadithit të mëhershëm.

Transmetimi për trembëdhjetë²⁶⁴ reqate nuk është i sigurt, deri sa në hadith *shaz*²⁶⁵ përmenden edhe shtatëmbëdhjetë reqate²⁶⁶. Këto reqate, pra ajo që si tërësi e quajtëm *namaz vitri*, janë namazi i tij i natës, e që në fakt është *tehexhjud*, dhe është *sunnet-i muekkede*, e për rëndësinë e tij do të flasim në *Librin për virdet*.

Nuk ka mendim unanim se cili namaz vitri është më i vlefshmi. Sipas disave, më i vlefshmi është vitri namazi nga vetëm një reqat, sepse dihet saktë se Resulallahu s.a.v.s., vazhdimisht ka falur vitri me vetëm një reqat. Për disa, më i vlefshëm është vitri me tri reqate, sepse kështu shpëtojmë nga pasiguria e mendimeve të ndryshme, sidomos për imamin, sepse është e mundur

²⁶³ Ebu Davudi me zinxhir të besueshëm, nga Ajsha r.anha., ku thuhet: "*Falte vitri namaz prej katër reqate me tri reqate, gjashtë me tri, tetë me tri dhe dhjetë me tri...*" Muslimi, gjithashtu nga Ajsha r.anha., shënon: "*Natën i falte njëmbëdhjetë reqate*".

²⁶⁴ Është i shënuar në hadithin emëparshëm, ndërsa te Tirmidhiu dhe Nesai, nga Ummu Seleme, thuhet se Resulallahu s.a.v.s., vitrin e falte prej trembëdhjetë reqateve. Tirmidhiu mendon që është hadith i mirë. Muslimi shënon nga Ajsha r.anha.: "*Natën i falte njëmbëdhjetë reqate*", e në një transmetim shtohet: "*...me dy reqate të sunnetit të sabahut*".

²⁶⁵ *Shaz* - hadith që e përcjellë një transmetues i besueshëm, mirëpo që transmetimi i tij kundërshton një apo më shumë transmetues tjerë të besueshëm.

²⁶⁶ El-Mubarek, nga Tavus, si *mursel*.

që pas tij të falë dikush që një reqat nuk e konsideron namaz. Nëse vitrin e falë bashkë me sunnetet e jacistë, të gjitha bashkë i bën nijet si namaz vitri. Nëse kufizohet në vetëm një reqat pas dy reqateve të sunnetit të jacistë, ose pas farzit të jacistë, do ta bëj nijet për namazin e vitrit, dhe do t'i jetë i drejtë, sepse kusht për namazin vitri është të jetë tek.

Nëse namazin vitri e falë para farzit të jacistë, kjo nuk është e drejtë, pra, nuk do të arrijë vlerën e namazit vitri, që është *më i mirë se devet e kuqe*.²⁶⁷ Përndryshe, një reqat i vetëm i falun në cilën do kohë është i drejtë, vetëm se para jacistë nuk lejohet, sepse me këtë e rrënon pajtimin praktik të pasuesve të Resulallahut s.a.v.s., si edhe që para këtij reqati të vetëm nuk ka falur diçka tjetër, e që ky t'i llogaritet vitri.

Nëse synon të falë namazin vitri prej tri reqateve të ndara (2+1), është pikëpyetje se si do t'i bëj nijet dy të parat, sepse nëse i bën nijet si tehexhud ose sunnet i jacistë, atëherë ato nuk janë vitri, e nëse i bën nijet si vitri (tek), ato dy reqate në vetvete nuk janë tek, por se reqati tek falet pas tyre. Më e drejtë është të bëj nijet namaz vitri, njëjtë siç e bën nijet edhe për tri reqatet e namazit vitri që i falë bashkë. Vitri (tek) i ka dy kuptime: njëra, që në vetvete të jetë tek, dhe e dyta, që të niset

²⁶⁷ Ebu Davud dhe Tirmidhiu.

me qift, e tek e bën reqati që vjen më pas, dhe kështu totalin do ta ketë tek, dhe dy reqatet e para i ka pjesë të atij totali, ani pse a do të jenë tek varet vetëm prej reqatit që vjen më vonë.

Nëse ai është i vendosur që ato dy reqate do t'i bëj tek duke falur edhe reqatin e tretë, ai ka të drejtë që dy të parat t'i bëj nijet si vitr. Reqati i tretë është tek në vetvete, dhe i bën edhe dy reqatet tjera tek, ndërsa dy reqatet, as nuk mund t'i bëjnë tek të tjerët, as nuk janë tek në vetvete, por se tek i bën reqati tjetër.

Vitri do të duhej të jetë namazi i fundit në natë, prandaj falet pas namazit *tehexhxhud*. Për vlerën e namazit vitri dhe të *tehexhxhud* si edhe rendimin e faljes së tyre do të flitet më shumë në *Librin për renditjen e virdeve*.²⁶⁸

7. Namazi i duhasë (namazi i paraditës)

Vazhdimësia në faljen e namazit të duhasë është vepra më e vlefshme dhe më kuptimplotë. Numri më i madh i reqateve të namazit të duhasë që përmendet në transmetime është tetë. Ummu Hani, motra e Ali ibn Ebu Talib r.a., thotë se *Resulallahu s.a.v.s., falte namazin e duhasë prej tetë reqateve, të bukura e të*

²⁶⁸ Sipas medh'hebit Hanefi namazi vitri është tri reqate, nuk ka namaz me një reqat.

*gjata*²⁶⁹. Këtë numër nuk e transmeton askush tjetër. Ajsha r.anha., tregon se Resulallahu s.a.v.s., *falte katër reqate namazin e duhasë dhe i shtonte aq sa dëshironte Allahu*²⁷⁰, mirëpo nuk e ka përcaktuar atë shtesë.

Pra, Resulallahu s.a.v.s., ka falur vazhdimisht katër reqate e nuk ka falur më pak, mirëpo ka falur edhe më shumë se kaq. Në një hadith të vetmuar (*mufred*) thuhet se *Resulallahu s.a.v.s., falte namazin e duhasë prej gjashtë reqateve*.²⁷¹ Sa për kohën e faljes së tij, Alia r.a., tregon se Resulallahu s.a.v.s., falte namazin e duhasë prej gjashtë reqateve në dy kohë:

- *kur Dielli të lind e të ngritet, Resulallahu s.a.v.s., i falte dy reqate, (ky është fillimi i virdit të dytë ditor, për çka do të flitet), e kur drita e Diellit të shpërndahet dhe Dielli të jetë në çerekun e qiellit nga lindja, atëherë i falte edhe katër*²⁷².

Koha e parë është kur Dielli të ngritet për gjysmë shtize, dhe e dyta kur të kalojë një e katërta e ditës, që është e kundërta e namazit të ikindisë, sepse koha e saj është kur nga dita të mbetet një e katërta e saj.

²⁶⁹ *Muttefekun alejhi*, pa shtesën: "...të bukura e të gjata."

²⁷⁰ Shënon Muslimi.

²⁷¹ Hakimi në *Fadhu salatid-duha*, nga Xhabiri, me transmetues të besueshëm.

²⁷² Tirmidhiu, Nesai dhe Ibn Maxhe nga Alia r.a., e Tirmidhiu thotë që hadithi është i mirë.

Dreka është në gjysmë të ditës, e namazi i duhasë është në mes të lindjes së Diellit dhe zevallit, siç është, ikindia në mes të drekës dhe akshamit. Kjo është koha më e mirë. Prandaj, koha prej ngritjes së Diellit deri para zevallit është koha e namazit të duhasë.

8. Namazi evvabin (në mes të akshamit dhe jacistë)

Është një namaz që falet mes akshamit dhe jacistë dhe ky është sunnet *muekkede*. Tregohet se Resulallahu s.a.v.s., në mes të akshamit dhe jacistë falte namaz prej gjasthë reqateve.²⁷³ Ky namaz është jashtëzakonisht i vlefshëm. Thuhet se për këtë namaz flet Allahu Teala, kur thotë: **“I heqin trupat e tyre prej dyshekëve.”**

32-Sexhde: 16

Tregohet se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Kush falë namaz mes akshamit e jacistë, po falë namazin *evvabin* - namazi i atyre që pendohen dhe i mbështeten Allahut.”²⁷⁴

²⁷³ Ibn Mende në veprën *ed-Duha*, Taberani në *el-Evsat*, dhe Asgaru nga Ammar ibn Jasir me zinxhir të dobët dhe Tirmidhiu, si të dobët, nga Ebu Hurejre: *“Kush falë pas akshamit gjasthë reqate dhe nuk thotë mes dy namazeve asgjë të shëmtuar, ibadeti do t'i vlejë për dymbëdhjetë vjet.”*

²⁷⁴ Ibnul-Mubarek në *‘Er-Rekaik’*.

Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

“Në një xhami ku personi falë akshamin me xhemat e pas kësaj qëndron në xhami dhe e pret jacinë pa folur për dynallëk, lexon Kur’anin dhe falet, Allahu Teala ia ndërton dy pallate në xhennet. Secilit pallat nuk mund t’i arrihet fundi për njëqind vjet ecje, gjatësia e secilit pallat është aq sa që mund të përfshijë të gjithë banorët e dynjasë.”²⁷⁵

Për vlerat tjera të namazit *evvabi* inshallah do të flasim në *Librin për virdet*.

²⁷⁵ Ebul-Velid Saffar në ***Kitabus-salah*** nga Abdulmelik ibn Habib, që e ka marë nga Abdullah ibn Omer.

Pjesa e dytë
NAMAZET NAFILE JAVORE

Namazet nafile për secilën ditë dhe natë të javës

Do të fillojmë me ***të dielën***:

Ebu Hurejre r.a. tregon nga Resulallahu s.a.v.s.:

“Kush i falë të dielën katër reqate, e në secilin reqat lexon *Fatiha* dhe *Amene’r-resul* njëherë, Allahu Teala do t’i shkruajë vepra të mira sa ka të krishterë e të krishtere. Allahu do t’ia japë sevapin e një pejgamberi, do t’ia shkruajë haxhin e umren dhe për secilin reqat nga njëmijë namaze, e në xhennet Allahu Teala do t’i japë për secilën germë nga një qytet me misk të jashtëzakonshëm”²⁷⁶

Alia r.a., tregon se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Dëshmoni njëshmërinë e Allahut (*vehhid*) me më shumë namaz të dielave, sepse Allahu Teala është Një (*Vahid*), nuk ka partner. Kush i falë të dielave pas farzit dhe sunnetit të drekës katër reqate, në të parin lexon *Fatiha* dhe *Sexhde*, në të dytin *Fatiha* dhe *Mulk*, pastaj teshehud dhe selam, pastaj falë edhe dy reqatet tjera dhe lexon *Fatiha* dhe *Xhuma* e i lutet Allahut për çka i duhet, Allahu Teala ia plotëson kërkesën.”²⁷⁷

²⁷⁶ Ebu Musa el-Medini nga Ebu Hurejre.

²⁷⁷ Ebu Musa el-Medini.

E hënë

Xhabiri tregon nga Resulallahu s.a.v.s.:

“Ai që të hënë, pasi të zbardhet dita, i falë dy reqate dhe lexon në secilin reqat *Fatiha* një herë, *Ajetul-kursijj* një herë, suret *Ihlas*, *Felek* dhe *Nas* nga një herë, dhe kur të japë salam kërkon falje nga Allahu Teala dhjetë herë dhe i dërgon salavat Resulallahut s.a.v.s., dhjetë herë, Allahu Teala do t’ia falë të gjitha gjynahet!”²⁷⁸

Enes ibn Malik tregon nga Resulallahu s.a.v.s.:

“Kush i falë të hënë dymbëdhjetë reqate dhe në secilin reqat lexon *Fatiha* dhe *Ajetul-kursijj* nga një herë, e kur të përfundojë lexon suren *Ihlas* dymbëdhjetë herë dhe kërkon falje, dymbëdhjetë herë në ditën e Gjykimit do të thirret:

- *Ku është filani, le të ngritet dhe le ta marrë shpërblimin e tij nga Allahu Teala!*

Shpërblimi i parë që do t’i jepet është njëqind mantela dhe kurora, e atëherë do t’i thuhet:

- *Hyr në xhennet!*

²⁷⁸ Ebu Musa el-Medini, nga Xhabiti.

e do ta presin njëqind mijë melekë, secili me nga një dhuratë për të, dhe do ta shoqërojnë deri sa t'i vizitojë njëmijë pallatet e tij, që ndriçojnë nur.”²⁷⁹

E martë

Jeziid Rekashi tregon nga Enes ibn Malik se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Kush falet të martën në mesditë²⁸⁰ dhjetë reqate dhe lexon në secilin reqat *Fatiha* dhe *Ajetul-kursijj* nga një herë dhe suren *Ihlas* tri herë, nuk do t'i shkruhet asnjë gjynah për shtatëdhjetë ditët e ardhshme, nëse vdes brenda atyre shtatëdhjetë ditëve, do të vdesë si shehid, dhe do t' falen gjynahet e shtatëdhjetë viteve.”²⁸¹

E mërkurë

Ebu Idris Halvani tregon nga Muadh ibn Xhebel r.a., se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Kush i falë të mërkurën dymbëdhjetë reqate kur të zbardhë dita, dhe lexon në secilin reqat *Fatiha* dhe

²⁷⁹ Ebu Musa el-Medini.

²⁸⁰ në transmetim tjetër: **“kur të zbardhë dita...”**.

²⁸¹ Ebu Musa el-Medini me zinxhir të dobët të transmetuesve.

Ajetul-kursijj një herë, ndërsa suret ***Ihlas, Felek*** dhe ***Nas*** nga tri herë, telalli do të thërret nën Arsh:

- O rob i Allahut, nis nga fillimi të punosh, sepse të gjitha gjynahet tua prej më herët të janë falur, Allahu Teala të ka çliruar nga mundimi i varrit, vështirësitë dhe errësira, dhe të ka shpëtuar nga tmerret e kiametit. Për shkak të asaj dite, Allahu barazoi veprimin tënd me punët e peygamberëve.²⁸²

E enjte

Ibn Abasi tregon se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Ai që të enjten mes drekës dhe ikindisë falë dy reqate, në të parin lexon *Fatiha* dhe *Ajetul-kursijj* njëqind herë, e në të dytin *Fatiha* dhe *Ihlas* njëqind herë dhe i dërgon salavat Muhammedit s.a.v.s. njëqind herë, Allahu Teala do t’i japë sevapin e atij që ka agjëruar muajin Rexhep, Sha’ban dhe Ramazan, do ta ketë shpërblimin e haxhilerëve në shtëpinë e Allahut, dhe do t’i shkruhen aq vepra të mira sa ka të tillë që e besojnë Allahun Teala dhe që mbështeten në Të.”²⁸³

²⁸² Ebu Musa el-Medini.

²⁸³ Ikrimenga Ibn Abbas, te Ebu Musa el-Medini me zinxhir shumë të dobët të transmetuesve.

E premtë

Alia r.a. ka treguar që Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“E gjithë xhumaja është namaz e ibadet, e robit që zgjohehet kur dielli ngritet një shtizë a më shumë e ndriçon, merr abdes mirë e falë dy reqate duha namaz, me besim në Allahun dhe me shpresë për shpërblim nga Ai, Allahu Teala ia shkruan dyqind sevape dhe ia fshinë dyqind gjynahe. Kush i falë katër reqate, Allahu Teala e ngritë në xhennet për katërqind gradë. Kush i falë tetë, Allahu Teala e ngritë në xhennet për tetëqind gradë dhe ia falë gjynahet. Kush i falë dymbëdhjetë reqate, Allahu Teala ia shkruan dymijë e dyqind sevape, e ia fshinë dymijë e dyqind gjynahe, dhe e ngritë në xhennet për dymijë e dyqind gradë.”²⁸⁴

Nafiu tregon nga Ibn Omeri r.a., që Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Kush hyn ditën e xhumasë në xhami dhe i falë katër reqate para namazit të xhumasë dhe në secilin reqat lexon *Fatiha* dhe *Ihlas* pesëdhjetë herë, nuk do të vdesë pa e parë ose pa iu shfaqur vendi i tij në xhennet.”²⁸⁵

²⁸⁴ Nuk është gjetur burimi.

²⁸⁵ Darekutni.

E shtune

Ebu Hurejre tregon që Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Kush i falë ditën e shtunë katër reqate dhe lexon në secilin reqat *Fatiha* një herë dhe *Ihlas* tri herë, e kur të përfundojë lexon *Ajetul-kursijj*, Allahu Teala do t’ia shkruajë për secilën germë nga një haxh dhe umre. Për secilin germë do t’ia ngritë shpërblimin vjetor sikur të atij që agjëron ditën, e falet natën. Allahu Teala do t’i japë gjithashtu, për secilin germë, sevapin e shehidit dhe do të jetë në flladin e Arshit të Allahut bashkë me pejgamberët dhe shehidët.”²⁸⁶

²⁸⁶ Ebu Musa el-Medini.

Namazet nafile të netëve

Nata e së dielës

Enes ibn Malik tregon që Resulallahu s.a.v.s., për natën e së dielës²⁸⁷ ka thënë:

“Ai që natën e së dielës falë njëzet reqate dhe në secilin reqat lexon *Fatiha* dhe *Ihlas* pesëdhjetë herë, dhe *Felek* e *Nas* nga një herë, dhe kërkon falje nga Allahu Teala për vete dhe për prindërit e tij njëqind herë, i dërgon salavat Resulallahut s.a.v.s., njëqind herë dhe thotë:

**- *La havle vela kuvvete illa billahil-alijjil-azim;*
pas së cilës do të thotë:**

- *Dëshmoj që Ademi a.s., është krijesë e Allahut dhe rob halis “Sefijji”, Ibrahimimi a.s., është halilullah, Musa a.s., kelimullah, Isa a.s., ruhullah dhe Muhammedi a.s., habibullah;*

do të ketë sevap aq sa ka të tillë që Allahut i përshkruajnë fëmijë, dhe të tillë që dëshmojnë se Allahu nuk ka fëmijë. Allahu Teala do ta ngjallë në ditën e Gjykimit me të shpëtuarit dhe meriton të hyjë në xhennet, bashkë me peygamberët.”²⁸⁸

²⁸⁷ Në islam, dita fillon pas ikindisë së ditës së mëhershme, prandaj nata në ardhje i takon ditës që po vjen.

²⁸⁸ Nuk është gjetur burimi.

Nata e së hënës

“Ai që natën para të hënës falë katër reqate dhe lexon në reqatin e parë *Fatiha* dhe *Ihlas* dhjetë herë, në të dytin njëzet herë, në të tretin tridhjetë herë, e në të katërtin katërdhjetë herë, e atëherë jep selam dhe lexon suren *Ihlas* shtatëdhjetë e pesë herë, dhe kërkon falje nga Allahu Teala për vete dhe për prindërit e vet shtatëdhjetë e pesë herë, e pas kësaj kërkon nga Allahu për atë që ka nevojë, Allahu Teala ia jep të gjitha ato që i kërkon.”²⁸⁹

Ky namaz quhet *salatul-haxhe* (namazi për nevojë).

Nata e së martes

“Kush i falë dy reqate e në secilin reqat lexon *Fatihane* dhe suret *Ihlas*, *Felek* dhe *Nas* nga pesëmbëdhjetë herë, e pas selamit lexon *Ajetul-kursijj* pesëmbëdhjetë herë, e pastaj kërkon faljen prej Allahut pesëmbëdhjetë herë, do të ketë shpërblim të madh dhe dobi që nuk mund t’i caktohet vlera.”²⁹⁰

Omeri r.a. tregon se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Kush i falë në natën e së martes dy reqate dhe lexon në secilin reqat *Fatihane* një herë e suret *Kadr*

²⁸⁹ Ebu Musa el-Medini.

²⁹⁰ Ebu Musa, pa zinxhir të transmetuesve, nga autorët tjerë. Me sened e përmend nga Ibn Mesud dhe Xhabiri, e aty thuhet se falen katër reqate.

dhe *Ihlas* nga shtatë herë, Allahu Teala do ta lirojë nga xhehenemi dhe në ditën e Gjykimit ky namaz do t'i bëhet udhëheqës dhe drejtues për në xhennet.”²⁹¹

Nata e së mërkures

Fatime r.a., tregon se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Kush i falë në natën e së mërkures dy reqate, e në të parin lexon *Fatiha* dhe *Felek* dhjetë herë, e në të dytin pas *Fatihës* suren *Nas* dhjetë herë, e pas selamit kërkon falje (*istigfar*) prej Allahut dhjetë herë dhe i dërgon salavat Muhammedit s.a.v.s., dhjetë herë, nga secili qiell lëshohen shtatëdhjetë mijë melekë, që këtij i shkruajnë sevape, deri në ditën e Gjykimit.”²⁹²

Në transmetim tjetër, thuhet:

“...gjashtëmbëdhjetë reqate, në të parin lexon *Fatihane*, një sure e pastaj suren *Ihlas* dhjetë herë, në të dytin *Fatihane*, një sure, pastaj *Ajetul-kursij* dhjetë herë, do t'i pranohet shefati për gjashtëmbëdhjetë anëtarë të familjes së vet që e kanë merituar xhehenemin.”²⁹³

²⁹¹ Nuk është gjetur burimi.

²⁹² E kemi gjetur vetëm transmetimin nga Xhabiri për namaz prej katër reqateve në këtë natë, që e shënon Ebu Musa Medini, e në transmetim nga Enesi thuhet... *tridhjetë reqate*.

²⁹³ Nuk është gjetur burimi.

Fatime r.a., tregon që Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Ai që natën e së mërkures falë gjashtë reqate dhe lexon në secilin reqat pas Fatihasë:

- *Kulillahumme malikel-mulki...*(3-Ali Imran: 26)

(O Allah, Zotërues i gjithë Pushtetit!),

e pas përfundimit të namazit thotë:

- *Xhezallahu Muhammeden anna ma huve ehlulh*

(Allahu e shpërbleu Muhammedin mes nesh, me atë që e meritoi),

do t’i falen gjynahet e shtatëdhjetë viteve, dhe do t’i shkruhet çlirimi nga Zjarri.”²⁹⁴

Nata e së enjtes

Ebu Hurejre r.a., thotë që Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Ai që para të enjtes në mes të akshamit dhe jacisë i falë dy reqate e në secilin reqat lexon *Fatihane* dhe *Ajetul-Kursij* pesë herë, edhe *Ihlas* pesë herë, edhe suret *Felek* dhe *Nisa* nga pesë herë, e kur të përfundojë namazin kërkon prej Allahut Teala falje pesëmbëdhjetë herë, e sevapet e kësaj i bën nijet për prindërit, e ka përmbushur obligimin e vet ndaj prindërve, edhe nëse ka qenë i padëgjueshëm ndaj tyre, dhe ngrihet në gradën e sidikkëve dhe shehidëve.”²⁹⁵

²⁹⁴ Ebu Musa Medini me zinxhir shumë të dobët të transmetuesve

²⁹⁵ Ebu Musa dhe Ebu Mensur.

Nata e së premtes

Nga Xhabiri përcjellet se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Ai që para të premtes në mes të akshamit e jacisë i falë dymbëdhjetë reqate, dhe lexon në secilin reqat *Fatihane* një herë dhe *Ihlas* njëmbëdhjetë herë, sikur t’i ketë bërë Allahut Teala ibadet për dymbëdhjetë vite duke agjëruar ditën e duke falë namaz natën.”²⁹⁶

Enesi thotë që Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Ai që para të premtes falë jacinë me xhemat, më pas dy reqate sunnet, e pastaj i falë dhjetë reqate e në secilin reqat lexon *Fatiha*, *Ihlas*, *Felek* dhe *Nas* nga një herë, e pas kësaj falë vitr-namaz prej tri reqateve dhe fle në krahun e djathtë me fytyrë kah kibla, sikur të ketë arritur ibadetin e *Lejletul-kadr*”²⁹⁷

E Resulallahu s.a.v.s., gjithashtu thotë:

“Dërgoni shpesh salavate mbi mua në natën e vlerësuar dhe në ditën e mrekullueshme; natën para të xhumasë dhe ditën e xhumasë.”²⁹⁸

²⁹⁶ Nuk është gjet buri mi.

²⁹⁷ Nuk është gjet buri mi.

²⁹⁸ Taberani në *‘Evsat’* nga Ebu Hurejre.

Nata e së shtunes

Enesi përcjellë që Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Ai që para të shtunes në mes të akshamit dhe jacisë i falë dymbëdhjetë reqate, do t’i ndërtohet një pallat në xhennet, dhe sikur t’ju ketë ndarë sadaka të gjithë besimtarëve dhe sikur të ketë hequr dorë nga të gjithë çifutët. Allahu e merr përsipër obligimin për ta falur.”²⁹⁹

²⁹⁹ Nuk është gjetur burimi.

Pjesa e tretë
NAMAZET NAFILE VJETORE

Janë katër: namazi i Bajramit³⁰⁰, namazi i taravisë, namazi i muajit Rexhep dhe namazi i muajit Shaban.

Namazi i Bajramit

Namazi i Bajramit është sunnet *muekkede* dhe një nga simbolet e islamit, prandaj duhet pasur kujdes në këto shtatë pika:

1) Leximi i tekbirit në rend tri hërë, e do të thotë:

Allahu ekber, Allahu ekber, Allahu ekber kebiren, vel-hamdu lilahi kesiren, ve subhanallahi bukreten ve esila. La ilahe ilallahu vahdehu, la sherike leh, muhlisine lehud-dine, ve lev kerihel-kafirun

(Allahu është më i madhi, Allahu është më i madhi, Allahu vërtetë është më i madhi. Shumë falënderime Allahut, dhe i Lavdëruar qoftë Ai, në mëngjes e mbrëmje. Nuk ka zot pos Allahut, të Vetmit, Ai nuk ka partnerë. Ne jetojmë fenë e Tij të singertë, edhe nëse nuk e pëlqejnë pabesimtarët).

³⁰⁰ Sipas medh'hebit Hanefi namaziti bajramit është *vaxhib* (obligim) e jo sunnet. Kushtet e namazeve të bajramit janë si kushtet e namazit të xhumasë. Por këtu hytbeja është sunnet dhe lexohet pas namazit.

Do të fillojë me këtë tekbir para Bajramit të madh (pas Ramazanit), e deri te fillimi i faljes së namazit të Bajramit,³⁰¹ e në Kurban Bajram do të fillojë me leximin e tekbirit pas namazit të sabahut, në ditën e Arafatit e deri te fundi i ditës së 13 të muajti Dhul-hixhret.³⁰² Ky është mendimi më i pranuar. Do të bëj tekbir pas namazit farz dhe pas nafileve, por pas farzit është më i domosdoshëm;

2) Në ditën e Bajramit, me sabah lahet, zbukurohet e parfumoset, vesh rrobat më të bukura, siç e përshkruam te xhumaja. Mëndafsh mos të veshin as fëmijët, dhe gratë të mos zbukurohen para daljes jashtë;

3) Të shkojë kah një rrugë, e të kthehet kah tjetra, siç vepronte Resulallahu s.a.v.s.³⁰³, dhe urdhëronte që edhe gratë të vijnë në namaz;³⁰⁴

³⁰¹ Sipas medh'hebit Hanefi gjatë rrugës për në namazin e Bajramit të madh, thotë tekbiret në heshtje.

³⁰² Në Kurban Bajram lexon tekbirin pas namazit të sabahut, deri në namazin e ikindisë të ditës së katërt të bajramit. Pas namazeve farz dhe rrugës në namaz këndohet tekbiri me zë.

³⁰³ Muslimi, nga Ebu Hurejre.

³⁰⁴ *Muttefekun alejhi* nga Ummu Atijje.

4) Lavdërohet falja në *namazgah* (ambient të hapur), pos në Meke e Kuds, e nëse është ditë me shi, mund të falet në xhami. Në ditë të kthjellët imami mund të urdhërojë dikë që për të dobëtit të falë namaz në xhami, e ai me të tjerët të dalë në ambient të hapur;

5) Të ketë kujdes për kohën. Koha e namazit të Bajramit është nga lindja e Diellit deri në zevall³⁰⁵, e koha e faljes së Kurban Bajramit është nga koha kur dielli ngritet, aq sa zgjasin dy hutbe e dy reqate, dhe deri në fund të ditës së 13 Dhul-hixhxhret. Është e lavdëruar të ngutet me faljen e namazit të Kurban Bajramit për shkak të therjes së kurbanit, e të ngadalsojë me namazin e Fitr Bajramit, që të ndahet *sadakatul-fitr* para namazit. Ky është sunnet i Resulallahut s.a.v.s..³⁰⁶

6) Mënyra e faljes.

Njerëzit do të nisen për në xhami duke bërë tekbir, e kur imami të vjen te *musalla*, nuk ulet as nuk falë nafile, e edhe të tjerët do të ndërprejnë nafilet e tyre. Atëherë dikush do të thotë me zë:

- *Falje e përbashkët e namazit!*

³⁰⁵ Sipas medh'hebit Hanefi, koha e namazit të Bajramit është nga momenti kur dielli të zbardhë dhe të ndahet nga horizonti për një shtizë, dhe vazhdon gati deri në namaz të drekës.

³⁰⁶ Shafiu, nga Ebul-Huvejris si mursel.

Imami më pas do t'i udhëheqë në faljen e dy reqateve. Përpos tekbirit hyrës për ruku, do të bëj edhe shtatë tekbirë tjerë³⁰⁷. Në mes të çdo dy tekbirëve, do të thotë:

Subhanallahi, vel-hamdu lilahi, ve la ilahe ilallahu, vallahu ekber

(Lavdi Allahut, falënderimet Allahut, dhe nuk ka zot pos Allahut, Allahu është më i madhi).

Leximin e eudhubilahut do ta shtyejë deri pas tekbirit të tetë. Suren *Kaf* do ta lexojë në reqatin e parë, pas Fatihasë, ndërsa suren *Kamer* në të dytin. Tekbire shtesë në reqatin e dytë përpos atij për ngritje dhe për ruku, janë shtatë. Në mes të çdo dy tekbirëve do të veprojë ashtu siç thamë. Pas kësaj do të mbajë dy hutbe, në mes të cilave qëndron ulur. Atij që i ikë namazi i Bajramit, do ta falë *kaza*; ³⁰⁸

³⁰⁷ Sipas medh'hebit Hanefi, takbiret shtesë në namaz të Bajramit janë vaxhib dhe janë 6, jo 12. Për më shumë, shih fundin e këtij libri.

³⁰⁸ Sipas medh'hebit Hanefi, si individ nuk e falë namzin e Bajramit kaza.

7) Të therret një dele.

Resulallahu s.a.v.s., i theri dy deshë të larëm. I theri me dorën e vet, duke thënë:

Bismilah, vallahu ekber, haza anni ve ammen lem judahhi min ummeti!

(Në emër të Allahut, Allahu është më i madhi, kjo është nga unë dhe nga ai prej ummetit tim që nuk ka therë kurban!).³⁰⁹

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kush e ka kurbanin e përgatitur për therje, kur të del hëna e dhul-hixhës, të mos qethet, as mos t’i prejë thonjtë, derisa ta kryejë therjen (në ditën e Bajramit).”³¹⁰

Ebu Ejjub Ensari thotë:

“Në kohën e Resulallahut s.a.v.s., njerëzit prenin kurban për familjet e tyre dhe e hanin, e i ushqenin edhe të tjerët.”³¹¹,

³⁰⁹ *Muttefekun alejhi*, nga Enesi, pa pjesën: **“anni ve ammen lem judahhi min ummeti”**, por kjo shtesë gjendet te Ebu Davudi dhe Tirmidhiu, nga Xhabiri, e Tirmidhiu thotë që është hadith *garib* dhe me zinxhir të këputur të transmetuesve (*munkati*).

³¹⁰ Muslimi, nga Ummu Seleme.

³¹¹ Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe, si të besueshëm (*hasen-sahih*).

pra, ka të drejtë të hajë nga kurban i vet edhe pas tri ditësh a më shumë. Edhe pasi një herë ishte e ndaluar, më pas u lejua, si lehtësim.

Sufjan Sevriu thotë:

“Është e lavdëruar që pas namazit të Bajramit të falen dymbëdhjetë reqate, e pas namazit të Kurban Bajramit, gjashtë reqate”,

dhe tregon se ky është sunnet³¹².

Namazi i taravisë

Ky namaz i ka njëzet reqate, dhe mënyra e faljes është e njohur. Është sunnet *muekkede*, sado që s’është sunnet i fortë si namazi i Bajramit. Ulemaja është e ndarë për atë se a është më mirë të falet në xhemat, apo vetëm. Resulallahu s.a.v.s., dy apo tri netë erdhi në mesxhid dhe iu fali namazin e taravisë, por pastaj nuk erdhi dhe tha:

“Frikësohem të mos ju bëhet juve obligim!”³¹³

³¹² Në burime nuk është gjetur si sunnet. Bile, në hadith të besueshëm përmendet që Resulallahu s.a.v.s., nuk është falur para namazit të Bajramit, as pas tij. Nuk ka mendim të përbashkët për fjalët e taibinëve se ky është sunnet, e fjalët e gjeneratave pas taibinëve, llogariten si *maktuh* (baraz me fjalët e zakonshme të taibinëve).

Omeri r.a., ka fillloi të falë taravinë me xhemat, sepse ishte i sigurt që nuk mund të bëhet obligim, me qenë se shpallja kishte përfunduar. Thuhet se falja në xhemat ka më shumë vlerë, për shkak të veprimit të Omerit r.a., sepse tubimi është bekim dhe e ka mananë e vet, për çka tregon edhe hadithi për faljen e namazit me xhemat, e gjithashtu edhe për faktin se te falja i vetëm njeriu mund të dembeloset, deri sa kur e sheh shumicën, aktivizohet. Të tjerët thonë se falja vetëm është më me vlerë, sepse është sunnet, e namazi i taravisë nuk është një nga simbolet e fesë, siç është namazi i Bajramit, prandaj duhet të pranohet si namaz *duha* dhe si *tehijjetul-mesxhid*, e këto falen vetëm. Ka ndodhur që në xhami të hynë bashkë një grup i myslimanëve, e nuk do të falnin *tehijjetul-mesxhidin* me xhemat. Edhe Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Përparësia e namazit nafile në shtëpi ndaj namazit në xhami është sikur përparësia e farzit në xhami ndaj farzit në shtëpi.”³¹⁴

³¹³ *Muttefekun alejhi*, nga Ajshe r.anha.

³¹⁴ Adem ibn Ebi Ijas në *Kitabus-sevab* nga Damr ibn Habib, si mursel. Ibn Ebu Shejb në *el-Musannef* nga Damr ibn Habib, e ky nga një as’habi i Resulallahut s.a.v.s., si *mekruf* (fjalët e as’habit). Në **Sunnen-in** e Ebu Davudit, me zinxhir të besueshëm të transmetuesve nga Zejd ibn Sabit, ku thuhet: **“Namazi që personi e falë në shtëpinë e vet i është më me vlerë se namazi që e falë në këtë xhaminë time, përpos farzeve.”**

E duke iu mbështetur hadithit:

“Namazi në këtë xhaminë time është më me vlerë se njëqind namaze në xhamitë tjera, e namazi në Mesxhidul-haram është më me vlerë se njëmijë namaze të falura në xhaminë time, e me më shumë vlerë se të gjitha këto është kur personi i falë në qoshin e shtëpisë së vet dy reqate për të cilat e di vetëm Allahu Teala.”³¹⁵

Dijetarët janë pajtuar se falja individuale është më me vlerë. Kjo për faktin se në xhemat mund të jetë dyfytërësh e të aktrojë, por në vetmi nuk ka një rrezik të tillë.

Kjo është ajo që është thënë për namazin e taravisë. E megjithatë, mendim dominues është që falja e namazit të taravisë me xhemat është më e mirë, ashtu siç veproi Omeri r.a., si dhe për faktin që për disa namaze nafile kërkohet xhemat, e namazi i taravisë

³¹⁵ Ebush-Shejh në *es-Sevab*, nga Enesi, në këtë formë: **“Namazi në xhaminë time vlenë 10 mijë namaze, namazi në Mesxhidul-haram vlenë 100 mijë namaze, e namazi në zonën kufitare vlenë 2 milion namaze, e më shumë se të gjitha këto janë dy reqate që robi i Allahut i falë në natën e vonë, e të cilin e sheh vetëm Allahu Teala.”** Zinxhirin e transmetuesve e ka të dobët. Ebul-Velid es-Saffar në *Kitabus-salah* e përmend duke u ndërlidhur me transmetimin e Evzait, ku thuhet: *“Hyra te Jahja e ma përmendi një hadith...”*, me atë që për të parin thotë njëmijë e për të dytin njëqind reqate.

përshtatet të jetë një nga simbolet që bëhen me xhemat. Përmendja e dyfytyrësisë në xhemat dhe mbrojtja nga dyfytyrësia e dembelosja në vetmi, nuk kanë të bëjnë asgjë me vlerën e xhematit. Kjo do të ishte sikur të thuhet:

- *Më mirë të falet namazi me dembeli, se sa mos të falet fare; ose të thuhet:*

- *Falja e sinqertë është më e mirë se ajo me dyfytyrësi;*

Këtë çështje mund ta shikojmë nga një perspektivë tjetër, e të themi: le ta paramendojmë rastin e atij që është i sigurt në veten se nuk do të dembelohet kur falë vet e as që do të jetë dyfytyrësh kur merr pjesë në falje me xhemat, cila është më me vlerë për të?

Kur të krahasohet vlera e namazit me xhemat me sinqeritetin e shtuar dhe me qetësinë e zemrës në vetmi, do të shfaqet ngurrim në preferimin e njëjës mbi tjetrën.

Është e lavdërueshme të lexohet duaja e Kunutit në namazin vitri të taravisë, në gjysmën e dytë të Ramazanit.³¹⁶

³¹⁶ Sipas medh'hebit Hanefi, leximi i duasë së Kunutit në namazin vitri është vaxhib dhe lexohet vazhdimisht.

Namazi në muajin Rexhep

Me një varg transmetuesish tregohet nga Resulallahu s.a.v.s., të ketë thënë:

“Secili që agjëron të Enjten e parë të muajit Rexhep, e më pas në mes të akshamit e jaxisë ose mes jaxisë dhe pjesës së tretë të natës i falë dymbëdhjetë reqate, duke ndarë çdo dy reqate me selam, dhe lexon në secilin reqat suren *Fatiha* një herë, suren *Kadr* tri herë dhe *Ihlas* dymbëdhjetë herë, e kur të përfundojë namazin më dërgon salavat mua shtatëdhjetë herë, duke thënë:

- *Allahumme sali ala Muhammedininnebijjil-umijji ve ala alih*

(O Allah, bekoje Muhammedin, peygamberin, që nuk e përdori shkrimin, dhe familjen e tij), e pas kësaj bën sexhde dhe sa është në sexhde thotë shtatëdhjetë herë:

- *Subhhuhun, kuddusun, Rabbul-melaiketi ver-ruhi*

(i Lartësuari, i Pastri nga çdo e metë, Rabb i melekëve dhe Xhebrailit), e pastaj e ngritë kokën dhe shtatëdhjetë herë thotë:

- *Rabbigfir, ve erham, ve texhavez amma ta'lem, inneke entel-eadhul-ekrem*

(O Rabb, më fal, bëj rahmet dhe fali ato që Ti i di, sepse Ti je i Dinjitetshëm dhe Fisnik), e pastaj prapë bie

në sexhde dhe lexon njëjtë sikur në sexhden e parë, dhe sa është në sexhde kërkon nevojën e vet – do t'i plotësohen nevojat.”³¹⁷

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kush e falë këtë namaz, Allahu Teala ia falë të gjitha gjynahet qofshin edhe sa shkuma e detit, sa zalli, të rënda sa malet, ose të shumta sa gjethet, dhe e bën shefatxhi për 700 akriba të tij që kanë merituar xhehenemin.”

Ky namaz është *mustehab*, por e kemi përmendur në këtë vepër sepse ai përsëritet çdo vit, ani pse grada nuk i arrinë gradën e taravisë ose namazit të Bajramit. Këtë namaz e kanë përcjellë individët. E megjithatë unë i kam parë banorët e Kudsit se si të gjithë rregullisht e falin e nuk lejojnë të braktiset ky namaz, prandaj edhe më pëlqeu ta përmend.

Namazi në muajin Sha’ban

Ka të bëjë me natën e pesëmbëdhjetë të Sha’banit. Falen njëqind reqate, në çdo dy reqate jepet selam. Në secilin reqat pas *Fatihës* lexohet surja *Ihlas* 11 herë, e

³¹⁷ Hadithi flet për *Salatur-regaib*, që e përmend Rezini në librin e vet, e hadithi është i pavërtetuar.

nëse dëshiron, do të falë dhjetë reqate dhe të lexojë në secilin reqat pas *Fatihës* njëqind herë suren *Ihlas*. Edhe ky namaz na është transmetuar bashkë me të tjerët. Gjeneratat e para, (*selef-i salihin*) e falnin këtë namaz dhe e quajtën *salatur-hajr* (namazi i hajrit), bile mblidheshin, kur ishte mundësia, dhe e falnin me xhemat.³¹⁸

Transmetohet nga Hasan Basriu të ketë thënë:

“Tridhjetë as’habë të Resulallahut s.a.v.s., më kanë treguar se atij që e falë këtë namaz në këtë natë, Allahu e shikon shtatëdhjetë herë dhe me secilin shikim ia hjekë shtatëdhjetë telashe. Më e vogla prej tyre është falja e gjynaheve”³¹⁹

³¹⁸ Sipas medh’hebit Hanefi, përveç namazit të taravisë, asnjë namaz tjetër sunnet nuk falet me xhemat.

³¹⁹ Ibn Maxhe nga Alia r.a., në këtë formë:

“Kur të hyjë nata e pesëmbëdhjetë e Shabanit, kalojeni në ibadet, e ditën agjërojeni”.

Pjesa e katërt

NAMAZET NAFILE QË NDËRLIDHEN ME SHKAKTARË, JO ME KOHË

Janë nëntë: namazi me rastin e zënies së Diellit (*Kusuf*) dhe Hënës (*Husuf*), namazi për shi (*istiska*), *tehijjetul-mesxhid*, dy reقاتet pas abdesit, dy reقاتe në mes të ezanit dhe ikametit, dy reقاتe para daljes nga shtëpia, dy reقاتe kur hyn në shtëpi, por edhe të tjera.

1. Namazi me rastin e zënies së *Diellit* (*Kusuf*) dhe *Hënës* (*Husuf*)

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Padyshim që Dielli dhe Hëna janë dy dëshmi të madhështisë së Allahut, dhe nuk errësohen për vdekjen apo jetën e askujt. Prandaj, kur ta shihni këtë, ngutuni të përmendni Allahun e të falni namaz.”³²⁰

Kjo ka ndodhur kur Resulallahut s.a.v.s., i vdiq i biri Ibrahim, dhe Dielli u zu, e njerëzit filluan të thonë:

- U zu Dielli për shkak të vdekjes së Ibrahimit.”

Të shohim si falet ky namaz dhe në cilën kohë:

³²⁰ Buhariu dhe Muslimi nga Mugir ibn Shu'b.

Kur Dielli ose Hëna të errësohet, pa marrë parasyshtë a është kohë e papëlqyer për namaz apo jo, thirren njerëzit të mblidhen dhe imami falë me xhemat në xhami dy reqate. Këto dy namaze nuk kanë ezan as ikamet. Në secilin reqat bëhen dy *ruku*, e para më e gjatë. Lexon heshtur në reqatin e parë *Fatiha* dhe *Bekare*, në të dytin *Fatiha* dhe *Alu Imran*, në të tretin *Fatiha* dhe *Nisa*, në të katërtin *Fatiha* dhe Maide, ose sure tjera të gjata. Qëllim i leximit të sureve më të gjata është zgjatja e namazit deri në fund të errësimit. Në tesbihun e rukusë së parë qëndron aq sa të mund të lexohen njëqind ajete, në të dytin sa të lexohen tetëdhjetë, në të tretin shtatëdhjetë, e në të katërtin pesëdhjetë ajete. Le të jenë edhe sexhdet në secilin reqat të gjata sa rukuja. Pas namazit i mbanë dy hutbe, me pak pushim mes tyre. I urdhëron njerëzit të japin sadaka e të lirojnë skllavin. Njëjtë edhe te errësimi i Hënës, pos që lexon me zë, meqë është namaz i natës. Koha e namazit për shkak të errësimit të Diellit është nga fillimi i errësimit deri sa të përfundojë, e përfundon kur të duket Dielli. Koha e namazit për shkak të errësimit të Hënës kalon me lajmërimin e harkut të Diellit, sepse atëherë përfundon dominimi i natës, por nuk ndalon nëse Hëna duket gjatë errësimit, sepse Hëna e mbizotëron natën.

Nëse errësimi ndalon gjatë namazit, e përfundon shpejt. Kush e arrin imamin në rukunë e dytë, reqati i ka kaluar, sepse rukuja e parë është kryesorja.³²¹

2. Namazi për shi (istiska)

Kur lumenjtë të shterren, të mos bjerë shi e kanalet të thahen, është e lavdërueshme që imami t'i urdhërojë njerëzit që fillimisht të agjërojnë tri ditë, të japin sadaka sipas mundësisë, të ndalojnë padrejtësitë e të pendohen për gjynahet, dhe më pas, në ditën e katërt të dalin në fushë të gjerë, me përlësi dhe modesti, bashkë me imamin, meshkujt, gra, pleq e fëmijë, me rroba të vjetra por të pastra, për dallim nga Bajrami. Thonë se është e lavdërueshme të nxjerren jashtë edhe kafshët shtëpiake, sepse edhe ato kanë nevojë të njëjtë, e në bazë të fjalëve të Resulallahut s.a.v.s.:

“Po të mos kishte foshnje në gji, pleq të kërrusur dhe bagëti që kërkon bar në livadh, dënimi do t’ju godiste plotësisht.”³²²

³²¹ Sipas medh’hebit Hanefi, këto dy namaze (*Kusuf dhe Husuf*) përbëhen prej dy reqateve. Këto namaze lejohet të falen edhe vet. Edhe nëse falen me xhemat, hutbeja nuk lexohet, falen me njet si namazet nafile dhe nuk janë dy ruku. Pas namazit, imami kthehet në drejtim të xhematit dhe bën duanë deri në fund të errësimi.

³²² Bejhekiu nga Ebu Hurejre.

Nëse dalin edhe ata që janë nën mbrojtje të myslimanëve³²³ bashkë me myslimanë, nuk ndalohen.

Kur të mblidhet xhemati në fushë të hapur, do të thirret *falje e përbashkët e namazit*, dhe imami do t'i falë me ta dy reqate, si në namazin e Bajramit por pa tekbir. Pas kësaj do t'i mbajë dy hutbe, me pauzë të shkurtë në mes. Pjesa më e madhe e hutbes le të jetë për kërkim-falje (*istigfar*). Kah mesi i hutbes së dytë do të duhej të kthehet me shpinë kah njerëzit e me fytyrë kah kibra, e në atë moment ta kthejë mbrapsht mantelin e vet, duke mbajtur ymyt për ndyshim të mirë të gjendjes. Kështu vepronte Resulallahu s.a.v.s.³²⁴, dhe pjesën e sipërme të mantelit e kthente poshtë e ajo që ishte në të djathtë dilte në anën e majtë, ndërsa pjesa e majtë dilte në të djathtën. Njëjtë do të vepronë edhe të pranishmit. Në atë kohë, të gjithë lexojnë duanë në vete. Më pas imami kthehet kah njerëzit dhe lexon duanë (transmetuar nga Imam Shafiu):

O Allah, vërtetë që Ti na ke urdhëruar duanë dhe na ke premtuar se do të na përgjigjesh. Ne po bëjmë dua ashtu siç na ke urdhëruar, prandaj na u përgjigj ashtu siç na ke premtuar Ti. O Allah, na i fal gabimet që i kemi bërë, na jep shiun dhe furnizim të bollshëm.

³²³ *Zimmi*: taksapaguesi i krishterë ose çifut, qytetar i shtetit islam. Për daljen e tyre në dua ka mendime të ndryshme.

³²⁴ Buhariu dhe Muslimi nga Abdullah ibn Zejd Mazenij.

Me këtë dua e përfundon hutben. Ata që kanë filuar të agjërojnë, nuk ka dëm të bëjnë dua në fund të namazeve gjatë tri ditëve, para daljes në namaz të shiut, e duaja i ka rregullat e sjelljes dhe kushtet e brendshme, siç janë pendimi, pagesa e borxheve e të ngjashme, për çka do të flasim më shumë në *Librin për duatë*.

3. Namazi i xhenazes³²⁵

Mënyra si falet namazi i xhenazes është e njohur. Njëra nga duatë më përmbajtësore nga tradita është ajo që përmendet në *Sahih* nga Avf ibn Malik, ku thuhet:

“E kam parë Resulallahun s.a.v.s., si falë xhenazen, e nga duaja e tij kam mbajtur në mend:

Allahummagfir lehu, verhamhu, ve afihi, va’fu anhu, ve ekrim nuzlehu, ve vessi medhalehu, vagsilhu bil-mail ves-selxhi, vel-berdi, ve nekkihi minel-hataja kema junekkas-sevbul-ebjedu mined-denes, ve ebdilhu daren hajren min darih, ve ehlen hajren min ehlih, ve zevxhen hajren min zevxhah, ve edhilhul-xhennete ve eizhu min azabil-kabri ve min azabin-nar

(O Allah, fale, mëshiroje, jepi shpëtim dhe mëshirë këtij të vdekuri. Vendose në vend të rehatshëm dhe zgjeroja varrin. Laje me ujë, me borë e me breshër, e pastroje nga gjynahet, ashtu siç pastrohet roba e

³²⁵ Sipas medh’hebit Hanefi, namazi i xhenazes është *farzi-kifaje*.

*bardhë nga papastërtia. Zëvendësoja shtëpinë me më të mirë nga ajo që e ka, familjen me më të mirë se ajo që e ka, bashkëshorten me më të mirë se që e ka. Fute në xhennet dhe ruaje nga tmerri i varrit dhe dënimi i xhehenemit)".*³²⁶

Bile, Avf ibn Malik ka thënë:

"Kur e dëgjova këtë dua, dëshirova të jem unë ajo xhenaze."

Kush mbërrinë në tekbirin e dytë duhet të ketë me kujdes në mendje renditjen në namaz, dhe do të lexojë tekbiret bashkë me imamin, e kur imani të japë selam, do të kompenzojë tekbirin e lëshuar, siç bën kur vonohet në xhemat. Sikur të tentojë të thotë menjëherë tekbiret e lëshuara, atëherë rreshtimi i tij pas imamit në këtë namaz nuk do të ketë kuptim, sepse tekbiret janë pjesë të jashtme përbërëse të namazit të xhenazes, dhe është e përshtatshme të kenë pozitën që e kanë reqatet te namazet tjera.

Kjo sipas meje është më e pranueshmja, ani pse edhe kuptimet tjera janë të mundshme. Transmetimet që flasin për vlerën e namazit të xhenazes dhe përcjelljen e të vdekurit janë të njohura, prandaj nuk do

³²⁶ Musliimi.

ta zgjasim me përmendjen e tyre. Si të mos jetë vlera e tyre e lartë, kur ky është *farzi-kifaje*, e i bëhet i paobligueshëm atij që nuk i kërkohet drejtpërdrejtë pjesëmarrje, pasi marrin pjesë të tjerët. Me këtë arrijnë vlerën e obligimit kolektiv, edhe mos qoftë obligim i tij personal, sepse ata si bashkësi kanë kryer obligimin e bashkësisë dhe e kanë hequr gjynahun nga të tjerët.

Prandaj, namazi i xhenazes nuk mund të jetë si namazet tjera nafile me të cilat nuk hiqet kurrfarë obligimi nga të tjerët. Është e lavdërueshme të kërkohet grupim sa më i madh, që të arrihet bekimi me kujdes dhe dua të shumta, dhe që të përfshihen edhe ata të cilëve duatë u pranohen.

Kjo është sipas transmetimit të Kurejbit nga Ibn Abbas, ku thuhet që i ka vdekur djali, e ka thënë:

- *O Kurejb, shiko sa njerëz janë mbledhur?*,
dhe tregon:

“Dola, e shumë njerëz tashmë ishin mbledhur, e i tregova, dhe ai më tha:

- *Po thua se janë katërdhjetë?*

- *Po.*

- *Atëherë nxjerreni xhenazen jashtë, sepse e kam dëgjuar Resulallahun s.a.v.s., të thotë:*

‘Secili mysliman që vdes dhe xhenazen ia falin katërdhjetë njerëz, që nuk i përshkruajnë asgjë Allahut, Allahu Teala do të pranojë ndërmjetësimin (shëfat) e tyre për të’.³²⁷

Nëse e përcjellë xhenazen dhe arrinë te varrezat, ose hyn aty posaqërisht, do të thotë:

Es-selamu alejkum, ehle hazihid-dijari minel-mu’minine vel-muslimine, ve jerhamu-lahul-mustak-dimine minna vel-muste’hirine, ve inna in sha’allahu bikum lahikun

(Es-selamu alejkum, muminë e myslimanë që banoni në këto shtëpi, Allahu pastë rahmet mbi të parët dhe të mramët, e edhe ne, në dhashtë Allahu, do të ju bashkohemi).

Më mirë e ka mos të largohet para se i vdekuri të varroset, e pasi që varri të rrafshohet mbi të vdekurin, do të qëndrojë para tij e do të thotë:

Allahumme, abduke rudde ilejke, fer’ef bihi verhamhu. Allahumme xhafil-erda an xhenbejhi, veftah ebvabes-semai li ruhihi, ve tekabelhu minke bi kabulin hasen. Allahumme in kane mufsinen fe daif lehu fi ihsanihi, ve in kane musien fetexhavez anhu

³²⁷ Nga Ibn Abbas e shënon Muslimi.

(O Allah, robi Yt t'u kthye Ty, rahmetit Tënd, prandaj bëju i butë dhe i mëshirshëm ndaj tij. O Allah, zgjeroja varrin e tij, hapi dyert e qiellit për shpirtin e tij dhe pranoje në mënyrë të bukur. O Allah, nëse ka qenë person i mirësisë, dyfishoja shpërblimin, e nëse ka bërë gjynahe, falja gjynahet).

4. Tehijjetul-mesxhid (nderim xhamisë)

Dy apo më shumë reqate është sunnet *muekkede*, kështu që ky namaz falet bile edhe për xhuma, kur imami të mbajë hutben, ani pse është obligim i vërtetuar që ta dëgjojë imamin³²⁸. Nëse do të fillonte ndonjë namaz farz, ose falë kaza ndonjë namaz që e ka lëshuar, me këtë e ka falë edhe tehijjetul-mesxhid dhe e ka arritë shpërblimin për të, sepse qëllimi është që vet hyrja në xhami të mos kalojë pa ibadet që ndërlihet me xhaminë, që kështu të kryejmë obligimin që kemi ndaj saj. Për këtë arsye është e papëlqyer të hyhet në xhami pa abdes, e nëse hyn vetëm për zjaret ose ulet, le të thotë:

Subhanallah, vel-hamdu hilal, ve la ilahe ilallahu, vallahu ekber

(Lavdi Allahut, falënderim Allahut, nuk ka zot pos Allahut, Allahu është më i Madhi).

³²⁸ Sipas medh'hebit Hanefi, derisa hatibi i drejtohet xhematit, duhet të dëgjojë dhe nuk falet asnjë namaz.

Këtë do ta thotë katër herë. Thonë se këto fjalë e kanë vlerën sa të dy reqateve. Qëndrim i medh'hebit Shafi është se falja e *tehhijjetul-mesxhid* nuk është e papëlqyer bile as në kohët kur ndalohet namazi,³²⁹ pas ikindisë, pas namazit të sabahut, kur Dielli është në zenit, gjatë lindjes dhe perëndimit të Diellit, sipas transmetimit ku thuhet se Resulallahu s.a.v.s., i falte dy reqate pas ikindisë, dhe dikush e pyeti:

- *E pse neve na e ndalon?*;

e s.a.v.s., tha:

- ***Këto janë dy reqatet që i fali pas namazit të drekës, e sot në këtë më pengoi një delegacion.***³³⁰

Nga ky hadith mund të nxirren dy përfundime:

1) mospëlqimi është i kufizuar në namaz, dhe nuk ka arsye tjetër. Një nga arsyet më të dobëta, është falja kaza e nafiles, sepse dijetarët janë ndarë rreth çështjes se a munden nafilet të falen kaza, dhe nëse po, a llogaritet kjo kaza apo *nafile*.

³²⁹ Sipas medh'hebit Hanefi, *tehhijjetul-mesxhid* lejohet të falet në secillën kohë, përpos asaj kur ndalohet namazi.

³³⁰ Buhariu dhe Muslimi nga Ummu Seleme, e te Muslimi nga Ajshe r.anha, thuhet:

"I falte dy reqate para ikindisë, e në këtë rast e penguan..."

Nëse mospëlqimi largohet me arsyetimin edhe më të vogël, më e rëndësishme është që ai mospëlqim të largohet sapo të hyjë në xhami, sepse kjo është arsye e fortë. Prandaj në ato kohë nuk është i papëlqyer namazi i xhenazes, nëse ndodhë, as namazi me rastin e zënies së *Diellit (Kusuf)* dhe *Hënës (Husuf)* e as namazi për shiun, sepse ato janë me arsye;

2) Edhe namazet nafile mund të falen kaza, e Resulallahun s.a.v.s., e kemi shembullin më të mirë. Ajsha r.anha., thotë që Resulallahu s.a.v.s., kur nuk kishte gjumë ose ishte i sëmurë, e nuk bënte ibadet atë natë, sapo të fillonte dita, i falte nga dymbëdhjetë reqate.³³¹

Dijetarët thonë: *“Kush është në namaz nafile dhe nuk arrinë të përgjigjet në thirrjen e muezinit, kur jep selam, do ta kompenzojë dhe do t’i përgjigjet muezinit, edhe nëse muezini tashmë heshtë”,*

prandaj nuk ka vend për mendimin e atyre që thonë se kjo është falje e namazit që është i ngjashëm me namazin paraprak, e jo falja kaza e tij, sepse po të ishte ashtu, Resulallahu s.a.v.s., nuk do ta falte në kohë të papëlqyer për namaz. Natyrisht, kush ka vird, dhe në

³³¹ Shënon Muslimi.

ketë e pengon diçka, nuk do të duhej që t'i lejojë vetes që ta lëshojë, por do ta falë në kohë tjetër, që shpirti mos t'i anojë kah relaksimi e komforti.

Kjo është e pëlqyeshme si luftë ndaj veseve, si edhe për shkak që Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Ibadeti më i pëlqyer te Allahu është ibadeti i vazhdueshëm, sado pak që është”³³²,

me çka synohet mosndërprerja e vazhdimësisë së ndonjë ibadeti.

Ajsha r.anha., ka treguar se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Kush e braktis një ibadet që e ka bërë adet të vazhdueshëm për shkak dembelisë, Allahu Teala e urren!”³³³

Njeriu le të ketë kujdes e të mos bëhet cak i këtij kërcënimi. Duke analizuar transmetimin e kuptojmë që Allahu Teala e urren për shkak të braktisjes së ibadetit nga dembelia, e po të mos kishte njeriu urrejtje për ibadetin, nuk do të ndjente as dembeli.

³³² Buhariu dhe Muslimi, nga Ajsher.anha.

³³³ Ibnus-Sunni në *Rijadatul-mute’abbidin*, si fjalë të Ajshes r.anha.

5. Dy reقاتet pas abdesit

Këto janë të lavdërueshme, sepse abdesi është mënyrë e afrimit Allahut Teala, e qëllim e ka namazin, deri sa ajo që e prishë abdesin i kundërvihen kësaj. Mund të ndodh që ato të paraqiten para namazit, e kështu të prishet abdesi, e të humbet mudi. Ngutja për t'i falë dy reقاتe është plotësim i qëllimit të abdesit para se ai të prishet.

Kjo kuptohet nga hadithi i Bilallit, që tregon se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Hyra në xhennet dhe e pashë Bilallin aty. E pyeta:

- Si hyre në xhennet para meje?; e Bilalli më tha:

- Nuk di asgjë të posaçme, përpos që gjithmonë pas marrjes së abdesit i falja dy reقاتe.”³³⁴

6. Dy reقاتe për dalje dhe hyrje në shtëpi

(Tahijjetu'l-menzil)

Ebu Hurejre tregon se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Kur del nga shtëpia, fali dy reقاتe, që do të ndalojnë pasojat e këqija të daljes, e kur të hysh në shtëpi, fali dy reقاتe që do të ndalojnë pasojat e këqija të hyrjes.”³³⁵

³³⁴ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre.

³³⁵ Bejhaki në *'Shu'abu'l-Iman'* nga Bekr ibn Omer.

Me këtë mendohet në çfarëdo pune të rëndësishme që e bën, prandaj është thënë: *“Dy reqate për hyrje në ihram, dy reqate për nisje në rrugë, dy reqate për kthimin prej rrugës, në xhami, para se të hyjmë në shtëpi.*

Të gjitha këto transmetohet se i ka bërë Resulallahu s.a.v.s.. Bile, disa nga robët e mirë të Allahut, kur hanin diçka, do të falnin dy reqate, kur pinin, përsëri i falnin dy reqate, dhe kështu pas secilit veprim që e bënin. Fillimin e ndonjë pune duhet ta bekojmë me përmendjen e Allahut Teala, e kjo i ka tri shkallë:

a) punët që vazhdimisht përsëriten, si haja e pija, e këto fillojnë me *bismilah*. Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Secila punë e rëndësishme që nuk fillon me *Bismilahir-Rahmanir-Rahim* është e mangët!”³³⁶

b) veprat që nuk përsëriten shpesh, por janë të rëndësishme, siç janë martesja, fillimi për të këshilluar tjetrin ose konsultime me të tjerët e të ngjashme. Te këto është e lavdëruar (*mustehab*) të fillohet me falënderim Allahut Teala. Kështu, ai që po e marton vajzën do të thotë:

³³⁶ Ebu Davudi, Nesai, Ibn Maxhe, si edhe Ibn Hibban në **Sahihun** e tij nga Ebu Hurejre.

- ***Elhamdulillah ves-salatu ala Resulillahi sallallahu alejhi ve sellem*** (Falënderim Allahut e salavat Resulallahut s.a.v.s). Po ta jap vazhën time për grua; e dhëndri, apo dikush nga ana e dhëndrit, do të thotë:
- *Falënderim Allahut e salavat Resulallahut s.a.v.s.. Po e pranoj martesën.*

Ka qenë praktikë e as'habëve që te dhënia e porosisë, këshillimi i tjetrit dhe konsultimi me tjetrin, fillimisht të falënderojnë Allahun Teala;

c) punët që nuk ndodhin shpesh, por kur të ndodhin, janë të rëndësishme dhe zgjasin, siç janë udhëtimet, blerja e shtëpisë së re, hyrja në ihram, e të ngjashme. Është e lavdëruar që para këtyre veprimeve të falen dy reqate. Vepra më së paku e rëndësishme mes këtyre punëve është dalja dhe hyrja në shtëpi, sepse ky është një lloj udhëtimi i shkurtë.

7. Namazi istihare

Kush synon një punë e nuk ia di përfundimin dhe nuk e di a është mirë ta bëj a jo, atij Resulallahu s.a.v.s., i ka urdhëruar të falë dy reqate, në reqatin e parë të lexojë *Fatiha* dhe suren *Kafirun*, e në të dytën *Fatihane* dhe *Ihlas*. E kur të përfundojë, të lexojë këtë dua:

Allahumme inni estehiruke bi ilmike ve estakdiruke bi kudretike, ve es'eluke min fadlikel-adhimi fe inneke takdiru, ve la akdiru, ve ta'lemu, ve la ealemu ve ente allamul-gujub. Allahumme in kunte ta'lemu, ve la ealemu ve ente allamul-gujub. Allahumme in kunte ta'lemu enne hazel-emre hajrun li fi dini, ve dunjaje, ve akibeti emri, ve axhilihi ve axhilih fakdirhu li, ve barik li fih, summe jessirhu. Ve in kunte ta'lemu enne hazel-emre sherrun li fi dini, ve dunjaje, ve akibeti emri, ve axhilihi ve axhilihi fasrifni anhu, vasrifhu anni vakdur lijel-hajre ejnema kane. Inneke ala kuli shej'in kadir.

(“O Allah, duke u mbështetur tek dituria Jote, kërkoj të më japësh më të mirën dhe të më japësh forcë. Të lutem, më mëshiro me begatinë Tënde! Unë nuk di, por Ti di, unë nuk kam fuqi ndërsa Ti je i Plotfuqishëm. O Allah! Nëse puna që do të bëj do të jetë e hajrit për fenë, jetën time në këtë botë dhe të ardhmen time, të lutem caktoje dhe ma lehtëso, më dhuro begati! Nëse është e dëmshme dhe e padobishme për fenë, jetën time në këtë botë dhe të ardhmen time, largoje nga unë! Më jep më të mirën dhe më fal lumturi. Vërtetë Ti je i gjithëfuqishëm).

Duanë e tregon Xhabir ibn Abdullah, dhe thotë:

“Resulallahu s.a.v.s., na e mësonte istiharen për secilën punë, njëjtë siç na i mësonte suret e Kur’anit.”³³⁷

E vet Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Kur dikush nga ju mendon të bëjë një punë, le t’i falë dy reqate, pastaj le ta përmend atë punë dhe le ta lexojë duanë (që e treguam).”

E një i urtë ka thënë: *“Kush i ka katër, nuk mbetet pa katër:*

- kush është falënderues, nuk mbetet pa shtim;*
- kush pendohet nuk mbetet pa pranim;*
- kush falë istihare nuk mbetet pa zgjedhjen e duhur;*
- kush këshillohet nuk mbetet pa përgjegjen e duhur”*

8. Salat-ul-haxhet

Kush të jetë në vështirësi, dhe të ketë nevojë të madhe për diçka që e ka vështirë ta bëjë, në interes të fesë së tij ose jetës së kësaj bote, le ta falë namazin *salatul-haxhet*.

³³⁷ Hadithin për namazin istihare e shënon Buhariu nga Xhabiri, e Ahmed i thotë që është hadith *munker*.

Është treguar nga Vuhejb ibn el-Verda:

“Një nga duatë që nuk refuzohet është kur të falë dymbëdhjetë reqate, në secilin reqat të lexojë Fatihanë, Ajetul-kursijj dhe suren Ihlas, e kur të përfundojë, bjen në sexhde e thotë:

Subhaneledhi lebisel-izze ve kale bihi, subhaneledhi teattafe bil-mexhdi ve tekerreme bihi, subhaneledhi ahsa kule shej'in bi ilmih. Subhaneledhi la jenbegit-tesbihu ila lehu. Subhane dhil-menni vel-fadli, subhane dhil-izzi vel-keremi, subhane zit-tavli. Es'eluke bi meakidil-izzi min arshike, ve munteher-rahmeti min kitabike, ve bismikel-adham, ve dheddikel-e'ala, ve kelimatiket-tamatil-amatilleti la juxhavidhuhunne berrun, ve la faxhirun en tusallije ala Muhammedin, ve ala ali Mhammed

(Lavdi Atij i Cili është plot dinjitet dhe ashtu flet, lavdi Atij i Cili është plot nder dhe ashtu nderon, lavdi Atij i Cili gjithçka e ka të përfshirë në diturinë e Tij. Lavdi Atij, të Vetmit që meriton lavdi. Lavdi Atij i Cili posedon dhunti e mirësi, lavdi Atij i Cili posedon forcën. Të lutem në harqet e dinjitetit të Arshit Tënd, me majat e rahmetit të librit Tënd, me Emrin Tënd më të madh, me madhështinë Tënde të lartësuar dhe me fjalët e Tua të plota e gjithëpërfshirëse, të cilat nuk i kalon as

*gjynahqari as mirëbërësi, që ta bekosh Muhammedin dhe familjen e Muhammedit).*³³⁸

Pastaj bën lutje, të pastër nga gjynahet, e në dashtë Allahu, i plotësohet. Bile, Vuhejbi tregon: *“I dëgjonim duke thënë:*

- Mos ju mësoni këtë dua atyre me nijet të keq, sepse e keqpërdorin.”

9. Salatut-tesbih

Ky namaz është përcjellë tradicionalisht. Nuk ndërlihet me kohë të caktuar e as me shkaktar. Është e lavdërueshme të falet një herë në javë, ose një herë në muaj. Ikrime tregon nga Ibn Abbasi r.a., që Resulallahu s.a.v.s., i tha Abbas ibn Abdul-Muttalibit:

“Xhaxha, a të mësoj diçka që të kesh dhjetë dobi? Nëse e bën, Allahu të falë dhjetë lloj mëkatesh, të parin a të fundit, të vjetër a të ri, të madh a të vogël, bërë me dëshirë a pa të, fshehur a haptas? Fali katër reqate, e në secilin lexo Fatihanë dhe një sure. Kur e përfundon leximin në reqatin e parë, sa je në këmbë thuaj:

³³⁸ Ebu Mensur Dejlëmi në *‘Musnedu’l Firdevs’*, nga Ibn Mesudi.

Subhanallah, vel-hamdu lilah, ve la ilahe ilallah, vallahu ekber (Lavdi Allahut, falënderimet Allahut, nuk ka zot pos Allahut, Allahu është madhështori), pesëmbëdhjetë herë, pastaj bëj rukunë e në ruku thuaje dhjetë herë, ngritu nga rukuja e në këmbë thuaje dhjetë herë, bëj sexhde e thuaje në sexhde dhjetë herë, ngritu nga sexhdeja e sa je ulur thuaje dhjetë herë, prapë bëj sexhde e në sexhde thuaje dhjetë herë, ngritu nga sexhdeja dhe thuaje dhjetë herë, dhe kjo do të jetë 75 herë, dhe kështu në secilin reقات.

Nëse mund ta falësh këtë namaz një herë në ditë, fale, e nëse jo, bile një herë në javë, nëse as këtë nuk e bën, bile një herë në muaj, e nëse as këtë nuk e bën, së paku bëje një herë në vit.”³³⁹

Në transmetim tjetër thuhet se para namazit lexon:

Subhanekeallahumme ve bi hamdike, ve tebarekesmuke, ve teala xhedduke, ve tekaddeset esmauke, ve la ilahe gajruke

(Lavdi të qoftë ty, o Allah, dhe falenderimet Ty. I bekuar është emri Yt dhe e lartësuar është madhështia Jote, të pacenueshëm janë emrat e Tu dhe nuk ka zot pos Teje),

³³⁹ Hadithin për *salatul-tesbih* është përmendur më herët.

pas së cilës duhet lexuar pesëmbëdhjetë tesbihë para leximit të Kur'anit, e dhjetë pas leximit, e tjerat janë siç u tha këtu, nga dhjetë herë. Nuk do të bëj tesbih kur të ulet pas sexhdes së fundit. Kjo është mënyra më e mirë, dhe është preferimi edhe i Ibn Mubarekit. Në të dy transmetimet ka treqind tesbihë. Nëse i falë ditën, do t'i falë me një selam, e nëse i falë natën, atëherë është më mirë t'i falë me nga dy selame, sepse është treguar se namazi i natës falet me nga dy reqate.³⁴⁰

Nëse pas tesbihut i shton edhe fjalët:

La havle ve la kuvvete ila bilahil-aliijil-adhim

kjo është më e bukur, sepse edhe kjo na është treguar në transmetime.

Këto janë namazet e përcjella me traditë. Nuk është e lavdëruar të falet asnjëri prej tyre në kohët kur është ndaluar të falet namaz, përpos *tehijjetul-mesxhid*³⁴¹.

Namazet tjera të përmendura pas *tehijjetul-mesxhid*, siç janë dy reqate pas abdesit, namazi para nisjes për rrugë, namazi kur del prej shtëpisë, si edhe namazi *istihare*, nuk duhet falur në atë kohë, sepse sebepi i tyre është i dobët, ndërsa koha e ndaluar për namazin është

³⁴⁰ Buhariu dhe Muslimi, nga Ibn Omeri.

³⁴¹ Si pas medh'hebit Hanefi, as *tehijjetul-mesxhid*.

sebeq i fortë, e këto nuk janë në nivelin e namazit *husuf*, *kusuf*, *istiska* dhe *tehijjetul-mesxhid*.

I kam parë bile disa sufi se si në kohët kur namazi është i ndaluar falin dy reقاتet pas marrjes së abdesit, që është plotësisht gabim, sepse nuk është abdesi shkak për namaz, por se namazi është shkak për abdesin, prandaj edhe merr abdes për të falë namaz, e jo që falë namaz për shkak se ka marrë abdes. Secili që është pa abdes, e dëshiron të falë namaz në kohën kur kjo është e ndaluar, nuk ka tjetër mënyrë pos të marrë abdes e të falë namazin farz, dhe atëherë ky mospëlqim nuk ka bazë. Nuk duhet bërë nijet dy reقاتe pas abdesit, siç i bën nijet dy reقاتe të *tehijjetul-mesxhid*, por kur të merr abdes, le t'i falë dy reقاتe vullnetarisht, që abdesi të mos i mbetet i papërdorur, siç bënte edhe Bilali. Kjo është plotësisht vullnetare, pas marrjes së abdesit. Hadithi i Bilalit nuk tregon se abdesi është arsye e veçantë, siç janë *husuf*, *kusuf* dhe *tehijjetul-mesxhid*, e që ky të duhet të bëj nijet dy reقاتet pas abdesit, sepse është absurde që me namaz të bëj nijet abdesin, por është e domosdoshme që me abdes të bëj nijet namazin. Si të harmonizohet kjo, nëse në abdes thotë:

- *Po marr abdes për namaz; e në namaz thotë:*

- *Po fali namaz për abdesin?*

Ai që dëshiron që ta ruajë abdesin e të mos i mbetet i papërdorur në kohën kur është e ndaluar të falet namaz, le ta bëj nijet për kaza, nëse ka borxh, sepse në kohën e ndaluar namazi kaza lejohet. Por namazet nafile nuk falen. E ndalesa e faljes së namazit në kohë të caktuar i ka tri arsye të rëndësishme;

Arsyeja e parë është që të largohet nga përngjasimi me ata që e adhurojnë Diellin.

Arsyeja e dytë është ruajtja prej përhapjes së shejtanit, sepse Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Briret e shejtanit dalin bashkë me Diellin, e kur dielli ngritet, ai largohet. Kur Dielli vjen në zenit, shejtani përsëri vjen, e kur Dielli e kalon gjysmën e qiellit, largohet. Kur Dielli i afrohet perëndimit, shejtani prapë vjen, dhe kur Dielli perëndon, prapë largohet.”³⁴²

Këto janë kohët e treguara në hadith kur dhe pse ndalohet namazi,; dhe

Arsyeja e tretë është se, udhëtarët e ahiretit bëjnë ibadet vazhdimisht, në të gjitha kohët. E bërja e vazhdueshme e vetëm një ibadeti shkakton mërzitje, dhe kur ato ndalohen për një kohë, rritet aktiviteti dhe motivimi.

³⁴² Nesai nga Abdullah Sunabihi.

Në të njëjtën kohë, pasi që njeriu anon kah e ndaluara, ai dëshiron sa më shpejt të kalojë kjo kohë dhe të fillojë namazin, prandaj në to duhet vetëm të lavdërojë Allahun Teala dhe të kërkojë fallje nga Ai, duke i ikur mundësisë për mërzitje për shkak të faljes së vazhdueshme të namazit, dhe duke kërkuar lehtësi me kalimin nga një lloj i ibadetit në tjetrin.

Ka kënaqësi dhe angazhim në bërjen e një veprimi të ri, si edhe në rifillimin e bërjes, siç ka edhe vështirësi e lodhje në praktikimin e vazhdueshëm të diçkaje.

Prandaj namazet nuk janë vetëm sexhde, as vetëm ruku, as vetëm qëndrim në këmbë, por se ibadetet përbëhen nga veprime e lexime të ndryshme, sepse kështu zemra fiton kënaqësi, duke kaluar nga një aktivitet te tjetri. Po të preokupohej vetëm me një aktivitet, shpejt do të mërzitej.

Këto ishin vërejtje të rëndësishme për mospërdorimin e kohës kur namazi është i papëlqyer, bashkë me arsyet tjera që njeriu nuk mund t'i njohë, ndërsa Allahu dhe Resulallahu s.a.v.s., i dinë më së miri.

Këto arsye të rëndësishme nuk bën të injorohen, përpos për arsye më të rëndësishme me shariat, siç është namazi kaza, namazi për shi, (*istiska*) namazi me rastin e zënies së Diellit (*Kusuf*) dhe Hënës (*Husuf*) si edhe *tehijjetul-mesxhid*.

Të tjerat, që janë të kategorive më të ulëta, nuk do të duhej të falen në kohën e ndaluar. Kjo, sipas nesh, është më e pranueshmja, e Allahu e di më së miri.

Me kaq përfundon *Libri për fshehtësitë e namazit*. Me ndihmën dhe me udhëzimin e Allahut, pason *Libri për fshehtësitë e zeqatit*.

Hamd (Falënderimi) i takon vetëm Allahut, salat dhe selam krijesës më të hairit, Muhammedit a.s., si edhe ehli-bejtit dhe as'habëve të tij të ndershëm e të pastër.

F U N D

SHPJEGIM NGA PËRKTHYESI
sipas medh'hebit Hanefi

Namazet ndahen në tri lloje:

Namazet farz (të domosdoshme), e që janë:

Pesë kohët ditore, namazi i Xhumasë dhe namazi i xhenazes (që është farzi kifaje);

Namazet vaxhib (të obliguara), e që janë:

Vitër namazi dhe namazet e bajrameve; dhe

Namazet nafilë (vullnetare), e që janë:

Sunnetet e pesë kohëve të namazit, namazi i travisë, namazi *tehexhud*, *tehijetul-mesxhid*, namazi *duha*, namazi *evvabin*, namazi *istihare*, *tesbih* namazi, namazi për shi (*istiska*), dhe namazi me rastin e zënies së Diellit (*Kusuf*) e Hënës (*Husuf*).

Secili namaz ka 12 farze. Këto ndahen në dy grupe:

1. Farzet e jashtme

që quhen edhe *kushtet e namazit*, për shkak se vijnë para namazit dhe përbëjnë përgatitjen në namaz; dhe

2. Farzet e brendshme

që quhen *ruknet e namazit*, pasi që përbëjnë esencën e namazit.

***Farzet e jashtme* (kushte) të namazit**

1. *Pastrimi prej hadesit*, marrja abdes ose gusul.
Nëse nuk ka mundësi për këto dy të parat, merr tejmum.
2. *Pastrimi prej nexhasetit*.
3. Pastrimi i tërë trupit, rrobave dhe vendit ku falemi.
4. *Setr-i avrat*, veshja/mbulimi sipas rregullit.
5. *Istikbal-i kible*, kthimi kah Kibla kur falemi.
6. Koha: Të falurit në kohën e duhur.
7. Nijeti: Bërja nijet se cili vakt i namazit po falet.

***Farzet e brendshme* (rukne) të namazit**

1. *Iftitahi tekbir* (tekbiri fillestar). Namazi fillohet duke thënë *Allahu Ekber*.
2. *Kijam*: Qëndrimi në këmbë.
3. *Kiraet*: Leximi i Kur'anit në namaz.
4. *Ruku*: Përkulja në namaz.
5. *Sexhde*: të biesh me fytyrë në tokë pas rukusë.
6. *Kade-i ahire*: Ulja e fundit.

Të gjithë këta faktorë së bashku përbëjnë namazin. Nëse vetëm një prej farzeve të namazit mungon, namazi nuk është i drejtë.

Vaxhibet e namazit

1. Të lexohet sureja *Fatiha*.
2. Pas *Fatihës*, të lexohet një sure, një ajet më i gjatë apo tri ajete më të shkurta.
3. Sureja pas *Fatihës* lexohet në rekatën e parë e të dytë të farzeve dhe në çdo rekat të sunneteve.
4. Në sexhde, i vë hundën dhe ballin në Tokë, bashkë me shuplakat dhe gjunjët,
5. Ulja (*teshehud*) pas rekatit të dytë të namazeve tre dhe katër rekatësh dhe leximi i dy *ettehijjatu*.
6. Përshtatja pjesëve përbërëse të namazit, dhe qetësia në ruku, sexhde, në qëndrim këmbë pas rukusë dhe në uljen në mes të dy sexhdeve.
7. Në fund të namazit të thuash: ***Esselamu alejkum ve rahmetullah*** (salami në të djathtë e në të majtë).
8. Duaja e Kunutit pas rekatit të tretë të vitër-namazit.
9. Tekbiret shtesë në namazet e bajrameve.
10. Leximi me zë nga imami në sabah dhe në dy reقاتet e para të akshamit dhe jacisë, bile edhe kur falet *kadha* (kompensim), si edhe në xhuma, bajrame, taravi dhe në namazin vitri në ramazan.
11. Të lexuarit e imamit pa zë dhe të atij që falet vetëm në farzet e drekës dhe ikindisë, në rekatën e tretë të akshamit dhe në rekatën e tretë e të katërt të jacisë.

12. Natën e kurban bajramit nga namazi i sabahut e deri në namazin e ikindisë të ditës së katërt, pas njëzet e tri namazeve farz të këndohet tekbiri:

Allahu ekber, Allahu ekber, la ilâhe il-lall-llah, vall-llahu ekber, Allahu ekber ve lil-lahi-l-hamd.

Nëse harrohet një vaxhib, kjo nuk e prishin namazin, por duhet të bëjë *sehvi sexhde* (*sexhde përmirësuese*).

Sunnetet e namazit

1. Ngritja e duarve në tekbirin fillestar deri tek lapa e veshit për mashkullin, deri te supet për femra. Duart nuk ngrihen me në tekbiret tjera.
2. Mashkulli vendos dorën e djathtë mbi të majtën nën kërthizë, e gruaja duart t'i vendosë në gjoks.
3. Të lexohet *subhaneke* pas tekbirit, *eudhubil-lahi* dhe *bismilah* në heshtje.
4. Pas Fatijasë të thuash *Amin*, të marrësh tekbir para rucusë, të kapen gjunjët me shuplakë gjatë rucusë, zgjerimi i gishtave, drejtimi i këmbëve, shpinës, qafës dhe kokës, për sexhde të marrësh tekbir, në mes të dy sexhdeve të ulesh në këmbën e majtë, e të drejtosh të djathtën duke i kthyer gishtat e saj kah kibra.
5. Të thuhet tri herë ***subhane rabbije-l-adhim***.
6. Të thuhet tri herë ***subhane rabbije-l-a'la***.

7. Të thuash ***semiallahu limen hamideh*** kur ngrihesh nga rukuja, dhe ***rabbena lekel hamd*** kur të drejtohem në këmbë pasi të ngrihem nga rukuja.
8. Në uljen e fundit, të dërgohen salavat pas ***teshehhudit***, të lexohet dua pas salavatit dhe të kthehet fytyra në anën e djathtë të selami i parë dhe në anën e majtë të i dyti (të shikosh në të dy supet).
9. Rënia në sexhde me shtatë gjymtyrë; me ballë, dy duart, gjunjët dhe këmbët. Gishtat e këmbës kthehen kah kibla. Burri e largon barkun e tij nga kofshët kur është në sexhde, ndërsa femra e bashkon. Ai gjithashtu i zgjeron dy bërrylat e tij në mënyrë të lirë, për dallim nga femra. Femra i vendosë ata në tokë përgjatë sexhdes. Nëse lihen sunnetet, kjo nuk e prishë namazin e as nuk e obligojnë ***sehvi sexhden***, por është veprim i keq.

Mustehabet (të pëlqyerat) e namazit

1. Të nxjerrësh shuplakat e duarve nga mëngët e rrobave para se të marrë tekbinin.
2. Kur fal namaz, të shikosh në vendin ku bën sexhde.
3. Kur shkon në ruku të vështros këmbët.
4. Në sexhde shikon në vendin ku do të vësh hundën.
5. Kur ulesh në tehiat të shikosh mbi gjunjë.

6. Ajetet që lexohen në namazet e sabahut dhe të drekës, të jenë më të gjata, në namazin e akshamit të jenë më të shkurtëra.
7. Kur të arrish në sexhde, të vësh në tokë së pari gjurin e djathtë e pastaj të majtin.
8. Sexhdenë ta bësh ndërmjet dy duarve.
9. Në sexhde, pas hundës të vësh ballin.
10. Nëse gogësin gjatë namazit, të mbyllësh gojën me anën e sipërme të dorës.
11. Në ruku dhe sexhde duhet të qëndrosh aq sa të mund të shqiptohet tri herë **tesbihu**.
12. Ngritë kokën nga sexhdeja duke thënë **Allahu ekber**.
13. Pasi ta ngresh kokën nga sexhdeja, i ngritë duart, e pastaj gjunjët.

Rekomandohet që pasi ta ketë kryer namazin, të bëj dhikrin dhe lutjet që i ka preferuar Resulallahu s.a.v.s..

Gjërat që e prishin namazin

1. Të kollitesh pa nevojë apo të dëlirësh fytin.
2. Kur teshtin tjetri të thotë ***Jerhamukallah***.
3. Ai që falë vetëm namazin, nëse e ndien se imami që fal me xhemat në anën tjetër ka gabuar duke lexuar dhe nëse ia tërheq vërejtjen, e prish namazin. Nëse edhe imami lexon duke u pajtuar me vërejtjen e këtij personi, edhe namazi i imamit priset.
4. Nëse në namaz thotë ***La ilahe il-lall-llah***. Por, nëse është që të tregojë qëllimin, namazi nuk priset.
5. Zbulimi i pjesëve të turpshme të trupit (avretit).
6. Të qash për shkak të dhembjes ose për shkak të ndonjë problemi tjetër. E nëse qan për shkak se përmendet xhenneti dhe xhehenemi, ose duke i menduar ato, namazi nuk priset.
7. Të japësh selam me gjuhë dhe me dorë.
8. Të hash e të pishë diçka në namaz.
9. Të flasësh në namaz.
10. Të përmirësosh gabimet e tjetrit pas imamit.
11. Të qeshësh me zë në namaz.
12. Të teshtish e të bësh “ah” në namaz.
13. Lëvizje e madhe apo tri lëvizje e më shumë, pa nevojë. Këtu hyn edhe largimi i tërësishëm i gjoksit prej anës së kibles.

14. Leximi gabimisht i tekbitit dhe Kuranit derisa i humb kuptimi.
15. Qëndrimi apo bërja sexhde mbi një papastërti.
16. Prishja e abdesit.
17. Falja e burrit përkrah femrës moshë-rritur ose pas saj në namazin e përbashkët në një vend, pa ndonjë pengesë në mes.

Mekruhet (të papëlqyerat) **e namazit**

Këto janë ato gabime që dëmtojnë namazin, mirëpo nuk e prishin saktësinë e tij:

1. Të falesh me xhaketën mbi supe, pa e veshur.
2. Të ngrehësh rrobat duke rënë në sexhde.
3. Të hysh në namaz me mëngë të përveshura.
4. Të bësh lëvizje të panevojshme.
5. Të falesh me tesha të punës dhe me tesha me të cilat nuk mund të dalësh para të mëdhenjve.
6. Të vësh në gojë diçka që nuk të pengon në lexim. Nëse vë në gojë diçka që të pengon, e prish namazin.
7. Të falësh namaz me kokë të pambuluar.
8. Të hysh në namaz duke u munduar në mbajtjen e nevojës së madhe e të vogël.
9. Gjatë namazit, të fshish me dorë dheun apo gurin te vendi i sexhdes.
10. Kur je në namaz, pra i lidhur në namaz, të kërcasësh gishtat.

11. Në namaz të vësh duart kryqas.
12. Të lëvizësh kokën dhe fytyrën anash, të shikosh me sy anash.
13. Të ulesh në bisht (si qen) në **teshehudd** (ndjenja e parë dhe e fundit në namaz).
14. Meshkujt, t'i shtrijnë krahët në namaz.
15. Të falesh përballë shpinës së atyre që flasin me zë të lartë dhe përballë fytyrës së një njeriu.
16. T'i përgjigjesh selamit të dikujtë me dorë, me kokë.
17. Të gogësisht në namaz dhe jashtë namazit.
18. Të mbulosh sytë në namaz.
19. Të falesh me rroba në të cila ka fotografi të qenieve të gjalla .
20. Varja e fotografisë së gjallë apo të vizatuar në mur në anën e djathtë, të majtë dhe përpara atij që falë namaz, ose e punuar në beze, në letër. Edhe fotografia e kryqit është si fotografia e gjallë.
21. Të falësh namaz përballë zjarrit me flakë.
22. Të numrosh me dorë ajetet, tespihet në namaz.
23. Të falesh i mbështjellë në një rrobë fund e krye.
24. Të falesh duke mbuluar gojën dhe hundën.
25. Të pështysh nga fyti pa detyrim.
26. Të lëvizësh dorën një - dy herë.
27. Të braktisësh një nga sunnetet e namazit.
28. Të fillosh namazin kur e ke fëmijën në prehër, pa detyrim.

29. Të falësh pranë gjërave që të preokupojnë zemrën, që të ngazëllesh, për shembull, përballë gjërave të dekoruara, pranë muzikës, lojës dhe përballë gjellës që e dëshiron shumë.
30. Të mbështetesh në mur a në shtyllë, pa nevojë të arsyeshme, kur fal farzin.
31. Të falësh namaz në vendet që mund të jenë të papastra.
32. Të falësh namaz përballë varrit.
33. Në rekatin e dytë të këndosh tre ajete më gjatë se në rekatin e parë.

***Mekruhet* (të papëlqyerat) jashtë namazit**

1. Të kthehesh para ose prapa kibles në nevojtoare dhe në çdo vend duke e prishur abdestin dhe duke u pastruar (pas kryerjes së nevojës së madhe e të vogël).
2. Të prishësh abdesin i drejtuar Diellit e Hënës.
3. Të mbahet fëmija kah kibla për të kryer nevojën.
4. Të shtrish njërin apo të dyja këmbët drejt kiblës, përpos kur detyrohesh.
5. T'i shtrish këmbët nga mus-afi ose nga librat fetarë. Nëse janë të vendosura lartë, nuk është mekruh.

Namazi i Xhumasë

Pasi thirret ezani, i cili lajmëron hyrjen e kohës së xhumasë, ngrihemi dhe falim 4 rekate sunet të xhumasë, të cilat falen si suneti i drekës. Pas kësaj, myezini thërret edhe një ezan brenda në xhami, pas të cilit imami (hatibi) mban hytben (ligjërimin dhe këshillat, që ka për xhematin). Me përfundimin e hytbes nga ana e imamit, myezini ngrihet në këmbë, bën ikametin dhe më pas falen dy rekat farz të xhumasë me xhemat, pra me imam dhe në të njëjtën mënyrë, si farzi i sabahut.

Namazi i xhumasë është farz për atë që plotëson këto kushte:

- Të jetë mashkull, pasi xhumaja nuk është obligim për femrat. Por, nëse ato dëshirojnë të marrin pjesë në namazin e xhumasë, janë të lira ta falin këtë namaz.

- Të jetë i lirë, sepse namazi i xhumasë nuk është obligim për të burgosurit ose robërit dhe për të gjithë ata që janë në pozita të ngjashme me ta;

- Të mos jetë udhëtar (mysafir);

- Të mos ketë sëmundje e cila do të përkeqësohet nëse personi shkon në namazin e xhumasë. Të mos jetë i verbër ose i gjymtuar nga këmbët.

- Të ketë më tepër se tre persona, përveç imamit;

- Të falet në xhaminë kryesore dhe nga ana e udhëheqësit të myslimanëve, ose nga dikush që emërohet prej udhëheqësit.

Namazi i Bajramit

Së pari bëhet nijeti. Imami bën tekbinin fillestar, të cilin e bëjmë edhe ne pas tij. Pastaj lidhen duart dhe lexohet *Subhaneke*. Pas kësaj, të udhëhequr nga imami, bëhen edhe tre tekbiere, duke i ngritur duart te veshi, si në tekbinin fillestar. Në dy tekbiert e para duart i mbajmë të lëshuara anash e në të tretin lidhen nën kërthizë. Më pas imami lexon me zë Fatihanë dhe një sure. Pas përfundimit të leximit shqipton tekbinin "*Allahu ekber*" dhe bashkërisht përkulemi në ruku, pastaj biem në sexhde.

Në rekatin e dytë, imami së pari lexon Fatihanë dhe një sure. Pastaj duke marrë tre tekbiere radhazi, duart ngrihen te veshët duke i lëshuar anash pas çdo tekbiere. Në tekbinin e katërt, pa i ngritur duart te veshët, përkulemi në ruku. Pastaj biem në sexhde dhe lexojmë *Ettehijatun*, salavatet, duatë dhe japim selam.

Pas namazit, muezini bën tekbiert e teshrikut, ndërsa imami hipën në hutbe. Pas përfundimit të hytbes, imami kthehet në mihrab, ku lexon duanë, e me këtë përfundon namazi i Bajramit.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE.....	3
RRETH VLERAVE TË LARTA (FAZILET) TË EZANIT, NAMAZIT, SEXHDES, XHEMATIT DHE PJESËVE TJERA.....	5
VEPRIMET E JASHTME NË NAMAZ, FILLIMI ME TEK BIR DHE ÇKA I PARAPRINË.....	33
KUSHTET E BRENDSHME TË VEPRIMEVE TË ZEMRËS ...	65
DETYRAT E IMAMIT NË NAMAZ DHE ÇËSHTJET PAS SELAMIT	131
VLERAT E LARTA (FAZILET), RREGULLAT E SJELLJES (ADABI), SUNNETET DHE KUSHTET E XHUMASË.....	151
ÇËSHTJE TË PËRGJITHSHME NË LIDHJE ME NAMAZIN QË SECILI KA NEVOJË T’I DIJË.....	199
NAMAZET NAFILE.....	217
SHPJEGIM NGA PËRKTHYESI	287

